Tematika e këtij punimi është përafrimi i politikave bujqësore të Kosovës me ato të BE-së. Fillimisht do të analizohet esenca e politikave bujqësore, ajo se çka përfshijnë politikat bujqësore në mënyrë të përgjithshme. Pastaj zhvillimi rural dhe integrimi i Kosovës në BE do të jetë objekt hulumtimi. Politika e përbashkët bujqësore (PPB) e BE-së, rëndësia e kësaj politike për Kosovën, Procesi i përafrimit të politikave bujqësore të Kosovës me ato të BE-së veçanërisht nga aspekti legjislativ, Krahasimi i Kosovës me vendet kandidatë të BE-së do të jenë çështjet tjera që do të trajtohen brenda kornizave të këtij punimi. Prandaj qëllimi kryesor i këtij punimi është ofrimi i njohurive bazike lidhur me tematikën e shtjelluar si dhe dhënia e konkluzioneve në formë të përfundimit në fund të punimit lidhur me këtë

¹⁴ Bujqësia e Ballkanit Perëndimor dhe Integrimet Evropiane, Fakultet za zemjodelski nauki i hrana, Shkup 2008, faq.4.

tematikë. E gjithë punimi është ndërtuar përmes të dhënave sekondare të mledhura nga materiale të ndryshme, që janë të lidhura me fjalët kyçe të këtij punimi.

Vështrim i përgjithshëm mbi politikat bujqësore

Zhvillimi rural është proces në të cilin njerëzit në viset rurale (individët, amvisëritë, komuniteti, fermerët etj.) i bashkojnë resurset e tyre për të përmirësuar kushtet jetësore dhe të punës. Përmes përmirësimit dhe rritjes së shkathtësive të tyre, ata synojnë të rrisin kapacitetet e përgjithshme individuale dhe të organizatave të tyre komunitare, për të përmirësuar të ardhurat e tyre, shëndetin, edukimin, infrastrukturën dhe shërbimet tjera sociale. Së fundi, banorëve të zonave rurale u jipet mundësia që të kontribuojnë për lirinë civile, të menaxhojnë vet zhvillimin e tyre, me marrëdhënie të balancuara gjinore dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të ambienteve rurale.¹⁵ Politikat bujqësore përcaktojnë objektivat, masat dhe programimin e zhvillimit bujqësor dhe rural, të shërbimeve publike bujqësore, të kërkimit dhe trajnimit profesional, si dhe bazën e të dhënave dhe informacionin për politikat në sektorët e bujqësisë dhe të zhvillimit rural. Në përgjithësi objektivat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural synojnë:

- Në rritjen e të ardhurave për popullsinë rurale, duke rritur mirëqenien e saj, nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës dhe të jetesës, si dhe duke krijuar mundësi të barabarta për burrat dhe gratë;

¹⁵ Instituti RIINVEST, Zhvillimi Rural në Kosovë (Raport Hulumtues), 2004, faq.9.

- Në rritjen e prodhimit nëpërmjet nxitjes së konkurrueshmërisë dhe të progresit teknik, si dhe garantimit të një përdorimi optimal të faktorëve të prodhimit dhe në veçanti të punës;
- Në stabilitetin e tregut, duke garantuar qëndrueshmëri në prodhimin bujqësor;
- Në cilësinë dhe sigurinë ushqimore, duke garantuar që zinxhiri ushqimor të ketë një cilësi të qëndrueshme dhe të mos shkaktojë pasoja të dëmshme në shëndetin e njerëzve;
- Në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, duke garantuar që bujqësia të ruajë burimet natyrore;
- Në uljen e varfërisë, në zvogëlimin e pabarazive ndërmjet niveleve të zhvillimit të rajoneve të ndryshme, si edhe të prapambetjes së zonave rurale, më pak të favorizuara, duke zhvilluar veprimtari alternative dhe plotësuese, që gjenerojnë punësim, me synim ngadalësimin e largimit të popullsisë nga fshatrat, si dhe duke fuqizuar biznesin e vogël dhe të mesëm.¹⁶

Bujqësia, zhvillimi rural dhe integrimi në BE

Në kuadër të procesit të integritimit evropian kemi dy elemente të rëndësishme të veçantë për sektorin e zhvillimit rural dhe të bujqësisë:

1. “Aspektet ekonomike – gjendja e vendeve në bazë të kriterit ekonomik për anëtarësim, si dhe”
2. Standardet e komunitetit – kapaciteti i vendit për të zbatuar dispozitat ligjore dhe administrative të komunitetit në fushat e zhvillimit rural dhe bujqësisë.” Një numër i madh i normave të detyrueshme dhe rregullave

¹⁶ Politikat bujqësore, qasur në <http://shtetiweb.org/politikat-bujqesore>, më 15.03.2015.

drejtpërdrejtë të zbatueshme për vendet anëtare përbëjnë kapitullin për bujqësinë. Përdorimi i duhur dhe zbatimi efektiv i tyre nga një administratë publike efikase është shumë i rëndësishëm për funksionimin e Politikës së Përbashkët të Bujqësisë (PPB). Në mënyrë që të zbatojnë në mënyrë efektive PPB, shtetet duhet të forcojnë kapacitetet e tyre dhe strukturat administrative. Për shtetet kandidate potenciale, mbështetja për miratimin shkallë-shkallë të standardeve të BE është prioritet kyç për ndihmën në ndërtimin e institucioneve. Në fushën e ZhRB, mund të theksohen prioritetet kyçe në vijim:

- “Forcimi i kapacitetit administrativ i administratave bujqësore, në veçanti në fushën e formulimit të politikave bujqësore, analizimit, zbatimit dhe kontrollit.
- Ndërtimin e kapacitetit administrativ për zbatimin në të ardhmen të masave të para-anëtarësimit për zhvillim rural (IPAZhr).”

Për vendet kandidate, përqendrimi kryesor është në përafrimin legjislativ dhe ndërtimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e *acquis communautaire* që përbën PPB. Zbatimi, menaxhimi dhe kontrolli i PPB kërkon krijimin, ndryshimin dhe/ose përforcimin e strukturave të duhura administrative. Ajo çfarë kërkohet shprehimisht është themelimi i një **komiteti monitorues** për vlerësimin e efikasitetit dhe cilësisë së zbatimit të programeve për zhvillim rural. Lista e lartcekur e kërkesave institucionale të BE nuk është gjithëpërfshirëse. Megjithatë informata shtesë dhe më të hollësishme janë në dispozicion në dokumentin e quajtur “Udhëzim për strukturat kryesore administrative që nevojiten për zbatimin e së *acquis communautaire*”

Nuk ekziston asnjë udhëzim apo rregullore e vetme që përshkruan kërkesat e përgjithshme statistikore përkitazi me sektorin e bujqësisë për shtetet anëtare të BE. Këto lloje të kërkesave gjenden në rregulloret e

veçanta dhe udhëzimet për zbatimin e organizatave të tregut të përbashkët, skemat e zhvillimit rural, rregulloret financiare, etj (statistikat për eksportet/importet, prodhimin e mallrave, strukturat e fermave bujqësore, të ardhurat e bujqve, pagesat e subvencioneve, numri i kërkesave, etj).¹⁷

Politika e Përbashkët Bujqësore e BE-së

Bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik në shumicën e zonave rurale të BE-së. Megjithatë, shumë bujq kryejnë aktivitete plotësuese, siç janë përpunimi i ushqimit dhe sigurimi i akomodimit për turistët. Kjo shumëllojshmëri e ekonomisë rurale është burim i i fuqisë të cilën BE-ja e mbështet dhe e inkurajon përmes programeve të veta të zhvillimit rural. Rreth gjysma e popullatës së BE-së jeton në zona rurale. Pa bujqësinë nuk do të kishte mundësi të ekzistojnë shumë komunitete dhe të mbahen së bashku. Nëse bujqësia do të zhdukej, në shumë zona do të shfaqej problemi i braktisjes së tokës.¹⁸

Për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, rëndësi të veçantë kanë dy elemente:

Aspektet ekonomike: Gjendja e vendeve, në bazë të kriterëve ekonomike për anëtarësim, që përbëhet nga:

- Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut, e cila bazohet në të drejtat e qarta të pronësisë, tregjet funksionale, liberalizimin e çmimeve dhe stabilitetin ekonomik;

¹⁷ Task Forca për Integrim Evropian, ,Tryeza Tematike “Bujqësia, Zhvillimi Rural, Pylltaria, Peshkataria dhe Siguria e Ushqimit”, Material diskutues: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural”,2012 , faq.5-8.

¹⁸ Komisioni Evropian, “Politika e Përbashkët Bujqësore dhe Partneriteti mes Evropës dhe Bujqve”, Zyra e Publikimeve të BE-së, Luksemburg,2012, faq.6.

- Kapaciteti për t'u ballafaquar me presionin e konkurrencës dhe me forcat e tregut përbrenda Bashkimit Evropian, ipërfshirë këtu edhe importin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore.

Standardet e komunitetit: Kapaciteti i vendit për të implementuar dispozitat ligjore dhe administrative në fushat e bujqësisë dhe zhvillimit rural:

- Kapaciteti adekuat administrativ i administratave bujqësore, sidomos në fushën e hartimit të politikës së bujqësisë, analizës, implementimit, pagesave përkrahëse dhe kontrolleve të caktuara.

- Kapaciteti adekuat administrativ për formulimin dhe implementimin e masave para-anëtarësuese për zhvillim rural (IPARD) dhe rrjedhimisht edhe programet e Komunitetit për Zhvillim Rural.

- Harmonizimi legjislativ dhe themelimi i kapaciteteve administrative në fushat e bujqësisë organike, politikës së kualitetit dhe aspekte të tjera horizontale.

- Në nivel të tregut bujqësor, themelimi i mekanizmave të tregut (përfshirë këtu edhe standardet e marketingut, raportimin e çmimeve, menaxhimin e kuotave, organizatat e prodhuesve, intervenimi publik etj.).¹⁹

Politika e përbashkët bujqësore është emri i përbashkët për instrumentet juridike dhe buxhetore të UE në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Roli i bujqësisë dhe i PPB shumë shpesh është kuptuar gabimisht ose është nënvlerësuar në lidhje me proceset evropiane për integrim dhe sistemin e marrjes të vendimeve. Kjo gjithashtu i detyrohet edhe kompleksitetit të PPB dhe nga konotacionet e forta ideologjike të këtyre pyetjeve. PPB ishte politika e parë e përbashkët e vërtetë në UE dhe vazhdimisht po tregohet si pikë ku pyetje kryesore në procesit evropian të

¹⁹ Komisioni Evropian, “Drejtorja e Përgjithshme për Bujqësi dhe Zhvillim Rural”, Bujqësia dhe Zgjerimi, Zyra e Publikimeve të BE-së, Luksemburg, 2012, faq.6-7.

integritit dhe interesat vendosin. PPB mund të kuptohet si sistem shumë dimensional politik – ekonomik dhe politika të cilat bazohen në interesa të cilat si të atilla janë seriozisht të kundërvëna në partneritetin tregtar ndërkombëtar të UE dhe barra në radhë ta parë është bartur nga ana e Shteteve anëtare të cilat janë paguesit – neto në buxhetin e UE.²⁰ Këto objektiva duhet të plotësohen nga zbatimi i masave të ndryshme prioritare të tilla si përmirësimin e investimeve në ekonomitë bujqësore për të ristrukturuar dhe përmirësuar në nivel me standardet e BE-së, përgatitjen e veprimeve për implementimin e masave bujqësore mjedisit miqësor dhe zhvillimin e ekonomisë rurale. BE-ja i ndihmon vendet kandidate dhe kandidatët e mundshëm siç është Kosova, jo vetëm duke ju dhënë ndihmë financiare, por edhe me mbështetje në reformimin e sektorëve, për të rritur produktivitetin dhe për të ngritur potencialet e ekspertëve të tyre.²¹ Në këtë perspektivë, objektivat kryesore të PPB të fundit janë të promovojnë:

- Një sektor konkurrues bujqësorë pa subvencione të tepërta, derisa njëkohësisht të sigurohet një standard i mirë i jetesës për komunitetin bujqësor; ;
- Metodatat e sigurta të prodhimit, e që kanë mundësi të ofrojnë prodhimet cilësore;
- Komunitetet rurale, të prekshme që kanë mundësinë të gjenerojnë punësim dhe mundësi;
- Prodhimtari bujqësorë e qëndrueshëm në mjedis, që ruan burimet natyrore dhe trashëgiminë natyrore;

²⁰ Bujqësia e Ballkanit Perëndimor dhe Integritet Evropian, Fakultet za zemjodjelski nauki i hrana, Shkup ,2008, faq.1.

²¹ Ministria e Integritet Evropian&Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, “BE&KOSOVA NJË PASQYRË E POLITIKAVE KYÇË TË INTEGRIMIT EVROPIAN”, 2013, faq.6

- Një proces të thjeshtë dhe transparent të vendim-marrjes, ku përfshihen palët e interesuara në nivel qendror, rajonal, komunal dhe të komunitetit dhe
- Një lidhje e qartë në mes të përkrahjes publike për bujqësi, përfitimeve ekonomike, sociale dhe mjedisore që arrihen nga kjo.²²

Rëndësia e PPB për Kosovën

Bujqësia është njëri nga sektorët më të rëndësishëm në ekonominë Kosovare nga perspektiva e zhvillimit njerëzor. Kontribuon me rreth 12 përqind të GDP-së dhe ofron punë (megjithëse joformale) për rreth gjysmës së personave që jetojnë në zonat rurale (ASK 2009). Poashtu, ofron një rrjetë të sigurisë sociale për një numër të madh të njerëzve të varfër të cilët varen prej bujqësisë familjare për jetesën e tyre. Është llogaritur se më shumë se 50 përqind të prodhimit bujqësor në Kosovë është i konsumuar nga brenda, nga vetë ekonomia familjare, përderisa shpenzimet për ushqim mbesin pjesa më e madhe e shpenzimeve të përgjithshme të ekonomive familjare. Sektori bujqësor ka pësuar një periudhë të rënies dramatike gjatë viteve 1990 – duke rënë nga 25 përqind të GDP-së në vitet 1980 dhe vitet e hershme të 1990-tës deri në rreth 12 përqind. Kështu që, çdo rritje ofron numra mbresëlënës të përqindjes. Megjithatë, ky sektor konsiderohet të jetë shumë joformal në aspektin e punësimit – edhe pse një numër i firmave bujqësore të shkallës së mesme së fundi kanë zyrtarizuar operimet e tyre. Një pjesë e rritjes në punësim është për shkak të ndërrimit nga sektori joformal në atë formal.²³

Politika e Përbashkët Bujqësore e BE-së është e rëndësishme për Kosovën, pasi që ajo ofron një bazë të mirë mbi të cilët duhet të bazohet një

²² Republika e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2010-2013, Prishtinë, 2010, faq.14

²³ UNDP&Swiss Cooperation Office Kosovo, Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2012 Sektori privat dhe punësimi, faq.33-82

politikë bujqësore. Në vend të mbajtes së çmimeve të ushqimit të larta dhe cilësinë e ulët, politika bujqësore e BE-së i mban çmimet e ushqimit të ulët dhe cilësinë e tyre të lartë. Këtë e arrinë duke mbështetur fermerët, duke nxitur zhvillimin rural, dhe duke përmirësuar produktivitetin bujqësor dhe stilin e jetës së njerëzve që jetojnë në zonat rurale. Duke pasur parasysh se dy të tretat e popullsisë së Kosovës jetojnë në zonat rurale dhe mbi gjysma e territorit është tokë e punueshme, politika bujqësore e BE-së ofron një mundësi të mirë për zhvillimin rural të Kosovës në të ardhmen. Kjo politikë i ndihmon prodhuesit e ushqimit të kenë sukses në treg, ndërsa në të njëjtën kohë duke i dhënë ushqim të shëndetshëm dhe kalorik për tryezat e qytetarëve të vetë. Përveç rritjes së prodhimit të ushqimit, kjo politikë ka një ndikim në fusha të tjera që janë të rëndësishme për zhvillimin rural të tilla si; mbrojtja e kafshëve, mjedisi dhe burimet natyrore. Ajo do të përmirësoj turizmin bujqësor dhe kualitetin e jetesës së njerëzve që jetojnë në zonat rurale.²⁴

Procesi i Përafrimit me *Acquis communautaire*

Deri më tani, Kosova ka miratua disa nga parimet themelore të legjislacionit të BE në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural duke përfshirë legjislacionin dytësor. Lista në vijim paraqet bazën ligjore për zbatimin e politikave në këtë fushë.

- Ligji nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural,
- Ligji nr. 03/L-016 për Ushqim, i shpallur me dekretin nr. DL-004-2.009 më 6 Mars 2009,

²⁴ Ministria e Integritimit Evropian&Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, BE&KOSOVA NJË PASQYRË E POLITIKAVE KYÇE TË INTEGRIMIT EVROPIAN, 2013, faq.5

Scientific Challenges for Sustainable Development

- Ligji nr. 03/L-029 për Inspektionin Bujqësor, i shpallur me dekretin nr. DL-065- 2.008 më 13 dhjetor,
- Ligji nr. 02/L-122 për bujqësi organike, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/2 më 8 janar 2008,
- Ligji nr. 2004/21 për veterinarinë, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/28 më 30 korrik 2004,
- Ligji nr. 2004/33 për produktet e blegtorisë, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/39 më 14 tetor 2004,
- Ligji nr. 2005/02-L10 për përkujdesjen ndaj kafshëve, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/24 më 9 maj 2005,
- Ligji 03/L-042 07 për mbrojtjen e produkteve të bimëve, i shpallur me dekretin nr. DL-061-2008 më 27 nëntor 2008,
- Ligji nr. 2003/9 për ndryshimin e ligjit nr. 03/L-004 për kooperativat bujqësore, i shpallur me dekretin nr. DL-050-2008 më 13 tetor 2008,
- Ligji nr. 2007/02-L98 për mbrojtjen e varieteteve të bimëve, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/24 më 16 maj 2008,
- Ligji nr. 02/L-111 për bletari, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/5 më 8 shkurt 2008,
- Ligji nr. 02/L-95 për mbrojtjen e bimëve, i shpallur me Rregulloren e UNMIKut nr. 2007/6 më 31 janar 2007,
- Ligji nr. 2005/02-L26 për tokën bujqësore, i shpallur me Rregulloren e UNMIKut nr. 2006/37 më 23 qershor 2006,
- Ligji nr. 2005/02-L9 për ujitjen e tokës bujqësore, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/49 më 25 nëntor 2005,
- Ligji nr. 2004/13 për materialin fidanor më 28 maj 2004,
- Ligji nr. 2003/5 për farërat, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/10 më 15 prill 2003,

- Ligji nr. 2003/10 për plehrat artificiale, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/22 më 23 qershor 2003,
- Ligji nr. 2005/02-08 për verën, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/47 më 14 tetor 2005,
- Ligji nr. 04/L-040 për rregullimin e tokës (që hyri në fuqi më 22 shkurt 2012),
- Ligji nr. 2005/02-L9 për ujitjen e tokës bujqësore, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/49 më 25 nëntor 2005,
- Ligji nr. 04/L-041 për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit (që hyri në fuqi më 25 nëntor 2011),
- Ligji për shërbimet këshilluese, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 16 shkurt 2012.
- Udhëzimi Administrativ nr. 11/2011 për masat dhe kriteret për mbështetjen në bujqësi dhe zhvillim rural në vitin 2012.
- Udhëzimi Administrativ nr. 12/2011 për pagesat e drejtpërdrejta në bujqësi.

Ndonëse janë planifikuar Ligji për OMGJ, Ligji për ndryshimin e Ligjit nr. 2003/5 për farërat dhe Ligji për ndryshimin e Ligjit nr. 2004/13 për materialin fidanor ende nuk janë miratuar. Kjo tregon që procesi i përafrimit me *acquis communautaire* është një proces i vështirë dhe përcillet jo vetëm me sfida në zbatim, por edhe me probleme dhe vonesa në hartimin dhe/ose rishikimin e ligjeve. Një plan/strategji kombëtare për përafrimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE duhet të shqyrtohet si një zgjidhje e mundshme. Sfidat kryesore janë: zbatimi i ligjeve, mungesa e kapaciteteve njerëzore/personelit, mungesa e njohurisë së duhur, mungesa e

buxhetit për kapacitetit e zbatimit të legjislacionit.²⁵ Përveç kësaj, Kosova duhet të krijojë institucione të fuqishme administrative dhe ekzekutive për zbatimin e këtyre ligjeve në mënyrë efektive. Gjithashtu, nevojitet ndarje shtesë e burimeve financiare për të siguruar zbatimin e tyre. Shumë punë është e nevojshme për të përmirësuar kapacitetet e përfaqësuesve të fushës së bujqësisë si në nivel qendror ashtu edhe komunal për të zbatuar keto ligje.²⁶

Krahasimi i Kosovës me vendet e tjera kandidate

Shumë bujqë në vendet kandidate tani më kanë shijuar beneficionet e anëtarësimit para zgjerimit. Skemat e parapara për financim nga Komuniteti, për zhvillim rural dhe investime janë tani më në funksion në këto vende. Kurse liberalizimi gradual i tregut për prodhimet bujqësore në BE u ka ndihmuar bujqve të përgatiten për punë dhe për konkurrencë në suaza të tregut të zgjeruar. Operatorët ekonomikë në BE dhe vendet e zgjerimit kanë përfituar nga kufijtë e hapur dhe nga kushtet më të lehta të tregtisë. Turqia dhe rajoni i Ballkanit Perëndimor shtuan eksportet e prodhimeve bazike bujqësore dhe produkteve të përpunuara bujqësore drejt BE-së, nën dispozitat e favorizuara tregtare. Bujqit në shtetet e reja anëtare nuk do t'i gëzojnë vetëm beneficionet e pranimit në tregun unik të BE-së; ata do të përfitojnë edhe nga politikat e disejnuara për zhvillimin e bujqësisë së tyre në mënyrë të qëndrueshme dhe profitabile. Këto përfshijnë:

- Ndhimën financiare dhe ndihmë tjetër për ristrukturimin e zonave rurale;

²⁵ AgCLIR: KOSOVO. Commercial Legal and Institutional Reform Diagnostic of Kosovo's Agriculture Sector. Qasur më 10 Mars 2015 në http://egateg.usaid.gov/sites/default/files/Kosovo_Ag.pdf.

²⁶ Ministria e Integritimit Evropian&Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, BE&KOSOVA NJË PASQYRË E POLITIKAVE KYÇE TË INTEGRIMIT EVROPIAN, 2013, faq.5.

- Ndhimën e posaçme të paraparë për nevoja të veçanta dhe programe të mbrojtura për zhvillim rural për të ndihmuar në përmirësimin e efikasitetit dhe për të inkurajuar diversifikimin. Këto, shumë shpesh kofinancohen nga qeveritë nacionale, mirëpo në përgjithësi kontributete e BE-së janë më të mëdha se ato në shtetet e vjetra anëtare;
- Ndhimën e njëjtë direkte siç është e siguruar për bujqit e tanishëm të BE-së nga Politika e Përbashkët Bujqësore (të sinkronizuar për një periudhë të caktuar).²⁷

Të gjitha vendet e rajonit janë më të avancuara se Kosova në përafrimin e tyre me acquis të BE- së për bujqësinë, por ka dallime të mëdha mes tyre. Kroacia është në përputhje të plotë me acquis në politikat bujqësore, që njëkohësisht është kusht për tu bashkuar me BE- në. Ajo ka agjensinë e vet të pagesave, të certifikuar nga BE-ja. Gjatë bisedimeve të anëtarësimit, Kroacia gradualisht ka reduktuar, dhe në fund ka ndaluar të gjitha subvencionet e veta për fermerët. Vazhdimi i tyre do të ishte i paligjshëm pas anëtarësimit në BE. Tash e tutje, bujqësia Kroate do të jetë pjesë e politikës së përbashkët të BE-së dhe jo e drejtuar nga vetë Kroacia. Kroacia arriti të marrë nga BE-ja përkufizim tranzicional që e kufizon të drejtën e qytetarëve të vendeve të tjera të BE-së për të blerë tokë bujqësore për një periudhë deri në shtatë vite. Fermerët kroatë do të jenë në gjendje që të marrin fonde nga BE- ja në formën e pagesave të drejtpërdrejta. Për gjysmën e dytë të vitit 2013 kjo shumë arrinë në 93 milion euro dhe është paraparë që çdo vit kjo të jetë ndërmjet 350 milion euro, dhe 400 milion euro. Por prodhuesit Kroatë do të duhet të konkurrojnë brenda tregut të tyre me prodhimet nga pjesa tjetër e BE-së. Vende të tjera kandidate si Mali i Zi, Serbia, IRJM dhe kandidatët potencial si Shqipëria dhe Bosne e

²⁷ Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Bujqësia dhe Zgjerimi, Zyra e Publikimeve të BE-së, Luksemburg, 2012, faq.5.

Hercegovina, janë duke bërë përparim drejt përafrimit me *acquis*, por sipas vlerësimit të bërë nga Komisioni Evropian në raportet vjetore të progresit, ato mbeten ende në një fazë fillestare në këtë proces. Të gjitha këto vende janë duke përfituar nga komponentët tregtare të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, dhe duke rritur eksportin e tyre të produkteve bujqësore në BE.²⁸

KONKLUZION

Në bazë të zhvillimeve të deritashme dhe vlerësimit të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, ekzistojnë disa sfida strategjike që duhet të trajtohen nga ana e institucioneve Kosovare për të përmirësuar standardin e jetës të popullsisë rurale dhe për të ristrukturuar sektorët e bujqësisë dhe zhvillimit rural në përputhje me ato të Bashkimit Evropian. Prandaj si përfundim mund të ipen disa rekomandime për institucionet Kosovare me qëllim të përafrimit të politikave bujqësore Kosovare me ato të BE-së:

- Ndërtimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve administrative;
- Përgatitja për procesin e akreditimit të institucioneve;
- Bashkërendimi dhe bashkëpunimi më i mirë në mes të institucioneve qendrore dhe lokale;
- Ndarja e më shumë mjeteve financiare;
- MBPZHR të tërheq personel më të kualifikuar dhe të përmirësojë kapacitetet e personelit aktual me një program të duhur të ndërtimit të kapaciteteve;
- Shtimi i efikasitetit të burimeve njerëzore;
- MBPZHR të gjejë zgjidhje dhe të vë në dispozicion të gjitha kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe teknike;

²⁸ Ministria e Integritimit Evropian & Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, BE&KOSOVA NJË PASQYRË E POLITIKAVE KYÇE TË INTEGRIMIT EVROPIAN, 2013, faq.8.

- Politika zhvillimore për të rritur madhësinë e fermave dhe për të parandaluar copëzimin e mëtutjeshëm të tokës;
- Përmirësimi dhe profesionalizimi i mëtutjeshëm i shërbimeve këshillimore;
- Të ketë "këshilltarë të licencuar" për shërbimet këshillimore;
- Të krijojë një sistem efikas të raportimit, monitorimit dhe kontrollit;
- Të krijojë një mjedis për shfrytëzimin më të mirë të burimeve të dhënave në dispozicion;
- Vlerësim i thellë krahasimtar i legjislacionit të Kosovës kundrejtë legjislacionit të BE-së;
- Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërrimi i paligjshëm i destinimit;
- Sistemi i integruar i statistikave në përputhje me kërkesat e integritit evropian;
- Më shumë fonde dhe promovim i partneriteteve lokale për zhvillim rural.

LËTERATURA:

- 1.AgCLR: KOSOVO. Commercial Legal and Institutional Reform Diagnostic of Kosovo's Agriculture Sector. http://egateg.usaid.gov/sites/default/files/Kosovo_Ag.pdf;
- 2.Dr.Gazmend Qorraj Jean Monnet Chair, Integrimi Evropian dhe Kosova, Koha, Prishtinë;
- 3.Fakultet za zemjodelski nauki i hrana, (2008). Bujqësia e Ballkanit Perëndimor dhe Integrimet Evropiane, Shkup;
- 4.Instituti RIINVEST, (2004), Zhvillimi Rural në Kosovë (Raport Hulumtues);

5.Komisioni Evropian, (2012). Politika e Përbashkët Bujqësore dhe Partneriteti mes Evropës dhe Bujqve, Zyra e Publikimeve të BE-së, Luksemburg,;

6.Komisioni Evropian, (2012). Drejtoria e Përgjithshme për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Bujqësia dhe Zgjerimi, Zyra e Publikimeve të BE-së, Luksemburg;

7.Ministria e Integritimit Evropian&Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, (2013). BE&KOSOVA NJË PASQYRË E POLITIKAVE KYÇE TË INTEGRIMIT EVROPIAN;

8.Politikat bujqësore, qasur në <http://shtetiweb.org/politikat-bujqesore>;

9.Republika e Kosovës, (2010). Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2010-2013, Prishtinë;

10.Task Forca për Integrim Evropian, (2012). Tryeza Tematike “Bujqësia, Zhvillimi Rural, Pylltaria, Peshkataria dhe Siguria e Ushqimit”, Material diskutues: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural”;

11.UNDP&Swiss Cooperation Office Kosovo, Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2012 Sektori privat dhe punësimi.

Të dhënat bazë (DRAFT)		15 e BE	25 e BE	Bullgaria	Rumania	Kosova
Therja e derrave	Milion ton					
Prodhimtaria e qumështit të lopës	Milion ton	119.8	142.02	1.29	4.97	0.96
Rendimentet bujqësore						
Gruri	Ton për hektar (gruri i zakonshëm)	6.57	5.76	3.14	2.75	3.9
Elbi	Ton për hektar	4.53	4.14	2.94	2.33	2.5
Misri	Ton për hektar	8.61	7.86	4.53	3.62	3.9
Patatet	Ton për hektar	35.1	26.9	15.8	14.4	23
Rendimenti i qumështit	Kg për lopë	6,661	6,359	3,710	3,036	1,800
Struktura e sipërfaqes së shfrytëzuar bujqësore						
Rezultati përfundimtar bujqësorë	Milion EUR					
Produktet e drithërave	Milion EUR					
Produktet e blegtorisë	Milion EUR					20.27
Produktet e drithërave	% e rendimentit bujqësor					
Produktet e kafshëve	% e rendimentit bujqësor					
Madhësia mesatare e fermës	Hektarë					2.2
Financat publike						
Shpenzimet në mbrojtjen sociale	Për kokë PPS					
Shpenzimet në mbrojtjen sociale	% e BPV (2006)	28.3	28.0			122.6
Shpenzimet e përgjithshme të konsumit në familje	% e BPV (2004)	56.8	56.9		66.9	19.3
Shpenzimet e përgjithshme në arsimin	% e BPV	4.9	4.9	3.9	3.4	16.4
Çmimi i rrymës	EUR /kwh					0.063 0.086
Shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit	% e BPV					0.1
Qasja në internet për ekonomitë familjare	Përlind					

Fig.1. Disa të dhëna të karakterit bujqësor të vendeve të BE-së dhe Kosovës




Fig.2. Transferim i buxhetit në vendet e Ballkanit Perëndimor në Euro për cdo banorë dhe sipas tokës të punueshme dhe kulturat shumë vjeçare në krahasim me Slloveninë

Scientific Challenges for Sustainable Development

Vite	Detyra
Viti 0	Marrëveshja për stabilizim dhe asocim me EU
Viti 1-2	Kërkesë, Pyetësor, Këshill (mendim nga EU)
Viti 3-5	Fillimi I bisedimeve <ul style="list-style-type: none"> - Kontroll me: krahasim analitik të <i>acquis</i> (dallime, hapa për përshtatshmëri, pozicione biseduese) - Pozicione formale biseduese: obligime për të zbatuar, kërkesë për anulimin e periudhës tranzicione
Viti I 6	Paketa e fundit financiare <ul style="list-style-type: none"> - Pozicioni financiar i UE dhe bisedimet politike për zgjerim - Takime teknike për kuotat, zhvillimin rural, pagesat shtesë
Viti 7-8	Përgatitje për afrim / qasje

Fig.3. Shpërndarja e procesit për afrim /qasje në bujqësi, në baza të zgjerimit

KORRUPSIONI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK: RASTI I KOSOVES

Veton Jahmurataj

Master, Universiteti "HAXHI ZEKA"- Pejë, Kosovë, Veton.jahmurataj@gmail.com

Abstrakt

Korrupsioni është fenomen i përhapur në të gjitha pjesët e botës, dhe është mendim i gabuar i atyre që mendojnë se korrupsioni është produkt i vetëm disa sistemeve. Fjala korrupsion është një term i paqartë. Edhe në literaturën profesionale përmban kuptime të ndryshme dhe të pa padefinuara. Ky definicion është aq i lloj-llojshëm, por në vija të përgjithshme, të gjitha burimet e përkufizojnë korrupsionin si shpërdorim të pushtetit publik për përfitime personale, siç është mitmarrja, nga nëpunësit publikë, marrëveshjet e fshehta në prokurorimet publike ose përvetësimi i fondeve publike.

Korrupsioni është një tipar i shoqërive dhe vendeve të ndryshme. Vitet e fundit ai konsiderohet si një fenomen i pranishëm dhe një sëmundje për vendet në zhvillim dhe ato të zhvilluara. Ai ka prirje që të rritet më shpejt, sesa dinamikat e implementuara për ta neutralizuar atë. Sistematikisht ai ka shkaktuar shumë probleme shqetësuese në të gjitha vendet e botës.

Korrupsioni përbën një kërcënim për rritjen ekonomike të një vendi pasi ndikon në uljen e efikasitetit në sektorin privat dhe në atë publik. Ai është një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikon në reduktimin e rritjes ekonomike në shumë vende të botës. Kjo është një dukuri e zakonshme sot, si pasojë e kësaj dukurie rritja ekonomike minohet, edhe Kosova si një vend i dalur nga lufta dhe në proces shtet formues po përballet me këtë fenomen që nga shume organizata vendore dhe ndërkombëtare po cilësohet si një

fenomen mjaftë shqetësues dhe i dëmshëm për shoqërinë e sidomos për zhvillimin ekonomik.

Andaj, ky punim analizon ndikimin e korrupsionit në rritjen ekonomike, faktorët kryesorë të tij dhe pasojat që ka korrupsioni në ekonominë e Kosovës. Qëllimi i këtij punimi është të kontribuojë në luftimin e këtij fenomeni dhe të pasqyrojë impaktin që ka korrupsioni në rritjen ekonomike.

Fjalët kyçe: Korrupsioni, Zhvillimi ekonomik, Rritja ekonomike, Bizneset.

Jel Clasiffication: D73, O1, F43, M21.

HYRJE

Në aspekte dhe në një masë të ndryshme, korrupsioni ushtron një ndikim negativ në të gjitha shoqëritë. Korrupsioni si fenomen, pa dyshim se është shumë i dëmshëm për shoqërinë. Kjo vjen nga fakti se individë apo grupe të ndryshme, interesat personale i vënë mbi interesat e përgjithshme, që është në kundërshtim të plot me ligjin. Sistematikisht korrupsioni ka shkaktuar shumë probleme shqetësuese në të gjitha vendet e botës. Shumë institucione ndërkombëtare siç janë institucionet e Bankës Botërore, dhe ato të BE'së, kanë vërtetuar se korrupsioni i zvogëlon të ardhurat shtetërore, duke i rritur shpenzimet publike, e kjo ndikon në bilancin deficitar të pagesave, duke penguar edhe baraspeshimin e tyre. Një numër i madh ekonomistësh kanë qartësuar se shoqëria përjeton pasoja katastrofale nga korrupsioni, ngase është pengesa kryesore për zhvillimin e një vendi.

Faktorë të ndryshëm luajnë rol në zhvillimin ekonomik të vendit dhe rritjen ekonomike në vendet në zhvillim dhe në ato të zhvilluara, sidomos në vendet që po kalojnë neper fazën e tranzicionit siç është Kosova, shfaqja e

fenomeneve te tilla si Korrupsioni është një simptomë e dobësive të thella institucionale, dhe poashtu është një nga faktorët përgjegjës për reduktimin e investimeve dhe shpenzimeve, ndikon ne uljen investimet e huaja direkte, si dhe shfaqjen e pengesave apo barrierave te ndryshme për zhvillimin ekonomik te vendit.

Korrupsioni përbën një kërcënim për zhvillimin ekonomik, ai e pamundëson, shpeshherë edhe e paralizon plotësisht veprimtarinë tregtare, duke e shkatërruar edhe sektorin privat, nëpërmjet pengimit të investitorëve të huaja. Kjo është një dukuri e zakonshme sot në shumë nga vendet në zhvillim dhe lind si pasojë e varfërisë së tyre.

Prandaj, ky punim analizon ndikimin e korrupsionit në rritjen ekonomike, faktorët kryesorë të tij dhe pasojat që ka korrupsioni në ekonominë e Kosovës. Qëllimi i këtij punimi është të kontribuojë në identifikimin e pasojave qe sjell ky fenomen dhe impakti i tije në rritjen ekonomike, duke paraqitur një hulumtim te bere në ndërmarrje të sektorëve të ndryshme dhe duke ju referuar raporteve ndërkombëtare dhe vendore do te mundohem te jap konkluzionet e mija për ndikimin e korrupsionit ne zhvillimin ekonomik te Kosovës.

1. PËRKUFIZIMI I KORRUPCIONIT

Fjala korrupsion është një term i paqartë. Edhe në literaturën profesionale përmban kuptime të ndryshme dhe të pa padefinuar. Ky definicion është aq i lloj-llojshëm, aq sa janë edhe organizatat ndërkombëtare qeveritare e joqeveritare. Por në vija të përgjithshme, të gjitha burimet e përkufizojnë korrupsionin si shpërdorim të pushtetit publik për përfitime personale, siç është mitmarrja, nga nëpunësit publikë, marrëveshjet e fshehta në prokurorimet publike ose përvetësimi i fondeve publike. Me një fjalë mund

të themi se: çdo kush që i shërben vetes, në mënyrë jo morale dhe jo etike, është korruptor .P.sh. GRECO (grup shtetesh të BE'së (kundër korrupsionit) të formuara më 1maj 1999), korrupsionin e definojnë me marrjen e mitos në mënyrë direkte apo indirekte nga personi që i është besuar një funksion publik apo privat, me qëllim përfitimi për vete apo edhe për persona tjerë. Kurse OECD, korrupsionin e definojnë me marrjen e mitos, apo dhënien e premtimit, nga çdo përfitues me qëllim përfitimi në mënyrë të paligjshme. Ekzistojnë edhe shumë Organizata tjera, që korrupsionin thjesht e definojnë si keqpërdorim të detyrës si në sektorin publik apo privat.

Ka disa arsye se pse ky fenomen ka shfaqur një interes të lartë për hulumtime të ndryshme në këtë fushë:

- ❖ Së pari, është arritur në një konsensus që korrupsioni është një fenomen unik dhe universal. Ai është i pranishëm si në vendet e varfra dhe në ato të zhvilluara, në sektorët publik dhe ato privat, si dhe në organizata jofitimprurëse. (Banka Botërore 1997)²⁹.
- ❖ Së dyti, skandalet që vijnë si pasojë e korrupsionit kanë luajtur një rol të rëndësishëm në sferën politike gjatë viteve të fundit. Për shembull: qeveri të rrëzuara si dhe figura politike të shkatërruara ose shkatërrimi i reputacionit të organizatave të fuqishme si pasojë e kryerjes së aferave korruptive. Një ilustrim i mirë i tyre janë rënia e qeverisë së Marcos në Filipine (New York Times, Shkurt 26 1986) si dhe shkatërrimi i Koorporatës Enron në SHBA (Healy dhe Palepu, 2003). Shleifer dhe Vishny (1994) kanë vënë re se në Greqi kanë një ndryshueshmëri të lartë të punonjësve dhe drejtuesve kryesorë të korporatave kur fiton partia opozitare.

²⁹ Raporti i Bankës Botërore 1997

- ❖ Së treti, si dhe problemi më i rëndësishëm është që korrupsioni mund të jetë një pengesë për zhvillimin ekonomik të vendit si dhe ka një ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike të tij. Në vendet në tranzicion kalimi nga një ekonomi e centralizuar në një treg të lirë, ka krijuar hapësira për përfitime jo të lejueshme. Shihet se është shoqëruar dhe me një ndryshim nga një sistem i mirëorganizuar i korrupsionit në një sistem më kaotik (Shleifer, 1997). Rritja e ulët ekonomike ka qenë e pranishme në disa vende si pasojë e mosfunksionimit të institucioneve si dhe përhapjes së nëpunësve të korruptuar.

1.1 Çfarë është korrupsioni?

Edhe pse korrupsioni ka ekzistuar gjatë dekadave të ndryshme nuk ka një përcaktim apo përkufizim të njëjtë dhe të vetëm të tij. Studime të ndryshme kanë identifikuar tre tipe të korrupsionit në një ekonomi demokratike mes publikut të gjerë dhe qeverisë (Rose – Ackerman 1978; Jain 2001). Përgjithësisht, natyra e marrëdhënies mund të identifikohet në tre forma: marrëdhënia me elitën politike, administrative dhe juridike.

Korrupsioni është i njohur që nga kohët më të lashta. Edhe pse ekziston në të gjitha vendet e botës, shoqëritë shpeshherë i kanë devijuar diskutimeve rreth këtij realiteti. Edhe në literaturën profesionale ai ka kuptime të ndryshme dhe të pa përcaktuara. Ky definicion është aq i shumëllojshëm, aq sa janë edhe organizatat ndërkombëtare qeveritare e joqeveritare. Por në vija të përgjithshme, të gjitha burimet e përkufizojnë korrupsionin si shpërdorim të pushtetit publik për përfitime personale, siç është mitmarrja nga nëpunësit publikë, marrëveshjet e fshehta në prokurorimet publike ose përvetësimi i fondeve publike³⁰. Ekzistojnë edhe shumë Organizata tjera, që korrupsionin

³⁰ Ligji nr. 34/2004 neni 2, alineja 2

thjesht e përcaktojnë si keqpërdorim të detyrës si në sektorin publik apo privat.

1.2 .Shkaqet e Korrupsionit?

Disa studiues dhe ekonomistë mendojnë që varfëria është burimi i problemit. Pa varfëri nuk do të kishte korrupsion. Por dhe pse është një shkak ai nuk mund të jetë i vetmi. Nëse varfëria është shkak i korrupsionit, atëherë do të ishte e vështirë të shpjegohej pse vendet e pasura janë të përfshira nga skandale - shumë pak prej tyre përfshijnë ndonjë që mund të kategorizohet si i "varfër" apo "në nevojë". Korrupsioni është pra, —një thikë me dy presall - ai mund të shfaqet nga pasuria dhe bollëku, por dhe nga mungesa e tij³¹. Një vlerësim i fundit i Bankës Botërore për udhëheqësit e korruptuar Afrikan, vëren se ata kanë depozituar miliarda dollarë amerikane në bankat Europiane. Asnjë prej këtyre liderëve nuk mund të përshkruhet si viktimë e varfërisë, përkundrazi, duke grabitur thesarin kombëtar, ata padyshim që kanë thelluar varfërinë e popujve të tyre. Vendimet për shpenzime publike janë rënduar nga përfitimet private dhe subvencionuar nga rryshfetet marramendëse të firmave në vendet e industrializuara, të cilave iu intereson pak e mira e vendit apo popullit.

Shkaqet e korrupsionit mund t'i grupojmë në shkaqe institucionale dhe shoqërore.

- ❖ Ndër shkaqet institucionale mund të përmendim:
- ❖ Autoritetin e gjerë dhe kompetencat e shumta,
- ❖ Përgjegjshmërinë e ulët dhe mungesën e transparencës,

³¹ Instituti i Bankës Botërore

Politikat nxitëse që nuk motivojnë (pagat, shpërblimet për performancën, siguria e pozicionit të punës dhe profesionalizmi janë në një shkallë të ulët, struktura e rrogave dhe e shpërblimeve nuk është e standartizuar).

- ❖ Në shkaqet shoqërore mund të përmendim:
- ❖ Përkushtimin personal,
- ❖ Një qeveri jo të besueshme,
- ❖ Pabarazia dhe diskriminimi, etj.

1.3 Tipet e korrupsionit

Studiuesit e korrupsionit në përgjithësi bëjnë një ndarje të thjeshtë në atë që quhet korrupsioni —i vogëll ose —i mbijetesësll, i cili kryhet nga nëpunësit publik, që mund të paguhen shumë pak dhe varen nga rryshfetet e vogla nga publiku për të ushqyer familjet, për të paguar faturat e shkollave etj. Shumë ekspertë mendojnë se ky lloj korrupsioni ndihmon si kompanitë dhe individët për ti bërë bisht kërkesave qeveritare apo burokracive, duke zvogëluar vonesat dhe duke evituar rregullimet dhe taksat e rënda. Pra kryerja e pagesave paraqitet si asgjë më tepër se një -rryshfet, që nevojitet të funksionojë në një mjedis të vështirë.

Llojet e korrupsionit mund ti klasifikojmë në:

- ❖ **Korrupsioni administrativ** është më i përhapuri dhe merr forma të ndryshme që

nga më e dukshmja dhe e lehta për —t'u pranuarll, deri tek më e kamufluara që kërkon dhe metoda të ndërlikuara për t'u zbuluar e më pas për t'u luftuar. Ekzistojnë dy kategori të veçanta të korrupsionit administrativ: **E para** ndodh kur p.sh. shërbimet ose kontratat janë kryer "sipas rregullit" dhe **e dyta**, kur transaksionet janë "kundër rregullit". Në situatën e parë, një

nëpunës merr përfitim privat ilegalisht për të bërë diçka të cilën ai ose ajo duhet ta kryente në mënyrë ligjore. Në situatën e dytë, ryshfeti jepet për të siguruar shërbime, të cilat nëpunësi është i ndaluar t'i bëjë. "Sipas rregullit" ashtu dhe "Kundër rregullit" korrupsioni mund të ndodhë tek të gjitha nivelet e hierarkisë së qeverisë, duke u renditur në shkallë të ndryshme dhe i ndikuar nga "korrupsioni i madh" deri tek ai i një shkalle më të vogël.

Disa tipe më të shpeshta të korrupsionit administrativ janë si më poshtë:


- a) Sigurimi i një shërbimi të rrallë ose shmangia e pagesës
 - b) Sigurimi i një shërbimi jo të rrallë por që varet nga diskrecioni i administratës.
 - c) Sigurimi i një burimi informacioni të brendshëm ose përshpejtimi apo anashkalimi i procedurave.
- ❖ **Korrupsioni politik** është abuzimi i sistemit politik, abuzim i besimit dhe i principeve demokratike. Në ditët e sotme shumë udhëheqës të shteteve të ndryshme të botës abuzojnë për të siguruar përfitime personale apo në interes të grupeve të caktuara. Në —Raportin Global mbi Korrupsionin¹¹ publikuar nga Transparency International, numërohen tipet themelore të korrupsionit politik të cilët janë:

Shpenzimet joligjore përfshirë këtu blerjen e votave

- a) Financimi nga burimet te dyshimta
- b) Abuzimi i resurseve shtetërore
- c) Aktivitetet që injorojnë rregulloret mbi financimin e entiteteve politike
- d) Kërkesa për kontribute nga shërbyesit civil
- e) Pasurimit personal

- f) Kontributi politik për favore në formë kontrate dhe ndryshim të politikës
- g) Detyrimi i sektorit privat për të kryer pagesa apo të ashtuquajtura para për mbrojtje
- h) Ofrimi i mjeteve financiare nga jashtë.

Figura 1 Zanafilla e korrupsionit ne vendet me pak te zhvilluara



2. KORRUPSIONI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK: RASTI I KOSOVES

Shumica e analistëve kanë argumentuar se efektet e korrupsionit në shoqëri janë të shumëfishta. Duhet patur parasysh se shteti është përgjegjës për mbledhjen, shpërndarjen dhe administrimin e taksave në mënyrë korrekte. Shpërndarja e këtyre fondeve është nën kompetencën totale të zyrtarëve publik, të cilët ja përcjellin ato bizneseve private nëpërmjet

investimeve publike, ku këta të fundit janë të gatshëm të paguajnë një taksë të pashkruar‘ vetëm e vetëm që t’i përfitojnë këto mjete financiare. Me fjalë të tjera pjesa më e rëndësishme e investimeve publike në një shtet në zhvillim shkon për ngritjen e infrastrukturës së vendit. Këtu, kompanitë private përpiqen t’i përfitojnë ato nëpërmjet tenderave të hapur ose prokurimeve publike të organizuara nga administrata shtetërore. Shumë zyrtarë publik të korruptuar në vend të një procedure transparente dhe konkurimi të drejtë lejojnë që të japin ryshfetet duke e përcaktuar kështu si fituesin e një tenderi publik³². Në këtë mënyrë korrupsioni luan një rol deformues në tregun e lirë duke dëmtuar rëndë konkurrencën dhe duke ngritur kështu një sistem, i cili pengon zhvillimin e ekonomisë. Shumë organizata ndërkombëtare, kur i referohen problemeve financiare që sjell korrupsioni, përqëndrohen më së shumti në dhënien e ryshfetit në sektorët kyç për shoqërinë siç janë gjyqësori, administrata publike, partitë politike, institucionet që menaxhojnë taksat dhe tatimet etj.

Anketa e realizuar me bizneset private në Kosovë nxjerr në pah se korrupsioni dhe format e tjera të krimit janë një pengesë e madhe për ndërmarrjet private, dhe se kanë një efekt negativ në investimet private. Një përqindje e konsiderueshme e bizneseve iu paguajnë ryshfet zyrtarëve publikë, në mënyrë të përsëritur, gjatë gjithë vitit. Bizneset, në sektorët e prodhimit industrial, të furnizimit me energji elektrike, gaz dhe ujë, janë më të prekurit nga ryshfeti, të pasuar nga bizneset në sektorin e tregtisë me shumicë dhe të tregtisë me pakicë.


Shqyrtimi i përvojës së bizneseve, që iu paguajnë ryshfet zyrtarëve publikë thekson faktin se korrupsioni luan një rol në biznesin e përditshëm të shumë kompanive. Bizneset ryshfetsuese paguajnë mesatarisht 7.7

³² Korrupsioni dhe ndikimi i tij në Rritjen ekonomike, Adela Shera, Tirane, 2014

ryshfete në vit, ose rreth një ryshfet në gati çdo shtatë javë. Përhapja e ryshfetit është më e lartë kryesisht në mesin e bizneseve të mesme dhe të mëdha (me mbi 50 të punësuar) sesa në mesin e bizneseve të madhësive të tjera.³³

Figura nr. 2 tregon përbërjen themelore të ryshfetit të paguar në pesë sektorë ekonomikë në Kosovë. Sektori i tregtisë me shumicë dhe tregtisë më pakicë përbën pjesën më të madhe (62.3%) të normës totale kombëtare të përhapjes, për shkak të faktit se ky sektor llogaritet se përbën pjesën më të madhe (47.5%) të bizneseve në Kosovë.

Figura 2 Përbërja themelore e ryshfetit të paguar në pesë sektorë ekonomikë në Kosovë




Burimi: Agjencia e statistikave të Kosovës & UNODC, 2013

Siç tregohet në Figurën 3, nga i gjithë ryshfeti që i është paguar zyrtarëve publikë nga bizneset në Kosovë, 59.2% është paguar me para të gatshme, e që mund të jetë mënyra më e lehtë për fshehjen e veprës. Pothuajse, aq e rëndësishme është edhe ofrimi i ushqimit dhe pijeve, në

³³ Të dhënat që i referohen ryshfetit, nga ana e individëve dhe ekonomive familjare, janë marrë nga studimi i fundit i UNODC-së, Korrupsioni në Kosovë: ryshfeti siç është sprovuar nga popullsia (2011).

këmbim të një “favori” të paligjshëm nga ana e zyrtarit publik, që është përgjegjës për më shumë se gjysmën (58.4%) e të gjitha rasteve të ryshfetit në Kosovë.

Figura 3 Ryshfeti që i është paguar zyrtarëve publikë nga bizneset në Kosovë



Burimi: UNODC, 2013

Në rastin e sektorëve të bizneseve nën studim, pagesa me para të gatshme, në përgjithësi, duket të jetë forma më e përhapur e ryshfetit, përveç në tregti dhe akomodim, ku dhënia e ushqimit dhe pijeve është po aq e rëndësishme.

KONKLUZION

- Përfaqësuesit e biznesit në Kosovë e radhisin korrupsionin si pengesën më të madhe për të bërë biznes, pasuar nga taksat e larta dhe mungesa e stabilitetit politik.
- Nëntë nga dhjetë kompani kanë pasur të paktën një kontakt të drejtpërdrejtë me një zyrtar publik ose me një shërbyes civil, në 12 muajt para anketës.

- Norma e përhapjes së ryshfetit në mesin e atyre bizneseve, që kanë pasur kontakt me zyrtarë publikë në këtë periudhë është 3.2%.
- Bizneset që paguajnë ryshfet kanë paguar një mesatare prej 7.7 të ryshfetit për zyrtarët publikë, në 12 muajt para anketës.
- Në Kosovë, nga 120 biznese të anketuara 81.66 % e ryshfetit është paguar me para të gatshme. Në gjysmën e të gjitha rasteve të ryshfetit pagesa është bërë ose me kërkesë, në mënyrë eksplicite a implicite nga zyrtari publik, ose me kërkesë të palës së tretë në emër të zyrtarit.
- Qëllimet kryesore të pagesës së ryshfetit janë për ta përshpejtuar një procedurë ose për ta bërë të mundshëm finalizimin e një procedure.
- Vetëm 3.7% e të gjitha ryshfeteve të paguara nga bizneset në Kosovë janë raportuar te autoritetet zyrtare. Pothuajse, një e treta e përfaqësuesve të biznesit nuk e kanë raportuar ryshfetin, sepse ata konsiderojnë se raportimi do të ishte i pakuptimtë, meqë askujt nuk do t'i interesonte për të.
- Bizneset në Kosovë janë të prekura nga forma të ndryshme të krimit, në shkallë të ndryshme: vjedhje me thyerje, mashtrim, vandalizëm, vjedhje të automjeteve motorike dhe zhvatje.
- Bizneset e mëdha në Kosovë përdorin të paktën një masë mbrojtëse të sigurisë kundër krimit.
- Shumica e përfaqësuesve të biznesit kanë deklaruar se konsiderojnë që rreziku nga krimi për biznesin e tyre, të ketë mbetur stabil, në krahasim me periudhat e mëhershme. Ndërsa një pjesë e tyre mendojnë se ai është në rritje.

Pra, bizneset private në Kosovë nxjerrin në pah se korrupsioni dhe format e tjera të krimit janë një pengesë e madhe për ndërmarrjet private,

dhe se kanë një efekt negativ në investimet private. Një përqindje e konsiderueshme e bizneseve iu paguajnë ryshfet zyrtarëve publikë, në mënyrë të përsëritur, gjatë gjithë vitit, dhe ky fenomen është një determinues i zhvillimit ekonomik, sepse ky fenomen po ndikon negativisht edhe në tërheqjen e investimeve të huaja në vend, dhe po i japë një imazh të keq vendit tona në botë e po ashtu po ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik.

Andaj lufta kundër korrupsionit mbetet sfida kryesore e qeverisë së Kosovës dhe po ashtu mbetet një shqetësim në rritje i shoqërisë në këtë vend.

REFERENCAT

1. Bardhan, P. 1997, "Corruption and Development: A Review of Issues", Journal of Economic Literature, 35. pp: 1320-1346.
2. Acemoglu, Daren and Thierry Verdier, 1998, "Property Rights, Corruption and the Allocation of Talent, A General Equilibrium Approach." Economic Journal, Vol. 108 (450), pp. 1381-403.
3. Alesina, Alberto and Beatrice Weder, 2002, "Do Corrupt Governments Receive Less Foreign Aid?",
4. Andvig, J. C. 1991, "The Economics of Corruption: A Survey.", Studi Economici. 43. pp: 57-94.
5. Cheung, S.N, 1996, "Simplistic General Equilibrium Theory of Corruption", Contemporary Economic Policy, 14 (3). pp: 1-5.
6. Elliot, K. A. ed. 1997, "Corruption as an International Policy Problem: Overview and Recommendations, Corruption and the Global Economy", ed. By K.A. Elliott (Washington D.C.: Institute for International Economics), pp: 175-233.
7. World Bank, 2011, "World Development Report: The State in a Changing World" Oxford University Press. New York.

8. Adela Shera ,”Korrupsioni dhe ndikimi i tij në Rritjen ekonomike”,
Tiranë, 2014.

Të tjera:

1. Raporti i Bankës Botërore 1997;
2. Ligji nr. 34/2004 neni 2, alineja 2;
3. Instituti i Bankës Botërore;
4. Të dhënat që i referohen ryshfetit, nga ana e individëve dhe ekonomive familjare, janë marrë nga studimi i fundit i UNODC-së ,
Korrupsioni në Kosovë: ryshfeti siç është sprovuar nga popullsia
(2011);
5. UNODC, BIZNESI, KORRUPSIONI DHE KRIMI NË KOSOVË:
Ndikimi i ryshfetit dhe i krimit tjetër në ndërmarrjet private, 2013.

**TITLE: THE DETERMINANTS OF DEPOSITS IN THE
ALBANIAN BANKING SYSTEM DURING 2007 – 2014**

Dr. Ali Shingjergji & Dr. Anila Cekrezi

Lecturers in Portfolio Management and Financial Management

Finance and Accounting Department, Faculty of Economy

*University of Elbasan “Aleksandër Xhuvani” Rruga “Kozma Naska” 3001, Elbasan,
Albania*

E-mail: ali.shingjergji@gmail.com & vocianila@yahoo.com

Abstract

The aim of this paper is to analyze the influence of some macroeconomic and banking factors on deposit level in the Albanian banking system. From the literature review is noticed that the deposit level in the banking systems is influenced by both macroeconomic and banking factors. We use deposit level as dependent variable while as independent variables we use: GDP growth, inflation rate, unemployment rate, exchange rate, deposit interest rate, capital adequacy ratio and bank size. The relationship between deposit level and macroeconomic and banking factors will be tested by using a regression model like the ordinary least squares (OLS). We take into consideration a period from 2007 – 2014 using quarterly panel data for the whole Albanian banking system with a total of 32 observations per each variable. From the regression results we found out that the bank deposits in the Albanian banking system are influenced more by banking factors than macroeconomic factors. In fact we notice a positive relationship between bank size and bank deposits, a positive relationship between foreign exchange rate Euro/ALL and bank deposits and a positive relationship between net interest margin growth and bank deposits.

Keywords: banking system, deposits, macroeconomic variables, regression analysis.

JEL Classification: G 20, G21,

I. INTRODUCTION

The Albanian banking system has undergone to a progressive development especially after the year 2000. This is related mainly to the privatization of Saving Banks in 2004 which was the main state owned bank at that time. Today is to emphasize that the Albanian baking system is operating with 16 private banks offering all products like: deposits, credit, payments, credit cards, debit cards and a lot of services which were unknown for many Albanians ten years ago. The Albanian banking system is facing a lot of problems the last 6 years especially because of the global financial crises. The negative effects of the financial crises were reflected in the credit system in two directions: *firstly* is noticed a high level of nonperforming loans (24%) and *secondly* a reduction of the level of credit for the economy. These two problems need to be resolved as soon as possible because are threatening the whole financial system taking into account that the banking system occupies almost 90% of the Albanian financial system. In this paper are analyzed the deposits of the banking system from 2007 – 2014 and the main determinants which are divided in two groups: macroeconomic factors (external variables) and banking factors (internal variables).

II. Literature review

Many academic researchers and bank specialists have tried to analyze the relationship between the deposit level and macroeconomic and banking factors. In fact the deposit level can be influenced by both macroeconomic factors like: GDP growth, unemployment rate, inflation rate, interest rates,

foreign exchange rates and so on. In the same time the deposit level can be influenced by internal banking system like: bank policies on deposit interest rates, capital adequacy ratio, bank size and obligatory reserves.

Harald Finger and Heiko Hesse (2009) want to provide some empirical evidence of the main drivers of banks deposits demand in Lebanon. They study the relationship between deposit demand and some macroeconomic factors like: Country Risk Guide's Composite Risk Rating, advanced economy real industrial production, GDP in GCC, GDP deflator in G7, World Stock Market Index, Chicago Board Options Exchange Volatility Index, Goldman Sachs Risk Aversion Index, JP Morgan Emerging Market Sovereign Credit Quality Index and median emerging market credit growth to the private sector. The authors find out that a higher economic activity, an increase in consumer prices and a rise in advanced economy industrial production tend to be positively related to deposit growth. For the liquidity risk variables is found a relationship between Goldman Sachs Risk Aversion Index and deposit demand. The other variables seem to have any effect on deposit demand in Lebanon. The authors analyze also the relationship between some bank specific factors and the bank deposit growth from 1997 – 2007 over 50 banks operating in Lebanon. The dependant variables taken into consideration are: perceived riskiness of a bank (Z-score is used as a proxy), profitability, bank size, loans to assets ratio, liquidity buffers and some macroeconomic controls. The results suggest that more stable banks, liquid banks and banks with a higher loan exposure are associated with higher deposit growth. A positive relationship between net interest margin and deposit growth is noted during the study. It is also important to emphasize that bank profitability and bank size were found to be insignificant to explain deposit growth. Analyzing the influence of macroeconomic we see that the coincident indicator and domestic inflation

are significant drivers of bank deposit growth in Lebanon. The impact from higher industrial production is positive but not significant while GDP growth in the GCC countries is positively related to deposit growth and remittances, oil prices are not statistically significant in the regression.

Sudabeh Morshedian Rafiee and Zahra Houshmand Neghabi (2012) study the relationship between the banking deposit and some other variables like: capital market, money market, commodity market, foreign exchange rates such as US dollar and Euro exchange rates to local currency. The authors test the relationship between the dependant variable and the independent variables using regression analysis. According to the results is noticed a positive relationship between commodity market growth and dependent variables including banking growth, US dollar to Rial exchange to Rials growth, Euro to dollar growth, market growth and bank deposit growth but the relationship is not statistically significant when the level of significance is 5%. The results also indicate that there is a positive between market return and US dollar exchange, commodity market growth and bank deposit's growth rate. The exchange rate is noticed only a relationship with US dollar exchange with significance level of 5%. Banking rate and banking industry we notice a positive between these two variables.

Paul Ojeaga and Daniel Ojeaga and Deborah O. Odejimi (2013) study the relationship between nominal interest rates and customer savings, average incomes, legal rights strength, central bank monetary policy and total annual commercial losses using a regression analysis. The study includes a period from 1989 to 2012 a period of twenty three years. The results show that nominal interest rates do have a positive and significant effect on bank deposits. The incomes affect bank deposits but the impact was

weak, while bank lending has a negative effect on bank deposits. In the end is noticed that money supply exert a strong effect on bank deposits.

III. Data, methodology of the hypothesis of the research

In this paper we use two main data sources: the national institute of statistics (INSTAT) for the macroeconomic data and the Albanian association of banks (AAB) for the banking data. We take into consideration the period from 2007 – 2014 (first quarter of 2007 until fourth quarter of 2014) using quarterly data for the whole banking system with 32 observations for each variable.

To test the relationship between the dependant variable (bank deposits) and the independent variables (macroeconomic and banking) we use a regression analysis like the ordinary least squares.

The macroeconomic variables used in this study are as follows:

- GDP growth;
- Unemployment rate;
- Inflation rate;
- Exchange rate Euro/ALL

The banking variables are as follows:

- Capital adequacy ratio (CAR);
- Total assets used as a proxy of *bank size*;
- Net interest margin growth.

From literature review is noticed that bank deposits are influenced by both macroeconomic and bank specific variables. In this paper we want to test the following hypothesis:

***Hypothesis #1.** There is a positive relationship between GDP growth and bank deposits;*

***Hypothesis #2.** There is a negative relationship between unemployment rate and bank deposits;*

***Hypothesis #3.** There is a positive relationship between inflation rate and bank deposits;*

***Hypothesis #4.** There is a positive relationship between exchange rate Euro/ALL and bank deposits;*

***Hypothesis #5.** There is negative relationship between CAR and bank deposits;*

***Hypothesis #6.** There is a negative relationship between bank size and banks deposits;*

***Hypothesis #7.** There is a positive relationship between net interest margin growth and bank deposits.*

IV. Descriptive statistic and regression results

In table 1 we see the descriptive statistic of all the variables taken into consideration during the period of the study from 2007 – 2014.

Capital adequacy ratio (CAR) has an average of 16.60% during the study period with a standard deviation of only 0.96%. From here we can conclude that the Albanian banking system is quite well capitalized because the CAR

is higher than the regulatory level of 12% imposed by the supervising authorities.

Unemployment rate has an average of 13.64% with a standard deviation of only 1.14% showing an almost constant trend during the period of the study 2007 – 2014. Here is to emphasize that real data about unemployment rate are thought to be higher than official data and this is especially because in Albania a lot of unemployed people refuse to register in the job offices because they do not trust on them.

GDP growth has an average of 1.37% with a standard deviation of 8.30% showing a very volatile trend during the period 2007 – 2014. In fact we have to emphasize that GDP growth in Albania has seen a progressive reduction especially after the global financial crises which affected even the financial sector.

Inflation rate has an average of 2.67% with a standard deviation of 0.93% showing a stable performance during the period of the study. From here we can derive that price stability in the Albanian economy are within the objectives set by the Bank of Albania $3\% \pm 1\%$.

Foreign exchange rate Euro/ALL has an average of 137.73 with a standard deviation of 7.32 units showing an almost constant trend during the period of the study. In this section is very interesting to notice that approximately 50% of the deposits in the Albanian banking system are in the Euro currency.

Net interest margin growth has an average of 31.54% with a standard deviation of 64.42% showing a very unstable trend during the period of the study. This means that the net interest margin in the Albanian banking system during 2007 – 2014 has not been stable

After analyzing the data with Microfit 5.0 software we have the regression results as follows (table 3):

- ❖ The regression analysis confirms that the coefficient of determination, R-Squared, is equal to 85.20% and shows that the independent variables explain 85.20% of the variation of the deposit banks in the Albanian banking system, while the remaining part (14.80%) is explained by other factors that are not included in this study.
- ❖ The DW – statistic is equal to 1.586 indicating that the residuals are not correlated having a value approximately to 2.
- ❖ The indicator of F-Statistic shows that the observed value (8.699) is greater than its critical value (3.422) so the alternative hypothesis wins and the model is globally significant.
- ❖ The VIF (variance inflation factor) indicator is used to measure if there is multicollinearity in a regression analysis. From the results is noticed that all variables have VIF values lower than 5, showing an absence of the multicollinearity between the variables taken into consideration.

Analyzing the results of table 3 we derive the econometric model that explains the dependent variable (*deposit level*) and is shown as follows:

$$\begin{aligned} \text{Ln_DEP}_{i,t} = & 22.2488 - 1.6872\text{CAR}_{i,t} + 0.6621\text{UNP}_{i,t} - 0.1392\text{GDP_GR}_{i,t} \\ & - 4.5473\text{INF}_{i,t} + 0.1209\text{Ln_TA}_{i,t} + 0.0156\text{FXC}_{i,t} + \\ & 0.5214\text{NIM}_{i,t} \end{aligned}$$

To analyze the relation and statistical significance of Beta coefficients of the independent variables we review the values of the probability p . For p -values (observed level of significance) greater of 0.05 the influence of the independent variable on the dependent variable is unimportant when the other variables remain unchanged while for p -values smaller than 0.05 we refuse the hypothesis of the absence of relationship.

Hypothesis #1. Beta coefficient of GDP growth is negative and equal of -0.1392, showing a negative relationship between GDP growth and bank deposits. P-value is 0.7083 that is greater than 0.05 so GDP growth has no impact on bank deposits. This result is contrary to previous evidence which show a positive relationship between unemployment rate and bank deposits.

Hypothesis #2. Beta coefficient of unemployment rate is positive and equal of 0.6621, showing a positive relationship between unemployment rate and bank deposits. P-value is 0.8076 that is greater than 0.05 so the unemployment rate has no impact on bank deposits. This result is contrary to previous researches which show a negative relationship between unemployment rate and bank deposits.

Hypothesis #3. Beta coefficient of inflation rate is negative and equal of -4.573, showing a negative relationship between inflation rate and bank deposits. P-value is 0.1599 that is greater than 0.05 so inflation rate has no impact on bank deposits. In fact we were expecting a positive relationship between inflation rate and bank deposits. We can conclude that inflation rate does not have any effect on bank deposits in the Albanian banking system.

Hypothesis #4. Beta coefficient of foreign exchange Euro/ALL is positive and equal to 0.0156, showing a positive relationship between foreign exchange Euro/ALL and bank deposits. P-value is 0.0206 lower than 0.05

showing that FXC has a positive and significant relationship with bank deposits. This result is in line with our expectations and we can say that higher foreign exchange rates between Euro/ALL determine an increase of deposits in the Albanian banking system.

Hypothesis #5. Beta coefficient of capital adequacy ratio is negative and equal of -1.6872 showing a negative relationship between CAR and bank deposits. P-value is 0.7019 that is greater than 0.05 so the CAR has no impact on bank deposits. In fact we were expecting a negative and significant relationship between CAR and bank deposits.

Hypothesis #6. Beta coefficient of bank size (*natural logarithm of total assets*) is positive and equal to 0.1209, showing a positive relationship between bank size and bank deposits. P-value is 0.035 lower than 0.05 showing that bank size has a positive and significant relationship with bank deposits. This result is in line with previous studies where is noticed a positive relationship between bank size and bank deposits.

Hypothesis #7. Beta coefficient of net interest margin growth is positive and equal to 0.5214, showing a positive relationship between net interest margin growth and bank deposits. P-value is 0.012 lower than 0.05 showing that net interest margin growth has a positive and significant relationship with bank deposits. This result is in fact in line with previous studies where is noticed a positive relationship between net interest margin and bank deposits. From here we can conclude that higher net interest margins tend to increase the level of bank deposits in the Albanian banking system.

CONCLUSIONS

The aim of this paper was to determine the relationship between the bank deposits and some macroeconomic and banking factors in Albania.

Using a regression analysis we test the relationship between the bank deposits and GDP growth, unemployment rate, inflation rate, exchange rate Euro/ALL, capital adequacy ratio, bank size and net interest margin growth. From the regression results we found out that the macroeconomic variables did not have any effect on the bank deposits in the Albanian banking system. We also found out the following results about the relationship between banking factors and bank deposits like:

- ✚ A positive and significant relationship between exchange rate Euro/ALL and bank deposits in the Albanian banking system;
- ✚ A positive and significant relationship between bank size measured by the total assets and bank deposits in the Albanian banking system;
- ✚ A positive and significant relationship between net interest margin growth bank deposits in the Albanian banking system.

References

1. Bank of Albania, 2014, “The Banking Supervision Annual Report 2013, the Bank of Albania, Tirana”.
2. Bank of Albania, “Banking statistics, Quarterly data for the period 2007-2014”.
3. Bank of Albania, “Real Sector Statistics, Quarterly data for the period 2007-2017”.
4. Bank of Albania, “The official exchange rate, Quarterly data for the period 2007-2014”.
5. Demirgüç-Kunt, Asli, and Harry Huizinga, 1999, “Determinants of Commercial Bank Interest

Margins and Profitability: Some International Evidence,” *World Bank Economic Review*, Vol. 13 (May), pp. 379–408.

6. Herald Finger and Heiko Hess 2009, “Lebanon—Determinants of Commercial Bank Deposits in a Regional Financial Center Prepared by Harald Finger and Heiko Hesse”, *IMF working paper, Middle East and Central Asia Development*, pp. 1 – 20.
7. Paul Ojeaga and Daniel Ojeaga and Deborah O. Odejimi (2013), “The Impact of Interest Rate on Bank Deposits Evidence from the Nigerian Banking Sector”, Munich Personal RePEc Archive Paper No. 53238, posted 10. February 2014.
8. Sophie Ahlswede and Jan Schildbach (2012), “Poised for a comeback: Bank deposits”, *Deutsche Bank, DB Research*, pp 1 – 16.
9. Sudabeh Morshedian Rafiee and Zahra Houshmand Neghabi (2013), “An investigation on different factors influencing growth of banking deposits”, *Management Science Letters 3(2013)*, pp. 195–200.

Table 1. Descriptive Statistic

Variables	Mean	Std. Deviation	Min	Max
LN_DEP	27.3818	0.2139	26.9792	27.6839
CAR	0.1660	0.0096	0.1464	0.1807
UNP	0.1364	0.0114	0.1110	0.1700
GDP_GR	0.0137	0.0830	-0.1116	0.1999
INF	0.0267	0.0093	0.0110	0.0430
LnA	27.6707	0.5609	27.1929	30.4711
FXC	134.7371	7.3286	121.7600	141.4100
NIM_GR	0.3154	0.6442	-0.7635	1.0974

Table 2. Correlation Matrix

Variables	LN_DEP	CAR	UNP	GDP_GR	INF	LnA	FXC	NIM_GR
LN_DEP	1.00	(0.27)	0.19	(0.20)	(0.43)	0.60	0.78	(0.05)
CAR	(0.27)	1.00	0.26	(0.02)	(0.28)	0.05	(0.53)	0.00
UNP	0.19	0.26	1.00	(0.03)	(0.20)	(0.02)	0.26	(0.03)
GDP_GR	(0.20)	(0.02)	(0.03)	1.00	0.13	(0.09)	(0.19)	0.61
INF	(0.43)	(0.28)	(0.20)	0.13	1.00	(0.31)	(0.26)	(0.06)
LnA	0.60	0.05	(0.02)	(0.09)	(0.31)	1.00	0.42	0.04
FXC	0.78	(0.53)	0.26	(0.19)	(0.26)	0.42	1.00	(0.10)
NIM_GR	(0.05)	0.00	(0.03)	0.61	(0.06)	0.04	(0.10)	1.00

Table 3. Regression results

Variable	Beta	Std. Error	t - value	Sig.
Constant	22.2488	1.4185	15.6853	0.0000
CAR	-1.6872	4.3541	-0.3875	0.7019
UNP	0.6621	2.6882	0.2463	0.8076
GDP_GR	-0.1392	0.3675	-0.3788	0.7083
INF	-4.5473	3.1307	-1.4525	0.1599
LnA	0.1209	0.0540	2.2403	0.0350
FXC	0.0156	0.0063	2.4856	0.0206
NIM_GR	0.5214	0.1972	2.6412	0.0120

EKOTURIZMI DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM TURISTIK

MSC. Griserda TOPI

Assistent lecturer at “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Albania

Corresponding author e-mail: griserda.topi@gmail.com

Abstrakt

Turizmi luan një rol kyç në zhvillimin ekonomik të rajonit dhe në integrimin e tij në procesin e globalizimit, por gjithashtu ai ushtron presion të konsiderueshëm mbi burimet dhe mjedisin natyror. Promovimi i turizmit ekologjik të qëndrueshëm është jetik, sidomos në këtë periudhë, që bota po përjeton normën më të shpejtë të ngrohjes globale, me të gjitha pasojat përkatëse, siç janë shkretëtirëzimi, pakësimi i rezervave të ujit të pijshëm dhe humbja e biodiversitetit. Ekoturizmi është bërë një nga sektorët më të mëdhenj ekonomikë në botë me aftësinë për të luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të vendeve ku natyra tërheq turistët (**Powell & Ham, 2008:467; Fennel, 2002:12**). Administrata publike, pushteti vendor, operatorët turistikë, sipërmarrësit, banorët lokalë, pra, të gjithë aktorët duhet të bashkëpunojnë me njëri tjetrin dhe të krijojnë një sistem të integruar për vlerësimin e territorit në një perspektive afatgjatë dhe me objektiva për cilësi mjedisore, social-kulturore dhe ekonomike. Ruajtja e ambjentit dhe format e turizmit të qëndrueshëm janë në periudhën e mesme – të gjatë një burim pasurie dhe mirëqënie.

Qëllimi i këtij punimi ishte evidentimi dhe nxitja e veprimtarive që e kthejnë turizmin (kryesisht turizimin shqiptar, si turizëm i një vendi në zhvillim) në më të qëndrueshëm dhe procesin në të vazhdueshëm. Është e rëndësishme aktivizimi i projekteve për të mbështetur turizmin shqiptar dhe

politika serioze për një edukim ambjental. Dy nga prioritetet kryesore janë minimizimi i ndikimit mjedisor të turizmit përmes ndërgjegjësimit dhe menaxhimit më efikas të burimeve dhe infrastrukturës dhe zhvillimi i formave alternative të turizmit që do të kenë më pak ndikim në ekosisteme.

Fjalë kyçe: Ekoturizëm, Turizëm i qëndrueshëm, Mjedis natyror, Turizëm shqiptar, Politika

HYRJE

Turizmi është një nga industritë më të rëndësishme në Shqipëri. Për shkak të rritjes së shpejtë të tij, ai ushtron sot një presion të madh mbi mjedisin, burimet natyrore dhe kulturore të vendit. Shqipëria është e vetëdijshme për rolin e rëndësishëm që luan turizimi në të ardhmen ekonomike të saj, si dhe njeh nevojën e nxitjes së interesit në turizmin e qëndrueshëm, gjë që shprehet qartë në nenin 5 të ligjit Nr. 9734, datë 14.05.2007, “Për Turizmin”, ndryshuar me ligjin Nr. 9930, datë 09.06.2008.

Zhvillimi i Qëndrueshëm i Turizmit plotëson nevojat e turistëve aktualë dhe vendeve pritëse ndërkohë që mbron dhe forcon mundësitë për të ardhmen. Ai nënkupton menaxhimin e të gjitha burimeve në mënyrë të tillë që të plotësohen nevojat ekonomike, sociale dhe estetike ndërkohë që ruan integritetin kulturor, proceset bazë ekologjike, diversitetin biologjik dhe sistemet në mbështetje të jetës. Produktet të qëndrueshme turistike janë ato produkte të cilat funksionojnë në harmoni me mjedisin, komunitetin dhe kulturën lokale në mënyrë që këto të jenë përfituese dhe jo viktime të zhvillimit të turizmit.

Ekoturizmi shihet si një formë e butë dhe e kontrolluar e turizmit e cila kontribuon në mbrojtjen e vlerave natyrore. Ai është një formë e mirfilltë e turizmit të qëndrueshëm (Albania tourism guide, 1999).

Ekoturizmi mundëson dobi të rëndësishme ekonomike për shumë shtete, regjione dhe bashkësi. Ekoturizmi mund të gjenerojë në të vërtetë të ardhura të larta për ekonominë lokale e rajonale, të stimulojë qëndrimin publik dhe atë zyrtar në drejtim të ruajtjes së mjedisit. Ekoturizmi kombinon kënaqësinë e zbulimit e të përjetimit, të florës e faunës me mundësitë për të kontribuar në ruajtjen e tyre. Ai mund të përkufizohet si udhëtim në zonat natyrore të qeta dhe të pa ndotura, si një veprimtari njerëzore që respekton dhe shfrytëzon pasuritë natyrore dhe harmonizon njeriun me mjedisin, ku si objektiv kryesor i tij është studimi, admirimi, përjetimi i pamjeve dhe botës së gjallë si dhe të çdo manifestimi kulturor të pranishëm në këto zona.

Disa faktorë mund të shihen si "nxitësa", që shtojnë industrinë e turizmit drejt trajtimit të një zhvillimi të qëndrueshëm.

Këto janë:

- Rritja e presionit rregullator;
- Rritja e ndërgjegjësimit për të kursyer kostot nëpërmjet konsumit të kujdesshëm të burimeve;
- Profesionistët dhe operatorët turistikë pranojnë që cilësia mjedisore është thelbësore për një produkt konkurrues;
- Ndërgjegjësimi nga qeveritë dhe operatorët për impaktet negative që mund të sjellë rritja e turizmit në mjedisin tone;
- Rritja e ndërgjegjësimit të komuniteteve për potencialet që ata kanë për të influencuar në politikat e turizmit.

Planifikimi në industrinë turistike është i lidhur shumë me burimet natyrore dhe kulturore. Eksperiencat e ndryshme kanë treguar se komunitetet, rajonet dhe vendet përkatëse apo destinacionet turistike realizojnë fitime më të mëdha kur planifikojnë me kujdes dhe saktë.

Planifikimi synon përdorimin e mjeteve dhe mënyrave të ndryshme për të arritur një kombinim maksimal të bindshëm të plotësimit të nevojave të turistëve nga përdorimi i hapësirave dhe destinacioneve.

Qëllimi i punimit:

Qëllimi i kësaj teme është që të jepet një panoramë e potencialeve turistike të Shqipërisë. Nëpërmjet analizës dhe aspekteve teorike tregohet se si Shqipëria mund të aplikojë turizmin si formë e zhvillimit ekonomik të tij. Me anë të këtij punimi synohet të bëhet një përshkrim i gjendjes aktuale të mjedisit natyror dhe pasurive kulturore të rajonit zhvillimi i ekoturizmit, evidentimi i pikave turistike, mangësitë që pengojnë zhvillimin e tij dhe mundësitë që mund të shfrytëzohen në të ardhmen.

Objektivat e punimit:

- Vlerësimi turistik i potencialit natyror dhe kulturor të rajonit.
- Ndërgjegjësimi i organeve qendrore dhe njësiteve vendore mbi rëndësinë që ka zhvillimi i turizmit.
- Ndërgjegjësimi i komunitetit për mbrojtjen e mjedisit si hap drejt zhvillimit turistik.
- Krijimi dhe përmirësimi i kapaciteteve pritëse turistike në rajon.

Hipotezat e kërkimit

➤ **Hipoteza 1**

Si mund të arrihet menaxhimi sa më efikas i burimeve natyrore me qëllim minimizimin e ndikimit mjedisor të turizmit.

➤ **Hipoteza 2**

Zhvillimi i formave alternative të turizmit.

➤ **Hipoteza 3**

Arritja e zhvillimit të qëndrueshëm turistik në Shqipëri.

METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij punimi lidhet me përdorimin e një sërë faktorësh dhe burimesh. Gjatë mbledhjes dhe përpunimit të informacionit kam përdorur metoda të tilla si ajo e kërkimit shkencor, e vrojtimit, e analizës, e krahasimit etj.

Metoda e vëzhgimeve të drejtpërdrejta në terren është përdorur për t'u njohur më nga afër me objektet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Shqipërisë, si edhe mundësitë që ata krijojnë në zhvillimin e turizmit kulturor dhe natyror.

Metoda e krahasimit është një metodë e cila është përdorur për krahasimin e të dhënave statistikore gjatë ndërtimit të grafikëve. Gjithashtu kjo metodë është përdorur dhe në krahasimin kronologjik mbi zhvillimin e turizmit gjatë periudhave të ndryshme kohore.

Materialet dhe informacionet e nevojshme i kam siguruar nga literatura të ndryshme, Draft Strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2014-2020, website në internet.

REZULTATET E KËRKIMIT

- **Kërkesa e turizmit – statistikat e mbërritjeve të turistëve ndërkombëtarë për periudhën 2006 – 2012**

Që prej vitit 2001 numri i vizitorëve ndërkombëtarë³⁴ në Shqipëri është rritur ndjeshëm në një nivel të përgjithshëm prej 1000% duke çuar mbërritjet në mbi 3,45 milion vizitorë në 2012. “Rruga e Kombit” e ndërtuar kohët e fundit ka ndikuar ndjeshëm në numrin e vizitorëve, duke rritur numrin e personave që vijnë nga Kosova nga 473.422 në vitin 2009 në 1.179.327 në vitin 2010 (treguesi i rritjes 149% në vitin 2010) duke dominuar “pjesën tjetër të botës”. Me rreth 1,18 milion turistë të ardhur nga Kosova që llogariten në 49% të të gjithë mbërritjeve të turistëve ndërkombëtarë në 2010. Pas vitit 2010 numri vazhdon të rritet me rreth 260.000 në vit ose rreth 18 %. Në vitin 2012 numri i vizitorëve turistikë ndërkombëtarë u rrit me 25,7% në krahasim me vitin 2011. Në 2012 pjesa e turistëve nga Kosova në krahasim me numrin total të turistëve ndërkombëtarë mbetet mbresëlënëse: në nivelin 48,63% (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit: Draft-strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2014-2020).

Në vitin 2013 rritja e numrave pothuajse ndaloi në bazë viti; ka pasur vetëm një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2012. (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit: Draft-strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2014-2020).

➤ **Vizitorët e huaj sipas mjeteve të transportit**

Vizitorët e huaj hyjnë në Shqipëri me rrugë tokësore, ajrore dhe detare. Mënyra më e përdorshme është transporti rrugor. Ndërsa 85% e të gjitha hyrjeve për në Shqipëri realizohen në kufijtë tokësorë, vetëm 9% e vizitorëve mbërrinë me rrugë ajrore dhe 6% me rrugë detare. Kjo është mëse e dukshme me vendet fqinjë që numërojnë deri në 80% të numrit të përgjithshëm të turistëve. Megjithatë, vizitorët ndërkombëtarë që vijnë me rrugë tokësore mbizotërojnë. 49% e turistëve nga Evropa dhe nga SHBA

³⁴ Një vizitor është i barabartë me një prurje. Fjalët “prurje” dhe “vizitor” përdoren në mënyrë të barabartë.

mbërrijnë me rrugë tokësore, 35% mbërrijnë nëpërmjet ajrit në aeroportin e Rinasit dhe 16% vijnë me rrugë detare në Shqipëri (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit: Draft-strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2014-2020; grafiku 2, shtojca).

➤ **Turistët e huaj sipas muajve – sezonaliteti**

Si të gjitha vendet e tjera Mesdhetare, Shqipëria varet ndjeshëm nga stina e verës për shkak të pushimeve të plazhit. Prej numrit të përgjithshëm të vizitorëve ndërkombëtarë në 2012, 1.724.673 ose 50% e tyre kanë qëndruar në Shqipëri në muajt korrik ose gusht. Kjo përqindje nuk ka pësuar ndryshime gjatë viteve të fundit ndërsa piku i stinës së verës është bërë shumë më i rëndësishëm për shkak të rritjes së numrit të vizitorëve (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit: Draft-strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2014-2020; grafiku 1, shtojca).

➤ **Vizitorët e huaj sipas vendit të origjinës**

Në vitin 2011, 80% e vizitorëve në Shqipëri erdhën nga vendet fqinje dhe nga Evropa Jugore. Tregjet më të largëta, përtej fqinjëve dhe përtej “vizitorëve shqiptarë”, përfaqësojnë një përqindje pakice të numrit të përgjithshme të vizitorëve. Është e rëndësishme të përmendet se rritja ka ardhur nga të gjitha rajonet. Numrat e vizitorëve arritën më shumë se dyfishin nga Evropa Veriore dhe Evropa Qëndrore/ Lindore që prej vitit 2005, dhe pothuaj u katërfishuan nga Evropa Perëndimore (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit: Draft-strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2014-2020; tabela 1, shtojca).

➤ **Situata aktuale e produktit dhe shërbimit të turizmit të Shqipërisë**

Edhe pse industria e turizmit në Shqipëri është zhvilluar në një mënyrë të paplanifikuar, sektori privat i është përgjigjur në mënyrë spontane kërkesës së

tregut duke iu përshtatur në një farë mënyre këtij tregu (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit: Draft-strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2014-2020).

➤ **Turizmi bregdetar**

Turizmi bregdetar në Shqipëri ka qenë produkti kryesor dhe kufizohet me turizmin e detit dhe diellit, i cili është edhe qëllimi kryesor i vizitorëve për në destinacionet bregdetare. Turizmi bregdetar në Shqipëri shfaqet me karakteristikat e mëposhtme:

- Shumica e turistëve në destinacionet bregdetare janë nga Shqipëria, Kosova, dhe Maqedonia.
- Shpërndarja e turistëve në zonat bregdetare nuk është e njëtrajtshme; Velipoja dhe Shëngjini kanë varësi të madhe nga tregu i Kosovës ndërsa në zonat e tjera ka një prani të shqiptarëve me banim në Shqipëri, emigrantëve, komunitetit etnik (Kosovë dhe Maqedoni) dhe vizitorëve rajonalë (Maqedonia).
- Turizmi i plazhit në Shqipëri ka një karakter të theksuar sezonal, duke filluar në qershor- korrik, me numrin maksimal në gusht dhe me ulje të menjëhershme në 1 shtator. Në Sarandë situata është disi më e mirë; për hotelet që punojnë gjatë gjithë vitit sezoni veror zgjat rreth 5 muaj.
- Duke qenë të varur nga turizmi i plazhit, shumica e hoteleve në zonën bregdetare përballen me vështirësi sezonale të funksionimit (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit: Draft-strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2014-2020).

•
Shembull 1: Turizmi bregdetar në qytetin e Sarandës. Rezultatet e Analizës të Kapacitetit Mbajtës Turistik

Nga Analiza e Kapacitetit Mbjajtës Turistik të Sarandës doli që aftësia e kapacitetit mbajjtës së

ambientit është element vendimtar për territorin e Sarandës.

Zhvillimi turistik i Sarandës është i “kufizuar” nga tejkalimi i kapacitetit mbajjtës nga ana e ambientit të territorit të Sarandës nga njëra anë për vet turizmin dhe nga ana tjetër i pavarur nga turizmi, por që bashkë kufizojnë zhvillimin urban të qytetit.

Këto rezultate na lejojnë të pohojmë mosqëndrueshmërinë aktuale të zhvillimit turistik të Sarandës dhe domosdoshmërinë urgente në kryerjen e veprimeve dhe investimeve në gjëndje të rivendosin një nivel të kapacitetit ambjental të qëndrueshëm.

Tabela 2 Analiza SWOT mbi zhvillimin turistik të Sarandës

<p>Pikat e forta</p> <ul style="list-style-type: none"> -Destinacion i ri turistik - Bukuri të peisazhit natyror - Pasuri të spikatshme kulturele - Parku Kombëtar i Butrintit - Klimë e butë - Saranda si pikë mbështetje urbane me shërbime të përparuara - Afërsi me tregjet kryesore të kërkesës Evropiane - Zbavitje (bird watching, deltaplan etj) - Afërsi me Korfuzin dhe Igoumenicën - Një bregdetet i pa prekur në pjesën verjore 	<p>Pika të dobëta</p> <ul style="list-style-type: none"> -Zhvillim urban pa kontroll në Saranade dhe Ksamil - Peizazh i komprometuar nga ndërtesat e realizuar ose në fazë realizimi - Mungesë strategjie publike mbi planifikimin në përdorimin e tokës - Mungesë në pamjen e turizmit si një sektor i ekonomisë - Probleme me rrjetin rrugor - Fshatra të braktisura në zonat rurale - Mos përgatitje e operatorëve turistikë - Ndikime shumë negative në mjedisin për shkak të braktisjeve të mbeturinave - Pjesë të bregdetit te ndotur për shkak të derdhjeve ujore pa leje - Vazhdime në ndërprerjen e energjisë elektrike - Mungesë në edukimin ambjental - Mungesë në lidhjen detare me Italinë
<p>Mundësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> -Tuor operators të interesuar për të përcaktuar destinacione të reja - Hapje të tregjeve të reja në Evropën 	<p>Rreziqet</p> <ul style="list-style-type: none"> -Konkurim i lartë me destinacionet të tjera te Mesdheut - Mungesë në provimin e një turizmi alternativë

<p>Qëndrore</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillim i ekoturizmit në brendësi të vendit - Përmirësim në administrimin e mjedisit të shërbimeve bregdetare me anë të përhapjes së teknologjive ambientale (panele fotovoltaike) 	<ul style="list-style-type: none"> - Degjenerim i mjedisit ambientale dhe rënie e plotë e destinacionit - Rreziqe hidrogeologjike të shkaktuara nga ndërtimet e tepërta mbi faleza
--	--

Burimi: Veprime për Qëndrueshmërinë e Turizmit në Adriatik. Interreg III A – Adriatic Crossborder

Turizmi kulturor

“Trashëgimia kulturore përfshin aspekte të kulturës materiale – site, ndërtesa, peizazhe, monumente dhe objekte ashtu sikurse kulturën jomateriale (shpirtërore) aspekte të së cilës janë mishëruar në praktikat sociale, jetën e komunitetit, vlerat, besimet dhe format shprehëse si gjuha, artet, zejtaritë, muzika dhe vallet”. Ajo thekson se “koncepti i trashëgimisë kulturore po evoluon, si rezultat dhe në përputhje me qëndrimet, nevojat dhe kërkesat e njerëzve drejt saj” (Loulanski T., 2006).

Sipas Colin Michael Hall & McArthur identifikohen katër vlera kryesore të trashëgimisë: vlera ekonomike të cilat lidhen me gjenerimin e të ardhurave që i vijnë një vendi si rezultat i shfrytëzimit të kësaj trashëgimie për qëllime turizmi dhe rekreacioni; vlera sociale dhe kulturore, të cilat shprehen në lidhjen e fortë shpirtërore të njeriut me vendin dhe identitetin e tij në nivel lokal dhe kombëtar; vlera shkencore dhe edukative, të cilat shprehen në transmetimin e vlerave kulturore nga njëri brez tek tjetri, për të kuptuar më mirë nivelin e lartë kulturor që e karakterizon periudhën e ndërtimit të tyre; vlera politike shprehet nëpërmjet përdorimit të trashëgimisë kulturore dhe vlerave që ajo përmban nga ana e politikanëve për të promovuar vlerat historike dhe identitetin e tyre kombëtar. Turizmi kulturor në Shqipëri karakterizohet nga gjendja e mëposhtme:

- Vendet e Trashëgimisë Botërore si parku arkeologjik i Butrintit, Berati

dhe Gjirokastra janë atraksione simbol, të ndjekura nga një varg atraksionesh historike dhe kulturore, si dhe monumentesh.

Destinacionet kryesore të vizituara nga ture të organizuara kulturore dhe të vizitave turistike janë Shkodra, Lezha, Kruja, Durrësi, Tirana, Fieri, Berati, Elbasani, Korça, Përmeti, Gjirokastra, Saranda dhe Vlora (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit: Draft-strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2014-2020).

Tabela 3 Vizitorët në atraksionet kulturore 2008-2013

Vizitorët	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Vendas	94,142	253,002	291,542	265,103	1,301,479	245,703
Të huaj	65,347	81,991	93,716	107,836	131,254	109,771
Totali	159,489	334,993	385,258	372,939	1,432,733	355,474

Burimi: MK

- Shifrat e turistëve të huaj perëndimorë që vizitojnë atraksionet kulturore, madje me një rritje prej 15-25% në vit, janë shumë të ulëta (2008 – 2012); në vitin 2013 ato kanë ulje të ndjeshme dhe numëronin vetëm 109.771 vizita. Ndërsa ekspozimi në Muzeun Kombëtar të përkrenares dhe shpatës së Skënderbeut në muajin Nëntor 2012 solli një fluks të vizitorëve vendas prej rreth 950,000 vetë.
- Destinacionet më të vizituara kulturore nga vizitorë të huaj janë parku kombëtar arkeologjik i Butrintit, Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë, parku kombëtar arkeologjik i Apolonisë dhe atraksionet kulturore të Beratit, Gjirokastrës, Korçës dhe Shkodrës.
- Përveç parkut arkeologjik të Butrintit, si atraksioni kulturor kryesor nga të ardhurat e fituara dhe numri i vizitave, atraksionet e tjera kulturore renditen në nivel shumë të ulët; nga një krahasim i vizitave në vitin 2013 dhënë në grafikun më poshtë, shifrat tregojnë se Parku Arkeologjik i Butrintit menaxhohet më mirë sesa atraksionet e tjera

kulturore.

Atraksionet më të vizituara kulturore nga shqiptarët janë dy muzetë në Krujë, ku vizitorë nga Kosova janë një faktor i rëndësishëm i numrit të madh; ata llogariten si shqiptarë dhe jo si të huaj (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit: Draft-strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2014-2020; grafiku 3, shtojca).

➤ **Turizmi natyror / Ekoturizmi / Turizmi rural**

Deri tani Shqipëria është vlerësuar nga shumë operatorë dhe vizitorë ndërkombëtarë për peizazhin/natyren/pamjen e saj të bukur, të cilat konsiderohen gjithashtu si pikat e forta të Shqipërisë. Siç vlerësohet në një studim³⁵ nga operatorë turistikë gjermanisht folës, *natyra e virgjër dhe peizazhi i Shqipërisë konsiderohen si pasuria e saj më e madhe* pas karakterit të saj mistik dhe të panjohur. Turizmi i natyrës dhe turizmi rural në Shqipëri paraqet situatën e mëposhtme:

- Larmia klimatike, gjeografike dhe fizike e territorit të saj.
- Zonat natyrore dhe rurale në Shqipëri ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit rural, ekoturizmit dhe veprimtarive në natyrë.
- Ka një numër të konsideruar turesh të organizuar të natyrës, veçanërisht në zonat kodrinore dhe malore të Shqipërisë, si për shembull në Theth, Vermosh-Lepushë, Valbonë dhe Tropojë, në Alpet Veriore, Dibër dhe zonën e Bulqizës, zonën malore të Tiranës, zonën malore të Elbasanit dhe Librazhdit, zonën malore të Korçës, malin e Tomorit, Llogara dhe Karaburun dhe zonën malore të Gjirokastrës dhe Përmetit, Lumenjtë e Osumit dhe Vjosës, qafën e Llogarasë dhe Shashicës në Vlorë, Dhërmi, Sarandë (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit: Draft-strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2014-2020).

³⁵ GIZ 2012, Studim: Cilësia dhe Menaxhimi Mjedisor i Hoteleve Shqiptare- Perceptime të Operatorëve Turistikë gjermanisht-folës për Shqipërinë

KONKLUZION

- Shqipëria është një territor i vogël gjeografik, me një kombinim të shumëllojshëm të aktiviteteve të ndryshme turistike më shumë destinacione.
- Produktet kryesore turistike janë: Turizmi i Kulturës dhe Trashëgimisë, Turizmi Rural, Turizmi i Natyrës, Turizmi i Bregdetit.
- Numri i turistëve ndërkombëtarë nga viti 2006 deri në vitin 2013 ka ardhur gjithnjë e në rritje.
- Që prej vitit 2001 numri i vizitorëve ndërkombëtarë në Shqipëri është rritur ndjeshëm në një nivel të përgjithshëm prej 1000% duke çuar mbërritjet në mbi 3,45 milion vizitorë në 2012. Rritja ishte veçanërisht e fuqishme nga Evropa dhe Ballkani Jugor (Kosova dhe ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë) midis viteve 2008 dhe 2012.
- Në vitin 2013 rritja e numrave pothuajse ndaloi në bazë viti; ka pasur vetëm një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2012.
- 85% e të gjitha hyrjeve për në Shqipëri realizohen në kufijtë tokësorë, vetëm 9% e vizitorëve mbërrijnë me rrugë ajrore dhe 6% me rrugë detare.
- Shqipëria varet ndjeshëm nga stina e verës për shkak të pushimeve të plazhit. Prej numrit të përgjithshëm të vizitorëve ndërkombëtarë në 2012, 1.724.673 ose 50% e tyre kanë qëndruar në Shqipëri në muajt korrik ose gusht. Kjo përqindje nuk ka pësuar ndryshime gjatë viteve të fundit ndërsa piku i stinës së verës është bërë shumë më i rëndësishëm për shkak të rritjes së numrit të vizitorëve.

- Turizmi bregdetar në Shqipëri ka qenë produkti kryesor dhe kufizohet me turizmin e detit dhe diellit, i cili është edhe qëllimi kryesor i vizitorëve për në destinacionet bregdetare.
- Shpërndarja e turistëve në zonat bregdetare nuk është e njëtrajtshme; Velipoja dhe Shëngjini kanë varësi të madhe nga tregu i Kosovës ndërsa në zonat e tjera ka një prani të shqiptarëve me banim në Shqipëri, emigrantëve, komunitetit etnik (Kosovë dhe Maqedoni) dhe vizitorëve rajonalë (Maqedonia).
- Arkeologjia/trashëgimia/kultura identifikohen si pikat e forta kryesore të Shqipërisë në studime të ndryshme të kryera me vizitorë dhe industrinë e udhëtimeve nga tregjet e huaja. Vendet e Trashëgimisë Botërore si parku arkeologjik i Butrintit, Berati dhe Gjirokastra janë atraksione simbol, të ndjekura nga një varg atraksionesh historike dhe kulturore, si dhe monumentesh. Destinacionet kryesore të vizituara nga ture të organizuara kulturore dhe te vizitave turistike janë Shkodra, Lezha, Kruja, Durrësi, Tirana, Fieri, Berati, Elbasani, Korça, Përmeti, Gjirokastra, Saranda dhe Vlora.
- Destinacionet më të vizituara kulturore nga vizitorë të huaj janë parku kombëtar arkeologjik i Butrintit, Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë, parku kombëtar arkeologjik i Apolonisë dhe atraksionet kulturore të Beratit, Gjirokastrës, Korçës dhe Shkodrës.
- Natyra e virgjër dhe peizazhi i Shqipërisë konsiderohen si pasuria e saj më e madhe pas karakterit të saj mistik dhe të panjohur.
- Zonat natyrore dhe rurale në Shqipëri ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit rural, ekoturizmit dhe veprimtarive në natyrë.

REKOMANDIME

Për zhvillimin e qëndrueshëm turistik duhet:

- Konsolidimi dhe përcaktimi i produkteve të reja dhe konkurruese nëpër destinacione dhe i zonave, vendeve dhe pikave turistike prioritare për zhvillimin e turizmit në Shqipëri.
- Cilësimi i vendit në tërësi si destinacion turistik dhe i zonave të veçanta turistike, si dhe prezantimi dhe promovimi i efektshëm në tregjet botërore dhe të synuara.
- Përmirësimi i lehtësisë së hyrjes dhe transportit.
- Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës.
- Ofrimi i shërbimeve më cilësore turistike.
- Zhvillimi i burimeve njerëzore për sektorin e turizmit.
- Sigurimi i shëndetit dhe sigurisë publike.

LITERATURA


1. Fennel D., (2012): Tourism ethics
2. GIZ 2012, Studim: Cilësia dhe Menaxhimi Mjedisor i Hoteleve Shqiptare- Perceptime të Operatorëve Turistikë gjermanisht-folës për Shqipërinë
3. Hall, M., & McArthur S., (1996), The Human Dimension of Heritage Management: Different Values, Different Interests, Different Issues; fq. 2-21 (cit. Duhil K. Sustainable World Heritage Site Management: Between interpretation, conservation and visitor management – case study of Bamberg, master thesis, 2005, fq.8)
4. Ham S.H. & Power R.B.; (2008): *Natural Area Tourism: Ecology, impacts and management*. Clemson University, South Carolina.
5. Loulanski, T; (2006) Cultural Heritage in Socio-Economic Development: Local and Global Perspectives Environments, IDEAS, Journal Volume 34(2) 2006, fq. 54-55.
6. Meçaj N. (1999) “*Albania tourism guide*”. Tiranë.

7. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit: Draft - strategjia e Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri 2014-2020
8. Qiriazzi P., Sala S. (2006) “*Monumentet e Natyrës së Shqipërisë*”. Tiranë: MMPAU, IDEART.

Website


1. http://www.ambiente.marche.it/Portals/0/Informazione/ProgettiUE/A_STA_Sintesi_TCCA_Saranda_alb.pdf
2. <http://www.gazetadita.al/turizmi-dhe-zhvillimi-i-qendrueshem-urban/>
3. <http://www.slideshare.net/hoteleritourismalbania/udhezues-mbi-zhvillimin-e-qendrueshem-te-turizmit-ne-shqiperi>
4. <http://cor.europa.eu/en/activities/arlem/activities/meetings/Documents/sudev-report2012-tourism-sq.pdf>
5. <http://link.springer.com/article/10.1023%2FA%3A1006593421430>
6. <http://tmstudies.net/index.php/ectms/article/viewFile/311/476>
7. https://www.google.al/search?newwindow=1&bië=1242&bih=566&q=zhvillimi+i+qendrueshem+turistik&oq=zhvillimi+i+qendrueshem+turistik&gs_l=serp.3...19688.26573.0.27831.32.13.0.18.18.0.222.912.0j3j2.5.0.msedr...0...1c.1.62.serp..9.23.1024.8zm3E8Hwt0g

SHTOJCA




Burimi: MZHKT

Fig. 1 Aktivitetet e ndryshme turistike në Shqipëri



Grafiku 1 Vizitorët ndërkombëtarë për periudhën 2006-2013 (Burimi: MZHKT)



Scientific Challenges for Sustainable Development


Grafiku 2 Vizitorët e huaj sipas mjeteve të transportit

Burimi: MZHKT

Tabela 1: Vizitorët e huaj sipas rajonit/ vendit

Rajoni	Vendet	Vizitorët në vitin 2011	Pjesa në përqindje e mbërritjeve të përgjithshme
Evropa Jugore	Itali, Greqi, Spanjë, Slloveni	59.174	21,8%
Kosova		217.774	46,9%
Maqedonia		359.174	12,4%
Evropa Qendrore/Lindore	Përfshirë Rusinë & Ukrainën	85.069	3,1%
Evropa Veriore	Mbretëria e Bashkuar & Irlanda, Vendet Skandinave, Danimarka	115.804	4,2%
Evropa Perëndimore	Austria, Gjermania, Zvicra, Vendet e Beneluksit (Belgjika, Holanda, Luksemburgu), Franca	203.943	7,5%
Evropa Mesdhetare Lindore	Izraeli, Turqia, Qipro	39.532	1,4%
SHBA dhe Kanada		71.775	2,6%
Të tjera		18.723	0,8%
Numri i Përgjithshëm		2.733.650	100%

Burimi: MZHKT



Grafiku 3 Numri i turistëve vendas dhe të huaj në atraksionet kulturore të Shqipërisë

Burimi: MZHKT

PAGESA ME MARRËVESHJE SI ZGJIDHJE E PROBLEMIT TE BORXHIT TATIMOR

Osman Neziri

Magjistër i shkencave ekonomike

Abstrakt

Ky punim synon të sjellë analiza kualitative, në raport me masat stimuluese për shlyerjen e detyrimeve tatimore me marrëveshje me këste për bizneseve nga autoritetit tatimor. Shumë biznese në Kosovë për ti shlyer detyrimet tatimore të pa paguara e të prapambeture janë të detyruar që të marrin kredi nga bankat komerciale, andaj mundësia e shlyerjes së këtyre detyrimeve me këste sipas marrëveshjes është shumë e rëndësishme për zhvillimit të afarizmit të bizneseve. Vetëm një rezultat nga kontakti me një borxhliu tatimor mund të aprovohet një marrëveshje më këse në qoftë se borxhliu tatimor nuk ka mundësi të bëjë pagesën e tërësishme menjëherë. Marrëveshja është një pajtim ose pranim i detyrimeve dhe të drejtave të përcaktuara nga dy a më shumë palë për të zgjidhur çështje, për të kryer punë, etj. Është e zakonshme që para arritjes së marrëveshjes secila palë hulumton historinë e palës tjetër dhe bazuar në te bëhen përcaktimet për marrëveshje. Kjo mënyrë e shlyerjes së obligimeve tatimore vlen në ato raste kur analiza financiare tregon se kjo është mënyra e vetme për ta bërë atë, kjo bëhet nëpërmjet pagesës në këste te njëjta për muaj të caktuar brenda afatit të caktuar.

Tab nr;1 Marrveshjet e lidhura sipas regjioneve per pages me keste

Nr	Regjioni	Biznesi	Borxhi	Pagesapar amarrvesh jes	Shuma e paguarne %	Nr I kisteve	Shuma e kistit
1	Prishtina 1	10	2,751,445.33	532,309.15	19.35	12	286,345.00
2	Prishtina 2	10	524,301.60	131,085.00	20.02	12	33,740.00
3	Prishtina 3	10	360,872.73	96,659.28	26.78	9.5	34,937.93
4	DTM	10	3,470,726.03	676,820.20	19.50	8.8	319,130.95
5	Prizreni	9	157,915.46	31,294.00	19.82	12	16,690.00
6	Mitrovica	6	130,392.57	52,935.42	40.60	9.5	24,102.00
7	Peja	16	193,275.83	53,404.00	27.63	12	24,345.00
8	Gjakova	10	183,772.73	52,720.00	28.69	10	16,802.00
9	Gjilani	10	120,369.71	18,633.76	15.48	14.5	2209.7
10	Ferizaji	9	309,482.45	63,465.53	20.51	9.6	6393.14
Gjithsejt		100	8,202,554.44	1,709,326.34	23.83	11	764,695.72

Sigurimi i te dhënave ATK- 2014

Hulumtimi i këtyre informatave në ATK i trajton ato raste të shlyerjes së detyrimeve tatimore me pagesa me këste.

Konceptet kyçe: detyrimet tatimore, borxhli tatimor, marrëveshje, analiza financiare .

HYRJE

Zgjidhje e problemit të borxhit tatimor me marrëveshje, pagesa me këste

Qëllimi i studimit të kësaj problematike është zbatimi standard i kësaj metode të shlyerjes se detyrimeve tatimore për bizneset që kanë mungesë fondesh me qëllim që bizneset të mundin ta ushtrojnë veprimtarin e tyre pa ndërmarrjen e masave shtrënguese nga autoriteti tatimor. Është e qarte se shume aktivitete janë te rëndësishme per një autoritet tatimore te suksesshëm, siç janë, edukimi dhe shërbimet, kontrolli, teknologjia informative, përkrahja, etj.

Të gjitha këto punë bëhen per te arritur një qellim përfundimtar, te kemi një përbushje të detyrave në

nivel sa më të lartë. Të gjitha funksionet brenda autoritetit tatimor duhet të ndihmojnë në këtë drejtim. Nëse nuk mbledhen të hyra për qeverinë atëherë të gjitha funksionet brenda autoritetit tatimor janë të pavlefshme. Në këtë mënyrë, mbledhja profesionale është e një rëndësie kritike për një autoritet tatimor.

Formulimi i përmbajtjes së punimit ka të bëjë me:

- ▶ Studimi i faktorëve që ndikojnë në mbledhjen sa me efikase të tatimeve;
- ▶ Studimi i faktorëve që ndikojnë në përmbushjen vullnetare të tatimeve;
- ▶ Testimi në teren i metodës marrëveshje me këste për shlyerjen e tatimeve ;
- ▶ Efikasiteti i këtyre masave në mbledhjen e tatimeve në veçanti pagesa me këste;
- ▶ Të rriten njohuritë për praktikat dhe zhvillimet ndërkombëtare në fushën e tatimeve;
- ▶ Të identifikohen ide të reja për përmirësimin e autoritetit tatimor;
- ▶ Njohurit se aktiviteti ekonomik është duke lëvizur nga fabrikimi në shërbime.

Roli i tatimeve në jetën financiare e me këtë edhe në jetën ekonomike të vendit po rritet nga viti në vit. Tatimet kanë rol të rëndësishëm për shtetin, tatimet mund të krahasohen me pagat e punëtorëve duke theksuar se sikurse punëtori që nuk mund të ekzistoj pa pagë ashtu as shteti nuk mund të ekzistoj pa tatime. Tatimet janë pagesa të detyrueshme, të vendosura me ligj pa

kthim të drejtpërdrejtë që aplikohen mbi të ardhurat, konsumin dhe pasurinë, dhe në këmbim të të cilave përfitohen shërbimet publike.

Vjelja efektive dhe gjithëpërfshirëse e detyrimeve tatimore është një nga prioritete e çdo qeverie. Sektori publik dhe departamentet e shtetit me theks të veçantë buxhetet në shtete të ndryshme vazhdimisht përballën me vështërsit e mbledhjes së tatimeve, madje në shumicën e rasteve aplikohen metoda mjaft të ashpra për përmbushjen e detyrimeve tatimore ndaj tatimpaguesve. Zbatimi efektiv i ligjeve tatimore është jetik për mundësinë e qeverisë të plotësojë nevojat buxhetore , ligjet për tatimet janë përpiluar që ti ofrojnë autoritetit tatimor mjetet të fuqishme administrative për vjeljen e të hyrave.

Kërkimi në këtë fushë përqendrohet në ofrimin e një baze ligjore dhe një qasje praktike ne trajtimin e vendosjes së çështjeve administrative me qëllim që të ofroj autoritetit tatimor informata , qartësoj nivelin e tanishëm te përgjegjësive dhe vendosjen e çështjeve administrative në fushën tatimore.

Mbledhja e tatimit mund te jen burim i zhvillimit apo pengës e madhe për zhvillim.

Mbledhja e parave është tërësisht çështje kohe:

- Mbledhje e hershme apo
- Do ta humbësh

Historiku i tatimeve :

1. Prezentë me mijëra vjet;
2. Asnjë herë burim i kënaqësisë publike;

3. Mbledhja e tatimeve si një nga profesionet më të vjetra në botë;
4. Një profesion ndërkombëtar me dukuri të përbashkëta;
5. Probleme të ngjashme;
6. Përvoja të njëjta të mbledhjes.

Detyrimet tatimore lindin nga deklaratat tatimore të dorëzuara nga tatimpaguesit apo të lëshuara nga Autoritetet Tatimore në interes (emër) të tatimpaguesit, vlerësimi i kontrollit tatimor, llogaritja periodike e interesit dhe ndëshkimet e vendosura në rast të shkeljes administrative.

Praktika deri me tani ka treguar se sistemi tatimor nga vendi në vend ndryshojnë shumë për shkak të faktorëve, politik, ligjor, historik, kulturor dhe ekonomik.

Ekzistojnë vetëm pesë mënyra për të shlyer një detyrim tatimor. Kjo është e vërtetë në tërë botën. Këto pesë mënyra për të shlyer një detyrim janë të vërteta pavarësisht se a flasim për një mbledhje si private apo publike.

Mënyra e parë dhe më e mire për ta shlyer një detyrim është që të inkasojmë shumën e tërësishme të detyrimit. Kjo mund të ndodhë menjëherë pasi t'ia dërgojmë njoftimin e parë tatimpaguesit delikuent, apo derisa të mos jetë nevoja për të shfrytëzuar ndonjë mjet tjetër të mbledhjes. Nganjëherë ndodhë që tatimpaguesi të tregojë se është i pa aftë të bëjë pagesën e tërësishme edhe pse në kemi zbuluar me një analizë financiare se ai mund ta bëjë këtë. Në këto raste, autoriteti tatimor duhet të insistojë që të bëhet pagesa e tërësishme e detyrimit. Një gjendje jo e mirë financiare nuk do të thotë se ka të drejtë të mos bëjë pagesën e tatimit.

Mënyra tjetër për të bërë një shlyerje të detyrimit tatimor është që t'i ofrohet tatimpaguesit një shtyerje më e gjatë apo më e shkurtër kohore për

pagesën e tatimit, në rastet kur shihet nga analiza financiare se një pagesë e tëresishme nuk është e mundur me një herë. Ky opcion është zakonisht i mundshëm për ato biznese të cilat kanë pune sezonale apo periodike, si p.sh. bujqësia apo ndërtimataria dhe ka një mundësi që të zgjatet afati i pagesës prej 30deri në 90 ditë.

Mënyra e tretë për të shlyer një detyrim është nëpërmjet marrëveshjes për pagesë me këste, ndonjëherë e quajtur marrëveshje për pagesë më të gjatë, në ato raste kur analiza financiare tregojnë se kjo është mënyra e vetme për ta bërë atë, kjo bëhet nëpërmjet pagesës me këste të njejta për muaj te caktuar brenda afatit të caktuar.

Mënyra e katërt për të shlyer një detyrim tatimor është duke përcaktuar se ky detyrim nuk mundet të mblidhet për arsye se nuk mund të gjendet vendi i tatimpaguesit (bazuar në hulumtimin e dokumentave) apo për arsye se, (bazuar në analizat financiare) nuk ka kurfarrë mundësie financiare që detyrimi të paguhet. Në të dy rastet , mbledhësi duhet të përcaktojë se a ekziston mundësia e përmirësimit të kësaj gjendjeje në të ardhmën, nëse po, atëherë ky rast duhet të ruhet si dosje në pritje për një shqyrtim të më vonshëm, nëse jo, atëhere ai vendoset në dosje dhe nuk shikohet prapë pasi nuk mund të përcaktohen shkaktarët.

Mënyra e pestë dhe e fundit është që detyrimi të shlyhet nëpërmjet të mbledhjes së sforcuar. Veprimet e mbledhjes së sforcuar janë:

- Bllokimi i llogarive bankare të tatimpaguesit;
- Vendosja e barrës, urdhër-vjeljes;
- Konfiskimi i pasurisë së TP;
- Shitja e pasurisë së TP për të mbuluar borxhin tatimor;

- Bllokimi I mallrave të TP në import / eksport në Dogana;
- Mos-lejimi I TP të lëshojë vendin;
- Fillimi i padisë juridike kundër TP.

Sistemi tatimor në Kosovë është tërësisht i ri , pa trashëguar asnjë element të sistemit të kaluar tatimor ,i ngjajshum me praktikat ma të mira evropiane dhe ndërkombëtare ndihmuar nga BE, USAJD, BB, FMN etj. Sistemi tatimor në Kosovë është pasuruar me kalimin e kohës nga mënyra e paragjykuar e taturjes është kaluar në mënyrën reale të taturjes. Në Kosovë, edhe pse ekzistojnë ligje me standarde evropiane , reformat në këtë lëmi janë të nevojshme në mënyrë që Kosova te jetë konkuruase me shtetet fqinje.

Shumë biznese në Kosovë për të shlyer detyrimet tatimore të pa paguara e të prapambetura janë te detyruar që të marrin kredi nga bankat komerciale, andaj mundësia e shlyerjes se këtyre detyrimeve me këste sipas marrëveshjes është shumë e rëndësishme për zhvillimit te afarizmit të bizneseve.Vetëm një rezultat nga kontakti me një borxhliu tatimor mund të jetë një marrëveshje më këse në qoftë se borxhliu tatimor nuk ka mundësi të bëjë pagesën e tërësishme menjëherë. Marrëveshja është një pajtim ose pranim i detyrimeve dhe të drejtave të përcaktuara nga dy a më shumë palë për të zgjidhur çështje, për të kryer punë, etj. Është e zakonshme që para arritjes së marrëveshjes secila palë hulumton historinë e palës tjetër dhe bazuar në të bëhen përcaktimet për marrëveshje. Kjo mënyrë e shlyerjes se obligimeve tatimore vlen në ato raste kur analiza financiare tregon se kjo është mënyra e vetme për ta bërë ate, kjo bëhet nëpërmjet pagesës në këste te njëjta për muaj të caktuar brenda afatit të caktuar. Analiza financiare bëhet çdo here kur nuk kemi informat,për te gjithë tatimpaguesit e mëdhenjsi dhe:

Kur duhet vendosur për:

Scientific Challenges for Sustainable Development

1. Shlyerje
2. Detyrim apo
3. Shtyrje

Tab nr;1 Marrveshjet e lidhura sipas regjioneve per pages me keste

Nr	Regjioni	Biznesi	Borxhi	Pagesa para marrveshjes	Shuma e paguar në %	Nr I kisteve	Shuma e kistit
1	Prishtina 1	10	2,751,445.33	532,309.15	19.35	12	286,345.00
2	Prishtina 2	10	524,301.60	131,085.00	20.02	12	33,740.00
3	Prishtina 3	10	360,872.73	96,659.28	26.78	9.5	34,937.93
4	DTM	10	3,470,726.03	676,820.20	19.50	8.8	319,130.95
5	Prizreni	9	157,915.46	31,294.00	19.82	12	16,690.00
6	Mitrovica	6	130,392.57	52,935.42	40.60	9.5	24,102.00
7	Peja	16	193,275.83	53,404.00	27.63	12	24,345.00
8	Gjakova	10	183,772.73	52,720.00	28.69	10	16,802.00
9	Gjilani	10	120,369.71	18,633.76	15.48	14.5	2209.7
10	Ferizaji	9	309,482.45	63,465.53	20.51	9.6	6393.14
Gjithsejt		100	8,202,554.44	1,709,326.34	23.83	11	764,695.72

Sigurimi i te dhënave ATK- 2014

Bazuar në të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), të paraqitura në tabelën e mësipërme, kemi analizuar 100 biznese që kanë hyrë në marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve tatimore, shuma e detyrimit tatimor është mbi 8 mili € pagesa para marrveshejes është 23% e detyrimit tatimor, mesatarja e kësteve është 11 pagesa e kësteve mujore është afër 1 mil.

Në tabelen në vazhdim kemi hulumtuar shlyerjen e detyrimeve tatimore duke i zbatuar teknikat e masave shtërnguese, dhe kemi analizuar rezultatet e pagesave nga këto masa.

Tab nr.2, Pagesat e detyrimeve tatimore duke i zbatuar teknikat e masave shtrënguese

Nr.	Regjioni	Borxhi total	Nr l t/p	1. Kërkesat Tatimore			1. Barra tatimore/pasuri te luajtshme	paluajtshme	3. Barra tatimore/automjete	3. Vrejti e fundit para konfiskimit		4. Letër kujtesa e parë	5. Tatimi në rrezik	6. Lidhja e marreveshjes	7. Urdheri per bllokim dhe transfer	1. Banka	2. Thesar	palet e treat	arketueshme	5. Urdhervjelja nga pagat dhe rrogat	8. Konfiskimi I Psurise	9. shiti e pasuris me ankand	10. Embargo ne dogan	11. Ndalesane kufi	pergjegjes	3. Pronaret perfites dhe te emruarit	tatimit	14. Fajla e ndeshkimeve	15. Vendosja ne fajll pasiv	16. Anulim -Fshirje tatimi	17. Pagesa pas Çdo aktiviteti
				1. Vet-Deklarim	2. Njoftim vleresim	publik				1	1																				
1	Prish1	5,065,032.24	10	1	0		1	4	5	1	1		2		8	8						7	2		1	3				220,200.00	
2	Prish2	3,363,500.32	10	2	0		3			6	6		3		9	9	3	1	1			7	5			3		1		239,216.37	
3	Prish3	8,126,669.26	9		0	3	6	9	4	3	5	4			1	9	4					8	0			1				2,203.29	
4	DTM	2,754,288.67	10	1	6	3	3	7	2	3	3	1	3	1	2	2	1					2								436,438.72	
5	Prizreni	1,576,425.25	9	2	8	2	7	5	5	6	3	2	2	2	9	9	1					5				5		1			
6	Mitrovicë	1,150,919.56	10	3	5	4	5	1	2	2	2				7	5						6	2			2				20,397.00	
7	Pejë	1,731,518.48	10	1	8		4	4	4	3	4		1		8	7	1	1				3	3			2				15,860.00	
8	Gjakovë	1,213,606.06	11	1	0	3	8	9	7	8	8		2	3	9	0		1		2	2	3	2			5				5,594.04	
9	Gjilan	4,088,166.00	9	1	8		5	6	6	5	4	1	2	2	7	6						3	2			3				204,153.23	
10	Ferizaj	1,816,702.51	9	1	9		3	8	5	2	3		3		7	5						5	4			5				92,993.30	
	Gjithëjt	30,886,828.35	97	13	84	15	45	53	40	49	59	88	18	88	76	70	10	3	1	2	2	49	30		1	38		2		1,237,055.95	

Bazuar në të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), të paraqitura në tabelën e mësipërme, janë analizuar 97 biznese (përafërsisht nga nga 10 raste për secilin regjion,shuma e obligimit tatimor të bizneseve të kontrolluara është 31 549 439.80€ pagesa në total për obligimet tatimore 1,237 055.95 që paraqet 4.0% të obligimit tatimor të paguar.Vetë-deklarimi - nga numri i përgjithshëm i rasteve të rishikuara 16 raste obligimi tatimor ka lind nga vetëdeklarimi i bizneseve , shuma e obligimit tatimor është 3,720,832.€ kurse pagesat janë 725, 041.32 euro që paraqesin 19.5% të obligimit tatimor të paguar .

Kontrolli-Raste kontrolli janë 81 borxhlinj, borxhi i të cilëve arrin 27 828 607€ dhe pagesa totale për këtë kategori borxhi është 512 014 € që paraqet 1.9% e obligimit tatimor të paguar nga kontrolla.

Nga analizat e bëra të këtij procesi shihet se tatimi i pa paguar i bizneseve të kontrolluara është mjaft i madh 31 549 439€ kurse inkasimi i borxheve në raport me obligimin është 1237 056 që do të thotë se vetëm 4% e borxhit është inkasuar.

KONKLuzion

Tatimpaguesi nuk ka të drejtë ligjore për një marrëveshje me këste, edhe pse ekzistojnë masa specifike në ligj që autorizojnë ATK-në të vendosë marrëveshje më këste kur ajo është alternativa më e mirë për zgjidhjen e borxhit tatimor të tatimpaguesit. Autoriteti tatimor është ajo që vë kushtet e marrëveshjes.

Tatimpaguesi i regullt dhe me pagesa të plota duhet të ketë:

- Të drejtë ligjore për pagesën e detyrimeve tatimore me marrëveshje;
- Suspendimi i interesit gjatë një marrëveshje me këste;

-Ulja e ndëshkimeve të lidhura me marrëveshjen me këste;

-Marrëveshjes fleksibile nëse një tatimpagues ka biznes sezonal.

Tatimpaguesit kanë të drejta si:

- Ata janë klientë ;
- Të trajtohen me respekt;
- Të trajtohen me nder dhe në mënyrë të njëjtë .

Literatura:

1. Robert Phillips, Revenue Collection And Compliance Manual, Arlington, Virginia;
2. Prof. dr. H.H. Gorani, Kontabiliteti I Informatizuar Prishtinë 2007;
3. Kasem Seferi, Kontrolli Tatimor Tiranë 1999;
4. Ligji Riorganizimin e Personave Juridik në Falimentim;
5. Ligji 2003/12 mbi Qasjen në Dokumente Zyrtare;
6. Ligji 2003/25 mbi Kadastrën;
7. Ligji 2004/26 mbi Trashëgiminë në Kosovë;
8. Ligji 03/L--222 mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore;
9. Kodi Penal i Kosovës Rregullorja e UNMIK-u ne 2003/25, 6 korrik 2003;
10. Kodi i procedurës Penale të Kosovës Rregullorja e UNMIK-u ne 2003/26, 6 korrik 2003.

RIKONCEPTIMI I PRODHIMIT ARTIZANAL, FROM GJIROKASTRA – MADE IN GJIROKASTRA

PROF. ASOC.DR. ERMIRA QOSJA

**Departamenti i Menaxhimit dhe Ekonomiksit, Universiteti Europian i
Tiranës**

ermira.qosja@uet.edu.al

Abstract

Cultural and historical heritage of Gjirokastra (part of the World Heritage List of UNESCO since 2005) is one of the greatest potentials of its development, which on the one hand should be part of all national and regional strategies tourism and in turn be resized and modernized in order to become a very important axis of the economy (small business) local, the impact on local income and employment.

The purpose of this paper is to identify ways through which small business of Gjirokastra artisans can revitalize and become attractive to tourists (foreign and Albanian) who visit the city.

The paper is based on primary research "two questionnaires, one for tourists and one for artisans (small business), which were distributed during the days of Cultural and Historical Heritage of Gjirokastra (26-28 September 2014) as well as in a number of interviews half structured with expert craftsmen and conversations with cultural and historical researchers.

Key words: cultural and historical heritage, artisans, tourists, revitalization of souvenir business.

I. Hyrje

Gjirokastra dhe Berati janë të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s (Albanian National Commission for Unesco, 2006) si një sit i vetëm, për shkak të ngjashmërisë që këto qytete paraqesin nga ana arkitekturore, por sidomos të vlerave kulturore e historike të cilat mund të konsiderohen unikale.

Gjirokastra është shpallur “Trashëgimi Botërore” sipas kriterit (iii) - një dëshmi unike e një tradite kulturore të jetës e zhvilluar në shek XIV – XIX dhe sipas kriterit (iv) – tipi i shtëpisë së fortifikuar të Gjirokastrës paraqitet si shembull i dallueshëm i një tipi konstruksioni që ilustron një mënyrë jetese në periudhën e shek XIV – XIX (Albanian National Commission for Unesco, 2006).

Gjirokastra e ruan të paprekur skemën e saj urbanistike, duke u përbërë nga disa lagje të ndërtuara në një terren të pjerrët që rrethojnë kalanë, pazari dhe objektet e kultit. Çdo shtëpi ka karakteristika të veçanta që lidhen me terrenin në të cilin janë ndërtuar, ato dallohen për lidhjen e karakteristikave mbrojtëse të tyre dhe çatinë me pllaka guri, në harmoni perfekte me peisazhin shkëmbor (Martini, 2014). Gjirokastra, “qyteti i një mijë shkallëve” apo ndryshe “Qyteti i Gurtë” është sot një potencial shumë i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit të trashëgimisë kulturore (Fondacioni Gjirokastra)

Gjirokastra karakterizohet nga një pasuri kostumesh popullore, traditë popullore dhe muzikore, e njihet për përpunimin e drurit dhe të gurit . Gratë gjirokastrite kanë trashëguar brez pas brezi aftësinë për të bërë punimet. Kostumet lokale janë tradicionalisht të zbukuruar me qëndisma të komplikuara. Po ashtu, prodhohen me lesh natyral lokal në mënyrë artizanale

qilima e velenxa, triko, çorape e doreza, të famshme në të gjithë vendin janë dhe dantellat e Gjirokastrës.

Vitet e komunizmit shënuan përpjekje për një industrializim në shkallë të gjerë, por pati edhe përpjekje për të mbrojtur trashëgiminë kulturore unike të qytetit. Periudha pas 90-ës për shkak të humbjes së shumë vendeve të punës, emigrimit dhe migrimit të brendshëm sollën dhe cënim të trashëgimisë e banesave karakteristike, grabitjen e Muzeut Kombëtar të Armëve në Kala, deri në djegien e një pjese të Pazarit. Pas viteve 2000 ekonomia filloi të ringrihej e të marrë jetë bujqësia, blegtoria dhe industria e përpunimit.

Vitalizimi i trashëgimisë historike dhe kulturore, dhënia jetë e turizmit kulturor mbetet një nga shpresat më të mëdha për zhvillimin ekonomik të qytetit (kryeministria.al/newsroom, 2015), prej nga ka zanafillën dhe ky punim, por me një qëllim shumë specifik: *Të identifikojë rrugët, nëpërmjet të cilave biznesi i vogël i artizanëve gjirokastritë mund të rivitalizohet dhe të bëhet tërheqës për turistët (të huaj dhe shqiptarë) që vizitojnë qyteti.*

Pyetjet kërkimore të shtruara në punim janë: “A ka një treg real të prodhimit artizanal në Gjirokastër ?” dhe “Cilat janë rrugët për vitalizimin e biznesit të vogël të artizanëve?”, ndërsa **hipotezat e punimit** janë:

H.0. Prodhimi artizanal në Gjirokastër ka treg, por duhet rikonceptuar produkti i tij në përputhje me gjithë fazat e një proçesi marketing.

H.1. Prodhimi artizanal në Gjirokastër nuk ka treg.

Punimi bazohet në kërkimin primar i realizuar nëpërmjet anketimit me pyetësorë të 54 artizanëve (61% të pjesëmarrësve në Panair) dhe të 89

turistëve shqiptarë e të huaj, gjatë ditëve të Trashëgimisë Kulturore dhe Historike të Gjirokastrës (26-28 Shtator 2014) si dhe në një numër intervistash gjysëm të strukturuar me artizanë dhe biseda me njohës e studjues të trashëgimisë kulturore dhe historike.

II. Metodologjia e përdorur

Qëllimi i vënë në këtë punim dhe pyetjet kërkimore të shtruara, nënkuptojnë njohjen e kërkesës dhe të ofertës së produkteve të prodhimit artizanal. Kërkohet në këtë mënyrë, nga njëra anë një evidentim i qartë i të gjithë problematikave që kanë prodhuesit dhe tregtuesit e produkteve artizanale dhe nga ana tjetër, njohja e nevojave, dëshirave dhe pritshmërive të blerësve, turistëve shqiptar e të huaj (të pranishëm në ditët e Trashëgimisë Kulturore në qytetin e Gjirokastrës).

Pyetjet kërkimore të shtruara në punim janë: “A ka një treg real të prodhimit artizanal në Gjirokastrë?” dhe “Cilat janë rrugët për vitalizimin e biznesit të vogël të artizanëve?”, ndërsa hipotezat e punimit janë:

H.0. Prodhimi artizanal në Gjirokastrë ka treg, por duhet rikonceptuar produkti i tij në përputhje me gjithë fazat e një procesi marketing.

H.1. Prodhimi artizanal në Gjirokastrë nuk ka treg.

Punimi kërkonte formulimin e dy pyetësorëve, një për turistët dhe një për prodhuesit/shitësit e produkteve artizanale. Gjithashtu, me shitësit/artizanët u zhvilluan dhe intervista gjysëm të strukturuar, në funksion të specifikave të produkteve që ofronin, por dhe të origjinës së tyre e problematikave shumë personale.

Nga pikëpamja gjinore, artizanët/shitësit e anketuar janë 52 % femra (28 nga 54 të anketuar), i pritshëm ky rezultat për faktin se pjesa më e madhe e punimeve artizanale janë punime me grip, qilima e rrugica të leshta dhe pambuku, çorape me motive tipike shqiptare, triko dhe punime të tjera me shtiza, ndërsa prodhimet e baltës, qelqit, gurit, bronzit e drurit që realizohen nga meshkujt.

60% e artizanëve /shitësve të anketuar banojnë në Gjirokastrë dhe në qarkun e saj (përfshirë këtu Përmetin dhe Tepelenën); për shkak të afërsisë gjeografike 9.2 % vijnë nga qarku i Vlorës (më specifikisht nga Delvina dhe Saranda); po 9.2% nga qarku i Korçës (më saktësisht nga Pogradeci).

Punimi ka disa kufizime: së pari, koha e kërkimit është përqëndruar vetëm në ditët e Panairit, së dyti, kërkimi mbi turistët duhej të shtrihej më gjerë (pra dhe në qytete të tjera) dhe në agjensitë turistike të cilat organizojnë turet në Shqipëri.

III. Analiza e rezultateve

III.1. Analiza e pyetësorëve për artizanët/shitësit


Numri i bizneseve artizanale të pranishëm në Panair ishte 88, 54 prej tyre ose 61% pranuan të plotësonin pyetësorin dhe mbi to është bërë një analizë cilësore. Koha e marrjes me këtë aktivitet (prodhim apo shitje e produkteve tipike artizanale shqiptare) mesatarisht është 7 vjet, që dëshmon nga njëra anë për një aktivitet ekonomik (mikrobiznes) që ka mundur të mbijetojë, por dëshmon gjithashtu se artizanët me përvojë e tipikë gjirokastritë kanë shkuar në vite drejt shuarjes.

Vetëm 8 biznese (nga 54 të anketuar) kanë një histori 10 vjeçare, por vlen të theksohet që 70% e artizanëve/shitësve të anketuar tregojnë se kanë patur eksperiencë në këtë fushë, sidomos në prodhimin e produkteve karakteristike

vendore përpara se të hapnin aktivitetin e tyre aktual. Prodhimi artizanal kudo në botë është një aktivitet që përcillet kryesisht me trashëgimi e specifika shumë lokale, një pjesë e prodhuesve/shitësve që anketuam në Gjirokastër ishin “të rinj” në zanat, evidentohet mungesa e profesionalizmit dhe ngjante në disa raste si një aktivitet i ushtruar në mënyrë aksidentale.

Një nga pyetjet kishte të bënte me matjen e kënaqësisë së artizanëve/shitësve nga ecuria e aktivitetit të tyre dhe rezultatet paraqiten në grafikun e fig.1, prej nga rezulton se pak më shumë se 60% të artizanëve/shitësve që i janë përgjigjur pyetësorit, janë mesatarisht të kënaqur nga ecuria e aktivitetit të tyre; rreth 13% shprehen se janë pak ose aspak të kënaqur, ndërsa 26% shprehen se janë shumë të kënaqur me vijimin e punës së tyre.

Fig.1. Niveli i kënaqësisë së artizanëve/shitësve nga aktiviteti i tyre



Siç shihet, 87% e të anketuarve janë optimistë dhe relativisht të kënaqur me aktivitetin e tyre. Nga rezultati i anketimit kuptohet që oferta e artizanëve/shitësve është ende relativisht e kufizuar në krahasim me kërkesën e pranishme në treg. Mbi këtë bazë, mund të pranohet që tregu do të

përballonte një numër edhe më të lartë të aktiviteteve artizanëve/shitëse si dhe do të mirëpriste zgjerimin e gamës së produkteve të ofruara.

Pyetjes nëse objektet e shitura janë prodhuar në mënyrë vetjake nga artizanët/shitësit apo thjeshtë janë blerë, 70% e tyre (38 nga 54) i janë përgjigjur se produktet e shitura, janë montuar pjesërisht ose janë prodhuar tërësisht vetë. Pjesa tjetër (16 biznese në 54) janë thjesht ndërmjetës të produkteve tipike dhe artizanale. Përbën një tendencë shumë të mirë fakti se shumica e artizanëve kanë deklaruar se janë prodhuesit e drejtpërdrejtë të produkteve që shesin, ndonëse nuk është deklaruar shkalla e plotë i origjinës së tyre, pra nëse kanë marrë produkte gjysëm të gatshme apo thjesht lëndën e parë.

Artizanët/shitësit tregojnë se kanë nevojë/domosdoshmëri për të gjetur në tregun e punës njerëz të formuar apo me eksperiencë në punimin/prodhimin artizanal, veçanërisht ata shprehen se do të kishin dashur të shisnin më shumë produkte që vijnë nga punimi i drurit dhe punimi me shtiza, që për të qenë realistë kërkesë për to vjen jo vetëm nga vlerat utilitare, por është dhe në modë.

Kërkesë të lartë ka për kostume të mirëfillta popullore dhe për veshje që stilizohen mbi motivet popullore dhe traditën. Ka një prirje për të zgjeruar gamën e produkteve ushqimore tradicionale të Gjirokastrës, përfshirë këtu dhe pijet, pa harruar llojet e ndryshme të kafesë së pjekur dhe të përgatitur sipas traditës vendase.

Afërsisht gjysma e të anketuarve të artizanëve/shitësve pyetjes se “çfarë mund të bënin më shumë për të rritur shitjet e produkteve të tyre?” i janë përgjigjur se nuk e dinin ose se nuk kishte asnjë gjë tjetër për të cilën ata mund të angazhoheshin për të rritur sasinë dhe cilësinë e produkteve të

shitura. Rreth 30% e të anketuarve shprehen se promovimi dhe reklamimi i aktivitetit të tyre do të ishte i dobishëm për të rritur xhiron vjetore, pse jo duke marrë pjesë edhe në panairë të tjera, ndërsa rreth 15-20% shprehen se për të pasur një sukses më të madh do t'u duhej të kishin më shumë njerëz në numër dhe cilësi që punonin për ta, si dhe një zgjerim i aktivitetit prodhues e tregtar.

Përsa i përket kushteve infrastrukturore në të cilin zhvillojnë aktivitetin, ata shprehen se këto kushte janë relativisht të mira dhe të kënaqshme (69%), ndërsa pjesa tjetër mendon se do të duhej që ekspozimi të ketë kushte më të mira.

Prodhimi dhe tregtimi i produkteve artizanale kërkon dhe një qasje komunitare, 41 % e të anketuarve janë të angazhuar në shoqata apo organizata jofitimprurëse, pjesa tjetër, pra pjesa më e madhe reflekton një qasje të mbyllur e ndoshta pak dhe primitive ndaj ndryshimeve të mikro e makromjedist. Një pjesë e artizanëve/shitësve të anketuar na rezulton se e zhvillojnë aktivitetin në kufijtë e informalitetit..

Elementi i vetëm që lidh me pushtetin vendor artizanët/shitësit është ai tatimor. Ata shprehen se kanë një barrë të ulët tatimore, 32 nga 54 të anketuar ose 60% thonë se janë të përjashtuar nga taksat si organizata. Pjesa tjetër e të anketuarve e konsideron barrën tatimore si tepër të lartë, ata shprehen se e ushtrojnë aktivitetin e prodhimit dhe shitjes vetëm në mënyre sezonale, apo sepse nuk i është njohur e drejta për përjashtim nga tatimet vendore dhe konsiderohen si biznese me objektiv ekskluziv fitimin.

III.2. Analiza e intervistave gjysëm të strukturuar me artizanët/shitësit

Më poshtë jepet një përmbledhje e disa prej intervistave gjysëm të strukturuar më tipike:

Anastas Petridhi, zdrukthtar me mbi 25 vite në këtë zanat, ka hapur prej 4 vitesh dyqanin e tij në Qafë Pazar “ËoodCarver” dhe merret me gdhendjen e drurit me forma, madhësi dhe stile të ndryshme; ai shprehet se biznes, po i ecën mirë dhe është i kënaqur, por që është një punë sezonale dhe një pjesë të vitit mbetet e fjetur. Z. Petridhi, tregon që nuk ka bërë asnjë marrëveshje me biznese të tjera, apo në qytete të tjera për shpërndarjen e prodhimeve të tij, sepse nuk gjen interes për bashkëpunim.

Leonora, një zonjë që punon me grip veshje për fëmijë, shprehet se turistët blejnë vetëm produkte të vogla, të imëta dhe nuk interesohen për produkte me përmasa të mëdha. Shprehet që turistët paguajnë aq pak për një punë dore që i kane marrë orë e orë të tëra dhe ndjehet disi e pa motiv dhe shpresë për ndryshim.

Vjollca Mezini, duket se jo vetëm ka një dyqan të saj, por është optimiste dhe e qartë në atë çka bën e ofron: kartvizita e saj tregon ëeb, adresën e emai-itl, dhe profilin në fb. Ndërsa bisedon me të, kupton që ajo ka ngritur një netëork me rreth 50 gra që punojnë me porosi për Gold Hand, kështu e quan biznesin e saj dhe që kanë arritur të punojnë e të marrin porosi nga jashtë Shqipërisë. Gjithashtu, në dyqan vihet re lehtë, jo vetëm shumëllojshmëria e produkteve me dorë, por dhe një tendencë më moderne dhe mbi të gjitha prezantim e shërbim i orientuar nga klienti.

Në përgjithësi, artizanët/shitësit kanë një shqetësim të përbashkët: pamundësinë për të hapur tregun e për më tepër promocionin me forma nga më të ndryshme. Mungojnë dhe mjetet e thjeshta të të bërit marketing dhe të orientimit të klientit, nga një profil në Facebook e deri tek ëebsite, për më tepër të krijohet përshtypja që biznesi/puna e tyre lind, rritet dhe mbyllet në

Qafën e Pazarit, shpesh nga pikëpamja e modelimit dhe dizajnit dhe pa lidhje me Gjirokastrën dhe veçoritë e saj.

Gjatë bisedës apo tavolinave të rrumbullakta me ta, kuptohej mungesa e plotë të njohurive në marketing dhe të disa instrumentave efikase e me pak kosto që mundet të shihen si një pikë e fortë për të çuar përpara biznesin e tyre. Dimensioni dixhital dhe e-marketing dukej që nuk kishte lidhje me handmade e tyre, për më tepër projektet apo organizatat e ndryshme nuk kishin mundur të ndikonin apo të realizonin ngritjen e kapaciteteve në këtë drejtim.

Teksa artizanët/shitësit shprehnin rezervat e klientëve dhe tendencën e tyre për të blerë suvenire, produkte të vogla në përmasa e të lehta në peshë (produktet e punimit të gurit ishin shumë larg kuptimit të kësaj nevoje, por jo vetëm to) dukshëm ata hezitonin në shtimin e gamës së produkteve apo të dizenjove të tyre, madje dhe të një tendence që handmade-it të tyre të mos i jepnin një karakteristikë tipike gjirokastrite (kjo vihej re që nga çentrot me grep, prodhimet me shtiza, qëndismat, punimet e gurit, shajkur e drurit).

III.3. Analiza e pyetësorëve me turistët


Në ditët e Trashëgimisë Kulturore dhe Historike, qyteti i Gjirokastrës vizitohet nga qindra turistë (ne nuk mundëm të kishim të dhëna më të sakta për numrin e turistëve që kishin vizituar qytetin), prej tyre 81 iu përgjigjën pyetësorit të formuluar nga ne, nga të cilët 56 ose 69% ishin shqiptarë, pjesa tjetër të huaj.

Fakti që 31% e kampionit të anketimit janë të huaj dëshmon në një mënyrë për një interes të turistëve të huaj për qytetin e Gjirokastrës, trashëgiminë dhe vlerat kulturore e historike. Gjithsësi, tek turistët e huaj ne

gjetëm të njëjtin qëndrim, për nevojën për më shumë promovim të qytetit dhe të produkteve artizanale të tij.

Përsa i përket moshës, rreth 80% e turistëve shqiptarë ishin në moshën 20-50 vjeç, ndërsa turistët e huaj i përkisnin moshës së tretë, pra ishin mbi 60 vjeç. Kështu që nga pikëpamja e sjelljes si konsumatorë dy grupet e turistëve (sipas kombësisë) diferencohen shumë nga njëri-tjetri.

Fig 2. Arsimimi i turistëve



Rreth 66% e turistëve të anketuar kanë përfunduar arsimin e lartë dhe jo vetëm (pra një pjesë dhe atë pasuniversitar), kjo e dhënë përforcon vlerat njohëse nga pikëpamja kulturore dhe historike e Gjirokastrës nga njëra anë dhe nga ana tjetër kërkon një qasje ndryshe në promovimin e këtyre vlerave. Për turistët e huaj, 90% e tyre arsyeja e ardhjes së tyre në Gjirokastrë është një vizite turistike në Shqipëri dhe për arsye pune pjesa tjetër. 95% e tyre shprehen se janë mjaft të tërhequr nga produktet artizanale të ofruara në Pazarin e Gjirokastrës.

19 nga 25 të anketuarit e huaj mendojnë se çmimet e produkteve që ofrohen janë të arsyeshme ose të ulta, ndërsa 6 prej tyre se çmimet janë tepër të larta në krahasim me vlerën e produktit. Rreth 70% e të huajve besojnë gjithashtu se vendodhja e shitjes së produkteve është e duhura, por përqindja vjen në zbritje të shpejtë, kur gjykohet mënyra e ekspozimit të tyre brenda në dyqane (merchandising). Vetëm 13 nga 25 të anketuarit, besojnë se mënyra e ekspozimit është komplet e papërshtashtme, ose duhet përmirësuar, ata që mendojnë ndryshe (pra që ekspozohen mirë produktet) janë shumë pak.

Sjellja e shitësve ndaj klientëve, vlerësohet pozitive nga 60% e turistëve të huaj, ndërkohë pjesa tjetër beson se sjellja e shitësve duhet të përmirësohet duke evituar një interval nga eksetet e një indiferentizmi të theksuar ose të një përqasjeje tepër miqësore apo të bezdisshme.

Turistët e huaj pëlqejnë sipas një renditje në zbritje, të parat produktet tekstile dhe të traditës gjirokastrore dhe shqiptare, të dytat vijnë produktet prej guri e më pas ato prej druri dhe bronxi. Duket qartë që nuk ka preferencë për produktet e metaleve të çmuara si argjendi, ari. Shumica e turistëve që kanë blerë një produkt (60%) kanë preferuar punime dore dhe suvenire vendi. Objekti i blerë plotëson mjaftueshëm pritshmëritë e turistëve, por ata gjithashtu kanë vërejtur se mungonin kartolinat, albumet me pamjeve të zonave, banesave më muzeale të qytetit, guidat dhe mbi të gjitha suveniret autoktone/lokale janë të kufizuara.


Rreth 77% e turistëve shqiptarë të pyetur deklarojnë se çmimet e produkteve të ofruara janë të arsyeshme në krahasim me vlerën që produkti mban. Ngjashmërisht me turistët e huaj, 66% të shqiptarëve të anketuar besojnë se vendodhja e shitjes dhe e ofrimit të produkteve është e duhura, dhe kanë të njëjtën qasje për mënyrën e ekspozimit të tyre në dyqane, mbi

70% e tyre besojnë se tregtarët duhet të përmirësojnë mënyrën e ekspozimit të produkteve, aktualja i duket shumë e papërshtatshme.

Pak më shumë se 50% e të anketuarëve shqiptarë shprehen se shitësit janë sjellë në mënyrë të përkushtuar me ta, ndërsa pjesa tjetër beson se shitësit duhet të japin më shumë informacione, t'u përgjigjen pyetjeve dhe të jenë sa më qartë ndaj kërkesave të klientit. Në ndëryshim nga turistët e huaj, këta shqiptarë vlerësojnë shumë produktet e argjendit e të bronxit të ekspozuar në panair, produktet e drurit dhe të gurit. Turistët shqiptarë kanë interes më të vogël ndaj produktet tekstile dhe me grep.

Përtej përgjigjeve të pyetjeve, 50% e të anketuarve kanë blerë punime dore dhe një pjesë e mirë është drejtuar drejt suvenireve vendore, rreth 90% e të anketuarve shprehen të kënaqur me cilësinë e produkteve dhe besojnë se produkti plotëson pritshmëritë e tyre. Rreth 60% e të anketuarve shqiptarë shprehen se blejnë në mënyrë të rregullt suvenire në vendet që vizitojnë, por çmimi për të cilin do të ishin të gatshëm të blinin është mjaft i ndryshëm. Pavarësisht prirjes për shpenzim, turistët shqiptarë të anketuar duket se tregojnë gatishmëri, për produktë nga 10 deri më 20 euro.

Fig.3. Prirja për të shpenzuar në suvenire



Turistët shqiptare shprehen si dhe turistët e huaj, që nuk gjejnë disa suvenire tipike, që ata do të donin të kishin si: banesa gjirokastrite në miniature, kazanë rakië në miniaturë, monumentet e Gjirokastrës në miniaturë, bluza dhe pajisje të ndryshme me simbole të qytetit, kostume popullore për të rritur dhe fëmijë, këpucë popullore, qilima me motive të Gjirokastrës, prodhime druri e sënduqe, pije alkoolike dhe jo alkoolike, cd me muzikën polifonike, etj. Mbetet jo shumë e qartë nga pyetësorët raporti i turistëve ndaj çmimit, për më tepër duket që çmimi nuk justifikon pritshmëritë e tyre për cilësinë e produkteve, apo atë çka ata janë të gatshëm të blejnë me atë çmim.

IV.KONKLUZIONE & REKOMANDIME

Në përfundim të punimit, mund të konkludojmë:

- Prodhimi artizanal i Gjirokastrës nuk ka mundur të reflektojë ndryshimet strukturore të ekonomisë në këtë vite, për më tepër nuk është strukturuar në mënyrë të tillë që të shihet si kontribues real në ekonomi dhe të rikonceptohet në funksion të turizmit.

- Prodhimet artizanale kanë mbetur në nivelin e punishteve apo ndërmarrjeve artistike të zonës të kohës së komunizmit, prej nga rrjedh modelimi, dizajni, teknologjia e punimit dhe teknikat e marketingut e shitjes.
- Artizanët/shitësit tregojnë një shkallë të ulët të bashkëpunimit në komunitet dhe kjo i bën të parëndësishëm në lobim e përfitim të politikave, granteve në nivel qëndror lokal dhe në pamundësi ngritjesh së netëork-eve rajonale e më gjerë.
- Në Panairin e Trashëgimisë dhe në Pazarin e Gjirokastrës, gjetëm një mentalitet e kulturë të mbyllur, që shpesh nuk kapërcente pragun dhe muret e dyqaneve të tyre dhe që shtron domosdoshmërinë e orientimit nga tregu, marketimit që nis nga dizajni e që përfundon tek teknikat e promocionit e politikat kulturore e të nxitjes së turizimit dhe deri tek segmentimi i klientëve, për të cilët nuk mjafton të njohim (siç dhe u shprehë) që janë nga 30 deri në 70 vjeç. .

Për të ndryshuar situatën rekomandohet:

- Të përpunohet nga pushteti vendor një strategji mbështetëse, në bashkëpunim dhe me një numër ministrish si ajo e kulturës, punës, ekonomisë dhe turizmit, në lidhje me rivitalizimin e prodhimit artizanal, që mbi të gjitha të rrisë kapacitetet prodhuese e marketuese të tyre
- Në kuadrin e bashkëpunimit ndër-institucional mund të mendohet për hapjen e laboratorëve artizanal pranë shkollave të mesme të qytetit apo qendrave të formimit profesional, si dhe drejtime të caktuara si dizajn apo menaxhim arti të reflektohen dhe në Universitetin e Gjirokastrës. Kjo do të ishte një mënyrë për të rritur peshën e

trashëgimisë në ekonominë lokale, për të nxit turizimin dhe për të rritur punësimin

- Krijimi i një së paku një grupi interesi apo shoqate përfaqësuese të artizanëve dhe tregtarëve artizanë gjirokastritë me anë të së cilës të lobohej, të aplikonin për projekte ndërkombëtarë e rajonalë e shumë më gjerë.
- Të përpunohet një strategji gjithëpërfshirëse sektoriale në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe atë të Turizmit që të hartohen strategji agresive marketing, të bëhen panairë “shëtitëse” gjatë periudhës së verës në të gjitha plazhet, Gjirokastra të bëhet pjesë e të gjitha aktiviteteve me karakter kombëtar e ndërkombëtar që bëhen në Shqipëri.
- Me anë të një konkursi të hapur për artistët e rinj, të dizajnohen disa simbolika të qytetit të gurtë, të cilat të mund të prodhohen në suvenire të natyrave dhe me lëndë të para të ndryshme dhe të shiten me një çmim 5-20 Euro (siç ndodh në të gjitha vendet historike në botë).

Bibliografia

1. *Albanian National Commission for Unesco.* (2006). Retrieved January 2, 2015, from www.unesco.al: <http://www.unesco.al/sitet-e-trashegimise-boterore/berati-dhe-gjirokastra>
2. Fondacioni Gjirokastra. (n.d.). *gjirokastra.org*. Retrieved maj 31, 2015, from <http://www.gjirokastra.org/albanian/>
3. [kryeministria.al/newsroom](http://www.kryeministria.al/newsroom). (2015, mars 21). *per-gjirokastren-thesarin-e-trashegimise-kulturore-me-shume-investime-sesa-ne-20-vite-bashke*. Retrieved Maj 31, 2015, from <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/>

4. Martini, M. (2014, tetor 22). *Vlerat unike shqiptare që i bashkohen trashëgimisë botërore*. Retrieved maj 31, 2015, from koha.net: <http://koha.net/?id=4&l=30357>

SFIDAT E LIDERSHIPIT FEMËROR NË ORGANIZATAT SHQIPTARE TË BIZNESIT

Prof.Assoc. Dr, Ermira Qosja,

**Universiteti Europian i Tiranës, Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1,
Njësia Bashkiake Nr.7, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri
ermira.qosja@uet.edu.al;**

Dr. Arbi Agalliu,

Universiteti Europian i Tiranës, Bulevardi "Gjergj Fishta",
Nd.70, H.1, Njësia Bashkiake Nr.7, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri
arbi.agalliu@uet.edu.al

Abstract

21st century besides globalization and information technology challenges, it must surely cope with a new role and standing position of women in contemporary society - a leadership position. Through 24 years of sluggish transition from communistic governing system to plural democratic system, Albanian society went thru significant and important changes. Positive changes nowadays are noticeable, whereas comprehensive social justice is demanded aiming not only to combat issues like gender inequality and diversity, but justice is asked for in order to prevail upon matters such as new women's role in business leadership positions as an imperative role which will boost prosperity of a country overall.

Global theories, intentions and trends in concerning to women's leadership could be measured and treated with local once. As such, theories, intentions and trends will be neatly elaborated via surveys and interviews conducted having seen effect of women participation and their direct impact in organizational and business performances. Meantime, role of women will be revealed even amongst many challenging factors which Albanian women encounters in daily surroundings working environment.

Fjalët kyçe: lidhshipi femëror, kultura organizatës, steriotipi gjinor, menaxhimi diversitetit

I. HYRJE

Lidershipi është aftësia për të ndikuar mbi një grup njerëzish dhe për ta drejtuar atë, në arritjen e vizionit apo një tërësie objektivash (Robbins, Judge, & Parker, 2008). Historikisht, pjesa më e madhe e liderave kanë qenë burra, grave u është dashur të bëjnë shumë përpjekje për të fituar respekt e sot kudo ato vazhdojnë të luftojnë për më shumë barazi, në fuqinë punëtore dhe në pozicione lidershipi.

Në fillim të viteve 90-të, vetëm pesë nga kompanitë e Fortune 500 kishte CEO-në grua (Feminist Majority Foundation, 1991); ndërmjet 1300 shefave më të paguar të kompanive më të mëdha në botë, gratë përbënin diçka më pak se 0,5% (Dodge & Gilroy, 1995). Numrat për femrat në menaxhim kanë ardhur në rritje ndër vite dhe në fund të viteve 90-të nga një anketim rezultoi që 11% e anëtarëve të bordeve të Fortune 500 ishin gra (Mann, 1999, July 16).

Në vitin 2010 në Sh.B.A., 51% e pozicioneve menaxheriale dhe e profesionistëve, si dhe 25% e shefave ekzekutive i përkisnin grave (U.S.Bureau of Labor Statistics, 2011). Në kompanitë e Fortune 500, në vitin 2010 gratë mbanin vetëm 15,4 % të pozicioneve të senior, 14.8% të vendeve në bord dhe 2.4% të pozicionit të CEO-ve (Evans, 2011).

Megjithëse në 2011 gratë përbënin 47% të fuqisë punëtore të Sh.B.A-ve (U.S.Bureau of Labor Statistics, 2011), vetëm 5.2 % të tyre ishin CEO (Catalyst, 2011a) dhe 16% të tyre zinin vende në bordet e kompanive (Catalyst, 2011b). Në Europë gratë zenë vetëm 16 % të vendeve në bordet drejtuese (European Commission, 2013) dhe paguhen mesatarisht 16% më pak se burrat (European Union, 2012).

Në mënyrë logjike këto statistika botërore ngrenë pyetjen “Pse ky akses i kufizuar i grave në role lidershipi në organizata?”. Përgjigjja e pyetjes në kohë ka bërë që në botë të kryhen një numër i madh studimesh, studime multifaktoriale mbi një numër të madh kompanish lidere në tregun botëror dhe një numër të madh menaxherësh të tyre, vetëm McKinsey&Company ka kryer 7 studime në vitet 2007-2012 (McKinsey 2008), (McKinsey, 2010), (McKinsey, 2013), (Piterman, 2006).

Në këtë punim, bëhet përpjekje për të kuptuar e analizuar ndikimin që ka kultura e organizatave shqiptare të biznesit në pozicionimin e gruas në lidhshmëri. Pyetja kërkimore e shtruar në punim është “Çfarë ndikimi ka kultura e organizatave shqiptare në ngjitjen e grave në pozicione lidhshmëri?” ndërsa hipoteza e punimit është “Kultura e organizatës shqiptare ndikon negativisht në ngjitjen e grave në pozicione lidhshmëri”. Natyra e punimit është cilësore, në të përdoren një numër i konsiderueshëm burimesh sekondare dhe kërkimi primar i bazuar në intervista të hapura, metoda e analizës mbetet ajo cilësore.

II. Baza teorike e punimit

Literatura e menaxhimit nuk ka rregulla të shkruara mbi strukturën dhe dinamikën gjinore të vendit të punës. Një numër studimesh ndërkombëtare kanë identifikuar korrelacionin midis një morie forcash strukturore dhe kulturore dhe prezencës së ulët të grave në nivele seniorësh. Kërkime të tjera mbi kulturën e lidhshmërit dhe autoritetin në organizatë kanë nxjerrë në dukje rolin e gjinisë, seksualitetit dhe fuqisë në formëzimin e eksperiencës së gruas (Piterman, 2008), (McKinsey, 2008), (McKinsey, 2013).

Numri i grave në pozicione të larta drejtuese është një tregues çelës i barazisë midis gjinive (Appoid et al, 1998) (Evans, 2011), (McKinsey2013). Numri i grave në nivelin e mesëm po vjen duke u rritur, ndërkohë që ndërhyrjet ligjore dhe politikat që angazhojnë një organizatë në diversitet në vendet e zhvilluara, nuk kanë lehtësuar avancimin e gruas në pozicione lidhshmëri (Piterman, 2008).

Literatura, në lidhje me gratë në menaxhim, sugjeron që diskriminimi gjinor është kaq thellë dhe i ngulitur në jetën e organizatave, sa shpesh duket i padallueshëm. Bëhet fjalë për rregulla të pa shkruara, praktika pune me bollëk dhe norma kulturore që qeverisin strukturën e vendit të punës dhe dinamikën gjinore (Lift & Ward, 2001), (Meyerson & Fletcher, 2000, January - February). Këto elementë të kulturës organizative janë subjektive, por akoma shumë të fuqishme. Ato kanë potencial të kufizojnë oportunitetin e promovimit të grave dhe të minojnë eksperiencën e tyre në vendin e punës.

Seria e studimeve Women Matter të McKinsey&Company nëpërmjet një analize shumëfaktoriale nxjerr arsyet pse lidhshipi i femrave është i lidhur ngushtë me performancën e organizatës. Studimi evidenton që nga 9 tiparet e lidhshiptit (*1. Participative decision making, 2. Role Model; 3. Inspiration; 4. Expectations and Rewards; 5. People development; 6. Intellectual stimulation; 7. Efficient Communication, 8. Individualistic decision making; 9. Control and corrective action*) të shek.XXI që përmirësojnë performancën organizative, femrat menaxhere zotërojnë disa prej tyre më me efikasitet se sa menaxherët meshkuj (McKinsey, 2010). Për më tepër femrat mund të jenë më efektive në stimulimin dhe aplikimin e praktikave të lidhshiptit efikas në gjithë organizatën, ndonëse kjo nuk është e mjaftueshme për të garantuar suksesin.

Tiparet e lidhshiptit që do të përballojnë sfidat e së ardhmes të organizatave të biznesit, varen prej vetë organizatave në se zhvillohen apo jo, për këtë arsye ka një lloj urgjence në zhvillimin dhe përforcimin e këtyreve tipareve.

Organizatave duhet të analizojnë situatën brenda tyre, pikat e forta dhe të dobta të kulturës së tyre organizative, të vendosin indikatorë që kanë të bëjnë me procesin e rekrutimit apo promovimit të femrave në departamente dhe në çdo nivel menaxhimi; të vendosin barazi në pagat për të njëjtin pozicion mes femrave dhe meshkujve. Këta indikatorë dhe të tjerë janë të rëndësishëm për t'i dhënë përparësi politikave dhe programeve që i hapin rrugë evoluimit të diversitetit gjinor, por ata janë të rëndësishëm edhe për të ruajtur gjendjen aktuale si dhe për të vlerësuar progresin në procesin e diversitetit gjinor (McKinsey, 2013).

III. Metodologjia e punimit

Megjithëse fokusi i punimit është sfida e gruas në lidhshipi në organizatat shqiptare të biznesit, shumë nga çështjet që studimi ngre kanë të bëjnë me dinamikën në një këndvështrim të gjerë. Punimi ndjek linjën e intervistimit që bën të mundur evidentimin e impaktit që ambjenti organizativ ka në eksperiencën e punës së grave. Punimi shqyrton eksperiencën e burrave dhe grave në organizatat shqiptare duke nxjerrë dinamikën e kulturës organizative që impakton mbi oportunitetet dhe

barrierat e grave në menaxhim, si dhe politikat organizative apo inisiativa të tjera, në mbështetje të axhendës së diversitetit.

Pyetja kërkimore e punimit: Çfarë ndikimi ka kultura e organizatave shqiptare në ngjitjen e grave në pozicione lidershpi; *hipoteza e punimit:* Kultura e organizatës shqiptare ndikon negativisht në ngjitjen e grave në pozicione lidershpi.

Punimi kërkonte një intervistë të thellë, një bashkëbisedim open-ended midis kërkuesve dhe të intervistuarve, sepse në këtë mënyrë mund të tërhiqeshin eksperiencat më të holla që gratë përballin çdo ditë në ambjentin e tyre të punës, që afektojnë qëndrimin e tyre ndaj punës dhe zgjedhjet e karrierës që ato bëjnë.

Intervistat janë realizuar bazuar në këtë grup pyetjesh: 1. Cila është mosha dhe pozicioni juaj në organizatën ku punoni? 2. Mund të tregoni një histori të shkurtër të punës tuaj? 3. Cilat janë aspiratat tuaja të karrierës? 4. Mund të na tregoni jetën tuaj jashtë organizatës – me familjen dhe përgjegjësitë e tjera? Si e menaxhoni balancën punë - jetë? 5. Çfarë vlerësohet në organizatën tuaj? 6. Çfarë besoni që duhet bërë për të patur sukses në organizatën tuaj? 7. Çfarë veçorish dhe sjelljesh demonstrojnë njerëzit e suksesshëm? 8. A ka rrugë të veçanta që të çojnë në sukses? 9. Ju besoni që keni patur akses në këto rrugë? OSE 10. Si do e përshkruanit udhëtimin tuaj në pozicionin e lidershpit? 11. Ju besoni se keni vështirësi në avancimin e karrierës tuaj? Në se po, cilët janë faktorët që sipas jush krijojnë vështirësitë? 12. Cilat marrëdhënie janë të rëndësishme për ju? 13. Si i ushqeni ju këto marrëdhënie? 14. E konsideroni numrin e grave në pozicione drejtuese që reflekton tërësinë e talenteve të organizatës? 15. Si besoni që konsiderohen gratë me autoritet në organizatën ku punoni? 16. Besoni që gratë në organizatë tuaj kanë të njëjtën rrugë karriere si burrat? 17. Pse po / pse jo? 18. Si organizata juaj mbështet gratë në pozicionet drejtuese? 19. Sipas jush, cilat janë arsyet e numrit më të vogël të grave në pozicione drejtuese menaxheriale?

Një kufizim i punimit (Tab.1) është numri i kufizuar i intervistave, kufizim i llojeve të bizneseve nga të cilët vijnë menaxherët e intervistuar si dhe pamundësia për të intervistuar CEO organizatash të mëdha.

Tab1. *Të intervistuarit sipas gjinisë dhe nivelit menaxherial*

Të intervistuar	femra	meshkuj	Totali
Senior (CEO dhe ekzekutive)	5	3	8
Middle	18	4	22
Totali	23	7	30

IV. Diversiteti gjinor dhe lidershipi femëror në Shqipëri

Ndryshimet e sistemit politiko–ekonomik në vitet '90-të në Shqipëri, sollën përkeqësimin social-ekonomik të femrës shqiptare, për shkak: a) të mungesës së përgjithshme të punëve për shkak të ristrukturimit të ekonomisë; b) përqëndrimit të ekonomisë në sektorë që i punësojnë gratë për kohësisht; c) kapacitetin e kufizuar të ekonomisë për të përthithur një numër të madh grash që dolën të papuna nga ish-ndërmarrjet shtetërore; d) kalimit të meshkujve nga punë në bujqësi në punë jo bujqësore; e) ndjekjes së modelit të mashkullit si fitues i bukës në familje; f) mungesës së politikave të punësimit të ndjeshme ndaj gjinisë (Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta, 2011).

Shoqëria shqiptare është e ndërgjegjshme që zhvillimi dhe demokratizimi i qëndrueshëm social – ekonomik i vendit mund të arrihet vetëm nëpërmjet përpjekjeve fuqizuese dhe emancipuese, të cilat i garantojnë grave dhe burrave përfaqësim në të gjithë sektorët dhe fushat, për këtë arsye, por dhe për shkak të gjitha kriterëve dhe kushteve të integritimit evropian të Shqipërisë; në korrik të 2008 Kuvendi miratoi ligjin nr. 9470 për barazi gjinore në shoqëri, i cili garanton dhe kontribuon për shance të barabarta të femrave në jetën shoqërore dhe politike të vendit .

Ky ndryshim ligjor i vitit 2008, reflektohet dhe në rritjen e numrit të femrave në Kuvendin e Shqipërisë nga 7% në vitin 2005 në 18% në vitin

2013 (Kuvendi i Shqipërisë, 2013), por duke mbetur akoma larg 30% të përfaqësimit të tyre, të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor i RSH.

Rregjistrimit i popullsisë në vitin 2011, nxorri një përqindje më të lartë të popullsisë urbane (53.7%), në krahasim me atë rurale (46.3%) (Institute of Statistics, 2012). Të dhënat e LSMS treguan për një përqindje relativisht të lartë të grave që bëjnë migrim të brendshëm (Institute of Statistics and UNDP, 2008) të cilat angazhohen më shumë në punësimin me rrogë, se gratë që kanë një anëtar të familjes jashtë vendit (Agolli.M, 2011).

Ka disa faktorët që ndikojnë negativisht mbi statusin social dhe ekonomik të gruas shqiptarë ndarjen horizontale dhe vertikale profesionale të grave dhe burrave; d) kontributi i përgjithshëm i grave në punën e paguar dhe të papaguar është dy orë më shumë në ditë se ai i burrave, diferencë që lidhet me modelin e stereotipizuar gjinor ku gruaja kontribuon në mirëmbajtjen e shtëpisë dhe familjes 96 % , ndërsa burri vetëm 4% (Institute of Statistics, 2011) .

Disa faktorë të tjerë duket të kenë ndikim pozitiv në disa aspekte dhe negativ në disa të tjera, mes tyre mund të përmendim:

17. Mc Connel. (1980). *Foreign Direct Investment in the United States*. Annals of the Association of the American Geographers. (Vol.70.-2).
18. Palit, et.al. (2007). *Technological Capabilities as a Determinant of FDI inflows: Evidence from Developing Asia and India*. Working paper No.193.
19. Persephone Economou, "Harnessing ICT for FDI and Development", Global Forum on International Investment, OECD, March 2008
20. Reynolds, R., Kenny, C., Liu, J., Zhen-Wei. (2004). Networking for foreign direct investment: the telecommunications industry and its effect on investment. *Information Economics and Policy*. (Vol. 16).

21. Veermachaneni, B. et.al. *Information Technology, FDI and Economic growth: An India Case Study.*

Woodward, D.P., (1992). *Locational determinants of Japanese manufacturing start-ups in the United States.* Southern Economic Journal 58.

PAPUNËSIA , PROBLEM KONSTANT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Mr. AGIM BEQIRI

International University of Struga - e-mail: agim.beqiri@hotmail.comTel:
071/441423

Abstract

Macroeconomic problems of Macedonia are numerous, but one is crucial that determines functioning Macedonian daily use, it is a problem that most ordinary citizens feel that is unemployment.

Not only in Macedonia, unemployment and globally represents bitter problem. The unemployment rate in Macedonia is very high if compared to unemployment in Macedonia unemployment in countries that spend the transition time as Macedonia will see that Macedonia has the highest unemployment rate in the most rigid structure of the market labor. The official unemployment rate in Macedonia is very high, and in 2013 was 29.0 %.

The question is why Macedonia has so much unemployment, ie which are the factors that led to the striking figure of unemployment? The question is really whether unemployment in Macedonia and is such that you can take in terms of reducing the number of unemployed? In the further course of this paper will elaborate any of the above questions. This Work is divided into two parts. The first section discusses the concept of labor market in order to more easily explain the notion of unemployment which is dealt in the second part of the work. Emphasis is placed on macroeconomic issues of Macedonia called vertiginous unemployment, analyze the factors that led to

unemployment and what should be the policy of the Government of the Republic of Macedonia to reduce unemployment.

Keywords: Macroeconomic problems, unemployment, transition.

HYRJE

1.TREGU I PUNËS DHE FORMAT E PARAQITJES

Duke u bazuar në përkufizimet e përgjithshme të shkencës ekonomike të cilat e përkufizojnë tërësinë e nocionit treg, mund të përkufizohet edhe nocioni treg i punës . Me nocionin treg tradicionalisht nënkuptohet vendi ku shiten dhe blehen mallra dhe shërbime të caktuara , nocioni treg mund të përkufizohet si hapësirë ekonomike ku bëhet organizim i ofertës dhe i kërkesës së mallrave dhe shërbimeve, gjatë së cilës determinohet çmimi dhe sasia e tyre që do të shkëmbehet. Në mënyrë tjetër tregu përcaktohet si grup aranzhmanesh përmes së cilit blerësit dhe shitësit në një mall ose shërbim të caktuar vijnë në kontakt për ta shkëmbyer të njëjtën (Kadikijan dhe Rushkov, 1999 fq.64).

Konform të lartpërmendurës tregu i punës si kategori ekonomike mund të definohet si hapësirë ekonomike ku arrihet deri te takimi i organizuar i ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore, ku përcaktohet çmimi i fuqisë punëtore si dhe sasia që këmbëhet.

Që të kuptohet më mirë esenca e nocionit treg i punës dhe funksionimi i tij, duhet që të sqarohen nocionet kërkesë e fuqisë punëtore e cila përcaktohet nga sjellja e blerësve (atyre që u duhet fuqi punëtore), dhe ofertë e fuqisë punëtore e cila përcaktohet nga sjellja e kërkuesve (ata që e ofrojnë fuqinë punëtore konkrete). Kërkesa e fuqisë punëtore paraqet raport në mes sasive të ndryshme të fuqisë punëtore që

dëshirojnë blerësit dhe kanë mundësi ta marrin, e gjitha kjo gjatë çmimeve alternative të përcaktuara në kohë të caktuar, nën supozimin se ambienti i tregut mbetet i pandryshuar (*ceteris paribus*). Me nocionin ofertë e fuqisë punëtore nënkuptohet tërësia e fuqisë punëtore që mund t'i ofrohet tregut gjatë çmimeve alternative në periudhë të caktuar kohore, nën supozimin se ambienti i tregut mbetet i pandryshuar (*ceteris paribus*). Gatishmëria dhe mundësia e punëtorëve që t'ia ofrojnë veten tregut të punës, respektivisht oferta e fuqisë punëtore varet nga çmimi që rrotullohet në treg si dhe periudha kohore. Kur bëhet fjalë për kërkesën e fuqisë punëtore, është e rëndësishme të kuptohet se atë tërësisht nuk e përcaktojnë dëshirat dhe nevojat e punëdhënësve, por edhe gatishmëria faktike ose aftësia e punëdhënësve që t'i angazhojnë punëtorët e duhur që t'i kënaqin nevojat e organizatave.

Kur bëhet fjalë për ofertën dhe kërkesën e fuqisë punëtore duhet të cekem ligjet e ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore dhe pastaj është e nevojshme të elaborohen kurba e ofertës së fuqisë punëtore si dhe kurba e kërkesës së fuqisë punëtore.

Ligji i kërkesës së fuqisë punëtore e përcakton kërkesën e fuqisë punëtore përmes çmimit të fuqisë punëtore si përcaktues kryesor i saj. Ligji i kërkesës thotë: sasia e kërkuar e fuqisë punëtore në kohë të caktuar do të zvogëlohet me rritjen e çmimit të fuqisë punëtore, ndërsa do të rritet me zvogëlimin e çmimit të saj, nën supozimin se të gjitha rrethanat tjera mbeten të pandryshuara (*ceteris paribus*). Ngjashëm me ligjin e kërkesës, ligji i ofertës i fuqisë punëtore gjithashtu ofertën e fuqisë punëtore e përcakton përmes çmimit si përcaktues kryesor i ofertës. Ligji për ofertën e fuqisë punëtore thotë: sasia e ofruar e fuqisë punëtore varet drejt dhe në mënyrë proporcionale nga çmimi, nën

supozimin se të gjitha sendet tjera mbeten të pandryshuara (ceteris paribus).

Kurba e kërkesës së tregut të fuqisë punëtore tregon raportin mes çmimit dhe fuqisë punëtore dhe sasinë e kërkuar të fuqisë punëtore në treg të dhënë në periudhë kohore, nën supozimin ceteris paribus. Kurba e kërkesës e fuqisë punëtore padyshim tregon raportin e kundërt proporcional në mes çmimit dhe sasisë së kërkuar të fuqisë punëtore. Kurba e kërkesës është në vijë të lakuar në rënie. Kurba e ofertës e fuqisë punëtore, në dallim nga kurba e kërkesës është e lakuar në rritje.

Në rast se analizohen kurbat e ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore dhe paraqiten në mënyrë grafike bashkë do të përballet pika e ekuilibrit të ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore. Kur elaborohen kurbat e ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore arrihet deri te nocioni pika ekuilibruese. Pika ekuilibruese paraqet kryqëzimetë kurbave të ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore, kështu që përcaktohet optimaliteti i ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore gjatë kriterëve konkrete të përcaktuaratë optimalitetit.

Principi i ndërrimit të lirë i tregut të punës, në mes punëtorve dhe punëdhënësve gjatë kohë kishte dominim absolut në teorinë ekonomike, fakti se tërësia e ofertës dhe kërkesës së punës të shfaqura përmes ndërrimit të lirë e përbëjnë të njohur thelbin e tregut të lirë të punës. Në të vërtetë, supozimet për teorinë e produktivitet kufizues (ekzistim i konkurrencës së lirë për vendet e punës, konkurrencë e lirë në mes punëdhënësve për angazhimin e punëtorëve tjerë) janë kushte themelore edhe për treg pune të lirë.

Praktika botërore tregon kohëzgjatje relative të raporteve mes shitësve (punëtorëve) dhe blerësve (punëdhënësve). Tendencat e tilla

lidhen me të ashtuquajturin tregu intern i punës (Kadikijan dhe Rushkov 1999). Thelbi i tregut intern të punës përbëhet në supozimin themelor se të punësuarit në një kompani nuk janë të shfaqur në konkurrencë nga punëtorë nga jashtë kompanisë dhe se konkurrenca zhvillohet mes punëtorëve të vetë kompanisë, që drejt për së drejti kundërshton teorinë për përcaktimin e reciprocitetit sipas produktivitetit kufizues. Fenomeni i tregut intern i punës pothuajse përgjithësisht është pranuar nga ekonomistët. Si karakteristika të tij përmenden:

- Ekzistimi i pëlqimit të vazhdueshëm dhe besimi reciprok i punëtorëve dhe punëdhënësve, duke shfaqur edhe përparësi të verifikuara me stabilitet relativ (konsistencë) të vendeve të punës.
- Ekzistimi i përfitimit personal të punëtorit nga e tija, në kuadër të kompanisë, trajnimit dhe progresit, si dhe kufizim të mundësive për hyrje në tregun intern të punës.
- Definim i qartë dhe i drejtpërdrejtë i të drejtave dhe detyrimeve të të punësuarve dhe punëdhënësve.

Tregu intern i punës e then mitin e teorisë për produktivitet kufizues, respektivisht për valorizim vetëm të tregut përmes marrëdhënieve të lira të shitblerjes që lindin ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësve.

Në realitetin e botës moderne ekziston treg i punës fragmentar ose segmentar i cili i shfaq kundërthëniet e intereseve ndërmjet grupeve të caktuara të punëtorëve (Kadikijan dhe Rushkov, 1999, f1.185).

Segmentimi i tregut të punës do të thotë ç'antarësimi dhe ndarja në tregje të veçanta (të ndara), kur oferta dhe kërkesa e një tregu të punës nuk konkurren me ofertën dhe kërkesën e tregut tjetër të punës. Në vend që një treg pune të

vetëm, karakteristik për sistemin industrial të prodhimit, sot ekzistojnë tregje pune të ndryshme, secili me ofertën dhe kërkesën e tij. Gjatë analizës së tregut segmentar më i kapshëm është mendimi për ndarjen e tij në treg i punës primar dhe sekondar.

- Tregu i punës primar është karakteristik për degët ekonomike tradicionale (minierë, metalurgji, hekurudha) me numër të madh punëtorësh, dhe sipas rregullës të organizuar në sindikata. Tregu i punës i vërtetë sillet me punëtorët në tekno-strukturën. Teknostrukturën e përbëjnë vende pune që kërkojnë kualifikime në sistemin arsimor ose me shkollim dhe trajnim të veçantë. Stimulohet iniciativa individuale dhe kreativiteti. Ekziston siguri në vendet e punës dhe fitohen të ardhura relativisht të larta dhe mundësi për ritjen e tyre të mëtutjeshme. Mirëpo në vendet më të zhvilluara pjesa më e madhe e punëtorëve është i angazhuar në tregun e punës sekondar.
- Tregunsekundartëpunës e përbën një mozaik i vërtetë i punëve dhe punëtorëve. Sipas rregullës të punësuarit janë kompani të vogla, nuk janë të organizuar nëpër sindikata, ekziston një marrëdhënie indirekte punëtor-punëdhënës, interesimi i dobët për mbrojtjen higjienike-teknike të të punësuarve, pasiguri në vendin e punës, konkurrencë e madhe në çdo vend pune. Në tregun sekondar hyjnë edhe e ashtuquajtura ekonomia gri.

2.PAPUNËSIA

2.1 NOCIONI DHE RËNDËSIA E PAPUNËSISË

Papunësia paraqet njërin nga problemet më të mëdha makroekonomike me të cilat përballen shtetet. Në bazë të standardeve

ndërkombëtare, puna paraqet kriterin themelor për ndarjen e popullsisë sipas aktivitetit ekonomik. Kjo nënkupton që bëhet ndarje e popullsisë në të punësuar, të papunë dhe popull si ajo aktive ekonomikisht.

Papunësia nuk mundet të definohet si numër i personave që janë të papunë. Ky përkufizim i gjerë do t'i përfshijë në të punësuar edhe fëmijët, të rinjtë, pensionistët, shtëpiakët, të sëmurët dhe personat e pa aftë për të punuar, si edhe personat të cilët thjeshtë nuk duan që të punojnë dhe sipas saj ata nuk kërkojnë punësimin. Do të ishte më e realizueshme të themi që të papunët përbëjnë ata të cilët janë të aftë për të punuar, dëshirojnë që të punojnë dhe në mënyrë aktive kërkojnë punësim por nuk mundin të gjejnë. Shkalla e papunësisë fitohet si raport në mes numrit të personave të papunë dhe numri i fuqisë punëtore gjithsej.

Sipas standardeve të ILO përkatësisht Enti shtetëror për statistikë i R. Së Maqedonisë si të punësuar konsiderohen ata të cilët i përmbushin tre kushte:

- Gjatë kohës përderisa bëhet analiza për përcaktimin e papunësisë, përkatësisht gjatë javës së raportimit në përgjithësi nuk është punuar.
- Në mënyrë reaktive kanë kërkuar punë, përkatësisht kanë marrë aktivitet konkret për punësim.
- Personat të cilët kanë qenë të gatshëm të pranojnë punë në javën e raportimit ose javën në vijim.

Papunësia ndoshta është problemi më i madh makroekonomik, ekzistenca e saj u shkakton probleme të mëdha ekonomisë moderne të tregut.

Papunësia shkakton shpenzime sociale, veçanërisht bëhet fjalë për shpenzimet ekonomike, për shpenzimet sociale, dhe shpenzimet e arkës shtetërore (Fiti, 2004.146). Problemet e tanishme sociale të të punësuarve

kanë efekte të konsiderushme mbi sigurinë njerëzore. Në fakt, të papunësuarit shpesh shoqërohen me qajse të kufizuar deri te kontributet, deri te mjetet për punë, deri te shërbimet sociale, shëndetsore, arsimore dhe edukative, të shoqëruar me varfëri dhe skamje (Jakimovski, 2000, 41).

Shkalla e lartë e papunësisë mund ta dëmtoj fuqinë e komunitetit dhe lidhjes në shoqëri. Në studimin klasik sociologjik të vitit 1930, Mari Johoda me bashkëpunëtorët kanë hulumtuar rastin Marientala, qytezë në Austri, që e kaploi papunësi e madhe për shkak të mbylljes së fabrikave lokale (Jahoda et. Al. 1972). Hulumtuesit erdhën në dijeni se papunësia në fund filloi ta dëmtojë strukturën e shoqërisë dhe marrëdhënieve në shoqëri. Popullata më pak merret me aktivitete shoqërore, aq më pak shoqëroheshin mes vete dhe shumë më pak vizitonin bibliotekën e qytetit.

3.PAPUNËSIA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Pas rënies së Federatës Jugosllave, rritja e papunësisë në R. Maqedonisë kishte një tempo të shpejtë. Shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore, si dhe shtetet fqinje që në fillëm arritën ta kufizojnë zvogëlimin e BDP-së dhe të tregojnë rezultate në ritje të BDP-së. Rimëkëmbja ekonomike e këtyre vendeve gjithashtu ishte shumë më e mirë se e R. Maqedonisë, që i arriti nivelet e BDP-së qysh para tranzicionit në vitin 2005.

Rezultatet dëshpëruese në nivel makro reflektohen në strukturë rigjide në tregun e fuqisë punëtore, që tregon ekzistimin e problemit të rëndë insajder-atsajder. Në R. e Maqedonisë, në dallim prej vendeve tjera në tranzicion ka lëvizje të vogël prej papunësie kah punësimi, e gjitha kjo si rezulton me shkallë të lartë të papunësisë në kohë afatgjate. Mobilizimi i tregut të fuqisë punëtore u rit gjatë vitit 2005, por ajo ishte kryesisht ishte shkaktuar në punëtorë joaktiv në kuadër të të punësuarve ndërsa papunësia

afatgjate vazhdoi të ritet. Punësimi në bujqësi ritet për 10.5% në vitin 1995 në 19.1% në vitin 2011. Republika e Maqedonisë në këtë periudhë është e de-instrualizuar dhe e shndëruar në shtet agrar (Jakimovski ,2012, 28). Një tjetër tregues për rigiditetin e strukturës së tregut në R. e Maqedonisë është shkalla e lartë e papunësisë të rinjtë, rreth 50% e fuqisë punëtore në moshë prej 15 deri 29 vjeç është pa punë. Karakteristikë e rëndësishme e papunësisë të rinjtë në Republikën e Maqedonisë është ajo se përfshin përqindje të lartë të personave me arsim të mesme (54,4%) dhe arsim të lartë (24,4%). Përqindja e lartë e personave të papunë me arsim të mesëm tregon se sa humb shteti nga investimet e pashfrytëzuara në fuqinë e re punëtore me kualifikim profesional. Numri më i madh i pjesëtarëve të gjeneratës së re të shkolluar vjen në situatë që t'i humb vitet më të mira të jetës duke pritur punësim edhe atë në vitet kur shoqërisë mund t'i dhurojë më së shumti energji dhe aftësi krijuese.

Edhe përkundër papunësisë së lartë në R. e Maqedonisë megjithatë ekziston papunësi jashtëzakonisht e fshehur në kuadër të kompanive, që reflektohet me detyrime të larta të mbetura për rroga (rreth 15% nga pagat totale), që ishin relativisht stabile gjatë viteve të fundit.

Kur elaborohet papunësia në R. e Maqedonisë në mënyrë laike ose profesionale gjithmonë bëhet pyetja se a është me të vërtetë shkalla e papunësisë 29,0?

Analiza e burimeve të ndryshme të të dhënave për punësimet tregojnë se papunësia ndoshta është më e vogël se 29.0 por prap se prapë është e lartë.

3.1. FAKTORËT QË PËRCAKTOJNË PAPUNËSINË NË R.M

Papunësia në R. e Maqedonisë përcaktohet në shumë faktorë:

Ritja e ulët ekonomike në R.Maqedonisë e kufizon hapjen e vendeve të reja të punës që duheshte ta zbus humbjen e vendeve të punës në kompanitë shtetërore. Shkaqet për rezultatet e këqia në ritje përfshijnë goditje politike, siç është mbyllja e kufirit grek, restriksione tregtare nga embargoja e KB-së ndaj Serbisë dhe kriza e Kosovës, që krijuan klimë afariste të pakënaqshme. Por Maqedonia gjithashtu hyri në procesin e tranzicionit si ekonomi që ishte e varur nga një numër i vogël i sektorëve tradicional, veçanërisht bujqësia, çeliku dhe tekstili.

1. **Investimet ulëta të huaja**, pjesërisht të shkaktuara nga privatizimi i brendshëm, gjithashtu e kufizuan ritjen e punësimit. Udhëheqja dhe blerja e menaxhmentit dominuan në procesin e privatizimit, duke kufizuar investimet e jashtme, të cilat janë të ulëta në krahasim me vendet e rajonit. Gjithashtu krijimi i vendeve të reja të punës është më i lartë në kompanitë e reja ku pronar janë të huaj. Në Maqedoni u vërtetua fakti se mungesat me udhëheqjen dhe blerjen nga ana e menaxhmentit shkaktuan rënie të produktivitetit dhe fitim të ulët. Duke marrë parasysh se blerja nga ana e të punësuarve e ndjek ideologjinë për pronë shoqërore sipas së cilës qëllim kryesor i kompanisë është punësimi, jep sqarim për nivel të lartë të papunësisë së fshehur që reflektohet me detyrime të mbetura të pagave.

- Në shumë vende që funksionojnë në bazë të principeve të ekonomisë së tregut, **njësitë e mesme dhe të vogla afariste** paraqesin punëdhënësin kryesor të fuqisë punëtore. Në R. e Maqedonisë kompanitë e vogla dhe të mesme përballen me kushtë të këqia. Përkrah kompanive që janë pronë e të huajve, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të sapo hapura tregojnë dinamikë më të fuqishme në krijimin e punësimeve. Numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në banor në Maqedoni

është në nivel mesatar në krahasim me vendet tjera të rajonit, por ato përballen me probleme në punë, veçanërisht për shkak të qasjes së kufizuar deri te financat.

- Ekzistimi i **ekonomisë gri në Maqedoni** e zvoglon efektivitetin e tregut të fuqisë punëtore. Duke marrë parasysh se ekonomia gri vlerësohet nga një e treta deri në një gjysmë nga sektori formal, shpenzimet e pagave varen nga ajo se sa lehtë mund ndërmarrja të mbulojë aktivitetet e saja. Humbja e të ardhurave tatimore nga aktivitete joformale shkakton shërbime publike të kualitetit të ulët, ritje të ryshfetit për shkak të pagave të vogla në sektorin publik dhe shtypje për ritjen e ngarkesës tatimore mbi sektorin formal, që ndryshe quhet i ashtuquajtimi rrethi magjik.
- Si shkak për ritjen e papunësisë llogaritet **vetë tregu i fuqisë punëtore**. Regullat e tregut të fuqisë punëtore tani janë liberalizuar. Duke pasur parasysh se punësimi në kohë të caktuar u tregua si burim i rëndësishëm për ritjen e punësimit në ekonomitë në tranzicion, reforma e tregut të fuqisë punëtore i zvogëloi kufizimet në këtë lëmi. Me reformën gjithashtu u thjeshtësuan procedurat e komplikuara për shkarkim, të cila shpesh u kontestuan në gjykatë, duke shkaktuar vonesa të mëdha dhe rezultate të pa parashikueshme. Edhe pse reforma në tregun e fuqisë punëtore i lehtësoi kushtet për punësim në kohë të caktuar, ajo akoma është diskriminuese me kontribute sociale minimale të cilat bazohen në pagën mujore mesatare në sektorin me orar të plotë. Si pasojë e kësaj ky hendek i madh në kontributet sociale është nxitësi më i madh i punësimit në sektorin joformal.

- Në krahasim me vendet tjera të UE, **sistemi arsimor** është shumë i dobët. Edhe pse mundësitë për punësim dukshëm rriten në arsimin e lartë, rruga e të rinjve nga arsimi në punë është më e gjatë, e komplikuar dhe turbulente (Jakimovski, 2013). Qartë se ekziston problem në arsim i cili nuk i siguron kualifikimet e duhura që nevojiten për tregun e fuqisë punëtore.
- **Periudha e tranzicionit** solli në ritjen e papunësisë. Në këtë periudhë u bë privatizimi i një pjese të madhe të ndërmarrjeve shoqërore. Privatizimi në Maqedoni kishte pasoja katastrofale, proceset ku kryhej privatizimi e çvlerësuan kapitalin shoqëror, i çvlerësuan subjektet shoqërore ekonomike me qëllim më lirë të privatizohen nga biznesmenët e fuqishëm maqedonas.

3.2 HIPOTEZA PËR ZVOGËLIMIN E PAPUNËSISË

Secila zgjidhje afatgjate për problemin e Maqedonisë me papunësinë varet nga rritja e zhvillimit ekonomik. Vetëm zhvillim ekonomik permanent do të krijojë kushte për punësim afatgjat që është i mjaftueshëm për absorbimin e fuqisë punëtore në rritje dhe ta zvogëlojë papunësinë. Megjithatë, në lidhje me strukturën e papunësisë, e cila kryesisht është afatgjate dhe jo e kualifikuar, shkalla normale e papunësisë do të mbetet e lartë për një kohë afatmesëm. Veçanërisht duhet shqyrtohen masat në vijim (Jakimovski, 2013, 73):

- Mënjanimi i pengesave me të cilat përballen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe dhënie mbështetje iniciativave të tyre.
- Promovim të investimeve punuese intensive në infrastrukturën ekonomiko-sociale.
- Krijimi i politikës aktive për punësim fleksibol.

- Përforcimi i revizionit dhe inspektimit, duke përfshirë inspektoriatin e punës.
- Zvogëlimin e ekonomisë gri
- Zhvillim rajonal i barabartë në Republikën e Maqedonisë
- Lidhjen e institucioneve arsimore me nevojat e ekonomisë
- Duhet definimi i qartë i profesioneve, diturive dhe aftësive edhe atë jo vetëm në sektorin real por edhe në sektoret tjera të shoqërisë.

KONKLUZION

Që të rritet punësimi në Maqedoni është e nevojshme të zhvillohet *strategji gjithëpërfshirëse për kuantitet dhe kualitet në arsim*. Për një vend të vogël pa dalje në det dhe me pak resurse natyrore, fuqi punëtore mirë e trajnuar është mjet kryesor për tërheqjen e investimeve. Sipas kësaj qeveria duhet të jep prioritet rritjes së kualitetit në sistemin arsimor dhe sigurim të stimuleve për trajnim.

LITERATURË E SHFRYTËZUAR:

- Vlladimir Kandikijan dhe Todor Rushkov, *Ekonomika*, pjesa e parë Mikroekonomika, Universiteti “Sh.Kirili dhe Metodij” Shkup, Fakulteti Juridik Economy Press, Shkup 1999.
- Jakimovski, *Papunësia-rreziqet dhe sfidat*, Studim hulumtues, Instituti per hulumtime sociologjike dhe politiko-juridike, Shkup 2013.
- Jorde Jakimovski, *The Unemployment and the Social Problems, Economic and social Aspects of the Unemployment in the Republic of Macedonia and Republic Bulgaria and Perspectives for its Surpassing: Proceedings-Skopje: Institute of Sociological, Political*

and Juridicial research Skoje, Economic Insititute in Skoje and Fridrich Ebert Stiftung in Skopje, 2000, p.41-49.

- Jorde Jakimovski, Development in the Macedonian labor Market EBES 2010, Anthology, Istanbul-Turkey, 2012, p. 22-36.
- Marie Jahoda, Paul F. Lazarsfeld and Hans Zisel 1972: Marienthal: The Sociography of an Unemployed Community (London: Tavistock: First pub., 1993)
- Taki Fiti, Makroekonimia, Bazat e makroekonomisë, Universiteti “Sh.Kirili dhe Metodij” Shkup, Fakulteti Ekonomik, Shkup 2004
- Ligji për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë TEKST I KONSOLIDUAR (Gaz.zyrt. e RM nr. 112/2014)
- Udhëzues për qytetarët përmes strukturës, kompetencat e shërbimit të Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale, botues Vladimir Milçin Shkup 20099.
- KNOCK EM DEAD
The ultimate Job search Guide 2012, Martin Yate, cpc. New York Times bestselling autor 2011
- CAREER PLAN
The Best Moves Now for a solid Future.
Laurece Shatkin P.h.D
- STEP -BY -STEP
Resumes second Edition Build an Outsading Resume in 10 Easy Steps, Evelyn U. Salvador 2011
- EXPLORING CAREERS
A young Person’s Guide to 1000 jobs
THIRD EDITION 2003.

APLIKIMI I SISTEMEVE TË DISTRIBUARA NË BIZNESIN ELEKTRONIK NËN FUNKSIONIMIN E ARKITEKTURËS KLIENT-SERVER

¹Dr.sc. Vehbi Ramaj,

Fakulteti Ekonomik, departamenti Menaxhment dhe Informatikë
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Prishtinë

²D.sc. Aferdita Berisha,

Fakulteti Ekonomik, departamenti Menaxhment dhe Informatikë Universiteti
i Prishtinës “Hasan Prishtina” Prishtinë

Abstract

In recent times, Distributed Systems, have found wide use in many different areas of life. With the rapid evolution of technology, the need to access data from a distance has increased rapidly. These file systems form the base for many different applications, especially for those that support client-server architecture. Apart from many different fields, these systems have found very great applicability in the field of electronic business. Electronic business involves the application of information and communication technology in support of all business activities.

These processes, including the following: buying and selling of products, services of a variety of clients, product management, recruitment and automatic management of employees etc. To demonstrate the practical connection and interaction between these systems we developed a web application for data management of persons who are willing to provide services depending on their skills or professions. The motive for this web application development came to us because in our country there are many people who are skilled (training or skills) to perform services of various

spheres (electrician, shopkeepers, accountants, etc.), who have not had any easy opportunity to promote and make use of their skills.

This is the reason why most of them are unemployed, or have insufficient income for their needs. On the other hand, it is not easy and nor a fast way to find people with certain skills, which causes daily problems and delay. Our idea was to build a web application that, for people who know how to perform a specific job, offers them an alternative where they can easily promote their skills. As a novelty in this direction, this web application enables the person to submit the necessary contact information and also it allows him to prove his work by presenting photos, videos or any other evidence in his profile. According to our research through different portals, have not found any platform that offers such an option in our country.

Key words: Distributed systems, e-business, web pages, architecture, client server.

1. Ndikimi i internetit në biznes

Është shumë e vërtetë që teknologjia e ka lehtësuar jashtë mase komunikimin e njerëzëve me njëri-tjetrin, por në të njëjtën kohë kjo teknologji ka sjellë edhe një dimension për të cilin shpesh nuk jemi edhe aq të vetëdijshëm. Tashmë teknologjia është bërë “palë e tretë” në çdo komunikimi që ne kemi me miqtë apo palët në biznes. Interneti u ofron bizneseve mundësinë për të prezantuar imazhin komercial pa marrë parasysh madhësinë dhe vendëndodhjen e tyre.

Trilogjia e zhvillimit është fundamenti mbi të cilin krijohet baza e zhvillimit të përgjithshëm të biznesit në ditët e sotit, duke përfshirë biznesin tradicional dhe atë në internet. Kjo trilogji mund të perceptohet vetëm në pikëpamjen e përgjithshme, ndërsa në pikëpamjen e zhvillimit të biznesit

është një proces që zhvillohet në prapavijë. Është një proces shtytës që ndikon drejtpërdrejtë ose tërthorazi në zhvillimin e strategjive të reja të biznesit. Të kuptuarit të drejtë të këtij zhvillimi bëhet përmes analizës së çështjeve si zhvillimi i teknologjive të internetit dhe hapat e përmirësimit të biznesit elektronik, të kuptuarit e depërtimit të bizneseve në ambientin elektronik, ndikimi i internetit mbi modelet tradicionale të biznesit, ndikimi i internetit mbi ndryshimet në treg, lëvizja e bizneseve tradicionale drejt zhvillimit të strategjive të biznesit elektronik, ndikimi i internetit në zhvillimin e strategjive inovative të bizneseve tradicionale e të tjera. Këtë zhvillim më së miri mund ta shohim më anë të figurës së mëposhtme.




Figura.1. Ndërlidhja e biznesit me internet

Të gjitha temat e sipërpërmendura, dhe shumë të tjera, pikësynim kanë sqarimin e zhvillimit të biznesit nën ndikim të zhvillimit të internetit ku zhvillimi i internetit ndikon drejtpërdrejtë në zhvillimin e strategjive të reja të biznesit të cilat u mundësojnë kompanive lëvizjen në treg.

2. Modelet e biznesit elektronik

Modelet e biznesit elektronik që ndryshe njihen edhe si kategori të biznesit definojnë kategorizimin e kompanive të cilat merren me e-biznes dhe e-commerce dhe relacionet e biznesit me partnerët, furnizuesit, konsumatorët dhe punonjësit e tyre. Modelet e biznesit elektronik janë:

- Business-to-Business-(Biznesi-te-Biznesi), i njohur me shkurtesën B2B;
- Business-to-Consumer-(Biznesi-te-Konsumatori), i njohur me shkurtesën B2C;
- Consumer-to-Consumer-(Konsumatori-te-Konsumatori), i njohur me shkurtesën C2C;
- Business-to-Government-(Biznesi-te-Qeveria/Spektori publik)- i njohur me shkurtesën B2G;
- Consumer-to-Business-(Konsumatori-te-Biznesi) i njohur me shkurtesën C2B;
- Consumer-to-Government-(Konsumatori tek Qeveria/Spektori publik), i njohur me shkurtesën C2G;
- Business-to-Employees-(Biznesi tek punonjësit), i njohur me shkurtesën B2E;
- Government-to-Government-(Qeveria tek Qeveria), i njohur me shkurtesën G2G.

3. Ndikimi i web aplikacionit tonë në biznesin elektronik

Webaplikacioni i një formati të tillë ka një ndërlidhje mjaftë të mirë me mënyrën dhe realizimin e biznesit elektronik në vendin tonë. Pra ai është sikurse një urë komunikuese në mes dy palëve, komunikim ky që laun rolin

vendimtarë në dakordimin në mes palëve biznese. Me anë të këtij Webaplikacioni u mundësohet të gjithë atyre personave që janë të gatshëm për t'u inkuadruar në biznes të regjistronen, si dhe njëkohësisht të gjithë atyre njerëzëve që bëjnë biznes u ofrohet një mundësi më e lehtë të gjejnë punëtorin adekuat. Me që është i pari i këtij lloji në vendin tonë, besojmë që do të ndikoj në mënyrë positive në zhvillimin e biznesit dhe rekrutimin e punëtorëve në vendin tonë.

4. Hyrje në sistemet e distribuara

Në kohën e kaluar kompjuterët ishin fizikisht të mëdhenj dhe kushtonin shumë. Shumica prej tyre ekzekutonin një instruksion për sekond. Zbulimi i mikroprocesorëve dhe zbulimi i rrjetave kompjuterike, me shpejtësi të madhe ka ndikuar në lidhjen dhe koordinimin e shumë kompjuterëve në anë të ndryshme të botës. Këta kompjuterë të lidhur në rrjetë formonin një sistem kompjuterik që i qasemi me emrin sistem i distribuara.

Sistem të distribuara quajmë një bashkësi të kompjuterëve që bashkëpunojnë së bashku për ta kryer një punë të caktuar. Një definicion i pranueshëm është edhe ky:

Definicion:

Një sistem i distribuara është një bashkësi e kompjuterëve të pavarur që në rast të përdorimit nga shfrytëzuesi i duket atij si një sistem kompjuterik i vetëm.

Shembuj të sistemeve të distribuara janë:

Computer clusters (CERN), BOINC, Distributed storage systems (NFS, DropBox), Google, Facebook, P2p.

4.1. Përparësitë e sistemeve të distribuara janë:

- 1. Performanca dhe zgjerueshmëria (scale)**

- Më lirë të blehen 100 kompjuterë se një superkompjuter.
- Lejon ngritjen graduale të performancës.

2. Përdorimi i përbashkët dhe komunikimi

- Ofron qasje në resurse të përbashkëta (printer, sistem i shpërndarë i fajllave).

3. Qëndrueshmëria

Të vazhdon puna e sistemit edhe në prani të prishjeve individuale të kompjuterëve. Një karakteristikë e sistemeve të distribuara është se dallimet në mes kompjuterëve të ndryshëm dhe mënyrat se si këta kompjuterë komunikojnë mes vete fshehen nga përdoruesi. Një karakteristikë tjetër e rëndësishme është se përdoruesit dhe aplikacionet mund të bashkëpunojnë me sistemin e distribuar në mënyrë të barabartë dhe të qëndrueshme. Në parim sistemet e distribuara duhet që të zgjerohen në mënyrë të lehtë (scale).

Një sistem i distribuar do të jetë në dispozicion vazhdimisht, edhe pse ndonjë pjesë e tij mund që të mos funksionojë. Përdoruesit dhe aplikacionet nuk duhet që ta vërejnë që pjesët përbërëse të sistemit të distribuar janë duke u zëvendësuar me pjesë të reja ose janë duke u rregulluar.

Për ti mbështetur kompjuterët e ndryshëm dhe rrjetat e ndryshme gjatë ofrimit të pamjes së një sistemi të vetëm (single-system view), sistemet e distribuara janë të organizuar në atë mënyrë që në mes të shtresës së fundit të **sistemit operativ** dhe shtresës së parë të aplikacioneve, gjendet një shtresë softurike logjike që e paraqet arkitekturën **middleware**.

5. Hyrje në arkitekturën Klient-Server

Jemi në mes të ndryshimeve teknologjike dhe aplikimit të tyre. Sot, organizatat dhe bizneset presin që të kenë përfitim maksimal nga investimet e tyre në teknologji. Mundësitë janë në dispozicion tek organizatat dhe njerëzit të cilët janë të gatshëm të konkurrojnë në tregun global. Në

ekonominë globale konkurente si kjo e sotit nuk ka mëshirë për ata të cilët nuk mundën apo nuk duan të konkurrojnë. Të gjitha organizatat duhet të gjejnë rrugë të reja për t'i demonstruar vlerat. Ne më në fund po e shohim një rishqyrtim të strukturës organizative dhe praktikës biznese. Bizneset në mënyrë të dukshme kanë përfitime nga instalimi i një infrastrukture të rrjetës. Rrjeta i mundëson bizneseve të rrisin bashkëpunimin dhe t'i ndajnë resurset.




Figura 2. Rrjeta me arkitekturën Klient/Server

Modeli Klient-Server është një strukturë e aplikacioneve të distribuara e cila ndanë detyrat apo ngarkesat e punës në mes të ofruesit të resurseve ose shërbimeve, të quajtur Server, dhe kërkuesit të shërbimeve, të quajtur Klient. Në shumicën e rasteve, klientët dhe serverët komunikojnë me anë të një rrjete kompjuterike me harduer të ndarë, por që të dy mund të gjenden në të njëjtin sistem. Një Server-Host ekzekuton një ose më shumë programe të cilat shpërndajnë resurset me klientët. Një klientë nuk shpërndanë asnjë prej resurseve të tij, por kërkon përmbajtje apo ndonjë shërbim. Për këtë arsye klientët fillojnë sesionet komunikuese me serverin i cili pret për kërkesa hyrëse. Shembuj të aplikacioneve kompjuterike të cilat përdorin arkitekturën Klient-Server janë: aplikacionet për e-mail, Printerët, dhe WWW.

6. PHP dhe konceptet themelore

Nësë e keni shikuar rrjetin ndër vite sigurisht e keni vërejtur që ka ndryshuar. Kur interneti u bë publik, ai ishte një mënyrë për të shkëmbyer dokumente. Këto dokumente ishte shumë e thjeshtë që të ndërtohen. Çdo kush që kishte kohë të lirë dhe një editor të tekstit mund ta ndërtonte një ueb faqe. Ndërtimi i një ueb faqe në kohët e hershme kishte të bëjë me ndërtimin e dokumenteve. Sot, interneti është shumë më shumë se atë. Ueb faqet nuk janë thjeshtë vetëm dokumente; ato janë aplikacione. Kanë shumë më shumë kompleksitet dhe ofron shumë mundësi të reja. Mund ta mendosh që interneti nuk është më një vend për individ apo programer fillestar. Shumica e mjeteve softuerike për zhvillimin e këtyre aplikacioneve janë të shtrenjta dhe të komplikuar. Është një komunitet i madh që beson se duhet të ketë softuer falas, i fuqishëm dhe lehtë të përdoret. Ky komunitet e ka ndërtuar disa gjuhë programuese dhe aplikacione të tilla, duke përfshirë PHP dhe MySQL. PHP është një gjuhë e fuqishme programuese që përdoret për të ndërtuar ueb faqe dinamike. Punon mirë në platforma të ndryshme, dhe është e lehtë të kuptohet. Ueb faqet janë interesante, por ashtu të vetme janë thjeshtë dokumente. Një gjuhë skriptuese sikurse PHP mund ta bëjë një ueb faqe statike në një aplikacion interaktiv me shfrytëzuesin.

6.1 Shtimi i PHP ne ueb faqe

Gjuha skriptuese PHP mund të përdoret për t'i shtuar karakteristika të ndryshme një uebfaqeje, që nuk është e mundur të shtohen me HTML apo CSS. Një faqe e shkruar në PHP mund të jetë identike me një faqe në HTML. Të dy këto mund të shkruhen me një editor tekstual të thjeshtë, dhe të ruajtura në server. Një program PHP mund të ketë <script> elemente të bashkangjitura në faqe. Kur përdoruesi kërkon një faqe në PHP, serveri së pari kontrollon faqen dhe ekzekuton <script> elementet para se t'ia dërgoj

përdoruesit në formë të HTML. Kjo funksionon vetëm nëse serveri është i konfiguruar të përdorë gjuhën PHP. Për të funksionuar këto skripta të PHP, serveri duhet t'i ketë së paku këto tri komponente të instaluar. Fillimisht, nevojitet një ueb server sikurse që është Microsoft IIS ose Apache. Së dyti, nevojitet një interpretues i PHP-së, i cili është një program që i lexon skriptat e PHP-së dhe i konverton në HTML. Së fundi, të nevojitet një program për menagjimin e databazës (DBMS) për tu marrur me të dhënat.

6.2. Implementimi i web aplikacionit me php

Për ndërtimin e një web aplikacioni të tillë siç është web aplikacioni “Une Mundem”, i cili duhet të jetë shumë dinamik që kërkon interaksion të madh me shfrytëzuesin, dhe të jetë i gatshëm t'i përgjigjet kërkesave të tij në mënyrë shumë të shpejtë, për këtë arsye kemi vendosur ta përdorim gjuhën skriptuese PHP. Gjithashtu një arsye shumë e fuqishme lidhur me këtë gjuhë është edhe përkrahja e çfardo platformeje, pra është platformë independent (e pavaruar ndaj platformave). Web aplikacioni Une mundem është ndërtuar duke përdorur këtë gjuhë skriptuese, duke i ndarë funksionet e implementuar në PHP ashtu që të jetë sa më lehtë i mirëmbajtshëm, gjithashtu duke siguruar një lloj enkapsulimi të të gjithë web aplikacionit në fjalë. Disa funksione të implementuara në këtë web aplikacion, janë future në skedarin “includes”, siq janë lidhja me databazë:

```
require("constants.php");  
// 1. Create a database connection  
$connection = mysql_connect(DB_SERVER, DB_USER, DB_PASS);  
  
if(!$connection) {  
    die("Database connection failed: " . mysql_error());  
}
```

```
// 2. Select a database to use
$db_select = mysql_select_db(DB_NAME, $connection);
if(!$db_select) {
    die("Database selection failed: " . mysql_error()); }
}
```

Dhe përfundimi i kësaj lidhjeje:

```
<?php
// Close connection
if(isset($connection)) {
    mysql_close($connection);
}
?>
```

Dhe funksione tjera siq jane: kërkime të ndryshme në databazë, headeri, footeri, sesionet, validimi etj. Gjithashtu vlenë të përmendet qe gjatë regjistrimit të një klienti, të gjitha të dhënat validohen ashtu që të sigurihemi për hyrjet tekstuale të shënaura nga klienti, që të mos kemi informata jo valide në databazë. Kjo është arritur duke përdorur validim në anën e serverit me anë të PHP-së. Më poshtë kemi paraqitur një pjesë të kodit që ndihmon në validimin e hyrjeve tekstuale, në këtë rast emrit.

```
$mesazhi = "Fusha duhet plotësuar!";
$emailErr = "";
$validationError = false;
if ($_SERVER["REQUEST_METHOD"] == "POST") {

if (isset($_POST['emri'])) { $emri = $_POST['emri']; } else { $emri = ""; }

if (empty($_POST["emri"])) {
    $emriErr = $mesazhi;
```

```
$validationError = true;
} else {
    $emriUp = ucfirst(strtolower($_POST["emri"]));
    $emri = test_input($emriUp);
}
}
```

7. Dizajnimi dhe implementimi i databazës së web aplikacionit

Për shkak që të dhënat e secilit person që regjistrohet në web aplikacionin Une mundem duhet të jenë gjithmonë të gatshme për qasje nga klientët, duke përfshirë të dhënat bazike, aftësit e tij punuese të dëshmuara jo vetëm me shkrim por edhe me anë të fotografive, duke iu mundësuar secilit person që regjistrohet të ruaj fotografi të ndryshme varësisht prej profesionit apo aftësive të tij, patjetër që nevojitet që ky aplikacion të ketë një databazë. Për implementimin e databazës kemi përdorur MySQL, e cila është përmendur më lart, duke përmendur shumë beneficione të cilat i ofron. Fillimisht është bërë ERD diagrami i web aplikacionit të sipër përmendur dhe pastaj implementimi i tij duke përdorur MySQL. Më poshtë është paraqitur dizajni i databazës së web aplikacionit Une Mundem.




Figura.3. Dizajni i databazës së web aplikacionit Une mundem

Kjo databazë është e normalizuar deri ne shkallën e tretë të normalizimit, duke i ruajtur të gjitha të dhëant e nevojshme dhe duke larguar kështu përsëritjen e të dhënave dhe alokimin e hapsirës memorike sa më të vogël. Për shkak të mirëmbajtjes dhe efikasitetit, fotografit që ngarkohen nga përdorues të ndryshëm nuk janë ruajtur drejt për drejt në databazë, por ne skedarë të veçantë për secilin përdorues.

8. Prezantimi i web aplikacionit ne disa hapa

www.unemundem.com është një portal me një dizajn mjaft të thjeshtë por që kryen një punë tejet efikase. Si i tillë, ne jemi munduar që ky portal të jetë lehtë i përdorshëm nga secila grupmohë e cila synon të përfitoj diçka përmes këtij portali. Edhepse vet do të befasoheni sa lehtë është të punohet me të, ne ndjejmë se është e udhës të japim disa instruksione që do të ju ndihmojnë në rast se keni nevojë për ndihmë. Për çdo pengesë që nuk mund të gjeni zgjidhje këtu, ju lutem të na shkruani në kontaktet tona që mund ti gjeni në seksionin [Rreth nesh](#).

Si të regjistrohem?

Hapi 1:

Nëse dëshironi që të regjistroheni në portalin tonë, ju duhet shikoni në anën e djathtë-lart në ballinë, dhe të shtypni në vegëzën: Regjistrohu.

Mundem

Home icon | Ndihmë | Rreth nesh

Çka po kerkoni? Ku?

Profesioni Vendi

Kerko

Login
Regjistrohu

Kerkim i avancuar:

Profesioni:
Zgjedhni profesionin | Nen profesioni

Qyteti:
Qyteti

Pas klikimit në vegëzën Regjistrohu ju do të kaloni në faqen e regjistrimit e cila duket kështu:

Regjistrohu

Emri:

Mbiemri:

Telefoni: 044 000-000

E-mail:

Password:

Rishkruaj password-in:

Profesioni: Profesioni

Nen profesioni: Nen profesioni

Qyteti: Qyteti

Adresa: Lagjia ose fshati

Përshkrimi:
Përshkruani profesionin tuaj.

Shto fotografi:
Choose File | No file chosen

Regjistrohu Cancel

- Vlenë të përmedim që në fushat që duhet ti plotësoni, ju patjetër duhet ta shkruani numrin tuaj të telefonit, sepse do të përdoret si informatë e komunikimit të personave tjerë me ju.
- E-mail-i nuk është e detyrueshme të shënohet, por rekomandohet shënimi i sajë për arsye të më shumë informatave komunikuese me ju, si dhe nëse dëshironi që ta ndryshoni fjalëkalimin (passëordin) tuaj, kjo gjë bëhet më shpejtë përmes e-mail-it.
- Profesionin është i detyrueshëm që të zgjedhet, kurse nënprofesionin rekomandohet të zgjedhet për shkak se nevojtarët do të kenë më të lehtë gjetjen tuaj.
- Në fushën e fundit Përshkrimi ju mund të përshkruani punën tuaj (çka dini të bëni më tepër, përvojën e punës dhe informata tjera shtesë).

Pas plotësimit të këtyre të dhënave ju mund të regjistroheni duke e shtypur pullën Regjistrohu ose mund ta anuloni regjistrimin duke e shtypur pullën Cancel. Nëse fushat nuk janë plotësuar në rregull, ose nuk janë plotësuar fare, portali do të lajmëroj që plotësimi i tyre duhet të jetë në rregull. Luteni që të dhënat të jenë të sakta dhe të shkruara në rregull. Për çdo parregullsi që vërehet nga stafi ynë, mund të pasojë largimi i të dhënave tuaja nga portali.

KONKLUZION

Shpresojmë që ky web aplikacion do të ndikojë në mënyrë pozitive tek përdoruesit, duke u ofruar atyre një alternativë më tëpër për promovimin e tyre, si dhe të jetë miku më besnik i çdo qytetari. Ne si themelues të këtij projekti, shpresojmë që në të ardhmen ky projekt të zgjerohet edhe më tutje, duke kaluar kufinj të shtetërorë. Gjithashtu ne do angazhohemi në mirëmbajtjen dhe evoluimin e më tutjeshëm të web aplikacionit, si dhe të jemi gjithmonë të gatshëm për ndihmë ndaj çdo kërkesë të shfrytëzuesëve të ndryshëm.

REFERENCAT:

1. “Distributed Systems: Principles and Paradigms” -_Andreë S. Tanenbaum,_Maarten Van Steen;
2. “Software Engineering 9th ed” - Sommerville, 2010;
3. “Distributed Systems - Concepts and Design” - Addison Wesley , 5th edition;
4. “Electronic Commerce: The Strategic Perspective” - Richard T. Watson, Pierre Berthon, Leyland F.Pitt, and George M. Zinkhan;
5. “Advanced PHP Programming” - George Schlossnagle;
6. “High Performance MySQL THIRD EDITION” - Baron Schwartz, Peter Zaitsev, and Vadim Tkachenko;
7. “Learning MySQL” - Seyed M.M. “Saied” Tahaghoghi and Hugh E. Williams;
8. “Head First HTML With CSS & XHTML” - Elisabeth Robson, Eric Freeman;
9. “Client Server Architecture (Course Material)” – FaaDoOEngineers;
10. “Guide to Software verification and validation” - ESA Publications Division.

EDWARD GREY DHE QËNDRIMI I TIJ NDAJ SHQIPËRISË

Elvin ELEZI

Doktorant-profilu Histori Universiteti i Tiranës Fakulteti i Historisë dhe i
Filologjisë Departamenti i Historisë

HYRJE

Periodha e shpalljes së Pavarësisë është një nga segmentet kohore më tërheqëse të historisë së popullit shqiptar. Ndoshta kjo për faktin se ngjarjet e kësaj periudhe shënojnë një pikë kthese në historinë tonë kombëtare. Studimi i thelluar në vazhdimësi i kësaj pjese të rëndësishme të historisë sonë, duke u mbështetur në të vërtetën faktike dokumentare shkencore, pa dyshim e pasuron vetëdijen tonë kombëtare.

Numri i temave që paracakton kjo periudhë është i konsiderueshëm për trajtimin e tyre në një ese të vetme. Megjithatë nën dritën e informacionit të dokumentave britanike dhe veçanërisht të telegrameve, letrave, udhëzimeve, opinionëve dhe konsideratave që mbajnë emrin e sekretarit britanik të Shtetit për Punët e Jashtme Sir Edward Grey-i në të cilën mbështetet kjo ese, në të cilën trajtohen disa nga çështjet më thelbësore që kanë ravigjësuar këtë periudhë, nga shpallja e Pavarësisë deri në muajt e parë të Luftës I Botërore.

Britania e Madhe në fillim të shekullit XX kishte trashëguar një rol primar në marrëdhëniet ndërkombëtare, si një nga shtetet më aktive dhe më të fuqishme në fushën e diplomacisë botërore. Kështu që mbajtja e

Konferencës së Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha në Londër në dhjetor 1912 nuk ishte e rastësishme dhe aq më pak kryesimi i saj nga E. Grey-i.

Anglia në fillim të dhjetëvjeçarit të dytë të shekullit të XX ishte për ruajtjen e një klime paqeje në Europë dhe në këtë frymë janë të gjitha qëndrimet e saj, përfshirë këtu edhe qasja ndaj së ardhmes së Ballkanit.

Për E. Grey-in në plan të parë ishte moslejimi i afrimit të rrezikut të mosmarrëveshjeve ndërmjet Fuqive të Mëdha, gjë që mund të sillte një konflikt të armatosur të përmasave të paparashikuara. Ndërsa vetëm për në plan të dytë ngelte për politikën e Jashtme britanike trajtimi me drejtësi reale dhe qëndrim të palëkundur të çështjeve kombëtare të popujve të vegjël që duan të realizojnë aspiratat e tyre kombëtare, siç ishte dhe rasti i Shqipërisë në periudhën e shpalljes së Pavarësisë.

1-QËNDRIMI I E.GREY NDAJ QEVERISË SË VLORËS DHE ISMAIL QEMALIT

Qeveria e Vlorës e kryesuar nga I.Qemali u krijua që në ditët e para të dhjetorit pas shpalljes së pavarësisë. I.Qemali pas aktit të pavarësisë njoftoi Fuqitë e Mëdha, vendet ballkanike për ndryshimet politike në Shqipëri dhe kërkoi njohjen prej tyre. Megjithëse si përfundim asnjë nga Fuqitë e Mëdha nuk e njohën zyrtarisht Qeverinë e Vlorës, duhet thënë se Austro-Hungaria dhe Italia për shkak se konvergonin edhe interesat e tyre në pajtim me këto ndryshime, dhanë sinjale në qoftë se fitonin edhe mbështetjen e Fuqive të tjera ishin pro njohjes së saj si qeveri kombëtare.

Përcaktuese do të ishin punimet e Konferencës së Londrës me marrëveshjen e 29 korrikut 1913 në pikën 7 të saj vendoste përfundimisht për statusin e organizimeve administrativo-shtetërore që gjendeshin në vend duke i njohur si “autoritete vendëse ekzistuese”. Po të njëjtin qëndrim do të

mbanin ndaj Qeverisë së Vlorës edhe antarët e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit që erdhën në Vlorë në tetor 1913 në koherencë me udhëzimet e marra nga secila fuqi që ata përfaqësonin.

Në telegrafin dërguar diplomatit Fairfax Cartwright më 24 tetor 1913, E.Grey-i fokusohet në qëndrimin unik që duhet të mbajë KNK ndaj njohjes së Qeverisë së Përkohëshme dhe sipas tij të bëhej kujdes në evidentimin e hapësirës territoriale ku shtrihej autoriteti i saj me kohë, hapësirë tokësore që do të përcaktonte njohjen e Qeverisë së Vlorës nga KNK dhe Fuqitë që e përbënin atë¹. Në këtë mënyrë ishte më e lehtë për KNK të përcaktonte edhe ekzistencën e shtrirjen e autoriteteve të tjera lokale në vend dhe ti njohë ato nëse janë të pranuar aty².

Për E.Grey-in në letrën e 30 tetorit 1913 për F.Cartwright ishte thelbësore që autoriteti i Qeverisë së Përkohshme dhe veçanërisht i kryetarit të saj të njihej nga KNK në atë hapësirë tokësore ku ishte pranuar dhe jo ti bëhej i detyrueshëm gjithë vendit: *Të mos imponohej Ismail Qemali t'u hidhet në fyt njerëzve në Shqipëri, por vetëm të njihej autoriteti i tij në ato krahina ku ai, tashmë, ishte pranuar*³.

Në pëlqimet dhe mos pëlqimet që kishin Fuqitë ndaj Qeverisë së Vlorës, mund të ketë luajtur rol dhe qëndrimi specifik i secilës Fuqi ndaj figurës së kryetarit të saj. Përfaqesuesi i diplomacisë britanike E.Grey-i në komunikimin me F.Cartwright nuk ngurron të shprehë opinionin jo aprovues ndaj veprimtarisë së I.Qemalit dhe se e barazonte Qeverinë e Përkohshme vetëm me autoritetin e një individi të vetëm, të kryetarit të saj: *Me sa dukej, Qeveria e Përkohshme ishte Ismail Qemali dhe se gjithçka që unë kisha dëgjuar për këtë xhentëlmën në vitet e fundit më bënte një admirues jo shumë entuziast të tij*⁴.

Në një komunikim me ambasadorin britanik në Austro-Hungari Maurice de Bunsen, E.Grey-i rithekson statusin si autoritet lokal që kishte gëzuar Qeveria e Vlorës: *Ismail Qemali, qeveria e të cilit kishte qenë tepër e pjesshme dhe e përkohshme*⁵.

Në fakt çdo pushtet ekzistues në vend u njoh si lokal nga Fuqitë e Mëdha dhe këto pushtete nuk do të merreshin në konsideratë si bazë për themelimin e Qeverisë Kombëtare të ardhshme.

Si përfundim vlen të nënvizohet që Qeveria e Vlorës gjatë veprimtarisë së saj u mundua të përfaqësonte sa më denjësisht interesat e kombit shqiptar, por që e detyruar të punojë në kushte shumë të vështira. Si rezultat i rrethanave komplekse Ismail Qemali dhe qeveria që ai drejtonte dhanë dorëheqjen më 22 janar të 1914. Pushteti në vend i kaloi Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, deri në ardhjen e princ Vidit.

2- QËNDRIMI I E.GREY NDAJ ÇËSHTJES SË KUFIJVE TË SHQIPËRISË

Lufta e Parë Ballkanike për sa i përket aleatëve ballkanikë filloi me një premisë paraprake, e cila synonte ndryshime të konfiguracionit të hartës së Ballkanit me vendosjen e paqes. Premisa paraprake siç u artikulua pas luftes cënonte rëndë të drejtën dhe lirinë e popujve për vetvendosje sipas parimit etnik, ajo bazohej në aneksim e zotërim terrioresh nga vendet fituese prej vendeve humbëse së luftes, sipas parimit “të së drejtës të kompesimit territorial”. Trojet shqiptare u gjykuan si pjesë e Turqisë, si rrjedhojë sipas kësaj logjike ishin të destinuar të bëheshin pre e aleatëve ballkanikë që rezultuan dhe fitues të luftës. Të njëjtën pikëpamje qeveritë e shteteve fituese të luftës e shtruan edhe në Konferencën e Paqes që u mbajt në Londër në të njëjtën kohë me Konferencën e Ambasadorëve.

Qeveria e Vlorës në memorandumimin që i dërgoi Konferencës së Ambasadorëve përveçese paraqiti kërkesat e drejta për kufijtë e shtetit shqiptar, gjithashtu hodhi poshtë me argumenta parimin e “kompesimit territorial” ku mbështeteshin aleatët ballkanikë.

Rezultatet e Konferencës së Ambasadorëve dëshmojnë që trojet shqiptare u cënuan rëndë, nuk u zbatua parimi etnik për ndarjen e drejtë të kufijve shtetërorë. Dy Komisionet Ndërkombëtare për caktimin e kufijve në terren që i krijoi Konferenca e Ambasadorëve shpesh herë përfshiheshin nga debate të shumta si derivate të kundërshtive midis Fuqive të Mëdha që ishin mbartur që nga punimet e Konferencës.

Caktimi i kufijve në terren po ashtu ishte më tepër kompromis midis interesave të Fuqive se sa respektimi i parimit etnik, ku edhe përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha ishin të ndërgjegjshëm për këtë, vlen të përmendet udhëzimi i 11 majit 1914 i E.Grey-t për kolonelin Granet, i cili ishte përfaqësuesi britanik në Komisionin e Caktimit të Kufirit Verior të Shqipërisë, përmbajtja e të cilit jep tablonë e padrejtësisë së ndarjes së kufijve në dëm të trevave shqiptare: *Asnjë fshat tjetër shqiptar nuk duhet t'i lëshohet Serbisë*⁶.

Kuptohet që pretendimet e fqinjëve tanë me përkrahjen e ndonjë Fuqie të Madhe për aneksimin e territoreve të populluara nga popullsi shqiptare mbështeteshin në një sërë argumentash e makinacionesh deri nga më absurdet, duke mbajtur të pushtuara territore shqiptare. Në këtë rast, në krahinat Verilindore gjendja reale e popullsisë ishte më shumë se e rëndë, vetë E.Grey ishte koshient për këtë: *Unë isha i sigurtë që në Gadishullin Ballkanik, përgjithësisht, kanë ndodhur shumë gjëra të tmerrshme*⁷.

Nuk duhet mohuar se ka patur udhëzime për të gjykuar me drejtësi çështjet e caktimit të kufirit, siç përmendet rasti i kazasë së Gorës në të cilën u hasën vështirësi për kompromis midis anëtarëve të Komisionit për caktimin përfundimtar të kufirit, udhëzimi i E.Grey-t për përfaqësuesin britanik në Komisionin e Caktimit të Kufirit është mbështetur në parime të shëndosha: *Në varësi të rezultatit të një hulumtimi lokal mbi besimin fetar dhe kombësinë e banorëve. Në këtë këndvështrim Sir E.Grey është dakort*⁸.

Ky qëndrim është cilësuar në letrën që E.Grey-i ja dërgon ambasadorëve të pesë Fuqive që ndodheshin në atë kohë në Londër. Kjo mënyrë komunikimi e qartë dhe e drejtpërdrejtë e në të njëjtën kohë me të gjitha Fuqitë e E.Grey-it kishte për qëllim të minimizonte kundërshtitë midis tyre dhe njëherazi të impononte autoritetin e tij. Autoritet i cili mbështetej në radhë të parë tek fuqia e vendit që përfaqësonte dhe më pas tek individi institucional që ishte drejtuesi i diplomacisë britanike.

Qëndrimi i E.Grey-t ndaj kufijve të Shqipërisë është i pandarë ndaj shqyrtimit prej tij të interesave territorialë të fqinjëve tanë⁹. Theksohet në letrën e E.Grey-t për ambasadorin britanik në Austro-Hungari Maurice de Bunsen më 27 dhjetor 1913, që caktimi i kufirit të Jugut të Shqipërisë është pjesë e kompromisit të Fuqive me Greqinë, që kjo e fundit do të mbante nën sovranitetin e saj gjithë ishujt e okupuar prej saj, me përjashtim të Tenedos e Imbros dhe në kompesim të kësaj Greqia do të pranonte që ekstremiteti i kufirit Jugor të Shqipërisë do të ishte Korça dhe Kepi Stilo¹⁰.

3- QËNDRIMI I E.GREY NDAJ KRIJIMIT TË BANKËS KOMBËTARE SHQIPTARE

Gjendja ekonomike në të cilën ndodhej vendi pas shpalljes së pavarësisë ishte e mjerueshme. Pavarësimi ekonomik dhe krijimi i institucioneve të

qëndrueshme financiare në vend ishte një hap i domosdoshëm për Shqipërinë dhe për Qeverinë e Vlorës. Në këtë kuadër qeveria i vuri detyrë vetes krijimin e Bankës Kombëtare Shqiptare. Së pari realizimi i kësaj nisme ishte i nevojshëm në kuadrin e sendërtimit social-ekonomik dhe së dyti forconte pozitat politike të shtetit shqiptar.

Vendet e Antantës ishin për krijimin e një Banke Kombëtare Shqiptare ku pjesëmarrja nëpërmjet kapitaleve në të, të ishte e ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet gjashtë Fuqive¹¹. Edhe Britania nëpërmjet telegrafit që E.Grey-i i dërgon konsullit të përgjithshëm Lamb nuk lëshon pe për sa i takon kësaj çështjeje, duke mbajtur të njëjtën linjë me vendet e tjera të Antantës: *Të jetë vendosur çështja e pjesëmarrjes së barabartë në Bankën e Shqipërisë. Qëndrimi juaj duhet të jetë i njëjtë me këtë*¹².

Avancimi i bisedimeve ndërmjet Qeverisë së Vlorës dhe Austro-Hungarisë e Italisë deri në miratimin e një marrëveshje koncesionare vetëm me këto dy Fuqi për krijimin e Bankës Kombëtare, kundërshtohet vazhdimisht nga vendet e Antantës, veçanërisht qëndrimi i prerë i Britanisë për ndërkombëtarizimn e Bankës nëse do të ishte nevoja, por në asnjë mënyrë nuk do të pranonte marrëveshje të privileguara të një apo disa Fuqive veçmas me Qeverinë e Vlorës

marrë aprovimin e KNK¹³. Në këtë kontekst E.Grey-i udhëzon konsullin Lamb për qëndrimin që ai duhet të mbajë në Komisionin e Kontrollit për këtë çështje: *Asnjë koncesion i dhënë prej Qeverisë së Përkohshme nuk është i vlefshëm pa u analizuar dhe pa u miratuar nga Komisioni i Kontrollit*¹⁴.

Rezerva dhe kundërshti ndaj këtij koncesioni u shfaqën edhe nga një pjesë e shqiptarëve, kryesisht për rolin e këtij institucioni financiar në të ardhmen e vendit. Vihej në dyshim aktiviteti i bankës në raport me interesat

ekonomike të Shqipërisë dhe për më tepër rreziku i dominimit ekonomik të vendit nëpërmjet bankës, e cila do të ngrihej plotësisht me kapital të huaj, gjë që do të sillte në një të ardhme të afërt ose të largët pashmangshmërisht edhe dominimin politik të

vendit nga dy Fuqitë që kishin sponsorizuar kapitalin e saj. Me gjithë vullnetin këmbëngulës të vendeve nënshkruese të koncesionit për jetësimin e tij, ky projekt ngeli vetëm në letër.

4-RËNDËSIA E EMËRIMIT TË PRINCIT NË KRYE TË SHTETIT SHQIPTAR SIPAS E.GREY. KANDIDATURA E VIDIT

Punimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, në përfundim të tyre përfaqësuesit e të gjithë fuqive kishin vendosur me marrëveshje në pikën e parë të vendimit që Shqipëria shpallej principatë dhe se në krye të saj do të caktohej një princ brenda një kohe të përcaktuar, po nga të gjashta Fuqitë.

Me ardhjen e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit në Vlorë, në tetor të 1913 dhe mos njohjen nga ana e tij të asnjë organizimi administrativo-shtetëror kombëtar në vend. Zgjidhja e vetme në optikën e gjashtë Fuqive ishte zbatimi i marrëveshjes së 29 korrikut 1913, të emëronin princin sa më shpejt të ishte e mundur, nën udhëheqjen e të cilit do të krijohet një qeveri kombëtare, e cila dhe të gëzonte atributin që të njëjtit në arenën ndërkombëtare si përfaqësuese e Shqipërisë dhe njëherazi duke i dhënë fund pushteteve ekzistuese lokale në vend.

Në komunikimin e 20 tetorit 1913 me ambasadorin britanik në Gjermani Edward Goschen, E.Grey-i në dritën e të dhënave që dispononte shpreh rëndësinë imediate të emërimit të princit sepse nën udhëheqjen e të cilit do të unifikohej politikisht vendi: *Sipas raporteve tona, gjëja më e*

rëndësishme për ta bashkuar tërësisht Shqipërinë do të ishte emërimi i një princi¹⁵.

Që kurse Shqipëria kishte hyrë në axhendën e Fuqive të Mëdha, rreth saj ishte zhvilluar një luftë e vërtetë diplomatike midis tyre, ku si përkrahëse të çështjes shqipëtare kishin spikatur Austro-Hungaria dhe Italia. Kjo predispozitë këtyre dy Fuqive vazhdoi edhe në pjesëmarrjen aktive për ngritjen e shtetit shqiptar sipas konceptit të njohur të të gjitha Fuqive, që ato ishin faktori vendimtar i ekzistencës së Shqipërisë dhe më tej në krijimin e institucioneve shtetërore me në krye princin, emërimi i të cilit ishte atribut ekskluziv i tyre.

Në konsekuencë të këtij pohimi, Fuqitë e tjera, të cilat ishin pak të interesuara në mënyrë të drejtëpërdrejtë për Shqipërinë, i lanë dorë të lirë Austro-Hungarisë dhe Italisë për përzgjedhjen e një kandidature serioze për detyrën e princit.

Në dijeninë e E.Grey-it se Austro-Hungaria parapëlqente që të caktohej princ Vidi në krye të shtetit Shqiptar, atëherë ai i bën të ditur ambasadorit anglez në Vjenë, Theo Russell më 7 nëntor 1913 qëndrimin e tij miratues ndaj figurës së Vidit dhe i pohon gjithashtu se edhe Franca e Rusia ndanin të njëjtin mendim me të: *Ne do ta pranohim atë (princ Vidin –E.E) dhe se unë nuk mendoja se do të kishte ndonjë që do të shfaqte ndonjë kundërshtim ndaj tij; por është e nevojshme që dikush të marrë iniciativën dhe ta propozojë atë¹⁶.*

Në këtë perspektivë konsensuale ndërmjet Fuqive ishte mëse e qartë që princ Vidi e kishte siguruar vendin për Fronin Mbretëror të Shqipërisë. Ngelej vetëm propozimi dhe miratimi zyrtar i kandidaturës së tij, gjë që nuk

vonoi shumë dhe më 28 nëntor 1913 të gjashta Fuqitë bënë shpalljen zyrtare të emërimit të Vidit si princ i Shqipërisë.

Princi Vilhelm Vidi erdhi në Shqipëri më 7 mars të 1914. Ai si kryetar shteti u mundua të ngrinte një shtet të mbështetur në baza të qenësishme ligjore. Hapi më i rëndësishëm në këtë drejtim ishte krijimi dhe aplikimi i Statutit Organik të Shqipërisë i së njëjtës natyrë me një Kushtetutë sot, ky ligj themelor u krijua nga KNK dhe mbështetej në vendimin e Konferencës së Londrës të 29 korrikut 1913. Jeta e shtetit Shqiptar në drejtimin e Vidit ishte tepër e shkurtër. Në rrethana të pafavorshme të brendshme e të jashtme princ Vidi u largua nga Shqipëria më 3 shtator të 1914.

5- E.GREY-I, MENDIMI I TIJ PËR SHQIPTARËT DHE SHQIPËRINË

Të qëniet e trojeve shqiptare dhe e popullsisë që e përbënte atë për një kohë relativisht të gjatë nën sundimin osman, të masave e të politikave të këtij pushteti të huaj, e kishte lënë këtë vend në nivelet më të ulëta të zhvillimit social-ekonomik-kulturor krahasuar me vendet e tjera të Europës. Kjo gjendje e vështirë e trashëguar nga sundimi osman mbizotëronte pothuajse në të gjitha aspektet e jetës dhe e shoqëroi vendin edhe pas shpalljes së Pavarësisë. Fakt ky që është konstatuar edhe nga E.Grey-i në letrën që i dërgon diplomatit britanik në Gjermani, Edward Goschen: *Nën sundimin turk shqiptarët nuk kishin pasur asnjë mundësi të zhvillonin vendin e tyre*¹⁷.

Sigurimi i pavarësisë i një vendi është veçse fillimi i ringritjes drejt zhvillimit dhe se kapacitetet e duhura për ta bërë këtë nuk mungonin tek shqiptarët, çka premtonte për një të ardhme të sigurtë për ta dhe vendin e tyre: *Unë shpresoja – shprehet E.Grey-i nga Londra për Edward Goschen –*

që një shtet i pavarur dhe cilësitë e njerëzve të tij do të mundësonin që tani ai të bëhej një vend i zhvilluar¹⁸.

Gjithashtu nga njohja që kishte E.Grey-i për Shqipërinë si vend mesdhetar, përshtypjet që i kishin lënë bisedat me shqiptarët dhe gjithçka tjetër që ai kishte dijeni për ta, kishte formuar në bindjet e tij një konsideratë shumë pozitive: *Unë besoja – vazhdon ligjëratat e E.Grey-it po në të njëjtin dokument - se shqiptarët ishin tërheqës dhe vendi ishte piktoresk*¹⁹.

6- INTERESI BRITANIK PËR SHQIPËRINË SIPAS E.GREY

Në problematikën e çështjes shqiptare E.Grey-i mbajti një qëndrim të distancuar për vetë faktin se interesat e qeverisë së vendit të tij për Shqipërinë varionin nga pak deri në aspak. Britania ishte i interesuar për ruajtjen e paqes në kontinent dhe mos rrezikimit të ekuilibrit midis Aleancës Tripalëshe dhe Antantës. Ky qëndrim i Britanisë nuk e humbet koherencën e vet edhe pas mbërritjes së Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit në Shqipëri. Gjatë analizimit të vështirësive që mund të hasnin në punën e tyre, si KNK, po ashtu dhe dy Komisionet e Caktimit të Kufijve, për shkak të mosmarrveshjeve ndërmjet anëtarëve të tyre, ose pengesa nga faktorë të jashtëm që mund të çonin deri në bllokimin e punës së tyre. Në verifikimin e kësaj hipoteze E.Grey në komunikimin me ambasadorin britanik në Francë, Francis Bertie, rikonfirmon qëndrimin e dizinteresuar politik të Britanisë ndaj Shqipërisë e në të njëjtën kohë në ligjëratën e tij lë të aludojë se vendi i tij mund të ketë interesa të tjera, siç mund të ishin ato ekonomike: *Një preferencë për tërheqjen nga ana jonë, pasi ne, politikisht, kishim shumë pak interes në Shqipëri*²⁰.

Gjithashtu çështja e krijimit të Bankës së Shqipërisë u bë objekt diskutimi e kundërshtish ndërmjet Fuqive, në aspektin se cili do të ishte roli i çdo Fuqie

në këtë nismë, sepse pozita e privilegjuar e ndonjë Fuqie ose disa prej tyre në krijimin e kësaj banke, përcaktonte në një farë mënyre dominimin e tyre në Shqipëri në raport me Fuqitë e tjera. Ngjarjet po rridhnin dhe bankat e Austro-Hungarisë dhe e Italisë po siguronin përparsi për të marrë koncesionin në fjalë nga qeveria e I.Qemalit dhe se de facto këto dy Fuqi po fuqizonin akoma më tepër pozitën e tyre të veçantë në Shqipëri. Në këtë hulli zhvillimesh, Austro-Hungaria dhe Italia për ti paraprirë pakënaqësive ose kundërshtimeve, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre diplomatikë kërkonin të testonin opinionin e Fuqive të tjera përballë objektivave të tyre në lidhje me këtë çështje dhe njëkohësisht se cili ishte interesi i Fuqive të tjera lidhur me Shqipërinë, në këtë rast është ambasadori italian në Londër në bisedën me E.Grey-in²¹.

KONKLUZION

Në dijeninë e këtyre të dhënave E.Grey-i në komunikimin me ambasadorin britanik në Itali, Rennell Rodd, rievidenton raportin e Fuqive të tjera me Shqipërinë dhe njëkohësisht pozicionin e distancuar në vazhdimësi të Britanisë me Shqipërinë: *Unë (E.Grey –E.E) i thashë se nuk mund të ndieja të njëjtën lidhje me Shqipërinë sa ndienin disa nga Fuqitë e tjera; në fakt, ne pothuaj jemi larguar nga Shqipëria më shumë se një herë*²².

REFERENCAT:

1. Valentina Duka, Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (janar-dhjetor 1914) II, Tiranë: TOENA, 2012;
2. Valentina Duka, Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913) I, Tiranë: TOENA, 2012;

GJEOPOLITIKA GLOBALE, LINDJA E MESME DHE BALLKANI

Doc. dr. Muhamed JUSUFI

(Universiteti Ndërkombëtar i Strugës - Dekan i Fakultetit të Shkencave
Politike)

HYRJE

Fuqia telurokratike e cila njihej si fuqia e pa konkurrentë në botën e shek. XX-të u shpërbërë pa zhvilluar ndonjë betejë klasike kundër talasokratëve. Nuk vonoi shumë, këta shpallën edhe shpërbërjen e Federatës Ruse. Bota nuk kishte njohur më parë një rast të tillë, prandaj ky vakum gjeopolitik duhej shfrytëzuar nga forcat talasokrate në krye të së cilës janë (SHBA-të). Kështu kjo mbeti forca e vetme në botë deri më sot, gjithsesi kështu do të vazhdojë për një kohë më të gjatë nëse nuk do të kemi ndryshime të mëdha të cilat mund të fillojnë këtë vit.

Duke qenë se hapësira e gadishullit të Ballkanit për gjatë dy shekujve të fundit ishte territor i pa përfunduar gjeopolitikisht, forcat talasokrate do të duhej të shfrytëzonin rënien e imunitetit të telurokratëve për t'u marrë me Ballkanin. Pak para se të fillonte shpërbërja e Federatës Jugosllave, diktatori i Irakut Sadam Huseini si duket nuk kishte nuhatur ndryshimet e mëdha gjeopolitike që po vinin, dhe më 1990 ai do të pushtonte Kuvajtin!? Ishte kjo një cytje e talasokratëve ose jo do të tregojë historia, mirëpo Sadam Huseini nuk kishte zgjedhur as kohën dhe as vendin e duhur për t'i bërë këto manovrime politike.

Nga viti 1990 talasokratëve ju dolën dy objektiva, anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE) ish shteteve anëtare në Paktit të Varshavës si dhe shtetet e Ballkanit, ndërsa shtetet e Lindjes së Mesme do të duhej të hynin nën ombrellën e forcave talasokrate. Tani na janë të njohura numri i shteteve të Evropës Lindore që janë anëtarësuar në BE, përfshirë këtu edhe dy republikat e ish federatës jugosllave, mirëpo për t'i përmbyllur këtë dy objektiva talasokratëve ju duhet ende kohë, gjë që pas shfaqjes së krizës

ekonomike botërore vështirë se mund të përmbyllen plotësisht këto objektiva.

Ky punim i imi do të hulumtojë mundësinë dhe mënyrën e arritjes ose mos arritjes së këtyre objektivave të talasokratëve në fushën e lëvizjeve ekstremiste aktuale fetare në Ballkan dhe Lindjen e Mesme, si dhe mbi zhvillimet politike në këto hapësira gjeografike.

Lindja e Mesme dhe Ballkani

Para se të shkoqisim problemet rreth Lindjes së Mesme shoh të domosdoshëm të sjell gjendjen aktuale demografike të kësaj hapësire gjeografike. Bazuar në censusin e vitit 2011-të, në Lindjen e Mesme jetojnë rreth 413 milion banorë në të cilën arabët përbëjnë shumicën. Në këtë regjion jetojnë një numër i vogël minoritarësh autoktonë sikur hebrenj, armenë, shqiptarë, grekë, koptë, etj., ndërsa popuj me numër më të konsiderueshëm janë persët, turqit dhe kurdët. Shumica dërmuese e këtyre popujve i përkasin civilizimit islam.⁹⁶ Nëse do të përjashtonim të krishterët, hebrenjtë, nacionalistët arabë dhe sekte të ndryshme të vogla të cilat jetojnë nën ombrellën e civilizimit islam, themi se shumica muslimane ka edhe një nënndarje tjetër të drejttimeve ose shkollave juridike.⁹⁷

Shpesh herë këto shkolla dominojnë ose përcaktojnë orientimet politike në vendet e tyre.⁹⁸ Shembulli më i mirë është Siria dhe Egjipti. Pakica alevite në Siri e ndihmuar nga telurokratët gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë kishte arrit që të sundojë ndaj shumicën sunite për disa decenie me radhë. Kështu është edhe me Egjiptin, pakica nacionaliste e ndihmuar ushtarakisht herë nga telurokratët e herë nga talasokratët kishte arrit të sundojë shumicën fetare.

Në gjithë botën Islame, drejtimi sunit përbën shumicën, pastaj ai shiit dhe drejtimi tretë është dhe më i riu është ai wehabit. Themeluesi i këtij drejtimi është Muhammed Abdulwehab (1699-1792).

⁹⁶ Shih tabelën nr. 1

⁹⁷ Hanefij, xhaferij, shafij, malikij dhe hambelij (shumica e dijetarëve wehabitë preferojnë t'i njohin si pjesëtarë të shkollës hambelite, prandaj nuk do t'i fusim si shkollë e veçantë edhe pse janë të tillë).

⁹⁸ Kemi 22 shtete arabe, shkollat juridike shpesh here arrijnë të përcaktojnë fatin e një shteti.

Ndarja e shteteve të Lindjes së Mesme sipas numrit të banorëve dhe përqindjes fetare⁹⁹

Nr .	Shteti	Muslimanë		Krishterë	Alevi	Duruzë	Të tjerë në	Nr.banorëve
		Sunitë	Shiitë					
01 .	Turqia	80.0 %	03.0 %		16.0 %		1.0 %	78.0 mil
02 .	Armenia			93.0 %			7.0 %	03.2 mil
03 .	Azerbejxh.	15.0 %	85.0 %					09.5 mil
04 .	Irani	07.0 %	92.0 %				1.0 %	78.0 mil
05 .	Iraku	38.0 %	57.0 %	05.0 %				36.0 mil
06 .	Siria	74.0 %	03.0 %	10.0 %	07.0 %	03.0 %		22.5 mil
07 .	Libani	30.0 %	30.0 %	33.0 %		06.0 %		04.5 mil
08 .	Palestina	95.0 %		05.0 %				04.5 mil
09 .	Izraeli	16.0 %		02.0 %		01.5 %	80,0 hebr.	08.5 mil
10 .	Jordania	92.0 %		06.0 %			0.20 %	06.7 mil
11 .	A.Saudit e	85.0%	15.0 %					30.0 mil
12 .	Kuvajti	65.0 %	35.0 %					04.0 mil
13 .	Bahrejni	40.0 %	60.0 %					01.4 mil
14 .	Katari	71.5 %	10.0 %	08.5 %			1.0 %	02.2 mil

⁹⁹ Wikipedia (Mars 2015). P.S.: Zyrat e statistikave ende nuk kanë nxjerrë të dhëna zyrtare të drejtimt politik wehabit në shtetet islame në Lindjen e Mesme, e as në ndonjë shtet të botës Islame.

Scientific Challenges for Sustainable Development

15	Emiratet	70.0 %	12.0 %	09.0 %			9.0 %	09.0 mil
16	Omani							03.2 mil
17	Jemeni	60.0 %	40.0 %					23.0 mil
18	Egjipti	88.0 %	05.0 %	0.7 %				89.0 mil
		235.mil	130.0					
		365 milion banorë	15.0 mil banorë	18.0 mil banorë	1.5 mil banorë	8. mil hebre +6 të tjerë		413.2 mil

Tabela nr. 1

Dy drejtimet e para politike, kanë lindur që në fillim të shfaqjes së shtetit islam në shekullin e VII-të, gjegjësisht gjatë viteve (661-680), në kohën e Khalifit Muavije. Ndërsa rryma tretë politike ajo e wehabitëve ka lindur si rezultat i kryengritjeve kundër regjimit osman në shekullin XIX-të e drejtuar nga familja al Saud dhe e “reformatorit të fesë” Abduwehab për të cilin janë thënë shumë mendime kontradiktore për të.¹⁰⁰

Prijësit fetarë në përgjithësi, menjëherë pas shpërbërjes së shtetit Osman kanë bërë përpjekje të vazhdueshme për bashkimin e lëvizjeve të tyre, mirëpo asnjëherë nuk ia kanë dalë qëllimit, derisa në vitin 1979-të revolucioni islamik iranian në vete korri suksesin e tij të madh. Në anën tjetër, përpjekjet për bashkëkoordinimin e forcave fetare e politike arabe¹⁰¹ kundër nacionalistëve arabë gjithmonë kishte dështuar. Mirëpo ndodhi që në vitet (1950-1979) shtetet kolonizatore të ikin nga këto vende, jo se nuk kishin potencial të qëndronin, por largimi ndodhi si rezultat i presionit të

¹⁰⁰ “...vehabizmi ishte në dëm të unitetit islam dhe në dobi të perandrive klonialste perëndimore, për të cilën hilafeti ishte pengesë për arritjen e ambicieve të tyre...” (<http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=2799>)

¹⁰¹ Asnjëherë, në asnjë kohë, organizatat sikur: Vëllezërit muslimanë, lëvizja e nurxhive, veabinjtë dhe të tjera nuk arritën t’i koordinojnë politikat e tyre kundër neokolonizatorëve, derisa nuk plasi revolucioni brendshëm arab më dhjetor të 2010 në Tunizi.

përgjithshëm ndërkombëtarë dhe lodhjes pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore.

Derisa globin e shek. XX-të e dirigjonin forcat telurokratike dhe talasokratike, roli i lëvizjeve islame për qëllime të tyre afatgjata balanconte politikat e këtyre dy forcave, gjë që kjo politikë ju mundësoi të jetonin për një kohë relativisht të shkurtër pa probleme të mëdha deri në shpërbërjen e Perandorisë Ruse më 1989-1992. Forcat talasokrate pa mëdyshjen më të vogël, menjëherë pas instalimit të forcave ushtarake në një pjesë të gadishullit të Ballkanit, do t'ia mësyjnë sërish territorit të Lindjes së Mesme për të dërguar atje ushtrinë forcave perëndimore.

Shteti më strategjik për aleancën e NATO-s ishte Afganistani, njëherësh edhe pushtimi i këtij shteti ishte edhe më i lehti, mirëpo historia ka treguar se këto vende nuk nënshtrohen me forcë. *“Malet Hindu kanë vërtetuar edhe një herë që janë parku i varrezave të perandorive. Për afërsisht 40 vjet, afganët s’kanë përjetuar asgjë tjetër përveç luftës dhe, pjesët e shtetit janë aq të varfra, saqë epoka e Gurit do të ndihej e modernizuar karshi tyre. Megjithatë, këta të ashtuquajtur njerëz primitivë, për një dekadë nuk kanë përballuar vetëm agresionin e ushtrisë amerikane - të vetëshpallurit superfuqi – por kanë përballuar gjithashtu edhe 40 aleatët e tyre. Çdo njëri prej aleatëve të Amerikës ka ikur tashmë vjedhurazi jashtë nga lufta e Afganistanit, pa guxuar të shikojë mbrapa”*.¹⁰²

Pas dy vjet qëndrimi në Afganistan, kishte ardhur koha për pushtimin e Irakut. Ky shtet historikisht ka treguar se është i pa mposhtur, asnjë fuqi botërore nuk ka arrit të qëndrojë e qetë në këtë vend pa dëshirën e popullit. Këtë e vërtetuan të gjitha perandoritë që shkuan atje. Në këtë shtet kanë gjet rehati vetëm ato fuqi që kanë shkuar atje si çlirimtarë të vërtetë.¹⁰³

Ballkani

Turqinë dhe Slloveninë në këtë hulumtim statistikor nuk e kam përfshi brenda shteteve të Ballkanit. Ndërsa shtetet sikur Kroacia, Rumunia,

¹⁰² Revista Paqja.

¹⁰³ Perandoria e Maqedonisë dhe perandoria e Kalifëve kanë jetuar në paqe, ndërsa të tjerat janë kthyer të turpëruara.

Bullgaria dhe Greqia edhe pse janë shtete anëtare në BE-së, duket qartë se proceset integruese të tyre ende nuk kanë përfunduar plotësisht, përkundër përcaktimit të tyre se do të ndajnë fatin e tyre me BE-në. Ndërsa shtetet sikur Bosnja e Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Kosova dhe Shqipëria janë shtete në proces të integrimi dhe që tanimë njihen me emrin shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Ndarja e shteteve të Ballkanit sipas numrit të banorëve dhe përqindjes fetare¹⁰⁴

Nr	Shteti	Krishterë		Muslima në	Protestantë	Bektashian	Të tjerë në	Nr. i banorëve
		Katolikë	Ortodoksë					
01	Kroacia	85 %	04 %	1 %	1 %		9.0 %	04.3 mil
02	B i H	14 %	37 %	48 %			1.0 %	04.0 mil
03	Serbia	05 %	85 %	0.6 %	1 %		3.0 %	07.2 mil
04	Rumani	5.6 %	87 %	-	5.2 %		2.2 %	20.0 mil
05	Bullgaria	-	84 %	14 %			2.0 %	07.4 mil
06	Kosova	02 %	04 %	94 %				01.9 mil
07	Mali i Zi	-	74 %	16 %			10 %	0.63 mil
08	Shqipëria	10 %	7 %	60 %		4 %	19 %	03.2 mil
09	Greqia	-	90 %	06 %			05 %	11.0 mil
10	Maqedonia		44 %	56 % (¹⁰⁵)				2.06 mil

¹⁰⁴ Bazuar në Wikipedia (Mars 2015). Fatkeqësisht, përveç Shqipërisë, Kosovës dhe Serbisë shtetet tjera nuk kanë raportuar përqindjet fetare. Përqindja fetare rezulton të jetë e barabartë me atë nacionalen në këtë gadishull, me përjashtim të disa sllavëve që një përqindje e vogël është myslimane.

								59.63 mil
		5.2 mil	45.52 mil	8.61 mil	0.2 mil	0.12 mil	2.2 1 mil	61.69 mil

Tabela 2.

Kur para nesh kemi këtë strukturë nacionale dhe fetare, mësojmë se Ballkani përveç interesit apriori të fuqive globale e kontinentale, është regjion me interes të veçantë të fuqive rajonale. Sa herë që kemi luhatje globale të interesave gjeopolitike, regjioni i parë që i ndien këtë luhatje është Ballkani. Kur ndodhi falimentimi i telurokratikëve (1989-1992), regjioni i parë i cili do të synohet nga talasokratët ishte Ballkani. Ballkani nuk ishte i integruar brenda vetvetes, ashtu siç pretendohet. Shpërbërja e Jugosllavisë edhe një herë tregoi se vullkani ballkanik mbetet i gjallë, edhe për shumë kohë.

Përkundër heshtjes politike dhe uljes së armëve midis popujve në Ballkan në fundshekullin e kaluar, prishmëria për lëkundje të sërishme të reja është shumë e madhe. Ambicjet njerëzore nuk kanë të ndalur, aq më tepër kur kemi të bëjmë me ambicjet e një ish perandorie e cila nuk ishte mundur në fushëbetë. Në kohën kur talasokratët menduan se çdo gjë po shkonte sipas planit të tyre, telurokratët do ta shfrytëzojnë rastin e tyre pas instalimit të ushtrisë të koalicionit perëndimorë në Afganistan. Kjo ndërhyrje me ose pa dashje, sikur i dha fuqi ish telurokratëve dhe detyrimisht do të duhej të ndërmerrenin diçka. *“Gjuha e Luftës së Ftohtë është rikthyer me hakmarrje, përmes një të folure të përtërirë të alarmit bërthamor, testimi të pretenduar të raketave me rreze të mesme bërthamore, dhe shqetësimeve mbi sistemin e mbrojtjes raketor të NATO-s”.*¹⁰⁶

Duke qenë se Rusia po tregon se është rizgjuar, ajo nuk lë pa u marrë, qoftë edhe me problemet më të vogla të rajoneve më të afërta të humbura dy decenie më parë. Nëse një pjesë e madhe e Ballkanit hë për hë i ka ikur nga dora, Ballkani Perëndimor ende është në proces, prandaj shihet qartë

¹⁰⁵ Qeveria e Maqedonisë nuk ka dhënë asnjë përqindje zyrtare mbi fetare, mirëpo ne jemi bazuar në rezultatin e WIN/Gallup-it i cili u publikua në gazetën Koha, e mërkurë, 15 prill, 2015.

¹⁰⁶ IGNATIUS, David, “Gazeta 55, e premte, 20 mars 2015.

prezenca Ruse në këtë region. Asaj nuk i mjafton vetëm prezenca politike në rajon, por edhe prezenca ushtarake, prandaj ajo nuk do të vonojë dhe do të bën manovra ushtarake me Serbinë. Manovra e fundit ruso-serbe e fundvitit 2014 u sulmua ashpër nga SHBA-të dhe Perëndimi në përgjithësi, mirëpo, Ministri i Mbrojtjes serbe Gashiç për t'i ulur tensionet u shpreh: “...në lidhje me stërvitjen se vendi i tij është neutral ushtarakisht dhe është i hapur për bashkëpunim me katër superfuqitë si Bashkimi Europian, Rusia, Shtetet e Bashkuara dhe Kina”.¹⁰⁷

Janë të njohura marrëdhëniet vëllazërore midis Ruisë dhe Serbisë, mirëpo një shtet tjetër, anëtare e BE-së, dhe njëkohësisht anëtare e Paktit të NATO-s të tregojë aderimin e saj ndaj Ruisë është për t'u habitur. Përkundër krizës së thellë ekonomike që po përjeton ky shtet, kohët e fundit sikur po jep shenja se dëshiron të bëjë një marrëveshje ushtarake me Rusinë. Greqia do blerjen e raketave S-300, Tor-M1. Shumica e analistëve ushtarak thonë se këtë marrëveshje të dëshiruar duket se e ka si kundërpërgjigje për të baraspeshuar arsenalin e armatimit të saj kundër Turqisë e cila pak ditë më parë nxori fotografi publike për përfundimin e prodhimit me sukses të shtatëqind avionëve luftarak F-16-të. Turqia dhe Greqia edhe pse dy shtete janë anëtare në Paktin e NATO-s, kanë një kontest të hapur për Qipron turke.

Turqia duke shpreh aderimin e saj në BE, si e tillë, ajo pretendonte të jetë ombrella e popujve vëlla me myslimanët e Ballkanit, mirëpo që nga dita e zbehjes së këtij aderimi, ajo ka ndryshuar strategji. Turqia gjithnjë e më shumë po tregon se është forcë rajonale,¹⁰⁸ prandaj interesi për Ballkanin nuk do të zbehet përderisa shteti grek ka pretendime territoriale ndaj Shqipërisë.

Si duket Qeveria turke qysh herët e kishte nuhatur se shtetet anëtare të BE-së nuk e duan atë brenda kufijve të saj, prandaj që moti kishte filluar ndërtimin

¹⁰⁷ <http://www.oranews.tv/rajoni/serbi-rusi-stervitje-te-fshehta-ushtarake-ne-kufi-me-nato-n/>

¹⁰⁸ Se Turqia është vërtetë fuqi rajonale e thonë shumë politikanë dhe analistë, ndër ta është edhe Ricardo Franco Levi i cili thotë: “Turqia është dhe tashmë ndihet një fuqi e madhe rajonale e cila, si e tillë, nuk mund të pranojë që t'i përmbajë aspiratat dhe ambiciet e veta në tablonë e vijëzuar nga interesat e përbashkëta të vendeve evropiane dhe ndaj, për këtë arsye nuk ekziston asnjë mundësi që të mund të asimilohet si një vend i thjeshtë anëtar i Bashkimit”.

e marrëdhënieve të mira me disa shtete të Ballkanit Perëndimor. “*Berisha, si i vetmi nga liderët themelues të kësaj nisme, i pranishëm në takim, vlerësoi vizionin e ish-presidentit turk, Turgut Özal dhe Kryeministrit Suleyman Demirel që themeluan këtë iniciativë*”.¹⁰⁹

Turqia i qëndroi pranë Shqipërisë që në ditët e para të demokratizimit të saj. Ajo ishte nismëtare e ndërtimit të rrugës së vjetër të mëndafshit Egnatia. Ish kryeministri Berisha në takimin e njëzet vjetorit të themelimit të Organizatës BEDZ¹¹⁰ tha: “*Duhet të mbajmë parasysh se rruga më e vjetër që lidhte kontinentet kalonte përmes këtij rajoni, rruga Egnatia, rruga e mëndafshit. Ka një debat të gjatë për korridorin 8-të, i cili është një mijë kilometra dhe që besoj se ka ardhur koha që vendet tona të angazhohen për ndërtimin e këtij Korridori, i cili është edhe një nga segmentet kryesore e më të rëndësishme të rrugës së mëndafshit*”.¹¹¹

Në anën tjetër edhe pse Greqia është shtet anëtarë e NATO-s, ajo sikur nuk është e sigurt me këtë aleancë dhe herë pas herë jep shenja pakënaqësie dhe sikur dëshiron të largohet nga kjo aleancë. Personalisht mendoj se në pyetje para së gjithash është ndjenja fetare, panortodoksizmi. “*Lidhur me Ballkanin përveç pragmatizmit të përgjithshëm të atlantizmit, që përfaqësohet nga SHBA-ja dhe nga Pakti NATO, ndikimin e vet të vazhdueshëm e manifeston edhe gjeopolitika evroaziatike, në mënyrë të veçantë, faktori rus*”.¹¹²

Greqia si shtet anëtarë në BE dhe në Paktin NATO, jep shenja luhatjeje duke “kërcënuar” BE-në dhe Paktin NATO se interesat e saj përkojnë më shumë me Rusinë, kur ajo paratregon se do të blejë raketa nga Rusia, dhe kështu vepron edhe Serbia e cila edhe pse ka shprehur aderimin e saj për t’u bërë shtete anëtarë në BE, bën manovra ushtarake me Rusinë.¹¹³

Për sa më sipër u tha, këto nuk janë paradokse por kemi të bëjmë me linja të qarta përkundër deklaramit të gjeopolitikëve stabile në rajonin e Ballkanit.

¹⁰⁹ <http://www.abcnews.al/lajme/ekonomi/5/20276>

¹¹⁰ Bashkimi Ekonomik të Detit të Zi

¹¹¹ <http://www.abcnews.al/lajme/ekonomi/5/20276>

¹¹² AJVAZI, Shemsi, “Gjeopolitika”, b. Dija, Prishtinë, 2009, f.190.

¹¹³ Manovra ushtarake Serbi-Rusi në territorin e Serbisë më 15.11.2014

Marrëveshjet ushtarake sikur sinjalizojnë për një gjeopolitikë shumë të koklavitur dhe shumë të përzier. Gjeopolitika e drejtuar nga verilindja drejt jugut (Moskë-Beograd-Athinë), sikur po kryqëzohet me drejtëzën horizontale e filluar nga perëndimi: Tiranë-Stamboll, e cila mund të shkojë deri në Teheran.

KONKLuzion

Nëse Shqipëria (shqiptarët në Ballkan), sikur të mos kishin lejen e SHBA-ve për këto marrëdhënie me Turqinë, a thua do të kishin këtë vëllazërim!? S' do mend se Turqia ka interesa historike me këtë vend, mirëpo, ambiciet e saj nuk do të realizoheshin asnjëherë sikur të mos kishte lejen e bashkanëtarëve të saj në NATO me në krye SHBA-në.

Ballkani historikisht ka nxjerrë aromë tërheqëse dhe shumë e nxehtë politikisht. Kështu ka joshur superfuqitë që në kohët e lashta, në mesjetë, si dhe në kohët moderne. Ka treguar se është vend burimi i përplasjeve të interesave të mëdha gjeopolitike. Ai që e ka nën mbikëqyrje këtë hapësirë gjeografike, ka mundësi të ketë nën mbikëqyrje një pjesë shumë të madhe të lindjes, thellë në linde të kontinentit të Azisë, për shkak se kjo hapësirë gjeografike, ndryshe është vetë Evroazia, sepse në të janë ngritur qytetërimet e tri civilizimeve të mëdha botërore.

Shteti me ndikim më të madh për të luajtur politikën e mëdha botërore sot për sot është Turqia. Pozita e saj gjeopolitike dhe historike sot i ka dhënë asaj një rol të madh që të mund të ndikojë në ndryshimin e politikave gjeostrategjike në botë, sidomos në Ballkan dhe Lindje të Mesme. Ky shtet edhe pse është shtet anëtar i NATO-s për shkak të shtrirjes së saj të hershme historike në Ballkan dhe në Azinë Qendrore, ka mundësi të lëvizë nga kjo aleancë. Interesi saj ishte dhe mbetet integrimi në BE, mirëpo mos interesimi i shteteve anëtare të BE-së për Turqinë si duket do të ndryshojë pozitën gjeostrategjike.

Turqia kohëve të fundit ka dhënë shenja përafrimi me Rusinë për interesa ekonomike dhe energjetike, mirëpo këto shenja nuk përjashtojnë mundësinë për një bashkëpunim më të gjerë në fushën politike dhe ushtarake. Turqia nëse nuk do të arrijë t'i mbrojë interesat e saj në Ballkan dhe në Lindje të Mesme me anë bashkëpunimit të ngushtë me perëndimin, ajo në një kohë

vendimtare mund të ndërrojë kursin gjeopolitik. Aleanca e pa shpallur midis Ruisë, Kinës dhe Iranit një ditë mundet që ta joshë edhe Turqinë. Nëse kjo do të ndodhte, atëherë do të kemi ndryshime të mëdha gjeopolitike në botë. S'do mend se ky ndryshim nuk vjen pa një luftë të përgjakshme, ndërsa pikëtakimi i këtyre dy forcave do të ishte Maqedonia dhe Izraeli.

LITERATURA

1. Wikipedia (Mars 2015);
2. Revista Paqja;
3. Gazeta Koha, e mërkurë, 15 prill, 2015;
4. IGNATIUS, David, "Gazeta 55, e premte, 20 mars 2015;
5. <http://www.oranews.tv/rajoni/serbi-rusi-stervitje-te-fshehta-ushtarake-ne-kufi-me-nato-n/>;
6. <http://www.abcnews.al/lajme/ekonomi/5/20276> ;
7. <http://www.abcnews.al/lajme/ekonomi/5/20276>;
8. AJVAZI, Shemsi, "Gjeopolitika", b. Dija, Prishtinë, 2009, f.190.

**SUMMARY JUDGEMENT AS AN ALTERNATIVE OF A
SPECIAL TRIAL GJYKIMI I SHKURTUAR SI
ALTERNATIVË E NJË GJYKIMI TË POSAÇËM
Msc. Denisa NAQELLARI**

Lecturer at University “Aleksander Xhuvani” Elbasan, Albania
Corresponding author e-mail: d.nnaqellari@hotmail.com

Abstract

This paper aims at addressing a very important topic in terms of a new institute in judicial practice, that of summary judgment. In the following we will discuss the causes of the prosecution of summary judgment and the fact that it consists in renouncing voluntarily by the defendant of some fundamental aspects of the right to a due process. However, in the paper, it will be analyzed that the demand of the defendant for summary judgment is not enough, it is also required the approval of a judge, who may refuse the request if he thinks that a genuine criminal process is necessary.

A great importance will be given to the description of the procedure to be followed in order to benefit from the summary judgment. Of course, this trial has its own problems, which will be brought to light thanks to a comparative analysis of the practices followed by different countries. However the development of this judgment does not presume the guilt of the defendant. His guilt or innocence will be established thanks to the inner conviction of a judge, who will decide on the basis of evidence presented by the representative of the prosecution. Summary trial has its own advantages and disadvantages. One of the main advantages and the most important of this trial is to reduce the penalty in the amount of 1/3 of ordinary punishment. Prosecution of summary leads to important benefits for the judicial process, and for the defendant as well. These benefits will be analyzed in details in the paper.

Keywords: summary judgment, procedure, defendant, guilt, innocence.

HYRJJE

Ky është një studim kushtuar një instituti të ri në praktikën gjyqësore shqiptare, atij të “Gjykimit të shkurtuar”, si një alternativë e gjykimit të posaçëm. Kërkesa për gjykim të shkurtuar mund të bëhet nga vetë i pandehuri në seancën gjyqësore, por edhe nga avokati mbrojtës i tij i pajisur me prokurë që shpreh vullnetin e të pandehurit. Gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit, i cili mund të refuzojë kërkesën nëse mendon se është i nevojshëm një proces i mirëfilltë penal. Kërkesën e të dënuarit dhe të mbrojtësit të posaçëm të tij gjykata e pranon vetëm atëherë kur ajo praktikisht bindet se mund të përfundojë çështjen në gjendjen që janë aktet, pa qenë nevoja për shqyrtimin gjyqësor.

Zhvillimi i këtij gjykimi nuk prezumon aspak fajësinë e të pandehurit. Fajësia apo pafajësia e të pandehurit do të vendoset në sajë të bindjes së brendshme të gjyqtarit, ky i fundit duke gjykuar në bazë të provave të paraqitura nga përfaqësuesi i akuzës.

Në këtë punim do të përshkruhet shkurtimisht zbatimi i gjykimit të shkurtuar në procesin gjyqësor në Shqipëri, si një alternativë e gjykimit të posaçëm.

Pushteti gjyqësor në Shqipëri

Për të mundësuar shqyrtimin e gjykimit të shkurtuar është e nevojshme që të analizojmë së pari pushtetin gjyqësor në përgjithësi. Pushteti gjyqësor është pushteti i cili ushtrohet nga gjykatat dhe prokuroritë. Ato veprojnë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të kompetencave që u ngarkohen atyre me ligj.

Gjykata e Faktit, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë janë pjesë përbërëse të Sistemit Shqiptar të Drejtësisë. Gjykatat e Rretheve Gjyqësore organizohen dhe funksionojnë në rrethe gjyqësore në të gjithë territorin e vendit. Krijimi i Gjykatave të Jashtëzakonshme është i ndaluar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Procesi gjyqësor zhvillohet në sajë të disa parimeve kryesore.

Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë, tërregullt, që mbron liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës dhe ligjeve.¹¹⁴

Ndër parimet më kryesore përmendim:

1. Parimi i prezumimit të pafajësisë.

Në lidhje me këtë parim Kushtetuta është shprehur: “Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia më vendim gjyqësor të formës së prerë”.¹¹⁵ Respektimi i këtij parimi përbën një ndër elementet e rregullsisë së një procesi gjyqësor. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është shprehur se prezumimi i pafajësisë kërkon, ndër të tjera, që kryerja e detyrave nga anëtarët e një gjykate nuk duhet të fillojë me idenë e paracaktuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

2. Parimi i një procesi të rregullt ligjor.

Ky është një parim i cili përbën një nga të drejtat dhe liritë themelore të individit. Përveç parashikimit të tij nga legjislacioni i brendshëm, një rëndësi e madhe i është dhënë edhe nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Ky parim përcakton se çdo person ka të drejtë që

¹¹⁴ Kodi i Procedurës Penale, neni 1, fq.9.

¹¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 30, fq.19.

çështja e tij të gjykohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të caktuar.

3. Parimi i pavarësisë së gjykatës.

Pavarësia e gjykatës nënkupton zgjidhjen e një çështjeje të caktuar me paanësi dhe në përputhje me ligjin. Në Kushtetutë është parashikuar: “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”¹¹⁶

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka theksuar në disa vendime të saj se “parimi i paanshmërisë ka në vetvetë elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimi prej saj të çdo dyshimi të përlligjur në këtë drejtim. Gjykata duhet të tregohet e kujdesshme në lidhje me përberjen e trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv.”

**Procedura e gjykimit të shkurtuar në situata të ndryshme juridike
procedurale**

Kodi i Procedurës Penale bën parashikimet e nevojshme në lidhje me zhvillimin e gjykimit të shkurtuar. Në praktikën gjyqësore të gjykatave shqiptare mund të ndodhë që gjyqtari apo gjyqtarët të mos e pranojnë kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar.

Kërkesa për gjykim të shkurtuar nga ana e përfaqësuesit të posaçëm në seancë gjyqësore bëhet me gojë apo me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore, 3

¹¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 42, fq 23.

ditë para datës së gjykimit të çështjes, kur i pandehuri është në gjendje arresti me burg.

Gjykimi i shkurtuar nuk mund të realizohet në momentin kur çështja ndodhet në fazën e hetimit paraprak. Nuk mund të bëhet kërkesë në këtë fazë pasi nuk kemi të dhëna të plota në lidhje me provat. Gjykata vendos zbatimin e këtij gjykimi kur çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, në rast të kundërt ajo e refuzon kërkesën. Nëse kjo kërkesë refuzohet, ajo nuk mund të paraqitet përsëri, por zhvendost procedimi në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

Ekziston mendimi se vullneti i shprehur nga ana e të pandehurit në aktin e përfaqësimit, prokurë e posaçme që cakton mbrojtësin e tij dhe i jep atij tagra për të kërkuar “gjykim të shkurtuar” në ngarkim të të pandehurit, duhet të respektohet nga gjykata. Pranimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar në një rast të tillë ka si premisë bazë:

Së pari, kur kërkesa është bërë nga ana e mbrojtësit të posaçëm të të pandehurit, situatë që vjen konform nenit 403/1 të Kodit të Procedurës Penale, ku konstatohet nga ana gramatikore lidhëza “ose... mbrojtësi i posaçëm”. Mbrojtësi i posaçëm për efekt të ligjit procedural penal është ai i caktuar me vullnetin e të pandehurit duke materializuar formalisht këtë caktim, me një akt përfaqësimi, siç është prokura e posaçme, e legalizuar pranë një noteri në bazë të ligjit për noterinë. Kjo mënyrë e caktimit të mbrojtësit parashikohet në nenin 48/2 të Kodit të Procedurës Penale. Paraqitja e kërkesës nga ana e mbrojtësit të posaçëm të të pandehurit, vjen konform edhe me nenin 50 të Kodit të Procedurës Penale.

Së dyti, premisa tjetër, për parimin e kërkesës për “gjykim të shkurtuar” lidhet me mundësinë e zgjidhjes së çështjes në gjendjen siç janë aktet, në respekt të nenit 404/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Së treti, ekziston mendimi se, një nga kushtet bazë për të proceduar me gjykim të shkurtuar për të pandehurin në mungesë lidhet jo vetëm me dhënien e të drejtës së kërkimit të “gjykimit të shkurtuar” nga ana e mbrojtësit të posaçëm, por edhe me shprehjen e vullnetit të të pandehurit, në aktin e përfaqësimit të lëshuar nga noteri, ku përcaktohet se dëshiron që gjykimi të zhvillohet në mungesë të tij, duke qenë i përfaqësuar nga mbrojtësi i tij i posaçëm.

Përsa i përket momentit të kërkesës për aplikimin e gjykimit të shkurtuar kemi përcaktimet e bëra nga jurisprudenca shqiptare dhe literatura bashkëkohore. Nuk mund të kërkohet aplikimi i gjykimit të shkurtuar dhe nuk mund t’i drejtohem gjykatës me këtë kërkesë atëherë kur procedimi penal ndodhet pranë organit të akuzës, që po zhvillon hetimet për autorin e veprës penale. Kërkesa për aplikimin e gjykimit të shkurtuar në këto momente do të përbënte një anomali, kjo edhe për arsyen sepse nuk janë kryer hetimet paraprake, nuk janë mbledhur provat e plota. Gjithashtu personi ndaj të cilit po zhvillohen hetimet njih shumë pak nga aktet e kryera nga prokurori.

Pranimi dhe fillimi i gjykimit të shkurtuar

Seanca e gjykimit të shkurtuar zhvillohet në bazë të rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Ajo kryhet me pjesëmarrjen e prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, si edhe të palëve private. Gjykata bën verifikimin e lidhur me legjitimitimin e palëve.

Në interpretimin e nenit 404/6 të Kodit Të Procedurës Penale konsensusi i prokurorit nuk është kusht i domosdoshëm që gjykata të pranojë kërkesën e të gjykuarit për të proceduar me gjykim të shkurtuar. Kjo justifikon edhe të drejtën që ka prokurori për të bërë ankim kundër vendimit të gjykatës për

pranimin e gjykimit të shkurtuar, ankim që mund të paraqitet së bashku me ankimin kundër vendimit përfundimtar.

I pandehuri apo mbrojtësi i tij kanë të drejtë të kenë në dispozicion kopje të fashikullit të hetimeve paraprake, si në momentin e hartimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, ashtu edhe për konkluzionet përfundimtare ku do të bëjnë analizën e tyre. Kjo është një e drejtë që sigurohet nga Kodi i Procedurës Penale.

Përsa i përket vlerësimit paraprak të gjyqtarit mund të themi se gjykimi i shkurtuar është zhvilluar dhe zhvillohet mbi bazën e dokumenteve dhe provave që janë ngritur, gjetur dhe paraqitur nga organi i akuzës apo nga prova të paraqitura nga i pandehuri gjatë hetimit paraprak. Këto të fundit administrohen si të tilla nga organi i procedimit penal dhe vendosen në fashikullin penal që i dërgohet gjykatës për gjykim.

Palët civile, paditësi apo i padituri civil, në rastin kur ka pësuar dëm material nga vepra penale, ai apo trashëgimtarët e tij mund të ngrenë padi civile në procesin penal.

Padia civile nuk do të gjykohet në rastet kur paditësi civil nuk pranon kërkesën për gjykim të shkurtuar. Mund të ndodhë që paditësi civil të pranojë gjykimin e shkurtuar, por njëkohësisht kërkon të gjykohet edhe padia civile në procesin penal. Në këtë rast me kërkesën e palëve ose kryesisht, gjykata mund të vendosë veçimin e padisë civile dhe dërgimin e saj në gjykatën civile.

Dhënia e vendimit nga gjykata

Gjykata mund të japë një vendim fajësie, pafajësi ose të ndryshojë cilësimin ligjor të veprës.

Çdo vendim mund të ankimohet edhe nga i pandehuri dhe nga prokurori apo palët civile kur marrin pjesë në këtë gjykim, si për kualifikim ligjor të

akuzës, fajësinë dhe për dënimin, për pranimin ose rrëzimin e padisë civile në këtë procedim penal.

Problematika në gjykimin e shkurtuar. Sigurisht që si çdo proces tjetër edhe gjykimi i shkurtuar ka shumë problematika. Gjatë zbatimit të këtij gjykimi janë hasur një sërë problemesh dhe mangësish ligjore. Një ndër problemet kryesore ka të bëjë me faktin kur kemi disa të pandehur të cilët kanë kryer një vepër penale në bashkëpunim.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë unifikuar praktikën gjyqësore duke eliminuar një problem tjetër të lidhur me zbatimin e gjykimit të shkurtuar. Kanë arritur në përfundimin se kur shqyrtimi gjyqësor ka filluar me gjykim të zakonshëm nuk mund të vazhdohet më tej me gjykim të shkurtuar vetëm që i pandehuri të përfitojë nga ky lloj gjykimi.

Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se, kur nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm procedohet me gjykim të shkurtuar, procedim në të cilin, duke qenë se gjykata merr në konsideratë vetëm dosjen e prokurorit, nuk ekziston mundësia e realizimit të së drejtës së mbrojtjes efektive nga i pandehuri, ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale nga ana e gjykatës, është në kundërshtim me qëllimin e këtij gjykimi.

Përfitimet e zbatimit të gjykimit të shkurtuar

Aplikimi i gjykimit të shkurtuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rretheve Gjyqësore apo në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në Tiranë sjell një mori përfitimesh si për procesin gjyqësor, ashtu edhe për të pandehurin që do të gjykohet në procedimin penal. Disa nga përfitimet kryesore janë:

1. Zhvillimi i gjykimit në mënyrë më të shpejtë dhe eliminimi i zvarritjeve të proceseve gjyqësore.

Në procesin gjyqësor që zhvillohet me gjykim të shkurtuar kemi mungesën e fazës së shqyrtimit gjyqësor të provave. Pikërisht kjo

mungesë ka bërë të mundur eliminimin e zvarritjeve të proceseve gjyqësore që në shumicën e rasteve vinin si pasojë e mungesës në seancën gjyqësore të organeve proceduese, apo të të pandehurit apo mbrojtësit të tij.

2. Ekonomia gjyqësore.

Me pranimin e kërkesës së të pandehurit apo mbrojtësit të tij për gjykim të shkurtuar nga ana e gjykatës, mundësohet minimizimi i kostove financiare që do t'i ngarkoheshin gjykatës deri në momentin e dhënies së vendimit të formës së prerë.

3. Parandalimi i kriminalitetit.

Duke u përmbushur në mënyre eficientë funksioni ndalues që ka vetë dënimi me burgim, bëhet i mundur ndalimi i të pandehurve, duke i dërguar ata sa më parë në institucionet e ndalimit, duke mundësuar kështu edhe parandalimin e shtimit të kriminalitetit.

4. Ulja e dënimit të të pandehurit.

Në momentin që jepet vendimi i formës së prerë, fillimisht përcaktohet dënimi për veprën penale dhe më pas aplikohet zbritja e 1/3 së tij.

Në rast se i dënuari deklarohet fajtor për disa vepra penale, fillimisht përcaktohet dënimi për secilën prej tyre, më pas aplikohet bashkimi i dënimeve sipas nenit 55 të Kodit Penal dhe në fund bëhet zbritja me 1/3 nga dënimi i bashkuar.

Në rast se për veprën penale parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm, i pandehuri i gjykuar me gjykim të shkurtuar dënohet me 25 vjet burgim.

Subjektet e legjitimuar për paraqitjen e kërkesës për gjykim të shkurtuar

Subjektet e legjitimuara për të paraqitur kërkesën për procedimin me gjykim të shkurtuar janë, vetë personi i marrë në cilësinë e të pandehurit, si dhe

mbrojtësi i tij i posaçëm. Nevojitet që mbrojtësi i të pandehurit për t'u legjitimuar mbi paraqitjen e kërkesës për gjykim të shkurtuar, duhet të jetë i pajisur me një akt përfaqësimi, ku shprehimisht të jetë dhënë tagra për të kërkuar procedimin me gjykim të shkurtuar të çështjes penale. Mbrojtësi mund të ushtrojë të gjitha të drejtat që i njeh ligji të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit, siç mund të jenë e drejta për të pohuar veprën penale, e drejta për të mos marrë pjesë në procedim, e drejta për të kërkuar gjykimin e shkurtuar, e drejta për të bërë ose jo ankim etj.¹¹⁷

Në rastet kur i pandehuri gjykohet në mungesë, kërkohet domosdoshmërisht që ky i fundit të manifestojë shprehjen e vullnetit (në aktin e përfaqësimit të lëshuar) nëse pranon që procesi në ngarkim të tij të zhvillohet me procedurën e gjyimit të shkurtuar. Në prokurën e posaçme duhet të jetë specifikuar qartësisht dhënia e të drejtës për të kërkuar midis kërkesave të ndryshme procedurale edhe të kërkesës për gjykimin e çështjes me procedurën e gjyimit të shkurtuar.¹¹⁸

Paraqitja e kërkesës nga përfaqësuesit të posaçëm, arsyeton se kërkesa për gjykim të shkurtuar nënkupton në thelb, vullnetin e shprehur për të proceduar me gjykim të shkurtuar, i cili bazohet edhe në aftësinë për të kërkuar aplikimin e një gjykimi alternativ, e ndikuar nga “gjëndja në të cilën ndodhen aktet”.

Pranimi nga ana e gjykatës të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar sjell dhënien përfitimit të uljes prej një të tretës së masës së dënimit, por nga ana tjetër nënkupton “heqjen dorë” nga disa garanci procedurale për të pandehurin gjatë zhvillimit të këtij lloji gjykimi. Duke

¹¹⁷ H., Hoxha. A., Panda I., “Komentari i Procedurës Penale”, Tiranë 2010, faqe 155.

¹¹⁸ Punim doktriture “Gjykimet e posaçme dhe rëndësia e tyre në procesin penal”, Klodjan Skënderaj, fq.57.

qënë se gjykimi i zhvilluar me procedurën e prek në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat e të pandehurit objekt gjykimi sidomos “mundësinë objektive e reale” drejt vendimit të dënimit, mendojmë se dhënia në mënyrë të shprehur nga i pandehuri i tagrit për të proceduar me gjykim të shkurtuar, kundrejt mbrojtësit të zgjedhur prej tij, mund të jetë një zgjidhje më e drejtë, në funksion kjo të pasojave që rrjedhin për të nga ky rit alternativ gjykimi.¹¹⁹

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është shprehur se “...avokati i caktuar kryesisht nga gjykata nuk e kishte tagrin që të kërkonte gjykim të shkurtuar, i cili ishte i lidhur ngushtësisht me të drejtat që Kodi i Procedurës Penale ia njuh vetëm personit të gjykuar, kjo në interpretim të nenit 50/1 Kodit të Procedurës Penale, i cili sanksionon se *mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njuh të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit...*”.¹²⁰

Vështrim krahasues i parashikimit të gjyimit të shkurtuar midis Kodit Italian të Procedurës Penale dhe Kodit Shqiptar të Procedurës Penale

Modeli i institucionit të gjyimit të shkurtuar në Kodin e Procedurës Penale Shqiptare është huazuar nga legjislacioni Italian si pasojë e përdorimit të modelit të Kodit të Procedurës Italiane në hartimin e kodit shqiptar.

Parashikimi i këtij instituti ka luajtur një rol të rëndësishëm për demokratizimin e legjislacionit në përgjithësi dhe ligjin procedural penal në veçanti. Në legjislacionin aktual italian, në ndryshim nga legjislacioni shqiptar, gjyqtari kur e çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, vendos të marrë edhe kryesisht prova të reja të nevojshme për vendimin. Në këtë rast prokurori mund të ndryshojë akuzën dhe i pandehuri mund të kërkojë që procedimi të vazhdojë në format e zakonshme. Ndërsa në

¹¹⁹ Po aty fq.59.

¹²⁰ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendimi nr. 101, datë 20.03.2013.

rastin kur gjyqtari çmon se çështja mund të zgjidhet më gjendjen që janë aktet, në gjykimin e shkurtuar zbatohen dispozitat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale Italiane për seancën paraprake, duke përjashtuar institutin e marrjes së provave të reja nga gjyqtari dhe atë të modifikimit të akuzës.

Një ndryshim ka të bëjë me faktin se në kodin Italian kërkesa bëhet në një seancë paraprake, ku i pandehuri njihet edhe me fashikullin e gjykimit. Ndryshe ndodh në kodin tonë, ku njohja me fashikullin e gjykimit bëhet sipas procedurave të gjykimit të zakonshëm, pra gjatë hetimeve paraprake.

Kodi italian parashikon se gjykata vendos me urdhër për pranimin apo refuzimin e gjykimit të shkurtuar. Ndërkohë që kodi ynë parashikon një tjetër procedurë për pranimin apo refuzimin e kërkesës.

Përsa i përket dhënies së vendimit nga gjyqtari kemi parashikime thuajse të njëjta nga të dy kodet, në lidhje me favorizimet që ofron zbatimi i gjykimit të shkurtuar.

Një element i cili nuk përmendet në kodin shqiptar, parashikohet në kodin italian dhe citon:

1. I pandehuri dhe prokuroria nuk mund të ankohen kundër pafajësisë.
2. I pandehuri nuk mund të apelojë kundër vendimeve dënuese vetëm me gjobë.
3. Prokurori nuk mund të ankohet kundër dënimit, përveç rastit kur vendimi mund të ndryshojë titullin e veprës.
4. Procedurat e ankesës do të bëhen në mënyrën e parashikuar në nenin 559.¹²¹

Në kodin shqiptar parashikohet se prokurori bën ankesë nëse nuk është dakort me vendimin e pranimit të procedurës së gjykimit të shkurtuar ndaj të pandehurit, si edhe kundër vendimit përfundimtar të dhënë ndaj tij.

¹²¹ Kodi i Procedurës Penale Italiane, neni 443, fq.169.

KONKLUZION

1. Procesi i gjyimit të shkurtuar ndryshon nga gjykimi i zakonshëm, pasi ai nuk parashikon ndjekjen e fazës së shqyrtimit gjyqësor. Kjo e fundit ka peshën kryesore në gjykimin e zakonshëm.
2. Gjykimi i shkurtuar kërkohet nga i pandehuri ose përfaqësuesi i tij i posaçëm që çështja të zgjidhet duke iu referuar vetëm provave që u janë vënë në dispozicion nga përfaqësuesi i akuzës në fashikullin e gjyimit, derisa të mos jetë filluar shqyrtimi gjyqësor.
3. Paraqitja e kërkesës për gjykim të shkurtuar e të pandehurit në mungesë bëhet nga përfaqësuesi i tij i posaçëm, i cili është i pajisur me një prokurë, kur kjo gjë është parashikuar shprehimisht.
4. Paraqitja e kërkesës bëhet nga përfaqësuesi i posaçëm në seancën gjyqësore me gojë, por mund të bëhet edhe me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore, 3 ditë përpara datës së gjyimit të çështjes, ku i pandehuri është në gjendje arresti me burg.
5. Kërkesa për aplikimin e gjyimit të shkurtuar e bërë nga personi nën akuzë nuk prezumon fajësinë e të pandehurit. Fajësia do të vendoset në mënyrë absolute vetëm në sajë të bindjeve të brendshme të gjyqtarit, i cili bazohet në provat e paraqitura nga përfaqësuesi i akuzës.
6. Kërkesa për gjykim të shkurtuar mund të bëhet edhe në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.
7. Në rast se kemi të bëjmë me një grup të pandehurish, ku një apo disa kërkojnë gjykim të shkurtuar, ndërsa të tjerët kërkojnë që çështja të vazhdojë me gjykim të zakonshëm. Në këtë rast gjykata vendos ndarjen e çështjes, pasi nuk mund të procedohet në një seancë gjyqësore me dy mënyra të ndryshme gjykimi.

8. Në gjykimin e shkurtuar administrohen vetëm provat e paraqitura nga përfaqësuesi i akuzës përpara gjykatës.
9. Gjykimi i shkurtuar zhvillohet në bazë të dokumentave dhe provave që janë gjetur, paraqitur dhe ngritur nga organi i akuzës. Në raste të veçanta provat mund të paraqiten edhe nga i pandehuri gjatë hetimit paraprak. Bëhet përjashtimi i atyre provave që janë të ndaluara nga ligji procedural penal.
10. Në rast se palët kanë pretendime lidhur me pavlefshmërinë e akteve, qofshin pavlefshmëri absolute apo relative dhe kërkojnë konstatimin apo deklarimin e kësaj pavlefshmërie, gjykata duhet të revokojë vendimin për gjykim të shkurtuar dhe të urdhërojë vazhdimin e procedimit me gjykim të zakonshëm.
11. Padia civile nuk do të gjykohet në rastet kur paditësi civil nuk pranon kërkesën për gjykim të shkurtuar.
12. Konsensusi i prokurorit nuk është kusht i domosdoshëm që gjykata të pranojë kërkesën e të gjykuarit për të proceduar me gjykim të shkurtuar. Kjo justifikon edhe të drejtën që ka prokurori për të bërë ankim kundër vendimit të gjykatës për pranimin e gjykimit të shkurtuar, ankim që mund të paraqitet së bashku me ankimin kundër vendimit përfundimtar.
13. Në rast se pranohet kërkesa për gjykim të shkurtuar, dosja e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore dhe shërben për t'u bazuar në parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare të palëve dhe për dhënien e vendimit nga gjykata.
14. Në momentin që jepet vendimi i formës së prerë, fillimisht përcaktohet dënimi për veprën penale dhe më pas aplikohet zbritja e 1/3 së tij.

15. Në rast se i dënuari deklarohet fajtor për disa vepra penale, fillimisht përcaktohet dënimi për secilën prej tyre, më pas aplikohet bashkimi i dënimeve sipas Kodit Penal dhe në fund bëhet zbritja me 1/3 nga dënimi i bashkuar.
16. Në praktikën gjyqësore të gjykatave shqiptare mund të ndodhë që gjyqtari apo gjyqtarët të mos e pranojnë kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar. Në këtë rast procedohet me gjykim të zakonshëm.
17. Çdo vendim mund të ankimohet ose nga i pandehuri ose nga prokurori ose nga palët civile kur marrin pjesë në këtë gjykim. Ankimi mund të bëhet si për kualifikimin ligjor të akuzës, për fajësinë dhe për dënimin, për pranimin ose rrëzimin e padisë civile në këtë procedim penal.

BIBLIOGRAFIA:

1. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Tiranë, 2009.
2. H. Islami, A. Hoxha, I. Panda: Procedura Penale, Botimet “Morava”, Tiranë, 2011.
3. V. Hysi: Kriminologjia, Shtypshkronja “Kristalina-H”, Tiranë, 2010.
4. V. Hysi: Penologjia, Shtypshkronja “Kristalina-H”, Tiranë, 2011.
5. F. Tartale, Revista Studimore Juridike: “Gjykimi i shkurtuar, një alternativë gjykimi”, Tiranë, 2007.
6. K. Skënderaj, A. Hoxha: “Vështrim krakasues midis legjislacionit procedural penal shqiptar dhe atij italian në lidhje me gjykimin e shkurtuar”, Tiranë, Qershor, 2010.

7. Vendim Unifikues i Gjykatës Së Lartë, nr.2, datë 29. 01. 2003: “Për njehsimin e praktikës gjyqësore lidhur me aplikimin e gjykimit të shkurtuar”.
8. G. Corso, V. Grevi: Comentario di Procedura Penale, Padova, 2003.
9. H., Hoxha. A., Panda I., Komentari i Proçedurës Penale, Tiranë 2010.
10. Punim doktore “*“Gjykimet e posaçme dhe rëndësia e tyre në proçesin penal”*”, Klodjan Skënderaj.
11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë Vendimi nr. 101 datë 20.03.2013.

Albania and its challenges to European integration

Dr.C. Av. Altin Maliqi

SHLUJ “LUARASË”, Rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 127/1, Tiranë E-mail:
maliqi.altin@gmail.com

Abstract

Europe is the largest project of peace ever seen in history. It was a miracle what happened in our continent after two world wars last century. Enlargement of Europe is indispensable in this regard. To strengthen the human rights and democracy is the best way to build peace. People should not ever forget that "where law of state prohibits, tyranny begins." As my opinion this is the intention of the Council of Europe.

With such goals as: protecting human rights, parliamentary democracy and the rule of law, development of pan-continental agreements to standardize the social and legal practices of member states, promoting and awareness of an European identity based on shared values and to penetrate through different cultures, we can freely say: - That's why it is important to cover the entire continent, that's why we need to join this union because we have a very good geographical position to have a constructive partnership with the institutions of all other European countries such as EU.

We must act together to maintain peace and to raise vital levels of our peoples, to expand and implement the human rights in every country of our continent. This union served the ideals and standards that are very important for our continent. This is what we should to achieve wanting to approach the standards of countries that enjoy this status. Finding the good will and effective government work, we also shall be part of this economic potential of our continent, that as my opinion is the main challenge which we must to be faced.

Keywords: European Union, integration, legislation, Stabilisation and Association Agreement (SAA), candidate Status.

HYRJJE

E parë në këndvështrimin politik, çështja e një pranimi paraprak për cilindo shtet të papranuar që kandidon për t'u antarësuar sipas planit të zgjerimit nga Këshilli i Europës, paraqet një sërë angazhimesh për qeveritë e këtyre shteteve.

Duhet pasur parasysh katër çelësat e artë të këtij Bashkimi, të cilë janë:

1. Lëvizja e mallrave përmes tregut të përbashkët.
2. Lëvizja e lirë e njerëzve (krahu i lirë i punës).
3. Qarkullimi i lirë i monedhës me sistemin e përbashkët monetar – financiar.
4. Lëvizja e lirë e shërbimeve që do të realizonte në të gjitha shtetet e Europës një unifikim të mallrave dhe prodhimeve me sisteme të njëjta ose të ngjashme të teknologjisë së prodhimit.

Përballë këtyre parimeve themelore të këtij bashkimi ekonomik¹²², mund të themi se edhe vendi ynë është gjetur jo pak me angazhime dhe detyra që kërkojnë realizim, pasi në disa etapa të shqyrtimit nga ana e Këshillit të Europës për marrjen e statusit nga ana e Shqipërisë, kanë rezultuar jo të suksesshme pasi nuk janë realizuar ato detyrime të lëna lidhur me reformat dhe stabilitetin politiko-ekonomik, status ky pa të cilin Shqipëria nuk do të mund të vihej përkrah vendeve të tjera europiane. Por, edhe pas marrjes së statusit të vendit kandidat, përsëri politikës dhe mbarë

¹²² Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit (MSA) (Aksesuar 05. 04. 2015) www.mie.gov.al

popullit Shqiptar vazhdon t'i rëndojë pesha e plotësimit të prioriteteve të vendosura nga BE, pa të cilat Shqipëria nuk po mundet të hapë negociatat e antarësimit në këtë familje të madhe, ku kryefjala është "Demokracia e vërtetë".

1. Shqipëria dhe Synimet, Objektivat Politiko-Ekonomike për Marrjen e Stasusit si Vend Kandidat, për Hapjen e Negociatave deri në Antarësimin në BE

Synimet për realizimin e një sërë reformave në sajë të MSA-së, në shumicën e rasteve në Shqipëri kanë nxjerrë në pah një vullnet politik jo të qartë dhe të vendosur ashtu siç ka qenë në shumicën e vendeve të cilat kanë kandiduar për t'u bërë pjesë e këtij bashkimi. Në këtë pozitë jo të mirëvullnetshme ku është gjendur në këto vite Shqipëria, kemi parë një sërë zhvillimesh me shumë problematika të cilat kanë treguar se sa e kulturuar dhe e orientuar drejt progresit ka qenë politika jonë. Kjo ka treguar më së miri se cilat janë ato elementë që e bëjnë të formuar një shtet dhe të konsoliduar kundrejt rregullave e parimeve të kësaj fuqie të madhe që quhet BE, kësaj fuqie që dikton zhvillim, ligj dhe drejtësi.

Synimet, por edhe objektivat më me rëndësi jetike dhe të qarta të shtetit lidhur me MSA-në kanë qenë: integrimi kulturor, arsimor, ligjor, ekonomik-social, përcaktimi dhe ligjërimi i pronës private, respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, lufta kundër korrupsionit, respektimi i të drejtave të fëmijëve, grave, etniteteve, trafiku ilegal i qënieve njerëzore, i narkotikëve etj, fusha ku ende shfaqen dhe do të ndihen gjatë problematikat e krijuara nga mosfunksionimi si duhet i legjislacioneve dhe ku edhe faktorë të tjerë si: korrupsioni dhe mosvullneti politik kanë krijuar vazhden e gjatë të pengesave të zhvillimit dhe një tranzicion të gjatë të hapave drejt integritit.

Pjesë e realizimit të synimeve dhe objektivave ishte edhe realizimi i raportit funksional të marrëdhënieve të qytetarëve me shtetin dhe ligjin pra, *reforma administrativo territoriale*¹²³ ç'ka do të ishte një ndër hapat më të sigurt që do të bënte shteti Shqiptar drejt Demokracisë dhe asaj çfarë kërkon familja e madhe Europiane. E thënë ndryshe, kjo tingëllon si një reflektim i mungesës së kulturës politike dhe mosvullnetit politik të treguar nga elita politike dhe ajo pjesë aktive në instancat qeverisëse, të cilat një nga detyrat e tyre kanë pasur dhe kanë bërjen e normave, rregullave dhe ligjeve të detyrueshme për tu zbatuar nga i gjithë populli. Dhe, ky mosfunksionim ka bërë që e gjithë shoqëria, edhe pse e etur për zhvillim, të përqafojë cilësitë e paorientuara qartë drejt Europës që ka ofruar ky sistem tranzicioni i gjatë dhe pa ide konkrete. Referuar këtij këndvështrimi, mund të them se, *Ja pse jemi këtu ku jemi dhe kështu si jemi....!*

BE, ky emër i madh që po ballafaqon ekzistencat e traditës, kulturave, standardeve njerëzore, aftësive për t'u integruar me vrullin e madh të ecurisë së zhvillimit që shumë vende të dala nga sistemi i regjimeve komuniste dhe socialiste po reflektojnë dukshëm, çka edhe për ne ka qenë vështirësi për të treguar vërtet, kush jemi? Duke u ballafaquar me realitetin madhor BE, duken qartë mangësitë e politikave të paformuara dhe programeve të paqarta të iniciuara nga pushtetarët tanë. Jo rrallë kemi dëgjuar se për t'iu bashkuar asaj familjeje të madhe duhet vullnet politik, mirëkuptim midis shtetit dhe ligjit, ligjit dhe njeriut, rregull dhe disiplinë politike, përpjekje për përshtatshmëri dhe integrim. Po Shqipëria ku është? Sa afër apo larg? Një tundim, apo një realitet?

¹²³ Raporti i Stabilizim Asociimit 2013, (Aksesuar 07. 04. 2015)

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/al_rapport_2013_en.pdf

Le t'i shohim si pjesë e orientimeve këto tre pyetje dhe duke u bazuar në përmbushjen e standardeve të përcaktuar nga BE për marrjen e statusit të vendit kandidat, gjë e cila tashmë është vendosur falë një vullneti të ri politik të nisur me reforma dhe praktika në plotësim të atyre detyrimeve që BE kishte vendosur për Shqipërinë si një qëllim të qartë se pa këtë punë të bërë nuk do të kishim prekur disi këtë integrim!. Për të disatën herë në raportet dhe vlerësimet e këshillimeve dhe detyrave të lëna nga BE, jemi vlerësuar nga ministrat e jashtëm të vendeve anëtare, se ritmet dhe hapat e ngadalëta që Shqipëria bënte tregonin se ende ekzistonin për Shqipërinë mangësi në zhvillimet politike.

Efekti negativ që vazhdoi aq gjatë të pengonte lirinë dhe të drejtën e Shqiptarëve, aktualisht po finalizohet nga qeverisja aktuale, e cila jo si më parë, ku politika përfaqësonte vetëm interesat e veta dhe jo popullin, po tregon qartë se me zhvillimet e fundit lidhur me luftën antidrogë në drogofobinë e Europës "Lazarat", themi se fati i buzëqeshi tashmë shqiptarëve, të cilët renditen në popujt që më së shumti e dëshirojnë integrimin në familjen e madhe europiane, atë të cilin më 24 Qershor 2014 Ministrat e Jashtëm të 28 vendeve anëtare të BE-së që ishin mbledhur në Luksemburg e votuan unanimisht duke na dhënë statusin e vendit kandidat për antarësim. Tashmë ka filluar dhe po vazhdon për ne dhe politikën tonë një epokë e re, ajo e hapjes së negociatave për antarësim. Le të themi se ndër objektivat më parësorë të qeverisë aktuale është që të arrijë tu sigurojë shtetasve të saj këtë të drejtë themelore si baza e Demokracisë Europiane.

Të ballafaqohesh me atë realitet të demokracisë njerëzore, nuk do të jetë e lehtë, pasi me moskoshiencë apo me ndërgjegje, politika jonë ka ngadalësuar këto procese, por edhe pjesa tjetër, ajo e popullsisë është gjendur shpesh para ndryshimesh madhore të jetës kapitaliste europiane të zhvilluar.

Përpara këtij ndryshimi do të na duhet sërish shumë punë për tu adoptuar me rend dhe shtet ligjor të zhvilluar, me parime të forta të demokracisë që duhen arritur, si dhe me standarde që duhen ndjekur, pasi vetëm kështu do të preken vërtet efektet e demokracisë dhe të drejtave të respektuara.

A do të jemi ne të denjë të menaxhojmë ato reforma të cilat do të sigurojnë më shumë akses për zhvillim ekonomik e social? A do të kemi ne vullnetin dhe drejtësinë që në bashkëpunim me direktoritë e ndryshme të Këshillit të Europës, dhe duke menaxhuar në mënyrën më të mirë të mundshme të gjitha fondet që BE investon në vendet me statusin e kandidatit, të mund të plotësojmë ato standarde dhe kritere lidhur me cilësinë e shumë aspekteve të zhvillimit jetik?

Synimet¹²⁴ për të arritur edhe zhvillimin edhe rritjen monetare, ekonomike dhe sociale, do të jenë pjesë e punës së madhe që do t'i duhet të bëjë populli shqiptar, shoqëria civile e organizuar përmes OJF-ve dhe qeveria në veçanti, në mënyrë që një ditë ta shohë veten si pjesë të jetës së familjes së madhe ku Demokracia dhe zhvillimi ekonomik janë liria për të jetuar, barazia dhe ekzistenca ligjore e sociale.

Por, edhe pse tashmë janë hedhur hapa konkretë si me reforma të nisura, ashtu edhe me tentativën për reformën e shumëpërfolur në Drejtësi, si hapa drejt hapjes së negociatave të antarësimit, edhe pse pikërisht sot është miratuar edhe Draft Rezoluta për Shqipërinë e cila do t'i hapë rrugën Shqipërisë për çeljen e negociatave të antarësimit, ende qartësisht dallohen detyra të vështira, punë, dëshirë, vullnet politik dhe mirëkuptim popullor për të plotësuar prioritetet dhe paketat ligjore që do t'i japin realizim detyrave,

¹²⁴ Raporti i Stabilizim Asociimit 2012 (Aksesuar 10. 04. 2015).

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/al_opinion_2012_en.pdf

do ta vënë në ekuivalencë legjislative, do ta përafrojnë me standarde sociale dhe ekonomike të njëjtë me vendet e tjera të BE-së.

2. Mangësitë në Legjislacionin Shqiptar Kundrejt Zhvillimeve Ekonomike dhe Sociale të Shqipërisë drejt BE-së

Tashmë duket qartë se të qënurit pjesë e një fuqie të madhe ekonomike siç është Bashkimi Europian, nuk duhet parë me fokus përfitimin, por duhet parë si një punë shumë e madhe që i del përpara shtetit dhe popullsisë në tërësi. Për tu organizuar dhe për të qenë transparentë me monitorimet që do të jenë pjesë e punës për antarësim, do të duhet që të lihen mënjana shumë elementë të rrugës nëpër të cilën shqiptarët kanë kaluar deri më sot, do të duhet t'i thuhet "stop" korrupsionit, dhe do të duhet implementim real dhe i prekshëm i mbështetjes me fonde për të arritur zhvillimin e vërtetë infrastrukturor, standarde të prekshme sociale dhe ekonomike, etj etj.

Nisur nga ç'ka kemi parë me ato shtete të cilat janë tashmë pjesa më e re e BE-së, mund t'i referohemi lirisht problematikave që ato hasën dhe përjetuan. Edhe për Qeverinë Shqiptare duhet që: jo vetëm të realizojë ato objektiva dhe standarde të shabllonizuara tashmë për secilin shtet kandidat për antarësim në BE, por edhe të përgatisë bazën e nevojshme ligjore lidhur me sfidat sociale, ekonomiko-financiare dhe ligjore, nëpër të cilat do të udhëtojë vendi ynë. Le t'i referohemi disi sjelljes së Kroacisë e cila me një punë dhe përkushtim të lartë realizoi angazhimin politik për antarësimin e vendit të tyre në familjen e madhe BE. Edhe para edhe pas antarësimit aty është konstatuar një angazhim i lartë i të gjithë aktorëve politikë për të luftuar korrupsionin, për një shtet të fortë ligjor duke vënë para drejtësisë të gjithë abuzuesit me ligjin dhe me pushtetin.

Sipas studimeve dhe vëzhgimeve të bëra nga organizmat ndërkombëtarë dhe nga vëzhguesit e BE-së në lidhje me ecurinë e reformave në Shqipëri, është vënë re një kuadër jo i plotë ligjor¹²⁵ përsa i përket politikave tatimore me të cilat shpesh herë përballen investitorët e huaj në Shqipërinë aktuale.

Gjithashtu, evidentohen zbrazëti të bazës ligjore lidhur me elementë si: standardet e çmimeve, referencat e tregut ndërkombëtar, si dhe kontrollin e normave të fitimit, të cilat sipas legjislacionit aktual reflektojnë mangësi të bazës ligjore ku mungon ekzistenca e autoriteteve të mirëfillta institucionale për përcaktimin e tavaneve dhe dysHEMEVE në referencat e çmimeve në shitblerje, duke përfshirë këtu çdo sferë të biznesit në tërësinë qarkulluese të mallrave dhe shërbimeve.

Edhe pse janë bërë unifikime paketash ligjore duke iu përafëruar legjislacionit europian në sektorë të veçantë të jetës, edhe pse janë ratifikuar një sërë konventash ndërkombëtare dhe janë nënshkruar shumë marrëveshje ndërkombëtare multilaterale dhe bilaterale, përsëri respektimi dhe zbatimi i bazave ligjore që përbëjnë standarde të mirëfillta, tregon një mosfunksionim të qartë dhe të mirëpërcaktuar të politikave legjislative drejt standardeve europiane.

Mosfunksionimi i paketave të tilla ligjore aktualisht në Shqipëri, tregon se bën të mundur mospërputhjen e sistemit tonë ligjor që aktualisht vepron në sferën ekonomiko-sociale dhe që e largojnë Shqipërinë nga familja europiane. E parë kjo në këndvështrimin e një popullate e cila po pret që t'i bashkohet zhvillimit ekonomik europian, por me shumë pasoja jetike të cilat

¹²⁵ Raporti i Stabilizim Asociimit 2011, (Aksesuar 05. 04. 2015).

do t'i përjetojë sistemi ekonomik, do të dalin në pah nevojat e plotësimit me paketa ligjore, udhëzime dhe ligje shtesë në kuadër të një integrimi sa më korrekt, të saktë dhe të shpejtë. Kështu pra, rruga e gjatë dhe e lodhshme për antarësimin tashmë ka filluar, vazhdon dhe do të na përballë me më shumë sfida¹²⁶!

Në fazën kur ne kemi përfituar të drejtën për të lëvizur pa viza në të gjithë vendet e Shengenit, gjithashtu edhe si popullatë e një vendi kandidat për antarësim, do të duhet që nëpërmjet lëvizjes dhe bashkëpunimeve të njohim dhe të edukohemi me ato dukuri, norma ligjore dhe rregulla që duhen zbatuar për t'i përmbushur totalisht të gjitha detyrimet që na presin deri në antarësim.

Referuar raporteve monitoruese të BE-së¹²⁷ janë evidentuar shpesh edhe ato fusha ligjore ku Qeveria Shqiptare duhet të rishikojë bazën ligjore dhe të zgjerojë kuadrin ligjor të atyre suazave jetësore sipas të cilave rezultojnë të jenë evidentuar mangësi. Të tilla janë: barazia gjinore, dhuna në familje, mosdiskriminimi racor etj, ku nuk mund të mohojmë punën që po bën me këto komunitete qeveria aktuale, e cila me shumë reforma po tregon këmbëngulje në arritjen dhe plotësimin e çdo kushti të duhur për ecjen përpara me objektivin e njohur të antarësimin në BE.

Situatë që në këndvështrimin e përgjithshëm, së fundmi edhe pse dukshëm evidenton tregues pozitivë të zhvillimeve në shumë sfera të jetës, përsëri do të evidentohen shumë problematika të veprimtarisë ligjore në vend. Këto dobësi do të reflektohen hap pas hapi dhe në mënyrë të

¹²⁶ Analytical Report accompanying the Communication from the Commission to the European Parliament and the Council, Brussels, 09 November 2010.

¹²⁷ Second Meeting of the Stabilization Association Council between Albania and the EU, Brussels, 11 May 2010.

vazhdueshme, pasi përveç ekonomisë do të ndihen edhe në arsim, mjeksi, gjyqësor dhe drejtësi etj, duke filluar me elementët e edukimit përkundrejt rregullave dhe ligjeve, e deri në eliminimin e burokracive zyrtare që vijnë si pasojë e mosfunksionimit të mirë të ligjit dhe rregullit në praktikën e ndryshme zyrtare e jetësore. Problematikat dhe parregullsitë e mbartura përgjatë këtyre viteve që Shqipëria ka kaluar në tranzicion, do të evidentohen gjatë në jetën e shqiptarëve, do të prodhojnë edhe për disa vite efekte negative në drejtim të ligjeve dhe të përshtatjes dhe integritimit në anën profesionale dhe avancimin bashkëkohor. Këto pasoja do të ulin domosdoshmërisht edhe rezultatin e punës profesionale dhe kualitative në tërësi të asaj pjese të popullatës e cila është e përshtatur dhe e adoptuar me elementët e jetës bashkëkohore dhe me zhvillimin e kontinentit tonë.

Sot, BE vazhdon të rritet ndërsa në të njëjtën kohë rrit monitorimin e saj për të siguruar që të gjithë antarët e saj të respektojnë detyrimet dhe angazhimet që ndërmorën kur u bashkuan me të.

KONKLUZION

Duke iu referuar analizës së mësipërme në lidhje me integrimin european të Shqipërisë në kuadër të statusit të vendit kandidat dhe detyrimeve të saj, fare mirë mund të themi se: përveç ecurisë me ritme të ngadalta që qeveria jonë ka bërë, zbrazëtisë ligjore dhe vullnetit politik, mungesës së kulturës politike dhe mirëkuptimit, mungesës së tolerancës dhe profesionalizmit, dukshëm vihet re edhe ndikimi jo favorit për Shqipërinë i situatës botërore ekonomike dhe në veçanti i krizës së eurozonës.

Kriza financiare e shoqëruar me problematikat që ajo solli së fundmi në shumë vende, i ka dhënë ndikimet e veta negative edhe në ekonominë shqiptare, në zhvillimin e saj ekonomiko-social dhe në përmbushjen e standardeve social-ekonomikë të shoqërisë shqiptare në kuadër dhe për

llogari të integritit të saj europian. Këto ndikime janë shoqëruar me problematika në zhvillimin e shumë sektorëve me rëndësi jetike për vendin, të cilat kanë ndikuar edhe në ecurinë e ulët të zhvillimit dhe të reformave europiane¹²⁸.

Edhe pse pretendimet e politikës shpesh janë se ekonomia shqiptare nuk është prekur shumë nga krizat financiare-ekonomike si shumë vende të rajonit, vihet re fare qartë se varfëria në rritje, korrupsioni, mungesa e funksionimit korrekt të qeverisjes dhe ligjit, politikat e zhvillimit me mungesa të theksuara në orientim perëndimor dhe me mungesa teknologjish të avancuara, e shumë elementë të tjerë, dukshëm kanë nxjerrë dhe po nxjerrin në pah krizën ekonomike dhe atë politike që e shoqëron prej vitesh vendin tonë.

Ndaj, për ta mbyllur këtë analizë, le të themi se Shqipëria - një vend me një tranzicion të gjatë politik, ligjor, social, ekonomik, kulturor, etj dhe në shumë aspekte të tjera të jetës, do të pranojë me shumë dëshirë daljen nga kjo gjendje e lodhshme e rrjedhjes së keq-qeverisjes. Shqipëria me shumë dëshirë e mirëpriti marrjen e statusit të vendit kandidat dhe tani po pret hapjen e negociatave të antarësimit, por që më vonë të prekë antarësimin e saj në BE duhet të respektojë tërësinë e të drejtave të autorit, pronësisë intelektuale, patentave dhe markave tregtare, pa të cilat nuk do të ketë tërheqje investimesh të huaja dhe projektesh të ndryshme zhvillimi. Pra, një konkurrencë e ndershme tregtare, një transparencë dhe koherencë ligjore dhe eliminim drejt minimizimit të abuzimeve dhe fiktivitetit. E thënë ndryshe, mesa duket po i vjen fundi lodhjes së gjatë të shqiptarëve për të jetuar në çdo aspekt si europianë të evropianizuar!

¹²⁸ National Official webpage of the Ministry of European Integration www.mie.gov.al

Referenca

1. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) (Aksesuar 05 04.2015)

www.mie.gov.al .

2. Raporti i Stabilizim Asociimit 2013, (Aksesuar 07.04.2015)

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/al_rapport_2013_en.pdf

3. Raporti i Stabilizim Asociimit 2012 (Aksesuar 10.04.2015).

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/al_opinion_2012_en.pdf

4. Raporti i Stabilizim Asociimit 2011, (Aksesuar 05.04.2015).

5. Analytical Report accompanying the Communication from the Commission to the European Parliament and the Council, Brussels, 09 November 2010. (Aksesuar 11.04.2015)

6. Second Meeting of the Stabilization Association Council between Albania and the EU, Brussels, 11 May 2010. (Aksesuar 10.04.2015)

7. National Official webpage of the Ministry of European Integration (Aksesuar 12.04.2015) www.mie.gov.al .

**KOSOVA NË RAPORT ME SHTETET E TJERA NË
MARRËDHËNJET NDËRKOMBËTARE, LOBIMI DHE
BOJKOTIMI NË PROCESIN INTEGRUES**
MSC.Senada Lacka

International University of Struga Email: s.lacka@eust.edu.mk

Abstract

Recognition of a new state by another state means official conclusion that the basic conditions for the existence of that state according to international law are fulfilled and the recognized state functions and is able to take international obligations and after that to develop bilateral and multilateral relations in different fields.

The approval of new states is a political act or a political decision and has more political importance even though it also brings legal and practical effects.

Recognition of Kosovo presents a difficult case for review of some basic attributes of law and international relations, such as the law of founding, the law of recognition of a state, the principle of the sovereignty of states and the principle of legal equality, etc.

Kosovo as a new state has a base and a space where it can find its international legitimacy, and to clearly define the element of being a state with its real existence entering into relations with other states and having a capacity to exist despite the efforts of various countries.

The European Union has stated that the recognition of Kosovo's independence depends on the state in particular, so states will individually decide about recognition of Kosovo as a state. In this case, most EU countries recognized the Republic of Kosovo, also this was done by most of the countries of NATO pact.

The Constitution of the Republic of Kosovo entered into force on 15 June 2008. Kosovo contains many provisions of the Ahtisaari Plan, ensuring

specific rights for the minority groups and creates a European secular state oriented in Europe.

Key words: International relations, international recognition, international integration, *European Union*.

HYRJE

Udhëheqësit politik kudo në botë e ndjejnë të nevojshme të parashikojnë zhvillimet e ardhshme në marrëdhënjet ndërkombëtare.

Shembja e sistemit komunist në Evropë solli një zgjim "të papritur" dhe shtim të nacionalizmit dhe në pjesën juglindore të kontinentit, e cila qysh nga viti 1808 ishte quajtur "*Ballkan*", sipas një fjale turke. Ky shpërthim i nacionalizmit çoi në një vlerësim mjegullues se çështjet kombëtare kishin qënë fatkeqësi për stabilitetin në rajon për shumë breza dhe me këtë u përforcua prirja për të fajësuar kryesisht popujt e Ballkanit, që kishin hyrë në armiqësira midis tyre.

Përderisa nocioni i "shtetit" e ruan rolin parësor në analizën e marrëdhënjeve ndërkombëtare e ndërshtetërore, për të kuptuar raportin ndërveprues mes popujve të Ballkanit duhet analizuar forcat e brendshme dhe të jashtme që veprojnë në Ballkan. Këto ndërveprime historikisht kanë qënë të stolitura me dhunë dhe agresion mes nacionaliteteve, por, të gjithë do të dakordohemi se rezultatet e konflikteve kanë qënë shumë larg nga evropianizimi dhe avancimi politik, ekonomik e kulturor.

E ardhmja e rajonit qëndron në bashkëpunimin e ngushtë dhe pa paragjykime i të gjitha vendeve të rajonit duke u larguar sa më shumë nga referencat e së kaluarës, të cilat veçse na ndajnë dhe na marrin kohën që nuk e kemi me tepriçë për të shpejtuar integrimin evropian të vendeve ballkanike pa përjashtim.

Kosova është qendra e fundit e luftërave të dhunshme në Ballkan. Sot, e pavarur dhe e institucionalizuar, ballafaqohet me sfida edhe më të

vështira. Diplomacia si instrument bazë i politikës të jashtme të çdo shteti është faktor qëndror sa i përket qëndrimit që do të marrin subjektet tjera ndërkombëtare qofshin shtete ose organizata ndërkombëtare ndaj Kosovës.

Njohja e Statusit të Pavarur të Kosovës nga Shtetet e Saj Fqinje

Njohja e Kosovës nga vendet fqinje nënkuptonte një impuls në vetë procesin e njohjes së Kosovës edhe nga vende të shumta anë e mbanë botës. Lëvizjet strategjike të vendeve fqinje për ta njohur Kosovën ose për të menduar në njohjen e Kosovës janë faktorë, të cilët konsiderohej se do të ndikojnë edhe në njohjen e saj nga ana e vendeve tjera, të cilat pikërisht këtë mosnjohje të vendeve fqinje në fillimet e para të procesit të njohjes e kanë përdorur si pretekst për të mos e njohur shtetin e Kosovës. Përveç Sërbisë, të gjitha shtetet fqinje të Kosovës më herët ose më vonë, veç më pranuan pavarësinë dhe lidhën marrëdhënjet diplomatike me Kosovën.

Sërbia pa dyshim mbetet kalaja e ambicjeve të Ruisë, pa marrë parasysh përpjekjet e pandërprera të Bashkimit Europian që të dobësojë ndikimin rus në Beograd. Shtetet e tjera ballkanike ortodokse ndjekin kursin tradicional të lidhjeve të forta me qendrën e fuqisë ortodokse, Moskën. Bashkëpunimi midis dy vendeve në çfarëdo çështjesh që mund të identifikohen si çështje të interesit për të dyja palët është thelbësore për të ardhmen e tyre evropiane. Kokëfortësia e Beogradit edhe më tej luan me ardhmërinë e popullsisë serbe. Ministria e jashtme e Sërbisë po vazhdon të përdorë të gjitha mjetet diplomatike që ka në dispozicion për të mbrojtur “soveranitetin e vet shtetëror”. Anëtarësimi në OKB është objektiv të cilin synon ta arrijë Kosova sa më shpejt që të jetë e mundshme, si një hap i natyrshëm pas mendimit të GJND-së por dy shtetet e tjera të përhershme të Këshillit të Sigurimit në kuadër të OKB-së, Rusia dhe Kina, kanë thënë se me gjithë opinionin e GJND-së, vazhdojnë që të mbështesin integritetin

territorial të Serbisë, dhe se nuk e kanë ndërmend që të ndryshojnë qëndrimet e tyre karshi shpalljes “së njëanshme të pavarësisë”. Është e qartë se pavarësia e Kosovës nuk ka krijuar asnjë precedent. Kosova është dhe gjithmonë ka qenë rast i veçantë, përkatësisht *sui generis*. Ky është fakti që Serbia dhe aleatja e saj e përjetshme Rusia duhet ta pranojnë njëherë e përgjithmonë. Vetëm atëherë komuniteti ndërkombëtar mund të shpresojë në ndryshim të raporteve ndërshtetërore në mes Prishtinës dhe Beogradit. Politika aktuale e shtetërore serbe ka mbetur në gjurmët e politikave të vjetra. Është e qartë se Beogradi me politikën e tij ndaj Kosovës ndjek synimin që ta sabotojë, aty ku mundet, konsolidimin e shtetit të Kosovës.. Pa dyshim, në periudhën e ardhshme Prishtina dhe Beogradi do të provojnë të forcojnë pozicionet e tyre edhe më tej, Prishtina mundësisht të sigurojë sa më shumë njohje, ndërsa Beogradi ta stopojë këtë proces. Serbia nuk ka kurrfarë gjasash të lirohet nga vetvetja, nëse shtetet europerëndimore nuk ushtrojnë një trysni ndaj Beogradit, që ka mbetur peng i planimetrive nacionaliste dhe jorealiste, për ta perceptuar shtetin serb si epiqendër të Ballkanit. Asgjë nuk do të mund të ndryshojë gjeografinë në rastin e Kosovës dhe Serbisë, sepse ato gjithmonë do të mbeten shtete fqinje dhe duhet të mësojnë se si t'i zgjidhin problemet mes veti. Nga ana tjetër, beteja diplomatike ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, për dhe kundër njohjes së pavarësisë së Kosovës, ka gllabëruar shuma të mëdha eurosh, ndërkohë që defekti real i këtyre shpenzimeve, sipas akterëve të procesit, nuk mund të matet konkretisht.

Edhe ish shtete të tjera të Federatës Jugosllave ishin të pavendosura për një kohe të caktuar sa i përket pranimit të Kosovës si shteti më i ri i Ballkanit Perëndimor si rezultat i ndikimeve serbe për hir të të kalurës të lavdishme të Jugosllavisë. Përpara fillimit të bisedimeve për statusin e Kosovës, Shkupi zyrtar kërkonte nga autoritetet kosovare të garantojnë se

statusi i ardhshëm i Kosovës nuk do të cenojë integritetin dhe sovranitetin territorial të Maqedonisë.

Maqedonia e njohu Kosovën si shtet i pavarur më 9 tetor të 2008. Pas shtate muajve u vendosën marrëdhëniet diplomatike mes Maqedonisë dhe Kosovës. Këtij akti solemn i parapriu përfundimi i procesit të demarkacionit të kufirit mes të dy vendeve. Ndërkohë parlamenteve të të dyja vendeve iu propozua për miratim dokumenti mbi përfundimin e shënimit të vijës kufitare dhe më pas pasoi nënshkrimi i vendosjes së marrëdhënieve diplomatike nga ministrat e jashtëm të të dyja vendeve. Analistët politik shpesh kanë komentuar se si Maqedonia në momentin e njohjes të shtetit të ri kosovar, ka shkelur parimin e reciprocitetit me Republikën e Kosovës. Në kohën kur Republika e Kosovës po konstituonte institucionet e saja demokratike, shtetin ligjor dhe sundimin e së drejtës të paktën në kuptim formal, Republika e Maqedonisë përgatitej për vendosjen e kushteve shtesë për hyrjen e qytetarëve kosovare në territorin e saj. Nuk kaloi shumë kohë nga shpallja e pavarësisë dhe ky shtet fqinj i Kosovës e obligoi Republikën e re të Kosovës që për qytetarët e saj, të cilët janë të paisur me pasaporta qoftë të UNMIK-ut qoftë të shtetit të ri, të paisen me “sigurim shëndetësor” nëse dëshirojnë të hyjnë në Republikën e Maqedonisë. Maqedonia nuk aplikon masë të tillë ndaj asnjë shteti tjetër! Përderisa qytetarëve të Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi as nuk u vulosen pasaportat gjatë hyrjes në pikat kufitare të Kosovës, qytetarët kosovar përveç që duhet të legjitimohen (në disa raste në procedura mjaft të gjata e të mundimshme) gjatë hyrjes në territorin e Republikës Maqedonisë, duhet të pajisen me dokument të posaçëm, i cili është i ngjashëm me leje qëndrimi, nëse dëshirojnë të qëndrojnë në territorin e saj më shumë se 72 orë (3 ditë të plota). Sa i përket kësaj mase, vlen reciprociteti ndaj qytetarëve të Maqedonisë në Kosovë, mirëpo kohëzgjatja është 2,160 orë (pra, 90

ditë)! Tërë këto veprime, të cilat bien ndesh me parimin e njohur nga drejta ndërkombëtare – parimin e reciprocitetit, u pranuan në heshtje nga institucionet e Republikës së Kosovës, eprorët e të cilëve kanë hasur në të njëjtat probleme gjatë hyrjes në Republikën e Maqedonisë në vitet e para të njohjes. Edhe pse sot raporti mes dy shteteve ka avancuar duke i lënë në pritje qytetarët për lehtësimin e shkëmbimit të shëbimeve dhe mallrave përmes vendosjes së regjimit të ri për kalimin me vetëm me letërnjoftime të kufirit dhe shkurtimit të kohës së udhëtimit nga Prishtina në Shkup dhe nga Shkupi në Prishtinë, përmes ndërtimit të një Autostrade. Qeveria e Kosovës e ka miratuar në parim nismën për marrëveshjen me Maqedoninë përmes së cilës qytetarëve të të dyja vendeve do t’ju mundësohet kalimi i kufirit pa pasaporta. Sipas komunikatës së qeverisë së Kosovës *“marrëveshja rregullon lëvizjen e shtetasve të të dyja vendeve në territorin e palës tjetër pa viza dhe me një dokument të vlefshëm udhëtimi ose kartë të vlefshme biometrike të identitetit dhe do të avancojë bashkëpunimin në mes të dyja vendeve dhe lëvizjen e lirë të njerëzve”*. Maqedonia ka një obligim plus ndaj qytetarëve të saj, nga vetë fakti se pjesë aktive në ndërtimin e këtij shteti luajnë edhe shqiptarët me një përqindje të konsiderueshme.

Mali i Zi, që deri vonë ishte pjesë e territorit dhe sovranitetit të Sërbisë, edhe pas shkëputjes të saj ka qënë në marrëdhënjet më të mira të mundshme me Sërbinë. Të dy vendet bashkëekzistuan në një bashkim të çlirët deri në referendumin e pavarësisë të Malit të Zi në maj 2006.

Pas një presioni ndërkombëtar, politika malazeze ishte e detyruar të lërë historinë pas dhe të orjentohej drejt vendimeve evropiane siç ishte pranimi i pavarësisë të Kosovës dhe lidhja e marrëdhënjeve diplomatike me të. Edhe pse 30 % të popullatës në Mal të Zi janë deklaruar pjesë e komunitetit sërb dhe në mes Beogradit dhe Podgoricës ka marrëdhënje ekonomike të

rëndësishme për popujt vendas, Mali i Zi ishte shteti i 49 i cili pranoi Kosovën edhe pse shumë politikanë serb deklarorin se e kanë ndërruar këtë veprim kundër vullnetit të vet. Beogradi i zemëruar i dha kohë 48 orë ambasadores së Malit të Zi, Anka Vojvodiç për të lënë Sërbinë. Kosova dhe Mali i Zi kanë vendosur raportet diplomatike, por ky vendim ka shkaktuar reagim të ashpër nga ana e Sërbisë. Ministria e Jashtme serbe i ka dërguar një demarsh të ashpër ambasadës malazeze në Beograd *“vendosja e marrëdhënieve diplomatike e qeverisë së Malit të Zi me Prishtinën e prish stabilitetin rajonal dhe e rëndon vendosjen e marrëdhënieve më të mira të mundshme ndërmjet fqinjëve, që është prioritet i qeverisë së Serbisë”*, thuhet në kumtesë. Edhe më tej, çështja e Kosovës mbetet një barrë në marrëdhëniet mes Sërbisë e Malit të Zi.

E kaluara, ndarja e gjatë dhe mungesa e komunikimit midis Shqipërisë dhe Kosovës, tregjeve respektive dhe deri diku e elitave politike të të dy vendeve e ka vështirësuar bashkëpunimin deri vonë. Në marrëdhëniet shqiptaro-kosovare pati një ndryshim të dukshëm në vitet '70, kur ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë nisën, sado pak, kontakte kulturore, shkencore dhe njerëzore dhe kur tregtia ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë pati një rritje të konsiderueshme dhe shërbente për të minimizuar "bllokadën".¹²⁹Në vitet e pluralizmit, qeveria shqiptare njohu Republikën e Kosovës, institucionet dhe Presidentin e saj, mbështeti kërkesat e shqiptarëve dhe e bëri çështjen e shqiptarëve të ish-Jugosllavisë temën bazë në të gjitha konferencat e takimet ndërkombëtare, duke kërkuar ndalimin e represionit dhe të gjendjes së pushtimit, respektimin e të gjitha të drejtave të

¹²⁹ Gazeta "Shqip", 28.08.2006

shqiptarëve, bisedime me përfaqësuesit legjitimë të shqiptarëve të Kosovës në prani të një pale të tretë e të tjera.

Politika e jashtme e Shqipërisë ka qënë agresive për të zgjeruar procesin e njohjes ndërkombëtare të Kosovës. Ndonëse mundësitë e Shqipërisë për të ndihmuar procesin e mëtejshëm të njohjeve mund të jenë më të shumta se të vetë Kosovës, gjithsesi ato janë modeste. Kosova aktualisht është njohur nga komuniteti i vendeve më demokratike dhe fuqive më të rëndësishme në sistemin e sotëm ndërkombëtar. Mundësitë që Shqipëria të ndikojë në zgjerimin e njohjes ndërkombëtare nuk mungojnë dhe ndoshta ajo që mund të bëhej do të ishte një koordinim më i mirë midis diplomacive të të dy vendeve.¹³⁰

Lobimi për shtetin e Kosovës dhe rritjen e njohjeve të saj zë një vend special. Sipas të dhënave të Ministrisë Për Punë të Jashtme të R.Shqipërisë , lobimi për Kosovën dhe përfaqësimi për pjesën e Kosovës përmes ambasadave apo konsullatave tona është parashikuar të jetë rreth 235 milionë lekë të vjetra. Për tre muajt e parë, për këtë qëllim Ministria e Jashtme ka shpenzuar rreth 45 milionë lekë.¹³¹

Kuptohet që imazhi i një Shqipërie të qëndrueshme, absolutisht është shumë i rëndësishëm edhe për përparimin e Kosovës si shtet i ri dhe demokratik. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO dhe stabilizimi i saj përfundimisht në procesin e integritit në BE, njohja e mundshme e Kosovës nga BE-ja si dhe ndryshimi i qasjes së BE-së ndaj rajonit të Ballkanit (përfshirë edhe anëtarësimin e mundshëm të Serbisë si shpërblim për heqjen dorë nga pretendimet ndaj Kosovës) do ta ulin vlerën politike konstruktive

¹³⁰ Kospress, 19 shtator 2008

¹³¹ <http://kosovaonline.info>

të shqiptarëve në rajon si dhe do të sjellë nevojën për moderimin e objektivave gjeopolitike shqiptare.

Marrëdhënjet e Kosovës me Bashkimin Evropian dhe SHBA-të

Kosova e lirë dhe e pavarur sot, është meritë e një politike ndërvepruese mes Bashkimit Evropian dhe SHBA-ve. Më 10 qershor 1999, puna e Bashkësisë Europiane dhe e organizatave tjera ndërkombëtare ishte e mirëpritur nga vendorët për të zhvilluar një qasje bashkëkohore drejt zhvillimit ekonomik dhe stabilizimit të rajonit të ndikuar nga kriza humanitare. Kjo ishte referenca e vetme e Rezolutës 1244 në Bashkimin Evropian dhe u bë bazë e zotimit serioz nga Bashkimi Evropian dhe shteteve anëtare të saj për të rindërtuar, renovuar dhe zhvilluar Kosovën dhe ekonominë e saj.

Nuk mund të mohohet se BE ka pasur arritje në zgjerimin e zonës së stabilitetit, të paqes e të begatisë në Europë. Por BE ka pasur arritje mjaft modeste në përpjekjet për të bërë të njëjtën gjë edhe në Ballkan, gjatë dy dekadave të fundit. BE e ndjeu nevojën e një angazhimi vendimtar dhe të një ndihme të fuqishme nga ana e SHBA për t'u marrë me krizat në Bosnjë, në Kosovë, në Maqedoni dhe në Shqipëri (1997), që goditën njëra pas tjetrës rajonin e Ballkanit. Duhet të kemi besim se BE në Ballkan mund të bëjë shumë më tepër e më mirë se deri tani për të përmbushur misionin e vet si aktor parësor ndërkombëtar. Megjithatë mbetet ende e pasigurtë se BE mund ta mbajë barrën e rëndë në të gjitha situatat e ardhshme pa mbështetje të fuqishme politike e ushtarake nga SHBA-ja. Dështimi i BE-së për të marrë një vendim të përbashkët lidhur me njohjen e pavarësisë së Kosovës është paralajmërim për vështirësi të tjera. Pra, nuk mund të ketë shtytja të reja integruese pa tejkalluar qëndrimin neglizhues dhe refuzues të pesë vendeve evropiane ndaj shtetit të Kosovës. Politikanët dhe diplomatët shqiptarë të

kapur peng nga vetëkenaqja dhe euforia, pas njohjes të Kosovës nga shtetet më të fuqishme të botës si: SHBA, Anglia, Franca, Italia, Gjermania dhe Japonia, nënvlersuan faktorin kundërshtar në gjirin e Bashkimit Evropian si: Spanja, Sllovakia, Rumania, Greqia, Qipro e të tjera që hasen më probleme të mosnjohjes të të drejtave të minoriteteve dhe janë mike besnike të Serbisë. Sërbia e tronditur nga fuqizimi i faktorit kosovar nuk la gurr pa lëvizur për mosnjohjen ndërkombëtare të Kosovës.

Me të drejtë, ambasadori gjerman Wolfgang Ischinger, ndërmjetës i BE-së në bisedimet për statusin e Kosovës, deklaroi se *“është për të ardhur keq që këto 5 vende po parandalojnë BE-në që të luajë një rol unifikues që do të duhej ta luante në rajon në dhjetëvjetëshin e fundit, duke shtuar se “me kalimin e kohës këto 5 vende do ta rishikojnë qëndrimin e tyre dhe BE-ja në një të ardhme jo të largët do ta ketë një qëndrim se si të shikojë problemin ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës”*. Sa më shpejt që të ndodhë kjo aq më e lehtë do të jetë edhe çështja e integritit të Ballkanit Perëndimor në BE, respektivisht ndërtimi i një pozicioni kohëviz të BE-së në rrafshin e politikës së jashtme brenda Evropës në planin global.

Dështimi eventual i politikës së BE-së në raport me Kosovën do të vinte në pikëpyetje jo vetëm kredibilitetin e politikës së jashtme evropiane edhe në raport me rajonin përreth, veçanërisht në Bosnjë-Hercegovinë, por edhe efikasitetin dhe aftësinë e saj për formulimin e një pozicioni të përbashkët në çështjet e politikës së jashtme dhe të sigurisë, dhe kështu do të rriste dyshimet për solidaritetin e brendshëm të Bashkimit Evropian.

SHBA-të ishin decide në pengimin e proceseve të shpërbërjes të ish-Federatës Jugosllave sepse kërkonin mundësitë e sëndërtimit të raporteve të reja në këto hapësira, kërkonin rregullativa kushtetuese, juridike, politike e demokratike. Qysh në vitin 1991, me Rezoluten numër 358 të Dhomës të

Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan është kërkuar pavarësia e Kosovës.¹³² Edhe pse në të kaluarën, një pjesë e elitës politike amerikane kanë pretenduar se zgjidhja e çështjes të Kosovës duhet të bëhej në kuadër të sovranitetit të Jugosllavisë, pas luftës ndëretnike mes sërbeve dhe kosovarëve, SHBA-ja ka mbështetur tërësisht shtetformimin e Kosovës.

"Shtetet e Bashkuara kanë njohur zyrtarisht Kosovën si shtet sovran dhe i pavarur" tha Sekretarja e Shtetit Kondoliza Rajs në 18 shkurt të 2008 në një deklaratë të lëshuar në Uashington. *"Ne urojmë popullin e Kosovës me këtë rast historik."* –tha ajo në vazhdim.¹³³

SHBA është më e angazhuar se kurrë për zgjidhjen e grindjeve e vështirësive ballkanike, për vendosjen këtu të stabilitetit e të demokracisë. SHBA-ja dha ndihmesë të madhe për të ndalur makinerinë sërbe të luftës në Bosnjë dhe në Kosovë, për të mbajtur baraspeshën e brishtë në Maqedoni dhe mbi të gjitha për shpalljen dhe njohjen ndërkombëtare të shtetit të pavarur të Kosovës. SHBA-ja ka treguar kujdes të veçantë për pranimin e disa shteteve ballkanikë në NATO. Të dy shtetet shqiptare kanë vendosur marrëdhëniet më të mira të mundshme me SHBA-në. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kryesojnë frontin e miqve të Kosovës.

Sot, Republika e Kosovës synon një politikë të jashtme aktive, e cila duhet të jetë në përputhje me synimet e popullit të Kosovës për integritet euro-atlantik, ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve me vendet mike, thellimin e marrëdhënieve të mira me vendet e rajonit, si dhe arritjen e statusit të një

¹³² Ismajli, Osman, "Partitë Politike shqiptare dhe Çështja e Kosovës (1989-1998)", Prishtinë, 2001, fq. 184-185

¹³³ Jonathan Clarke, article appeared in the Los Angeles Times, 2008

partneri të besueshëm në luftën kundër kërcënimeve të sigurisë ndërkombëtare.

Roli i politikës të jashtme Kosovare në njohjen ndërkombëtare të saj, lobimi dhe pengesat

Politika e jashtme e Kosovës formulohet dhe zbatohet nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës. Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës ka për mision mbrojtjen e interesave të Kosovës në raport me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, përfaqësimin e Kosovës në vendet e jashtme, ruajtjen dhe mbrojtjen e imuniteteve dhe privilegjeve të misioneve diplomatike dhe personave të cilëve u takojnë ato sipas konventave dhe zakoneve ndërkombëtare, zhvillimin dhe bashkërendimin e politikave në raport me vendet e tjera, zhvillimin e marrëdhënieve të mira me të gjithë fqinjët. Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës promovon dhe mbron politikat nacionale, kulturore e ekonomike të Kosovës në botë¹³⁴.

Prioritetet kryesore të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit sa më të suksesshëm të misionit të saj. Njohja e pavarësisë së Kosovës nga shumica absolute e shteteve të bashkësisë ndërkombëtare dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike me këto vende.

Edhe pse Kosovën e kanë pranuar si të pavarur shtetet fqinje të saj, aleati më i fuqishëm, Amerika dhe 22 shtete anëtare të Bashkimit Evropian, me përjashtim të Spanjës, Rumanisë, Greqisë, Qipros dhe Sllovakisë, shqetësimi i diplomacisë kosovare vjen si rezultat i faktit se pas GJND-së ende nuk kanë ndryshuar mendimin shumica e shteteve të lartëpërmendura bashkë me Rusinë e Kinën dhe kjo nënkupton se nuk do të ishte logjike që Sërbia të njohë Kosovën para Spanjës, Rusisë e Greqisë.

¹³⁴ www.rks-gov.net

Që nga 15 janari 2011, **110** nga **192** shtete sovrane anëtare të Kombeve të Bashkuara kanë njohur Republikën e Kosovës formalisht¹³⁵. Megjithatë, njohjet e reja për Kosovën kanë rënë në numër për çdo vit, ashtu si edhe rëndësia që kanë shtetet nga vijnë njohjet në arenën ndërkombëtare.

Viti 2014 ka pasur performancën më të keqe që prej shpalljes së pavarësisë sa i përket njohjeve të reja. Vetëm katër shtete kanë marrë vendimin për të njohur Kosovën gjatë vitit të kaluar, dy në Afrikë dhe dy në rajonin e Oqeanisë. Tonga, Lesotho, Togo dhe Ishujt Solomon kanë qenë katër vendet që kanë pranuar Kosovën, gjithsesi rëndësia që këto shtete kanë në arenën ndërkombëtare dhe në rajonet ku ndodhen është shumë e kufizuar dhe nuk ndikon tek vendet e tyre fqinje.

Analistë të ndryshëm e kanë lidhur këtë situatë me akuzat e vazhdueshme që janë bërë në drejtim të lidhshimit në Prishtinë për përfshirje në krime lufte gjatë vitit 1999, por edhe për shkak të mosfunksionimit normal të ministries së jashtme, përfshirë nga korrupsioni dhe emërtimet partiake.

Në Evropë, njohjet kanë ngecur prej vitit 2011, me Andorën që është shteti i fundit që pranoi pavarësinë e Kosovës më 8 qershor, ndërsa në Bashkimin Evropian, pesë vendet e mbetura nuk kanë ndryshuar qëndrim lidhur me njohjen e Kosovës. Vendi i fundit Brenda BE-së që njohu Kosovën ishte Portugalia, më 7 tetor të vitit 2008.

Objektivi kryesor i Kosovës mbetet antarësimi në Kombet e Bashkuara, por vetoja e Rusisë dhe Kinës në Këshillin e Sigurimit deri më tani e bën të pamundur këtë mision.

Edhe viti 2015 nuk ka nisur mbarë për shtetin e Kosovës. Emigrimi masiv i kosovarëve drejt vendeve të zonës Shengen dhe ngecja e Kosovës në rrugën e antarësimit në BE ndihmon propagandën dhe lobimin serb kundër njohjes së pavarësisë.

¹³⁵ <https://www.rks-gov.net>

Statistikisht, Kosova në OKB është njohur nga 53 % të shteteve anëtare të saj(110 shtete), në BE nga 82 % të shteteve (23 shtete anëtare), në NATO nga 85% ose 24 nga gjithsej 28 shtete anëtare, Në Këshillin e Evropës nga 47 shtete e kanë njohur 34 prej tyre(72 % e shteteve), në OSBE me 64 % ose 36 nga 56 shtete anëtare dhe në Ligën Arabe me 63 % ose më saktë, 14 nga 22 shtete arabe kanë njohur Kosovën të pavarur.

Lobimi për sa më shumë njohje të Kosovës nga shtete të ndryshme, përbën angazhimin e rëndësishëm të popullit të Kosovës në fazën aktuale. Që nga dita e shpalljes së pavarësisë duket sikur ka kaluar një përjetësi. Megjithatë, në një shtet të ri, ecuria e evenimenteve ka një ritëm më të madh sesa në demokracitë e konsoliduara apo shtetet e vjetra në moshë. Mund të thuhet se tashmë raporti i forcave po nis të anojë dukshëm nga grupimi i madh i shteteve që janë në favor të njohjes së shtetit kosovar. Megjithatë, duhet patur parasysh fakti se në lojë janë interesa të shumta, të vjetra e të reja, gjeopolitike dhe ekonomike, të natyrës etnike dhe me specifika të brendshme për secilin vend, të cilat ende e pengojnë avancimin e njohjeve.

KONKLUZION

Duke pasur parasysh të gjitha ngjarjet paraprake, për njohjen ndërkombëtare të Kosovës duhet punuar natë e ditë dhe jo në mënyre sporadike. Nuk ka vend për eufori dhe humbje kohe sepse skenarët serb për Kosovën po fillojnë t'i ngjasojnë atyre të Bosnjës dhe kjo do të shkaktonte çrregullime të reja në Ballkan dhe ngecje të proceseve integruese jo vetem për Prishtinën por njëkohësisht edhe për Beogradin.

Beteja diplomatike ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, për dhe kundër njohjes së pavarësisë së Kosovës, e nisur para më shumë se tre vjetësh ka gllabëruar shuma të mëdha eurosh, ndërkohë që defekti real i këtyre shpenzimeve, sipas akterëve të procesit, nuk mund të matet konkretisht.

Krahas angazhimeve të të gjithë mekanizmave shtetërorë për lobim, shefat e diplomacive të dyjave vendeve kanë ndërmarrë edhe udhëtime të shumta, nëpër vende të ndryshme, me qëllim të prezantimit të rrëfimeve të tyre për Kosovën, duke harxhuar kështu mjete të konsiderueshme nga buxhetet përkatëse, derisa rezultatet e këtyre angazhimeve nuk duken në sipërfaqe.

Kosova është pashmangshmërisht sfidë ndërkombëtare, por është edhe rasti i vetëm dhe më i qartë i suksesit të mundshëm. Në mënyrë të përsëritur është bërë e qartë se BE-ja e konsideron Kosovën dhe rajonin si çështje të saj. Evropa ka të gjitha nivelet: atë diplomatik, ekonomik dhe teknik për të sjell progres. E që është po ashtu me rëndësi, Evropa dhe ShBA-ja mund t'i ofrojnë inspirimin më të fuqishëm Kosovës dhe fqinjëve të saj. Ka sfida të mëdha në këtë rrugëtim, por , për dallim nga çështjet e tjera të pazgjidhura në rajon, unë do të thosha se këtu kemi një rezultat të qartë pozitiv, tashmë të pranuar gjërësisht.

Bibliografia

1. Boriçi, Gjon, “Lufta për Paqen në ish-Jugosllavi” 1987-1999, ”Geer”, Tiranë, 2008;
2. Habermas, Jurgen, “Perëndimi i përçarë”, “Asdren”, Shkup, 2006;
3. Puto, Arben, “E drejta ndërkombëtare publike”, ”Dudaj “, Tiranë, 2008;
4. Gruda, Zejnullah, “E drejta ndërkombëtare publike”, ”Furkan ISM”, Shkup, 2007;
5. Glenny, Misha, “Historia e Ballkanit 1804 – 1999”, TOENA, Tiranë, 2007;
6. Kissinger, Henri, ”Diplomacia”, ”B.K”, Tiranë, 1999;
7. Ruzie, David, ”E drejta ndërkombëtare Publike”, ”Data Pons”, Shkup, 2006;

8. Ismajli, Osman, “Partitë Politike shqipëtare dhe Çështja e Kosovës (1989-1998)”, Prishtinë , 2001, fq. 184-185;
9. Jonathan Clarke , article appeared in the Los Angeles Times , 2008;
10. Kospress, 19 shtator 2008;
11. Gazeta “Shqip”, 28.08.2006;

Materiale nga Interneti

12. <https://www.rks-gov.net/>;
13. <http://www.mfa-ks.net/>;
14. <http://kosovaonline.info/>.

KOSOVO IN THE INTEGRATION POLITICS OF THE EU
PhD Candidat, Man Poga

m_poga@hotmail.com

Abstract

European political developments during the 20th century, notably in the beginning of 21st century, have shown that the external borders of the EU are not unchangeable. Underlying the political existence of Europe stand a group of unknown political choices, among them are the changing of borders that have shaken already the future of this zone, so placing a long-lived peace. Expanding is one of the most powerful instruments of the EU politics.

Thus, the future of the Kosovo can't be seen out of the EU. This organism, that absorbs the whole region, is a "salvation" for the turbulent countries of Western Balkans. The stability of Kosovo and of the region also, can't be outside of the club of European countries. It's for sure that in front of the new born state of Kosovo, stand a lot, but not impossible challenges toward the versatile integration of the country in NATO and EU, as a full member together with the other countries of the Western Balkans.

The EU has been part of the efforts to help create a new future for Kosovo since 10th of June, 1999, time when Kosovo was under the administration of the UN, through the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo, according the United Nations Security Council Resolution 1244. Today EU is present in Kosovo through the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, whose priorities are defined "to support the Kosovo authorities in their efforts to build a stable and functional system of law.

Keywords: Kosovo, EU, Integration, Western Balkans.

HYRJE

Bashkimi Europian (BE) fillesat e jetësimit konkret si projekt i ka tek tre Komunitet europiane të themeluara fillimisht nga Belgjika, Franca, Gjermania, Holanda, Italia dhe Luksemburgu. Këto shtete ishin nënshkruese të traktateve të para të Komuniteteve europiane, konkretisht: te Traktatit të Parisit të 18 prillit 1951, që ka themeluar komunitetin Europian të Qymyrit dhe Çelikut¹³⁶; dhe dy traktat e tjera të njohura si traktaktet e Romës, të 25 marsit 1957, që kanë themeluar Komitetin Ekonomik Europian dhe Komitetit Europian të Energjisë Atomike¹³⁷. Bashkimi Europian që njohim sot u krijua me 1993, nga ku u bë kalimi nga Komuniteti Europian tek Bashkimi Europian, në zbatim të traktaktit mbi Bashkimin Europian i njohur më mire si Traktakti i Mastrohtit. Megjithatë, duhet theksuar se Komuniteti Europian vazhdoi të ekzistonte si pjese integrale e BE-së.

Politikat si ajo bujqësore dhe anti-trust ishin më shumë aktivitete të Komitetit Europian (KE), se sa të BE-së, studiuesit, shpesh përdorin termin “KE” kur i referohen zhvillimeve para '93 dhe “BE”, për zhvillimit pas vitit 1993, megjithse kur i referohen në përgjithësi “historisë së BE-së” duhet kuptuar historia e integrimeve europiane që më krijimin e komuniteteve të para¹³⁸. Me dy rishikimet e njëpasnjëshme nga traktati i Amsterdemit dhe Traktati i Nises shohim se Bashkimi Europian nuk i zëvendësoi 3 Komunitetet, por u bazua në to duke i kompletuar me politika te reja. Vetëm me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës me 1 dhjetor të 2009, vendoset në

¹³⁶ Traktat ka hyrë në fuqi 22 korrik të vitit 1952. Fuqia e tij juridike ishte deri në 50 vjet pas hyrjes në fuqi, kështu që ky traktat ishte i vlefshëm deri me 22 korrik të vitit 2002;

¹³⁷ Këto traktate kanë hyrë në fuqi me 5 janar 1958;

¹³⁸ Desmond Dinan, “Historia e Integritimit Europian”: AIIS, Tiranë, fq. 17.

nenin 1 të T.B.E, se Bashkimi zëvendëson dhe trashigon Komunitetin Europian¹³⁹.

Që kur është krijuar BE-ja, është zgjeruar gjashtë herë me antarë të rinj, zgjerimi është njëri nga instrumentat më të fuqishme të politikave të Bashkimit Europian. Ky organizëm që përthith rajonin është një “shpëtim” për vendet e trazuara të Ballkanit Perëndimor. Dyert mbeten të hapura për vendet e Ballkanit (Bosnja-Hercegovina), Kosova, Mali i Zi, Serbia dhe Shqipëria), të cilat sipas konkluzioneve të Këshillit Europian të Selanikut të 19-20 qeshorit 2003, kanë prirje për të aderuar në Bashkimin Europian¹⁴⁰. Megjithë tranzicionin e vazhdueshëm, korrupsionin e lartë, vaktësinë e reformave, dhe deri diku nga ana tjetër entuziazmin e munguar që strukturat e BE kanë herë pas here për mosmbushjen e kritereve, politike dhe ekonomike, përsëri për shtetet aspirante të Ballkanit Perëndimor, përfshirë dhe Kosovën, integrimi në BE, ngelet një prioritet kryesor.

Objetivi i integritit europian ka patur gjithmonë në vetvete një përbërës të fortë politik, sikurse e tregon ende sot zgjerimi i tij me shtetet e Europës Qendrore dhe Lindore, gjë që i përgjigjet po aq preokupimeve politike sa dhe atyre ekonomike. Kjo faqe politike e integritit europian është institucionalizuar vetëm tani vonë dhe jo pa vështirësi të mëdha¹⁴¹.

¹³⁹ Shih: Traktati i Lisbonës neni 1.

¹⁴⁰ Shih: paragrafin 40 të konkluzioneve të Presidencës së Këshillit Europian të Selanikut, 19-20 qeshor 2003.

¹⁴¹ François d’Arcy, “Politikat e Bashkimit Europian”, Papipus, Tiranë, fq. 16.

Asistimi i BE-së në hapat e para të Kosovës dhe Bashkëpunimi Rajonal

Bashkimi European ka qenë pjesë integrale e përpjekjeve për të ndimuar në ndërtimin e një të ardhme të re për Kosovën sidomos mbas 10 qershorit të vitit 1999, kur Kosova qeverisej nën administrimin e Kombeve të Bashkuara, nëpërmjet Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB.

Rolin e BE-së në Kosovë nga viti ‘99 fillimisht e gjejmë në kuader të strukturës së UNMIK-kut tek shtylla e IV, ku ishin të përcaktuar fushat:

- ✓ Shtylla I: për çështjet humanitare, u drejtuan nga UNHCR-ja;
- ✓ Shtylla II: administrata civile, u drejtua nga vetë UNMIK-u;
- ✓ Shtylla III: demokratizimi dhe ndërtimi i institucioneve, u drejtua nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE);
- ✓ dhe shtylla IV: zhvillimi ekonomik, u vu nën mbikëqyrjen e Bashkimit European.

Po gjatë kësaj periudhe Pakti i Stabilitetit, ishte përpjekja tjetër serioze nga Komuniteti Ndërkombëtar për zgjidhjen e krizave me një strategji bashkohore dhe afatgjate, për parandalimin e konflikteve. Në këtë frymë me 10 qershor të vitit 1999 në Këln të Gjermanisë, u iniciua “Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore”, në takimin e Ministrave të Puneve të Jashtme të BE-së, SHBA-së, RUSI-së si dhe grupit të vendeve të Ballkanike, pa Jugosllavinë¹⁴². Si mundësi reale për ndriçimin e zhvillime të reja dhe hapjen e një prespektivë reale për të integruar rajonin problematik.

¹⁴² Bashkim Rama, “Ballkani Pas Rënies së Murit të Berlinit”, Tiranë, 2013, Fq. 401.

Në Samitin e Sarajeves ne korrik 1999, Pakti i Stabilitetit u konfirmua dhe u prezantua si iniciative, ideja e të cilit lindi në vitin 1998 dhe lidhet me luftën në Kosove. Ky pakt njihet si bashkëudhëtare me procesin e integritit rajonal që në fillim të apelit që iu be vendeve rajonale që e konsideronin këtë integrim si pjesë e pandashme e një procesi më të gjerë, atë të integritit në Bashkimin European. Sepse nuk mund të ketë stabilizim dhe asociim me Europën e Bashkuar pa stabilizim të vetë rajonit. Dokumenti përmbante një rradhë principesh, në përputhje me të cilët, sipas me mendimit të hartuesve të tij, do të bëhej e mundur arritja e stabilizimit të rajonit në bazë të demokratizimit, shpejtimit të shndërrimeve ekonomike dhe luftës kundër korrupsionit.

Kosova, hap pas hapi i kushtoi një vëmendje të veçantë forcimit të marrëdhënieve shumëpalëshe rajonale, si bazë dhe kusht për integrimin e mëpasëm në BE.

Kjo duket në hapjen e menjëhershme të Zyrave përkatëse për bashkëpunim në Prishtinë, siç ishte Zyra e Paktit të Stabilitetit, themeluar në Qershor të 2002, me vendim të Kryeministrit Z. Hashim Thaçi. Në nëntor të 2008 po kjo zyrë u transformua në “Zyrën e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal” në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, konformë transformimit të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal.

Bashkëpunimi Rajon doli si domosdoshmëri dhe në Samitin e Zagrebit në nëntor 2000, ku vuri vulën mbi Procesin e Stabilizim Asociimit duke fituar pajtimin e rajonit në themelimin e një kornize objektivash dhe kushtesh. Prosesi i Stabilizim Asociimit bazohet kryesisht në tri shtylla, ku pika e 3-të thekson qartë objektiv konkret për vendet aspirante, konkretisht:

- ✓ Ofertën e stimujve atraktivë, ekonomik dhe politik, duke përfshirë marrëdhënie më të afërt me BE-në, dhe në periudhë afatgjate, integrim në BE;
- ✓ 2) Obligimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor për të ndërmarrë reforma gjithëpërfshirëse;
- ✓ 3) Theksimin e nevojës për bashkëpunim intensiv rajonal.

Në këtë këndvështrim obligues duhet parë dhe nevoja e pashmangëshme në ndërtimin e marrëdhënieve ndërshtetërore mes Kosovës dhe vendeve të rajonit në përgjithsi dhe për specifikat e veçanta me Serbinë në veçanti. Së pari si dëshmi e pjekurisë shtetëformuese dhe së dyti, si garanci për integrimin e mëpasëm të dy shteteve në Bashkimin Europian.

Pa mohuar kontributin e dhënë nga Pakti i Stabilitetit për Ballkanin, mund të thuhet se aktiviteti i tij, në mbledhjet dhe takimet e shumta për evidentimin e problemeve dhe zgjidhjen e tyre, lëvizte në një “rreth vicioz”, sipas të cilit, stabiliteti politik në rajon është i pamundur të arrihet pa një progres ekonomik, kurse ky i fundit pengohet nga mungesa e stabilitetit politik¹⁴³.

Për praninë e madhe të Bashkimit Evropian në Kosovë dëshmojnë vetë numri i madh i institucioneve dhe organizatave rezidente atje si:

- 1) Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë;
- 2) Prania e Agjencisë Europiane për Rindërtim (EAR)¹⁴⁴;

¹⁴³ B. Rama: vep e cit, fq. 402.

¹⁴⁴EAR, është themeluar në vitin 1999 nga Këshilli Evropian pikërisht për shkak të Kosovës pas pasojave

- 3) Përfaqësuesi special i BE-së/ Zyra ndërkombëtare civile;
- 4) Presidenca e Bashkimit Evropian;
- 5) Shtetet anëtare të BE-së, nëpërmjet përfaqësive të tyre;
- 6) EULEX-si¹⁴⁵, etj.,

EU-LEX, është misioni me i ri i vendosur në Kosovë, shefi i parë i misionit Z. Yves de Kermabon, ka vënë në dukje faktin se ishte emëruar në këtë post nga 27 vendet anëtare të Bashkimit Evropian. (megjithë problematiken e mosnjohjes nga disa shtete) Z. Yves de Kermabon, ju drejtua qeverisë së Kosovës se “Ju tash jeni përgjegjës, jeni të pavarur, duhet të punoni dhe ta formësoni të ardhmen e shtetit tuaj”. Ne jemi këtu për t’ju sjellur disa vlera europiane, disa ekspertiza kështu që me mbështetjen tonë, me këshillat tona por duke punuar bashkë, ne mund të arrijmë në një fazë për t’iu bashkuar Bashkimit Evropian”¹⁴⁶.

Politika e Bashkimit Evropian për Kosovën, Asistenca e Ekonomike

Fillimisht, për Kosovën u aplikua politika e afrimit në Bashkimit Evropian nëpërmjet Mekanizmit Përcjellës të Procesit të Stabilizim Asocimit (*Tracking Mechanism*). Ky mekanizëm u themelua në nëntor të vitit 2002 me qëllim që t’u mundësojë institucioneve kosovare që të përfitojnë tërësisht nga

që pat nga lufta, me seli në Selanik të Greqisë dhe me qendrat operative në Prishtinë, Beograd, Podgoricë

dhe në Shkup

¹⁴⁵ Është themeluar nga BE-ja dhe është drejtpërdrejt nën përgjegjësinë e përfaqësuesit për politikë të

jashtme dhe të sigurisë të BE-së, themeluar nëpërmjet veprimit të përbashkët të Këshillit të BE-së

(5928/08) më 4 shkurt 2008.

¹⁴⁶ Shih: <http://www.eulex-kosovo.eu/al/info>.

elementet kryesore të Procesit të Stabilizim Asocimit (PSA), si mbështetja financiare, këshillimi mbi politikat, preferencat tregtare dhe monitorimi i standardeve të BE-së. Nëpërmjet këtij Mekanizmit Përcjellës, Kosova u asistua në realizimin e reformave strukturore të nevojshme për përafrim me BE-në si dhe në zhvillimin e institucioneve dhe aftësimin e administratës mbi qëllimet dhe parimet mbi të cilat ndërtohen politikat dhe praktikat europiane. PSA-ja si vizion ishte korniza e marrëdhënieve të BE-së me rajonin, ndërkaq objektivi i këtij procesi është stabilizimi i tij nëpërmjet reformave politike dhe ekonomike, në mënyrë që me këtë të përforcohet përparimi drejt Bashkimit Evropian.

Duhet theksuar se në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asocimit, të krijuar enkas për Ballkanin Perëndimor, BE-ja përkrahu vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë reformave të tyre politike dhe ekonomike, si dhe në përmbushjen e kriterëve të Kopenhagenit.

Megjithatë, këto zhvillime pak u morës parasys, Kosova ende sot po punon për konkretizimin e një marrëdhënie kontraktuale me BE-në, siq është nënshkrimi i MSA, ndërkohë mund të kishte ecur më shpejt. Negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet BE-së dhe Kosovës kanë filluar në tetor të vitit 2013 dhe përfunduan në maj të vitit 2014. Në korrik të vitit 2014, kryenegociatorët vendosën inicialet në marrëveshjen. Komisioni tani është duke përgatitur propozimet për vendimin e Këshillit për nënshkrimin dhe përfundimin e saj.

Siç raportohet në raport progresin Komizionit European për 2014-tën “MSA-ja e ardhshme do të jetë një marrëveshje 'vetëm për BE-në`. Elementet e saj kryesore janë rritja e tregtisë mes BE-së dhe Kosovës, obligimi i Kosovës që të harmonizojë legjislacionin e saj me *acquis* e BE-së në një gamë të gjerë të sektorëve dhe mundësinë për të zhvilluar një dialog

politik mes BE-së dhe Kosovës. Zhvillimi i tregtisë dhe investimeve si dhe modernizimi i organizimit ligjor dhe institucional janë vendimtarë për ristrukturimin dhe modernizimin ekonomik të Kosovës. MSA-ja e vendosë Kosovën në kursin e marrëdhënieve të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe konfirmon perspektivën evropiane të Kosovës në kontekstin e kriterëve të Kopenhagës të vitit 1993”¹⁴⁷. Gjithashtu, në kontekst të **Procesit të Stabilizim Asocimit**, Kosova ka mbetur e angazhuar në Dialogun e Procesit të Stabilizim Associmit (DPSA). Ka vazhduar dialogu i strukturuar mbi sundimin e ligjit. Diskutimet janë fokusuar në ndërhyrjen politike në gjyqësor dhe në ngritjen mëtejshme të kapaciteteve të Kosovës për marrjen e përgjegjësi që do të transferohen nga EULEX-i. Dialogu për **liberalizimin e vizave** ka qenë një nga prioritetet kyçe për Kosovën.

Nga pikëpamja financiare në këtë proces Kosova ka marrë më shumë se 2 bilionë € ndihmë nga KE që nga viti 1999-2005. Fillimisht kjo ndihmë u fokusua në veprime për ndihmë emergjente dhe rindërtim, tani fokusohet në inkurajimin e zhvillimit të institucioneve, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe sigurimin e një të ardhme evropiane për Kosovën.

Shpejtësia e integritimeve në BE varet nga shpejtësia e realizimit të reformave. Kosova duhet të punojë për të bërë përparime në rrugën e vështirë të integritimit në BE. Ndimesë kyçe ofron për këtë objektiv, instrumenti i para-anëtarësimit, i cili ofroi asistencë të racionalizuar vendeve aspirante për t’u integruar në BE për periudhën 2007-2013 mbi bazë të mësimëve nga instrumentet e mëparshme të ndihmave të jashtme dhe instrumenteve të para-anëtarësimit (PHARE, ISPA, SAPARD, Instrumenti i Para-Anëtarësimit për Turqinë, Instrumenti i Para-Anëtarësimit për

¹⁴⁷ Progress Raporti i Komisionit Europian për Kosovën, 2014, Bruksel, 8.10.2014, SWD(2014) 306 final, fq.4

Ballkanin, CARDS). Qëllimi i IPA-s është të zhvillojë efikasitetin dhe koherencën e asistencës me mjete të një kornize të vetme. Ekzistojnë pesë komponente nën të cilat bien projektet në kuadër të IPA, ku Kosova ashtu si vendet e Ballkanit Perëndimor përfiton çdo vit nga kjo asistencë financiare për:

- 1) Asistencë Tranzicioni dhe Ndërtim Institucionesh;
- 2) Bashkëpunim Rajonal dhe Ndër-kufitar;
- 3) Zhvillim Regjional;
- 4) Zhvillim të Resurseve Njerëzore;
- 5) Zhvillim Rural.

Në shuma konkrete, BE-ja ka ofruar asistencën financiare për Kosovën përmes Instrumentit të asistencës së Paraanëtarësimit (IPA) 2007-2013, me një alokim total prej 673.9 milion €. Përmes IPA-së në vitin 2013, janë siguruar 38.5 milion € shtesë për të mbështetur dialogun Prishtinë-Beograd, procesin e normalizimit dhe integrimin në Kosovë, duke e përfshirë këtu edhe dialogun e vizave. Sipas IPA II, Kosova do të vazhdojë të përfitojë nga asistencë për para-anëtarësim për vitet 2014-20, me një alokim të përgjithshëm indikativ prej 645.5 milion €

Më 20 gusht, Komisioni miratoi një dokument strategjikë indikativë për vitet 2014-20, i cili u hartua në partneritet me Kosovën dhe në Konsultim me të gjitha palët e interesit. Asistencë e IPA-së do të fokusohet në mbështetjen për sektorët e demokracisë dhe qeverisjes, sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore; konkurrencën dhe inovacionin, arsimin, punësimin dhe politikatat sociale, energjinë, si dhe bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Kosova vazhdon të përfitoj nga asistenca sipas programeve shumë përfituese dhe rajonale si dhe merr pjesë në tre programe bashkëpunuese ndër-kufitare me vendet fqinje të Ballkanit Perëndimorë. Zbatimi i IPA-së menaxhohet nga zyra e BE-së në Kosovë.¹⁴⁸

KONKLUZION

Në bazë të së tashmes dhe të ardhmes së Kosovës qëndrojnë proceset integruese euro-atlatike të saj, të cilat ngërthejnë të gjitha aspektet reformuese dhe zhvillimore. Zbatimi i strategjisë (2010-13) dhe planit të veprimit (2012-14) për reformën e administratës publike ka qenë një sfidë e madhe për Kosovën, duke dhënë rezultate shumë të kufizuara. E përkrahur nga një angazhim serioz politik, Kosova duhet të krijojë një kuadër realist strategjik për hartimin e politikave, planifikimin legjislativ dhe zbatimin praktik të reformave. Kompletimi i kornizës legjislative për shërbimin civil, duke siguruar se është e depolitizuar dhe kryerja e vlerësimeve të performancës të shërbimit civil janë prioritet. Kosova gjithashtu duhet të miratojë një ligj mbi procedurat e përgjithshme administrative, të cilat janë vendimtare për zhvillimin e një mjedisi miqësor për biznesin¹⁴⁹.

Nisur nga zhvillimet e fundit, e ardhmja e Kosovës nuk duhet parë jashtë Bashkimit European, sepse, stabiliteti i rajonit në përgjithësi dhe i Kosovës në veçanti, nuk mund të vijë dhe forcohet jashtë këtij projekti European. Natyrisht se, përpara shtetit të ri të Kosovës qëndrojnë sfida të mëdha por jo të pamundura, në drejtim të realizimit të reformave, që synojnë përbushjen e kriterëve që mundësojnë realizimin e qëllimit final,

¹⁴⁸ Po aty.

¹⁴⁹ “Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2014-15”, Komunikatë nga Komisioni Evropian për Parlamentin dhe Këshillin Evropian, Komisionin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komisionin e Rajoneve, Bruksel, 8.10.2014 , COM(2014) 700 final.

antarësimin me të drejta të plota në BE dhe NATO, krahas vendeve të tjera të zhvilluara europiane.

Bibliografia:

I. Libra

- 1 Malcom, N. “Kosova një Histori e shkurtër”, Koha, Prishtinë, 2011;
- 2 Jasminka Udovički & James Ridgeway , “Yugoslavia’s Ethnic Nightmare”;
- 3 Bashkurti, Lisen, “Koncerti dhe Funerali 1815-1914: Shqiptarët-Ballkani-Fuqitë e Mëdha”, Tiranë 2013;
- 4 Desmond Dinan, “Historia e Integritit Evropian”: AIIIS, Tiranë;
- 5 François d’Arcy, “Politikat e Bashkimit Evropian”, Papipus, Tiranë;
- 6 Lendita Memeti-Kamberi, “Shteti Kandidat i Bashkimit Evropian”, Tiranë, 2011;
- 7 Jean-Yves Letessier, Jacques Silvano, Robert Soin, “Europa Ekonomike dhe e ardhmje e saj”, Tiranë, 2009;
- 8 Bashkim Rama, “Ballkani Pas Rënies së Murit të Berlinit”, Tiranë, 2013;
- 9 Yves Doutriaux, Christian Lequesne, “Institucionet e Bashkimit Evropian”, Tiranë, 2007;

II. Dokumente:

1. Progress Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, 2014, Bruksel, 8.10.2014, SWD(2014) 306 final;
2. Komunikatë nga Komisioni Evropian për Parlamentin dhe Këshillin Evropian, Komisionin Ekonomik dhe Social Evropian

- dhe Komisionin e Rajoneve: - “Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2014-15”, Bruksel, 8.10.2014 , COM(2014) 700 final;
3. Instituti Kosovar për kërkime dhe zhvillime të politikave, Prishtinë Shkurt 2007;
 4. Instituti: “Kosovar për zhvillime të politikave”, Prishtinë Nëntor 2005;
 5. Korniza e Përkohshme e Institucioneve Vetë-qeverisëse të Kosovës (UNMIK);
 6. Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
 7. Plani i veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, 2013;
 8. Raportet e Komisionit European dedikuar vendeve të Ballkanit Përendimor dhe Kosovës nga 1998-2013.

LEGAL ASPECTS FOR PRINCIPLE OF EQUALITY AND NON-DISCRIMINATION – THE CASE OF MACEDONIA

1) PhD Naser Ademi,
Full Professor, State University of Tetova, e-mail:
naser.ademi@unite.edu.mk

2) PhD Agim Nuhju,
Assistant Professor, State University of Tetova, e-mail:
agim.nuhju@unite.edu.mk

3) MA Ardit Xhaferi,
Official of the M.I.A - Gostivar Sector, e-mail: ardit_xh@hotmail.com

Abstract

The person that considers being subject to discrimination submits complaint to the Commission for protection against discrimination. Along the complaint, the person also submits evidence and facts from which can be determined the act or incident of discrimination.

The person considering the some right has been infringed because of discrimination is entitled to submit a lawsuit in front competent court. The provisions from the Law on litigation procedure are adequately applied for the procedure.

For the crime acts against state, the criminal law determines that will be punished for causing national, religious and racial hatred, discord and intolerance, the one who coercion, harassment, endangerment of safety, exhibiting derision of national, ethnic or religious symbols, damaging others objects, violation of monuments, graves or otherwise will cause incites national, religious and racial hatred, discord or intolerance.

If there are grounds for suspicion that a crime is been committed which is prosecuted through ex officio, the Ministry of the Interior is required to take the necessary measures to find the perpetrator of the crime,

the perpetrator or accomplice not to hide or to escape and to provide the evidence of the criminal offence and objects which can be used as evidence, and to collect all the information that could be beneficial for the successful conduct of the criminal proceedings and criminal charges to present to the Public prosecutor.

Key words: equality, nondiscrimination, litigation procedure, law, protection.

HYRJE

Çështja e mbrojtjes nga diskriminimi i është nënshtruar trajtimeve teorike shkencore, analizave dhe qasjeve nga shumë segmente dhe këndvështrime. Vështrimet mbi këtë temë kryesisht fokusohen në trajtimin e lindjes, zhvillimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi. Mbrojtja nga diskriminimi ka ndikuar edhe në krijimin e një zone lirie, sigurie dhe drejtësie, mbi parimet bazë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe qytetarit.

Dinamika që e karakterizon këtë temë detirminon kultivimin në vazhdimësi të mendimit teorik dhe të qenies përherë i orinetuar me evoluimin që pëson legjislacioni dhe jurisprudenca pozitive e vendit. Trajtresa mbi diskriminimin dhe mbrojtjen institucionale të këtij fenomeni në aspektin teorik – doktrinar me ndërthurje me rastet nga praktika dhe përcaktimet e legjislacionit pozitiv paraqet bazamentin e këtij shqyrtimi.

Çështja e diskriminimit në Maqedoni

Tema e diskriminimit është objekt relevant dhe shumë kompleks. Fenomeni i diskriminimit ka përjetuar jo rrallë herë rilindje dhe studim shkencor. Përveç tjerash çështja e diskriminimit dhe mbrojtja nga diskriminimi në Maqedoni duhet të trajtohet edhe në kuadrin e konsolidimit

demokratik dhe tranzicionit të shtetit në rrugën e shndërrimit në shtet juridik.

Maqedonia është një shtet relativisht i ri e që është ballafaquar me konflikte ndërnacionale, me konflikt luftarak ndëretnik në njërën anë dhe në anën tjetër është ballafaquar me sfida në rrugën e tranzicionit drejt shtetit të së drejtës, ekonomisë së tregut, vendosjes së demokracisë, sigurimit të të drejtave të njeriut. Maqedonia akoma nuk e ka realizuar tranzicionin e sukseshëm dhe konsolidimin demokratik. Nuk është arritur respektimi i procesit demokratik me të cilin zgjedhet pushteti, që qeveria të vijë në pushtet përmes zgjedhje të lira dhe demokratike, që pushteti të ndahet, ushtrohet dhe respektohet nga organet dhe institucionet e pushtetit shtetëror. Është fakt se regjimi prodemokratik në Maqedoni është në rrugën e konsolidimit me forcat qeveritare dhe joqeveritare, por ende nuk janë krijuar mundësitë që konfliktet sidomos ndëretnike të zgjidhen në mënyrë të drejtë, përmes veprimeve dhe institucioneve të reja demokratike. Konsolidimi i demokracisë në Maqedoni është edhe faktor kyç në mbrojtjen institucionale nga diskriminimi. Marrëdhëniet shoqërore në Maqedoni janë formësuar nga trendet konfliktuoze ndëretnike sidomos midis dy komuniteteve më të mëdha: maqedonasve dhe shqiptarëve. Për shumë çështje të hapura janë dhënë zgjidhje të çuditshme.

Kuadri kushtetutar dhe çështja e diskriminimit

Megjithatë, analizuar çështjen e diskriminimit dhe mbrojtjen institucionale nga diskriminimi, vlerësojmë se rregullimi ligjor dhe kushtetues i Republikës së Maqedonisë rëndësi të veçantë i kushton të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarit . Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë vend të veçantë u kushton lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit. Individit si genie njerëzore është në qendër të rregullimit kushtetues

dhe ligjor dhe liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit kanë marrë dimensione të institucionit shumë të rëndësishëm. Kushtetuta e Maqedonisë bën grupizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit në të drejta qytetare dhe politike, të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore.

Rregullativa kushtetutare dhe ligjore e Republikës së Maqedonisë vend të rëndësishëm i kushton edhe rregullimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave vetjake, si: të drejtës në jetesë, të drejtës mbi integritetin fizik dhe moral të njeriut, të drejtën e lirisë, të drejtën e ndalimit të diskriminimit, të drejtën e barazisë para ligjeve, të drejtën e ankesës, pacënueshmërinë e banësës, pacënueshmërinë e fshetësisë së letrës, lirinë e qarkullimit dhe vendbanimit, të drejtën e të menduarit dhe ndërgjegjës, lirinë e përcaktimit dhe besimit fetar, të drejtën në shtetësi.

Në lidhje më të drejtën në jetesë vlen të përmendet se jeta e njeriut është e pacënueshme. Neni 10 i Kushtetutës së Maqedonisë përcakton shprehimisht se dënimi me vdekje nuk mund të shqiptohet në asnjë bazë apo rrethanë. Nën kushtet e parapara ligjore mund të shqiptohet dënimi i përjetshëm për veprat e rënda penale.

Në lidhje më të drejtën mbi integritetin fizik dhe moral të njeriut, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë ndalon veprimet e organeve shtetërore apo të personave të tjerë me të cilat çënohet integriteti fizik dhe moral i njeriut. Në këtë drejtim Kushtetuta e Maqedonisë trajton dhe mbron në mënyrë të tërthortë edhe pozitën e njeriut në marrëdhëniet juridike civile, sidomos nga ndërhyrja e organeve apo personave zyrtarë shtetëror. Marrëdhëniet juridike civile krijohen mbi bazën e personave, d.m.th. personat janë vetë ata që i krijojnë midis vete këto marrëdhënie, pa ndërhyrjen arbitrare të shtetit. Vetëm njerëzit kanë cilësi të qenieve të gjalla, të vetëdijshme dhe vetëm ata mund të hyjnë në raporte juridike midis veti.

Vetëm njerëzit mund të jenë titullar të drejtave dhe detyrimeve, përkatësisht subjekte të drejtësisë, pasi drejtësia ekziston mu për shkak të njerëzve: *hominum causa omne jus constitutum est*.

Në lidhje me të drejtën e lirisë, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë garanton qarkullim të lirë të njerëzve, veprime të lira dhe shprehje të lira brenda kuadrit normativ pozitiv. Paraburgimi dhe heqja e lirisë, prezumimi i pafajsisë, e drejta në shpërbilim të dëmit të shkaktuar nga privimi i lirisë pa bazë ligjore, i burgosur apo dënuar pa bazë juridike, përbëjnë në fakt rendin e lirisë të personalitetit të njeriut të paraparë me Kushtetutë.

Sa i përket të drejtës së ndalimit të diskriminimit, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë në nenin 9 garanton liritë dhe të drejtat qytetare dhe politike. Sipas kësaj dispozite kushtetutare, secili qytetar është i barabartë në realizimin e të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj dhe Kushtetutë, pavarësisht nga gjinia, përkatësia nacionale, sociale, politike, fetare, nga gjinia, pozita në shoqëri, etj. Me këtë krijohen parakushtet për realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në secilën lëmi.

Në kuadër të kësaj të drejte vlen të përmendet edhe e drejta e barazisë para ligjeve të çdo njeriu dhe qytetari. Aspektet e rregullimit kushtetutar, ligjor dhe normativ për çdo lëmi duhet t'u referohen të gjithë qytetarëve pa dallime racore, gjinore, nacionale, sociale, politike, fetare, nga pozita në shoqëri, etj. Në këtë kornizë bën pjesë edhe e drejta e ankesës si e drejtë e lirisë së personalitetit. Neni 15 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë garanton të drejtën e ankesës nga ana e çdo qytetari brenda kuadrit ligjor pozitiv.

Nga korpusi i lirive dhe të drejtave vetjake, do të kishim veçuar edhe të drejtën e të menduarit dhe ndërgjegjes dhe lirinë e përcaktimit dhe besimit fetar. Në nenin 16 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë është e garantuar e drejta e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit. Kurse me amandamentin VII të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë mbrohet religjioni nga shteti, sepse kisha ortodokse maqedonase, bashkësia fetare islame, kisha evangelo-metodiste, bashkësia e hebrenjëve, bashkësitë dhe grupet tjera religjioze janë të ndara nga shteti dhe të barabartë para ligjit.

Rregullativa kushtetutare dhe ligjore e Republikës së Maqedonisë vend të rëndësishëm i kushton edhe rregullimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave politike, si: lirinë e fjalës, lirinë e bashkimit politik, të drejtën e informimit, të drejtën e tubimit të qetë, të drejtën zgjedhore, të drejtën e parashtrësive, të drejtën e ushtrimit të funksioneve publike, të drejtën e shtetasve të huaj, etj.

Nga korpusi i lirive dhe të drejtave politike do të kishim veçuar me këtë rast të drejtën e parashtrësive dhe ankesës në organet e pushtetit shtetëror. Sipas nenit 24 të Kushtetutës së Maqedonisë, qytetari ka të drejtë të paraqitet me parashtrësa të ndryshme për punët e organeve shtetërore apo ndërmarrjeve publike dhe të marrë përgjegje. Për një të drejtë të tillë qytetari nuk mund të merret në përgjegjësi n.q.s. nga brendia e parashtrësës apo ankesës nuk shkakton ndonjë vepër penale.

Rregullativa kushtetutare dhe ligjore e Republikës së Maqedonisë vend të rëndësishëm i kushton edhe rregullimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave ekonomike dhe sociale, si: të drejtën e pronësisë, të drejtën e trashëgimisë, të drejtën e punës, të drejtën e organizimit sindikal dhe të

drejtën për grevë, të drejtat në bazë të sigurimit social, mbrojtjen shoqërore të familjes, të drejtën për vendosjen e lirë për lindjen e fëmijëve.

Rregullativa kushtetutare dhe ligjore e Republikës së Maqedonisë vend të rëndësishëm i kushton edhe rregullimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave kulturore, si: të drejtën për arsim, lirinë për krijimtari shkencore dhe artistike, lirinë e shprehjes së lirë të përcaktimit të përkatësisë nacionale.

Respektimi i parimit të barazisë dhe mosdiskriminimi mendojmë se do të ndikojnë dukshëm në realizimin e sigurisë juridike, garantimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarit në Republikën e Maqedonisë. Afirmimi në këtë drejtim është permanent, jo vetëm në zbatimin e mirëfilltë të së drejtës me nxjerrjen e ligjeve të harmonizuara në të drejtën ndërkombëtare, por edhe në krijimin e ambientit të volitshëm për ekzistimin e sigurisë juridike.

Diskriminimi paraqet çdo formë të dallimit, përjashtimit apo kufizimit në gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe qytetarit. Që të konsiderohet se ekziston diskriminimi është i nevojshëm të ekzistojë veprimi apo aktiviteti i organeve, organizmave apo institucioneve që kanë autorizime të ushtrjnë funksione publike, baza e diskriminimit dhe pasojat nga shkaktimi i diskriminimit.

Trajtimet teorike dhe praktike mbi diskriminimin kanë bërë që sot të jenë të njohura disa forma të diskriminimit si: diskriminimi në bazë të ngjyrës së lëkurës, statusit familjar, moshës, gjinisë, përkatësisë nacionale dhe etnike, përkatësisë partiake, gjendjes sociale, pozitës në shoqëri, gjendjes shëndetësore, etj.

Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi

Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi është i vetmi autoritet kombëtar që ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkaqet e parashikuara në një listë të hapur bazash për diskriminim në sektorin publik dhe privat.

Mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Gjatë këtyre viteve të para të funksionimit, Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi ka arritur të ngritet si autoritet i vetëm kombëtar që kujdeset për parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Ky Komision për shumë çështje ka dhënë Mendime dhe Rekomandime për zbrapsjen apo tërheqjen e akteve apo veprimeve diskriminuese.

Qëndrimet e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, vlerësojmë se sot mund të trajtohen si burime formale subsidiare në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi. Për nga përmbajtja dhe rëndësia disa qëndrime të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, sot paraqesin mendime shkencore bashkëkohore në lëminë e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit.

KONKLuzion

Qytetarët gëzojnë disa liri dhe të drejta që njëkohësisht paraqesin një pushtet juridik të përbërë nga disa autorizime e që shërbejnë për nevojat personale dhe për përditshmërinë private dhe publike. Ndaj të drejtave të një qytetari ekzistojnë detyrimet e të tjerëve për të respektuar dhe mbrojtur ata përfshirë edhe detyrimet e organeve dhe institucioneve të sistemit shtetëror për të siguruar mbrojtje institucionale në rastet e shkeljeve të të drejtave në

fjalë. Cënimi i këtyre të drejtave paraqesin shkelje të normave juridike materiale. Titullari i të drejtave të cënuara ka të drejtë që të kërkoj mbrojtje institucionale.

Për mbrojtjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit ekzistojnë një sërë organesh dhe instituionesh shtetërore që kanë kompetencë lëndore për të proceduar, si gjykatat e rregullta, Gjykata Kushtetuese, Avokati i popullit, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi dhe trupat tjerë në shkallë kombëtare dhe në shkallë të vetqeverisjes lokale.

Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi është autoriteti i vetëm shtetëror në shkallë kombëtare që ka për kompetencë mbrojtjen nga diskriminimi në sektorin publik dhe privat në vend.

Bibliografia

1. Alajdin Alishani, “Studime nga e drejta e detyrimeve I”, Prishtinë, 2001;
2. Andrea Nathanaili, “E drejta civile e Shqipërisë”, Tiranë, 1974;
3. Ardian Nuni, “Leksione të së drejtës civile”, Tiranë, 2004;
4. Ardian Nuni, “Hyrje në të drejtën civile”, Tiranë, 2006;
5. Адам Лазаревиќ, “Основи на граѓанската судската постапка”, Парнична постапка, Shkup, 1986;
6. Alessandra Amato, Anna Costagliola, “Compendio di diritto processuale civile”, Maggioli Editore, 2012;
7. Blandine Rolland, “Procédure civile, 30 fiches de synthèse pour preparer les TD et reviser les examens”, Studyrama, 2007;

8. Borivoje Pozniq, “E drejta e procedurës civile”, Botimi i dytë, Prishtinë, 1980;
9. Cédric Tahri, Procédure Civile, Bréal, 2007;
10. Developing Anti-discrimination Law in Europe, The 27 EU Member States, Croatia, Former Yugoslav Republic of Macedonia and Turkey compared Prepared by Isabelle Chopin and Thien Uyen Do for the European Network of Legal Experts in the Non-discrimination Field November 2011 (Based on information current to 1 January 2011* Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2012;
11. Enver Hasani, “Ne bis in idem në procedurën kontestimore”, tezë e magjistraturës, Prishtinë, 1991;
12. Fuga Juliana, “E drejta civile”, pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2000,
13. Iset Morina/Selim Nikçi, Komentar – Ligji për procedurë kontestimore, Prishtinë, 2012;
14. Jenny Steele, “Tort law, text, cases and materials”, Oxford University Press, 2009;
15. Laura Caracciolo, “Diritto processuale civile”, 2006, Milano,
16. Nerxhivane Dauti, “E drejta e detyrimeve”, Prishtinë, 2002;
17. Paolo Franceschetti, “*La responsabilità civile*”, Maggioli Editore, 2009;
18. Petar Klariç&Martin Vedrish, “Gradjansko pravo”, Zagreb, 2006;
19. Stephen M. Gerlis,” Civil Procedure”, Paula Loughlin, London 2001; Spaiç Voislav, “Osnaovi gradjanskog prava”, Sarajevë, 1957;

20. Vincenzo Galatro, “Manuale operative di procedure civile”, 2008, Maggioli S.p.A., San Marino;
21. Ligji për pengim dhe mbrojtje nag diskriminimi i Maqedonisë;
22. Ligji për procedurë kontestimore i Maqedonisë;
23. Ligji për gjykatat i Maqedonisë.81 ; Kodi penal i Maqedonisë;
24. Rastet e zgjidhura në Gjykatën e Strazburgut;
25. Mata Estvez v. Spain (Ankimimi nr. 56501/00);
26. Glor v Switzerland (ankimi nr. 1344/04);
27. Case of Rasmussen v Denmark (Ankimimi nr. 8777/79);
28. Gas and Dubois v France, (Ankimi nr. 25951/07);
29. Horvath and Kis v Hungarisë (ankimi nr.1146/1);
30. Case of Koua Poirrez v. France (Ankimimi nr. 40892/98);
31. Marschall v Land Nordrhein- Westfalen, (Ankimimi C-409/95).

MENAXHIMI I PROKURIMEVE ME VLERA TE MESME PUNË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, SIPAS LIGJIT

04/L-042

MSc. Xhevdet Bushi, Cand.PhD

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është analizimi i procedurave të prokurimit sipas ligjit të prokurimit publik në Kosovë, si një fushë e gjerë dhe që kërkon përkushtim të madh. Shumë është marr si shembull i keq prokurimi se sa është marr për ndonjë shembull pozitiv në Republikën tonë, dhe përmes këtij punimi do të shihen qartas se çka është prokurimi, si është prokurimi dhe për çfarë shfrytëzohet prokurimi.

Menaxhimi i prokurimit në institucionet qëndrore, lokale në kompani publike dhe në organizata tjera buxhetore është shënjestra e çdo hetimi përkundër disa praktikave të këqija të aplikuara nga zyrtarë të ndryshëm që e kanë humbur reputacionin që e kanë zyrat e prokurimit për shkak të disa personave që kanë pasur interesa familjare, personale apo të ndryshme. Prokurimi i vlerave të mesme për Furnizime, shërbime dhe punë, përfshin një vend shumë me rëndësi, pasi që pjesa dërrmuese e autoriteteve kontraktuese, përfshin këto lloje prokurimesh. Varësisht fushës së prokuruar dallon edhe vlera e kontratës, pasi që furnizimet dhe shërbimet kanë një kufi më të ulët se sa prokurimi për punë, sepse dinamika e furnizimit dallon me atë të punimeve.

Fjalët kyçe: prokurim, vlera te mesme, të vogla dhe të mëdha, hapje e ofertave, vlerësim i ofertave.

HYRJE

Prokurimi është shkencë ose fushë, degë kryesore në administratën publike, pasi që shpenzimi i buxhetit pikërisht kalon përmes prokurimit. Në kohën e fundit prokurimi po keqpërdoret si fushë e korrupsionit nga mediet dhe organizatat e ndryshme apo partitë opozitare të qeverisjes qendrore apo lokale. Nuk mund të kalohet procedura pa rrespektuar rregullat ligjore, pa u bërë shpallje publike dhe pa bërë hapjen publike, leximin e çmimeve para ofertuesve dhe operatorëve ekonomik.

Klasifikimi i vlerave të prokurimit

Prokurimi si fushë e administratës publike në Republikën e Kosovës, rregullohet sipas ligjit 04/L-042 të shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.18/19 Shtator 2011, Prishtinë.

Klasifikimi i kontratave publike sipas vlerës së parashikuar¹⁵⁰:

1. Kontrata me vlerë ta madhe, konsiderohen:
 - a. Kontrata e furnizimit apo shërbimeve vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe se 125,000.00 €
 - b. Kontrata e punëve, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe se 500,000.00 €
2. Kontrata me vlera të mesme konsiderohen:
 - a. Kontratat e furnizimit apo shërbimeve, vlera e parashikuar e së cilës është më e madhe se 10,000.00 € ose më e vogël se 125,000.00 €
 - b. Kontrata e punëve, vlera e parashikuar e së cilës është më e madhe se 10,000.00 € por më e vogël se 500,000.00 €

¹⁵⁰ Ligji 04/L-042 faqe 19

3. Kontrata me vlerë të vogël konsiderohen, ato kontrata vlera e parashikuar e të cilave është më e madhe se 1,000.00 € por më e vogël se 10,000.00 €
4. Kontrata me vlera minimale, janë kontratat vlera e parashikuar e së cilave është më e vogël ose e barabartë me 1,000.00 € Dmth, më e madhe se 100.00 € por më e vogël se 1000.00 €

Procedurat me vlera të mesme

Procedurat me vlera të mesme janë ato procedura që kapin vlerën nga 10,000.00 € deri 125,000.00 € për furnizime, shërbime dhe punë dhe nga 10,000.00 € deri 500,000.00 € për punë. Projekti duhet të planifikohet dhe ti dërgohet AQP-së (Agjensioni Qendror i Prokurimit), çdo fillim viti fiskal. Çdo prokurim i kësaj natyre fillon, kur projekti në fjalë (projekti capital) është në listën e projekteve të aprovuara nga organi legjislativ i Autoritetit kontraktues (organ legjislativ në Pushtetin Lokal është asambleja komunale, kurse në buxhetin qendror është Kuvendi I Kosovës).

Procedurën për Autoritetin kontraktues e zhvillon apo menaxhon përgjegjësi apo menaxheri¹⁵¹ i zyrës së prokurimit i cili është shërbyes civil i certifikuar nga Instituti Kosovar për Administratë Publike (IKAP). Certifikata e vlefshme është për tre (3) vite.

Personi i cili punon në pozitën udhëheqëse duhet të ketë diplomë universitare. Pas mbarimit të trajnimit¹⁵² të zyrtarëve brenda 15 ditësh duhet t'i nënshtrohen provimit final për certifikim. Ai që nuk e kalon provimin herën e parë, i nënshtrohet testit herën e dytë, kurse nëse edhe herën e dytë nuk mund ta kalojë provimin, një vërejtje lëshohet nga IKAP, drejtuar Zyrtarit

¹⁵¹ Po aty fq.20, Neni 23 (zyrtaret e prokurimit), Ligji 04/L-042

¹⁵² Po aty fq.22, Neni 25 (Trajnimi I zyrtareve te prokurimit), Ligji 04/L-042

Autorizues (Kryetarit të komunës, kryeshefit ekzekutiv etj), që ti merret e drejtat nënshkrimit të kontratave dhe projektet t'i nënshkruaj dikush tjetër i certifikuar e jo ai që ska pas sukses për kalimin e provimit.

Njësia kërkuese bën kërkesë me shkrim për procedurën e prokurimit që prokurohet dhe deklaratën mbi disponueshmërinë e mjeteve dhe specifikimin teknik për projektin në fjalë, dhe më pastaj zyra e prokurimit e udhëhequr nga menaxheri i prokurimit bën punimin e dosjes së tenderit¹⁵³ dhe përgatitja e njoftimit për kontratë¹⁵⁴ dhe dërgohet në Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP) për publikim dhe në atë njoftim për kontratë të gjitha afatet do të caktohen (hapja e ofertës, takimi në vendpunishte etj). Vlerat e mesme kanë një afat 20 ditë kalendarike. Nëse kontrata nuk është me vlerë të madhe jo më pak se 10 ditë kalendarike. Autoriteti do të cakton afatin kohor për pranimit të tenderëve, përjashtohen prokurimet emergjente. Çdo kompani duhet bërë kërkesë me shkrim. Dorëzimi i dosjes së tenderit¹⁵⁵ për prokurimet e tilla duhet të dorëzohet jo më vonë se tre ditë pas pranimit të kërkesës së tillë. Çdo prokurim përzgjedhet¹⁵⁶ në bazë të kriterëve të përzgjedhjes sipas ligjit në fuqi, të caktuara në njoftim për kontratë, dmth. Brenda afatit 20 ditë dorëzohet oferta.

Hapja e ofertave – bëhet me komision në prezencë të përfaqësuesëve ekonomik të cilët kanë dorëzuar ofertën sipas nenit 58 të ligjit për prokurim publik. Me hapjen e ofertave do të regjistrohen çmimet e dhëna në ofertë për gjithë operatorët që kanë ofertuar, ku nënshkruajnë

¹⁵³ Po aty fq.23 Neni 27 Ligji 04/L-042

¹⁵⁴ Po aty fq.32 Neni 40, Ligji 04/L-042

¹⁵⁵ Po aty fq.35 Neni 48, Ligji 04/L-042

¹⁵⁶ Po aty fq.36 Neni 51, Ligji 04/L-042

procesverbalin e hapjes nga anëtarët e komisionit dhe operatorët ekonomik, por të vërtetuar nga menaxheri i prokurimit.

Vlerësimi i ofertave – brenda 96 orësh duhet të filloj vlerësimi për procedurën e prokurimit në fjalë. Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi bëhet sipas kritereve të përzgjedhjes:

- a.** Çmimi më i lirë me dokumentacion të përgjegjshëm,
- b.** Tenderi ekonomikisht më i favorshëm.

Pas vlerësimit të tenderit njoftohen të gjithë kandidatët për vlerësimin e procedurës dhe brenda dy ditëve bëhet pas dorëzimit të njoftimit në KRPP, kjo e fundit e bën publikimin e shpalljes së fituesit për 2 ditë, kurse nga momenti i publikimit afati për ankesë është 10 ditë nga moment i publikimit.

Në rast se ndodh operatori që është shpallur fitues të mos pranon nënshkrimin e kontratës, Autoriteti kontraktues detyrohet t’ia konfiskojë sigurimin e tenderit¹⁵⁷ që është 3-5% e vlerës së planifikuar të kontratës, dhe autoriteti kontraktues detyrohet të shpallë fitues kompanin e dytë sipas kriterit të vlerësimit.

Në rast se operatori i përzgjedhur për kontratë është i gatshëm apo pranon nënshkrimin e kontratës sipas Ligjit në fuqi 04/L-042, duhet të bëhet sigurimi i ekzekutimit¹⁵⁸ para nënshkrimit të kontratës. Shuma e sigurimit të ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës (sipas dinamikës). Sigurimi në fjalë bëhet nga banka apo institucionet e akredituara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), për lëshimin e sigurimeve të tilla.

¹⁵⁷ Faqe 40, Neni 57, Ligji 04/L-042

¹⁵⁸ Po aty fq.45 Neni 63, Ligji 04/L-042

Nënshkrimi i kontratave - bëhet në mes të Autoritetit kontraktues që e përfaqëson Menaxheri i Prokurimit dhe operatorit ekonomik. Kontrata bëhet me kushtet sipas ofertimit nga operatori ekonomik. Në kontratë përfshihen kushtet e veçanta dhe të përgjithshme, që këtu definojnë të gjitha kushtet e kontratës që bëhet fjalë..

Plani i menaxhimit të kontratës – ky plan nënshkruhet në mes të menaxherit të projektit të organizatës buxhetore (Komunës, Qeverisë, Agjensisë, Institutit etj) dhe Inxhinierit të kompanisë apo menaxherit të projektit të operatorit ekonomik.

Organi mbikqyres – përcjell projektin deri në pranimin e projektit dhe në fund të punimeve do të bëhet një raport me shkrim dhe do të krahasohen punët e kryera sipas paramasës dhe çdo mospërputhje duhet të analizohet dhe të definojnë punët e kryera dhe jo të kryera të minusohen (hiqen) nga paramasa dhe të del një raport final. Në fund të projektit bëhet pranimi teknik nga ekspertët e fushës përkatëse dhe çdo pozicion i paramasës analizohet për projektin në fjalë dhe në fund konstatohet se a pranohet apo nuk pranohet projekti.

Në rast se ka vërejtje do t'i jepet kontraktorit afat shtesë për eliminimin e defekteve dhe pas eliminimit do të del rishtas komisioni dhe do të bën pranimin teknik apo Inspektimin final dhe projekti në fjalë pranohet.

Pas pranimin duhet të bëhet një **raport final** për pranimin apo Inspektimin e punimeve dhe pas pranimin të raportit duhet të bëhet sigurimi i kualitetit të punimeve apo sigurimi i projektit të kryer për 10% të vlerës së kontratës (sipas kushteve të kontratës).Pas

kompletimit të të gjitha këtyre procedurave fillon pagesa e projektit në fjalë.

Buxheti

Buxheti është arka investuese për një organizatë buxhetore. Pra buxheti është çelësi kryesor për ekzekutimin e projekteve nga një organizatë buxhetore qoftë Qeveri, komunë, kompani publike. Buxheti burimin kryesor e ka nga: qeveria qendrore (thesari), të hyrat vetanake (tatimi në prone, taksat biznesore, taksat ekologjike, etj). Komunat¹⁵⁹ kanë buxhetet dhe financat e tyre për financimin e kompetencave të tyre. Buxheti komunal përbëhet prej të hyrave vetanake, garanteve nga Qeveria e Republikës së Kosovës, donacioneve dhe të hyrave të tjera. Buxheti dhe financat komunale rregullohet me Ligjin për financat lokale. Kërkesat thelbësore për menaxhimin publik financiar dhe përgjegjshmëri, të përcaktuara në legjislacionin qendror, zbatohen për të gjitha komunat.

KONKLUZION

Konkludojmë se duhet të amendamentohet ligji i prokurimit dhe të bëhet shkurtimi i afatit kohor nga 20 ditë në 10 ditë, për procedurat me vlera të mesme, për arsye se periudha e gjatë ndikon në humbjen e kohës për procedurat me vlera të mesme dhe në vënd që të fillojnë punët 10 ditë më herët për shkak të procedurës duhet të fillohen 10 ditë më vonë.

Lehtësimi i kriterëve të kërkuara për procedurat e prokurimit për operatorët ekonomik, që të ju jepet mundësi më shumë operatorëve për qasje në procedurat e prokurimit sepse konkurrenca ndikon që të kemi çmime më të përshtatshme për projektet e tilla.

¹⁵⁹ Ligji mbi financat publike 03/L-048

Rekomandojmë KRPP dhe Kuvendin e Kosovës që të amendamentohet ligji i prokurimit publik dhe të kenë më të lehtë si Autoritetet kontraktuese për zhvillimin e procedurës, poashtu edhe për operatorët ekonomik.

Literatura e shfrytezuar:

- Ligji mbi prokurimin publik 04/L-042;
- Ligji mbi financat publike 03/L-048;
- Ligji për vetëqeverisjen lokale 03/L-040;
- Rregullorja e prokurimit 01;
- Internet: krpp.rks-gov.net/prokurimi.

PËRDORIMI I GJUHËS SË PALËVE NË PROCEDUR DHE SHKRESAT E GJYKATËS

Msc.Shemsije Demiri

International University of Struga E-mail:sh.demiri@eust.edu.mk

Abstrakt

Parimi i gjuhës në procedurë është parim aktual dhe juridiko – politikisht i rëndësishëm. Përfshin dy aspekte edhe atë: parimi mbi gjuhën dhe shkrimin që do të jenë në pordorim zyrtar në gjykatë dhe parimi mbi të drejtën e pordorimit të gjuhës dhe të shkrimit të vet në procedurë përpara gjykatës.

Ne Republikën e Maqedonisë, e drejta e përdorimit te gjuhës është kategori kushtetuese dhe ligjore. Kjo do te thotë se gjithcka që ka te bëjë me përdorimin e gjuhëve rregullohet me Kushtetutën e RM-së dhe me ligjet si akte juridike të cilat i miraton Kuvendi i RM-së.

Nuk lejohet që përdorimi i gjuhës të rregullohet me akte nënligjore të cilat i miraton Qeveria e RM-së, organet e administrimit shtetëror apo pushtetit lokal.

Palët dhe pjesëmarsit e tjerë në procedurë, qytetarët e Republikës së Maqedonisë, të cilët flasin gjuhë tjetër zyrtare, e cila gjithashtu është gjuha zyrtare e tyre në RM, kanë të drejtë që në procedurë gjatë pjesmarjes në seancë dhe gjatë ndërmarjes në formë gojore të veprimeve të tjera procedurale përpara gjykatës të përdorin gjuhën e tyre

Palëve dhe pjesëmarësve në procedur do tu sigurohet përkthim gojor në gjuhën e tyre si dhe të bëhet përkthimi gojor dhe me shkrim i dokumentave që përdoren si prova për argumentim.

Edhe pse në Republikën e Maqedonisë Kushtetuta , Ligji për përdorimin e gjuhëve dhe Aktet tjera Ligjore në mënyrë precize dhe koncize përcaktojnë kurë dhe në çfar mase do të mund të përdoret gjuha shqipe në procedure kontestimore prap se prap aplikimi i saj është mjaft i kufizuar.

Fjalët çelës: Gjuha zyrtare e gjykatës , gjuha e palëve , shkresat e gjykatës, gjuha në të cilën flasin palët dhe shkelja e rregullave mbi gjuhën.

HYRJE

1.Parimi i përdorimit të gjuhës

1.1. Kuptimi

Parimi i gjuhës në procedurë është parimi aktual dhe juridiko – politikisht i rëndësishëm.Parimi përfshin dy aspekte edhe atë :parimi mbi gjuhën dhe shkrimin që do të jenë në pordorim zyrtar në gjykatë dhe parimi mbi të e pordorimit të gjuhës dhe të shkrimit të vet në procedurë përpara gjykatës.

2. Kushtetuta e R.M

Në pajtim me kushtetutën e republikës së Maqedonisë,në tërë territorin e RM-së dhe në mardhënjet e saja ndërkombëtare gjuha zyrtare është gjuha maqedone dhe shkrimi i saj qirilik(amandamenti V,paragrafi 1 KRM).Gjuha tjetër,të cilën e flasin së paku 20% nga qytetarët dhe shkrimi i sajë gjithëashtu është gjuhë zyrtare ashtu siç është përcaktuar me këtë nen (amandamenti V, paragrafi 2 KRM).Në organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonis gjuhë e ndryshme nga gjuha maqedone mund të përdoret në pajtim me ligjin (amandamenti V,paragrafi 5 KRM).

Gjuhë zyrtare e gjykatës duke marë parasyshë dispozitat e theksuara të amandamentit kushtetues V, metë cilat është zëvendësuar neni 7 i KRM,është e pakontestueshme se gjuha zyrtare në procedurën përpara

gjykatës është gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj qirilik. Kjo regull parimore është përcaktuar edhe në LPK, sipas të cilit procedura kontestimore zhvillohet në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik (neni 6, al 2 LPK).

Gjuha tjetër zyrtare, që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe shkrimij i saj, përdoret në procedur kontestimore në pajtim me këtë ligj (neni 6, al LPK). Dispozitat e theksuara janë me karakter parimor.

Konkretizimi i tyre është dhënë në LPK në kapitullin e pestë, në pjesën e cila është titulluar “Gjuha në procedur” (neni 93-97 LPK).

3. Ligji për përdorimin e gjuhëve

3.1. Ligji i vitit 2008

Marrëveshja Kornizë e Ohrit, për shkaqe të parashtruara më lartë, nuk arriti të rregullojë plotësisht përdorimin e gjuhës shqipe¹⁶⁰. Shqiptarët mendonin se nuk ishte rregulluar përdorimi i gjuhës shqipe, ndërsa maqedonasit vlerësonin se MKO-ja e kishte definuar ligjin, duke hezitur për ndryshime në ligjet ekzistuese. Por, insistimi i vazhdueshëm i shqiptarëve rezultoi i suksesshëm në vitin 2008, kur Ligji për përdorimin e gjuhës shqipe fitoi një status më të avancuar, pavarësisht se ende kishte mangësi në përdorim zyrtar krahas maqedonishtes. Në Ligjin për përdorimin e gjuhëve, të cilin e solli Parlamenti i Maqedonisë në vitin 2008,¹⁶¹ përmbante shumë elemente që pengonin përdorimin e lirshëm të gjuhës shqipe dhe e bënë atë me kapacitet jo të plotë

¹⁶⁰ Ligji për përdorimin e gjuhës që e flasin 20% e qytetarëve të RM-së (plotësim), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 100, 25 korrik 2011.

¹⁶¹ Sluzben vesnik na Republika Makedonija br.101 godLXIV sreda 13 avgust 2008.

Ligji i vitit 2008 për përdorimin e gjuhës shqipe ishte rezultat i bisedimeve intensive, të cilat sollën këto ndryshime në këtë ligj.

Konsiderohej se ishte rregulluar përdorimi i gjuhës shqipe në këto nivele:¹⁶²

- Në organet e RM-së, Parlamentin e Maqedonisë, Komunikimin e qytetarëve me ministrinë, Procedurat gjyqësore, Procedurat administrative , Zbatimin e sanksioneve, Zyrën e Avokatit të Popullit, Procesin zgjedhor, Deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve, Lëshimit të dokumenteve personale të qytetarëve, Mbajtjes së evidencës së amzës, Zbatimit të autorizimeve policore, Veprimtaritë radiodifuzive, Objektet e infrastructures, Vetadministrimin local, Financat, Ekonomi, Arsimit dhe shkencë, Kulturë, dhe, Institucione të tjera në pajtim me këtë ligj.

Ligji kishte lënë shumë mangësi, si pasojë e numrit të madh të problemeve që kishte gjuha shqipe, pasi që maqedonasit nuk e njohin si gjuhë të dytë. Kjo shtyri që shqiptarët vazhdimisht të kërkojnë ndryshime apo lëshime, siç parapëlqente të thoshte pala maqedonase. Defektet më të mëdha ishin në këto drejtime:

1. Në legjislacion (Parlament) gjuha shqipe nuk gjeti përdorimin adekuat
2. Në drejtësi dhe gjyqësi mbetën shumë paqartësi, pasi që pala qytetare mund ta përdorte gjuhën shqipe, ndërsa gjykatësi nuk mundej;
3. Në institucione të ndryshme s'kishte kritere se ku mund të përdorej gjuha shqipe;
4. Në procedurat e ministrive të ndryshme;

¹⁶²Po aty neni 2 .

5. Qytetari fiton të drejtën e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe, ndërsa zv. kryeministrat, ministrat, deputetët, nënkryetari/ja e Parlamentit nuk kanë të drejtë ta përdorin gjuhën shqipe, që krijon huti.

3.2.Ligji i vitit 2011 (i plotësuar)

Plotësim i ligjit për përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetadministrimit lokal,¹⁶³ i cili doli se ka defekte, edhe pse u promovua si i tillë që plotëson kërkesat e shqiptarëve, por koha tregoi se ka probleme dhe defekte, të cilat do të duhet të riparohen. Shqiptarët nuk pajtohen që të ketë kufizime kur bëhet fjalë për përdorimin e gjuhës shqipe dhe insistojnë me të madhe që gjuha shqipe të fitojë terren dhe përdorim të plotë në Republikën e Maqedonisë. Kështu, presioni i opinionit publik, i partive opozitare shqiptare, por edhe zërat brenda partisë shqiptare në pushtet ishin të atilla që kërkonin riparim të ligjit. Plotësim-ligji për përdorimin e gjuhës shqipe i vitit 2011, plotëson dhe rregullon përdorimin e gjuhës shqipe për funksionarët shqiptarë. Në këtë plotësim, i cili ka dy nene, përmirësohet përdorimi gjuhës shqipe për funksionarët shqiptarë.¹⁶⁴

4.Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë ,qytetarët të republikës së maqedonisë,të cilët flasin gjuhë tjetër zyrtare, e cila gjithashtu është gjuha zyrtare në RM, kanë të drejtë që në procedur gjatë pjesmarjes në seancë dhe gjatë ndërmarjes në formë gojore të veprimeve të tjera procedurale përpara

¹⁶³ Sluzben Vesnik na Republika Makedonija, br. 100, 25 LXVII, 25 juli 2011 .

¹⁶⁴ Ligji për përdorimin e gjuhës që e flasin 20% e qytetarëve të RM-së (plotësim), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 100, 25 korrik 2011.

gjykatës të përdorin gjuhën e tyre (neni 93,paragrafi 1 LPK). Këtyre palëve dhe pjesëmarësve në procedur do tu sigurohet përkthim gojor në gjuhën e tyre të gjithë asaj që parashtrohet në seanc, si dhe të bëhet përkthimi gojor dhe me shkrim i dokumentave që përdoren si prova për argumentim (neni 93,paragrafi 1 LPK). Këtyre palëve dhe pjesëmarësve në procedur do tu sigurohet përkthimi gojor dhe me shkrim i dokumentave që përdoren si prova për argumentim (neni 9,paragrafi 3 LPK)

Në pajtim me LPK, thirjet , vendimet dhe shkresat e tjera të gjykatës u dërgohen palëve dhe pjesëmarësve të tjerë në procedur në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik (neni 94,paragrafi 1 LPK).

Regulla e përdorur është regulla e përgjithëshme. Por, përveç kësaj regulle egzstojnë edhe një regull e posaçme, sipas së cilës, palëve dhe pjesëmarësve të tjerë në procedur, qytetarë të RM, gjuha e të cilëve është gjuhë zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase, thirjet, vendimet dhe shkresat e tjera gjyqësore dërgohen edhe në atë gjuhë (neni 94 paragrafi 2 LPK). Regulla e këtillë e posaçme është shprehje e zbatimit konsekuent të parimit mbi mundësinë e pordorimit në procedurë përpara gjykatës edhe të një gjuhe tjetër zyrtare e cila është e ndryshme nga gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj qirilik.¹⁶⁵

Palët dhe pjesmarsit tjerë në procedurë, paditë, ankesat dhe parashtresat e tjera i parashtrojnë në gjykatë në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik (neni 95, paragrafi 1 LPK). Nëpërmjet të kësaj dispozite është shprehur regulla e përgjithshme. Megjithatë, palët dhe pjesëmarsit e tjerë në procedurë, qytetarët të RM, gjuha e të cilëve është gjuhë zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj qirilik,

¹⁶⁵ Arsen Janeski, "E drejta procedural civile-e drejta kontestimore", Shkup 2009.

kanë mundësi që paditë, ankesat, dhe parashtrësat e tjera, ti parashtrojnë në gjykatë me gjuhën dhe shkrimin e tyre. Parashtrësat e ketilla gjykata i përkthen në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik dhe ua dërgon palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë (neni 95, paragrafi 2 LPK). Kjo rregull është përjashtim nga rregulla e përgjithshme dhe vlen vetëm për palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë, të cilët janë qytetarë të RM, gjuha e të cilëve është gjuha zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj qirilik.

Gjykata është e obliguar që ta këshillojë palën, respektivisht pjesëmarrësin tjetër në procedurë për rregullën, sipas së cilës në procedurën kontestimore mund të përdoret edhe gjuha tjetër zyrtare dhe shkrimi i saj të cilin e përdorin së paku 20% e qytetarëve, në pajtim me këtë ligj, si dhe për faktin se pjesëtari i bashkësisë, i cili si palë ose pjesëmarrës tjetër në procedurë nuk e kupton dhe nuk flet gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik ka të drejtë në përkthyes.¹⁶⁶ Kryetari i këshillit gjyqësor ose gjyqëtar individual është i obliguar që ta regjistrojë në procesverbal këshillën e gjykatës dhe deklaratën e palës, respektivisht të pjesëmarrësit tjetër në procedurë (neni 6, paragrafi 5 LPK). Pjesëtari i bashkësisë, i cili si palë ose pjesëmarrës tjetër në procedurë nuk e kupton dhe nuk e flet gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj qirilik dhe ka të drejtë në përkthyes (neni 6, al 4 LPK).

Nëse pala dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë deklarohen se do ta shfrytëzojnë të drejtën që procedurën gojore përpara gjykatës ta ndjekin në gjuhën e tyre me ndërmjetimin e përkëthyesit, atëherë gjykata përpara të cilës zhvillohet procedura është e obliguar që të sigurojë interpretues, i cili

¹⁶⁶ Ligji për përdorimin e gjuhës që e flasin 20% e qytetarëve të RM-së (plotësim), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 100, 25 korrik 2011.

gojarisht do ta përkthej atë që parashtrohet në seancë, por, gjithashtu edhe përmbajtjen e dokumentave, të cilat shfrytëzohen për të provuarit në seancë, por janë të përpiluara në gjuhën tjetër.

Shpenzimet për përkthim, për palët dhe pjesëmarrsit e tjerë në procedurë të cilët janë qytetarë të RM, që krijohen me zbatimin e dispozitave të LPK mbi të drejtën e pordorimit të gjuhës dhe shkrimit të vet bien ngarkesë të Buxhetin të RM (neni97 LPK).

5. Shkelja e rregullave mbi gjuhën

Mosrespektimi i dispozitave të LPK-së të cilët kanë të bëjnë me kërkesën e palës që në procedurë ti sigurohet interpretues, ndërsa gjykata në kundërshtim me dispozitat e LPK atë kërkes e ka refuzuar, dhe pala për këtë shkak ankohet, paraqet shkelje esenciale absolute të dispozitave të LPK (NENI 342,paragrafi 2,pika 8 LPK) Nëse shkelja është bërë, ndërsa pala në ankes nuk i referohet atij fakti atëher edhe pse ajo numrohet në grupin e shkeljeve esenciale absolute të dispozitave të procedurës, gjykata për të nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe vetëm përshkak të saj nuk do ta anulojë aktgjykimin. Në raste të këtillë, kjo shkelje fiton karakter të shkeljes esenciale relative të dispozitave të procedurës.

Gjykata e lartë duhet të anulojë vendimin e goditur pa hulumtuar se a egziston lidhje shkakësore ndërmjet shkeljes procedurale të rregullave mbi gjuhën dhe rezultatit të gjykimit meritator, edhe atëher kur pala nuk është ankuar për shkeljen e rregullave mbi pordorimin e gjuhëve.¹⁶⁷

“Vetëm sa për ilustrim, nëse në një procedurë gjyqësore në RM marrin pjesë një shtetas i Republikës së Kosovës me përkatësi kombëtare shqiptare dhe

¹⁶⁷ Arsen Janevski: E drejta procedural civile-e drejta kontestimore; Shkup 2009 fq 92.

një shtetas i RM-së po ashtu me përkatësi shqiptare, ata de facto dhe de jure, e kanë trajtimin e njëjtë, pra, mund të përdorin gjuhën shqipe përmes përkthyesit (sepse shteti i RM-së komunikon vetëm në gjuhën dhe shkrimin maqedonas), me atë dallim që shtetasi i RK-së vetë do t'i heqë shpenzimet e përkthimit, kurse shtetasi të RM-së, shpenzimet e përkthimit do t'ia heqë shteti”.

Në ish-Maqedoninë komuniste, udhëheqja e procedurës gjyqësore edhe në gjuhën shqipe ka qenë e përcaktuar me ligj si një e drejtë kolektive e shqiptarëve.

“Nga ana tjetër, sot në praktikë shpesh ndodhin situata tragji-komike, sikurse në një proces gjyqësor edhe pse të gjithë pjesëmarrësit janë shqiptarë, si: gjyqtari, avokati, prokurori publik, eksperti mjeko-ligjor, i akuzuari, procesmbajtësi, dëshmitarët, etj., megjithatë të gjithë ata komunikojnë në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj?”.

Paradoksi, ka të bëjë me faktin se shqiptarët nominalisht nuk i gëzojnë as edhe të drejtat gjuhësore që Konventat evropiane u garantojnë minoriteteve.

“Shqiptarët në RM nuk i gëzojnë madje, edhe të drejtat në bazë të statusit të minoritetit, si për shembull, Konventa evropiane mbi gjuhët regjionale dhe minoritare e cila i obligon vendet anëtare të KE-së (ku bën pjesë edhe RM) të sigurojnë që gjykatat në procedurat penale, civile dhe administrative, me kërkesë të njëjës palë, të realizojnë procedurën edhe në gjuhën regjionale ose minoritare”¹⁶⁸

Çështje shumë e rëndësishme gjatë zhvillimit të këtyre procedurave është që qytetarëve dhe personave juridik, pa marrë parasysh në çfarë cilësie

¹⁶⁸ <http://zeri.info/aktuale/8978/gjuha-shqipe-hale-ne-sy/>.

paraqiten (kërkues, i dëmtuar, paditës, i akuzuar), t'u garantohen dhe mundësohen të gjitha të drejtat. Krahas standardeve përgjithësisht të pranuar: pozitë të barabartë dhe jodiskriminuese ndaj palëve, ofrimi i ndihmës juridike për palët e paarsimuar dhe të tjerë, shumë shpesh paraqitet edhe e drejta për përdorim të gjuhës amtare, respektivisht gjuhës të cilën e përdor dhe kupton qytetari. Kjo është e nevojshme sepse qytetarët ndjehen më të rehatshëm kur komunikojnë me organet në gjuhën e tyre amtare, respektivisht në gjuhën të cilën më së miri e kuptojnë dhe flasin. Të shprehurit e gabuar në formë të shkruar (për shembull, kërkesë me shkrim për ndarjen e të drejtës për ndihmë sociale) ose në mënyrë gojore (për shembull, diskutim gojor në procedurë për dëmshpërbllim) nga ana e palës, për shkak të njohjes së dobët të gjuhës, mund të çojë deri në vërtetim të gabuar të fakteve, e me këtë edhe deri te mosrealizimi i të drejtës, respektivisht deri në imponimin e obligimit.

E drejta e të akuzuarit, dëmtuarit, paditësit privat, dëshmitarëve dhe personave të tjerë të cilët marrin pjesë në procedurën penale, të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, gjatë paraqitjes para veprimeve gjyqësore parahetuese, hetimore dhe të tjera dhe gjatë shqyrtimit kryesor, si dhe në procedurën e ankesës, ta përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre. Gjykata do të sigurojë përkthim gojor të asaj që deklaron personi, respektivisht të tjerët, si dhe përkthim të shkresave dhe materialit tjetër të shkruar dëshmues.

Gjykata do të sigurojë përkthim me shkrim të materialit i cili është me rëndësi për procedurën ose për mbrojtjen e të akuzuarit;

- E drejta e palëve të tjera, dëshmitarëve dhe pjesëmarrësve në procedurë për ndihmë të përkthyesit pa pagesë, nëse nuk e kuptojnë ose flasin gjuhën në të

cilën zhvillohet procedura. Personi do të njoftohet për të drejtën për përkthyes.

Përkthimin e bën përkthyes gjyqësor;

- E drejta e qytetarëve për t'i drejtuar paditë, ankesat dhe parashkresat e tyre në gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Parashkresat e tilla gjykata i përkthen dhe i dorëzon deri te palët tjera në procedurë;

- Detyrë e gjykatës është që ftesat, vendimet dhe dokumentet tjera të shkruara t'i referon në gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, ndërsa qytetarëve të cilët flasin gjuhë tjetër zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, u'a dorëzon edhe në atë gjuhë. Të akuzuarit, i cili është në paraburgim, në vuajtje të dënimit ose në shërim psikiatrik të detyrueshëm dhe ruhet në ent shëndetësor, i dorëzohet përkthim nga këto parashkresa në gjuhën me të cilën është shërbyer në procedurë.

Të akuzuarit i cili nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, përkthimi nga aktgjykimi i dorëzohet në gjuhën me të cilën është shërbyer në procedurë;

- E drejta e mohimit të aktgjykimit për shkak të shkeljes së procedurës nëse në të nuk është respektuar obligimi për përkthim në të gjitha pjesët e saj.

Nëse në procedurën administrative dëshmitari nuk e njeh gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, do të merret në pyetje me ndihmën e përkthyesit. Nëse një dëgjim në procedurën administrative zhvillohet me ndihmë të

përkthyesit, në procesverbal do të shënohet në cilën gjuhë ka folur pala dhe kush ka qenë përkthyes.¹⁶⁹

Pse është me rëndësi e drejta për përdorimin e gjuhës në procedurat të cilat zhvillohen para organeve gjyqësore ose administrative?

Çështje shumë e rëndësishme gjatë zhvillimit të këtyre procedurave është që qytetarëve dhe personave juridik, pa marrë parasysh në çfarë cilësie paraqiten (kërkues, i dëmtuar, paditës, i akuzuar), t'u garantohen dhe mundësohen të gjitha të drejtat.

Kjo është e nevojshme sepse qytetarët ndjehen më të rehatshëm kur komunikojnë me organet në gjuhën e tyre amtare, respektivisht në gjuhën të cilën më së miri e kuptojnë dhe flasin.



Hulumtimi është realizuar në pyetësor të standardizuar, në të cilin janë respektuar specifikat demografike të popullatës:

- (struktura gjinore, grupmoshat, niveli i arsimit, statusi i punësimit).
- Që të fitohen rezultate sa më të besueshme dhe njëherit të përfshihen sa më shumë qytetarë, hulumtimi është bërë duke i ndarë anketat, respektivisht janë përdorur dy lloje pyetësorësh,
- 1. një pyetësor është përpiluar i posaçëm për të punësuarit në gjykatë dhe administratë kurse:
- 2. pyetësori tjetër i përfshin qytetarët e rëndomtë.


Karakteristikat të anketës së realizuar me qytetarët

¹⁶⁹ <http://soros.org.mk/dokumenti/vodic-alb-za-web.pdf>


Scientific Challenges for Sustainable Development




Sipas mendimit tuaj në cilat institucione më lehtë përdoret gjuha shqipe si gjuhë zyrtare?




Sipas mendimit tuaj në cilin rast më shpejt do të merrni përgjigje me shkrim nga institucioni përkatës?



Sipas mendimit tuaj sa është administrata e aftësuar mjaftueshëm që tu përgjigjet kërkesave tuaja, kur duhet përdorur gjuha shqipe si gjuhë zyrtare?



Sipas mendimit tuaj kush nga këta faktorë e pengon jetësimin e gjuhës shqipe në institucione shtetërore si gjuhë e dytë zyrtare në RM?



KONKLUZION

Gjuha paraqet si një ndër shenjat themelore të secilit popull. Në të vërtetë, gjuha është një ndër karakteristikat, ndoshta edhe më e rëndësishmja, në bazë të së cilës edhe dallohen popujt. Me ane të gjuhës njerezit komunikojnë dhe kuptohen mes vete.

Gjuha lehtëson jetën e përditshme dhe u mundëson qytetarëve t'i realizojnë të drejtat dhe liritë e tyre themelore.

Alfabeti vetëm ndërlidhet me gjuhën, respektivisht ajo është forma me ane të së cilës shprehet të folurit. Gjuha luan rol, më pak kontradiktor, të dyfishtë.

Nga njëra anë, homogjenizon respektivisht shërben si kanal për komunikim ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve. Nga ana tjetër, diversifikon, respektivisht ndan qytetarët sipas vijës etnike, kulturore dhe politike. Nëse një gjuhë nuk praktikohet, ekziston rreziku i zhdukjes së saj!

Edhe pse në Republikën e Maqedonisë Kushtetuta, Ligji për përdorimin e gjuhëve dhe Aktet tjera Ligjore në mënyrë precize dhe koncize përcaktojnë kur dhe në çfarë mase do të mund të përdoret gjuha e shqipe në procedurë, prap se prap aplikimi i saj është mjaft i kufizuar.

Kjo ishte edhe teza fillestare e punimit e cila në fund edhe u konfirmua.

Provë për këtë është edhe vetë anketa e realizuar me qytetarët e intervistuar.

Literaturë e shfrytëzuar:

- Arsen Janevski, “E drejta procedural civile-e drejta kontestimore”, Shkup 2009;
- Faik Brestovci, “E drejta e procedurës civile” ;
- Galiç A., :Ustavno civilno procesno pravo: , Ljubljana, 2004;
- Georgievski S, :Gragjansko procesno pravo:, Skopje, 2000;
- Kushtetuta e RM-së, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 52/91 ;
- Marrëveshja kornizë për mbrojtje të pakicave kombëtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 11/97;
- Ligji për përdorimin e gjuhëve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 101/08;

Scientific Challenges for Sustainable Development

- Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 91/08;
- Ligji për përdorimin e gjuhës që e flasin 20% e qytetarëve të RM-së, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 101, 13 gusht 2008;
- Ligji për përdorimin e gjuhës që e flasin 20% e qytetarëve të RM-së (plotësim), Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 100, 25 korrik 2011.

BASHKIMI EUROPIAN DHE DILEMAT E PAZGJIDHURA BALLKANIKE

Shqipe Kastrati

PhD candidate - Internatinal University of Struga E- mail:eagle59-
1@live.com

Abstract

The European Union is a “sui generis” organization (a special type), which one is evolving over the time. This organization is a conglomerate of nations which have a single goal, the progress of their country, in principle, always working through the advancement of the organization in general. Ways of organizing and the functioning of the EU, with some modifications, the weathered dignity, the challenge of growth. However, the changes can only move forward.

Given this fact, we refer to the most important challenge of Europe and his Constitution. Ratification of the Treaty of Lisbon cut “troubled souls” in the EU since it is known that the treaty contained over 70% of the content of the European Constitutional treaty. We can say that the European politics, this time has passed the test of challenging which was submitted to the mark the continuation of reforms in contradiction with their slowdown and stagnation.

With the beginning of the democratic development in Eastern Europe, the Albanians were the first who asked for their right to self-determination. For European recognition of the new republic crucial was status of a Republic and the combination of the principles of the concept of “European” and that “classic”.

When there was not stability in Balkans, when the war in former Yugoslavia started; Slovenia, Croatia, Bosnia and Herzegovina, Kosovo was not independent, when the war began in the Presheva Valley, nor, when the war started in Macedonia, Kosovo was not independent. In a conclusion the answer to this wrong perception would be: the independence of Kosovo has stabilized the Balkans.

Key words: European Constitution, Treaty of Lisbon, legal-constitutional status.

HYRJJE

Bashkimi Europian si një organizatë e llojit të veçantë që u krijua nga gjashtë shtete e më vonë duke u rritur gradualisht në një konglomerat shtetesh vazhdimisht është në evoluime me një qëllim të vetëm, përparimin e tyre duke punuar gjithnjë në parim përmes avansimit të organizatës në përgjithësi.

Administrimi i kompleksitetit në rritje të BE-së është i rëndësishëm në vetvete, si një mjet për t'a bërë BE-në me konkurrencë dhe gjithashtu përse i përket afrimit të vendeve të tjera kandidate. Kjo e dyta ka lidhje me funksionimin e një demokracie të plotë, e cila kërkon përgjegjësi dhe pushtet të qytetarëve. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të BE-së, me disa modifikime, e përballoj denjësisht, sfidën e rritjes.

Gjatë dekadës së fundit strategjia e Bashkimit Europian për Ballkanin përfundimor është fokusuar në stabilitet në rajonin, në bazë të një koncepti të kurtë të sigurisë kjo strategji ishte si pasojë e drejtëpërdrejtë e mospushtimit për ndalimin e ushtrimit të dhunës në vitin 1998 në Kosovë.

Europa ka një strategji të kuartë sa i përket integritit të rajonit në përgjithësi, e në veçanti të Kosovës, sepse ajo nuk është dhe nuk mund të mbetet si një "NJOLLË E ZEZË" në Ballkan.

BASHKIMI EUROPIAN DHE BALLKANI

Ballkani Perëndimor është hapësira më e paparashikuar, shtete me probleme etnike, varfëri dhe histori të kontestuar, me probleme shekullore. Këto shtete ballkanike kaluan periudhën komuniste. Shtete këto që pranuan sistemin shumë partiak dhe pluralizmin politik në vitin '90.

Lufta etnike dhe problemet e shumta u bartën edhe pas fitores së sistemit shumë partiak dhe ekonomisë së tregut e vetmja shprehje e Ballkanit ishte dhe mbetet integritet në BE dhe strukturat euro-atlantike përndryshe ky region s'po mundet të ndahet nga betejat e nacionalizmit dhe historive dhe ndodhive shekullore në të cilat kanë kaluar.

Megjithatë është arritur një lloj stabiliteti ndër-rajonal, si dhe njëfarë përparimi ekonomik, gjendja e përgjithshme në Ballkanin Perëndimor mbetet e ndërlikuar. Gjeografia politike mbetet për t'u sqaruar; statusi përfundimtar i Kosovës është një çështje mjaft polemike. Bosnje-Hercegovina është ende e përfshirë në paqartësi në lidhje me ekzistencën e saj si një njësi politike dhe është mjaft e brishtë ekonomikisht për shkak të varësive të saj ekstreme prej ndihmës nga jashtë. Pjesa më e madhe e rajonit vazhdon të vuajë prej papunesisë së lartë dhe "largimit të trurit". Niveli i krimeve është i lartë dhe korrupsioni mbizotëruar. Masat e kursimeve dhe investimet janë të ulta dhe rindertimi i infrastrukurës është duke ecur ngadalë. Në fund të fundit, BE duhet të jetë më e përfshirë në "trainimin" dhe ndihmën për vendet e Ballkanit Perëndimor, ndërsa ata përpiqen të arrijnë një zhvillim ekonomik të vazhdueshëm dhe të përmirësojnë institucionet e

tyre. Per te qene te paanshem, duhet thene se BE tashme ka nje prani te shumanshme ne rajon, duke perfshire nje rol paqeruajtes. Bosnje-Hercegovina eshte duke siguruar testimin e aftesise se BE-se per te vepruar fuqishem dhe ne menyre te efektshme ne rast nevojje. Megjithate, disa mesime duhen patur parasysh ne menyre qe te arrihen rezultate me te mira.

Serbia ballafaqohet me probleme të brendshme, korrupsion, sistemin te drejtësisë jo të pavarur, me papunësi të proklamuar 22%, realisht varfëria ekstrem ne këtë shtet vlerësohet mbi 10%0. Statistikat zyrtare flasin për emigrimin nga ky shtet për ne vendet e BE e gjetiu, përndryshe vendi merret me shumë me politik se sa me ekonomin e tregut, lojërat politike, inatet ndaj fqinjëve, betejat ne mes vet politikanëve serbë s'kanë të ndalur, atje mbretëron një klimë nacionaliste në pushtet duke marr përpara çdo gjë, pushteti politik kurajues dhe nxitës për të bërë probleme me fqinjët, nuk pritojn fare në secilën situatë të dërgon forca policore dhe ushtarake në secilën situatë pak a shumë kritike apo fare sa për te demonstruar se na jena këtu.

Ekonomia serbe e trazuar, e pashpresë ka nxit këtë shtet të mos e lëshojë politiken prej dore edhe pse ekonomia ende mbetet e pa shpresë për të u zhvilluar dhe rritur bruto produkti vendor. Gjyqësia e katandisur nga politika, emërimet e gjyqtarëve janë problemet kryesore për këtë shtet. Nuk e kanë mirë më asnjë shtet ne regjion as nuk janë të interesuar që seriozisht të punojnë për paqe, janë të prirë të bëjnë gracka, shantazhe shteteve regjionale, kacafyten me fjalë politike duke qar njeri tjetrit selame si të ishte koha e viteve te hershme historike.

Politika serbe ende bënë politik me dy karrika njëren ne Moskë e tjetrën në Bruksel përderisa shteti serb kishte ruajt raporte miqësore me

Maqedoninë, shtet që nuk ka stabilitet, edhe këtë shtet e katandisur korrupsioni i vrazhdët që ka varfëruar qytetarët e Maqedonisë, papunësia mbi 26% pastaj monopol ekonomik, përfitime të larta nga partia në pushtet e Gruevskit, dy vjet fundit kupa është mbush në këtë shtet me kriminalitet ekonomik më kontroll të parasë publike me biznese të mëdha partiake, duke kontrolluar doganat, mediat dhe duke inskenuar raste konflikte etnike dhe fshehur para qytetarëve maqedonas biznesin dhe krimin e organizuar, edhe populli maqedonas është lodhur nga një pushtet përfutës i cili i mori ardhmërinë e tij duke u fshehur prapa kartave imagjinare nacionaliste të rrezikimit të shtetit.

Atje tash e sa vjet mbretëron klimë biznesi por shumë me pak rreziqe etnike, çdo herë kur është rrezikuar biznesi dhe lufta në mes maqedonasve është rrit atëherë zbrazjet janë bërë mbi shqiptarët , kështu ndodhi herën e fundit, situatë e pas shpjegueshme interesante dhe kontroverse kishte ndodhur. Rasti i Kumanovës pa kërkesa politike të reja të shqiptarëve autokton dhe pa ndonjë kërkesë tjetër apo paralajmërim ndodhi konflikti dhe askush nuk është fitues atje, vetëm humbës të gjithë janë në konfliktin e inskenuar.

Perëndimi e donë ndryshimin politik edhe shqiptarët e Maqedonisë, parti tjera të vijnë në skenë pro perëndimore dhe jo të nxitur apo të shqetësuar nga problemet shekullore të cilat do të zgjidhen me një klasë të re politike edhe në domenin e maqedonasve edhe të shqiptarëve atje. Ndryshime tjera priten të ndodhin në këtë shtet interesant dhe shtet i maketeve plastike.

As Kosova nuk është në gjendje të shendosh demokratike , gjithashtu me probleme të mëdha të korrupsionit, pa sigurisë, ikjes së qytetarëve ,

fshehja dhe heshtja e intelektualëve, pa aftësia e njerëzve për të gjet një model të stabilitetit demokratik, ku qytetari do të nxjerr interesin e duhur demokratike ku ne emër t ë tij nuk mund të flasë secili i njeri i pasuruar pa bazë ekonomike dhe me drejtësi të politizuar, shërbim civil e publik partiak e familjar, edukim jo cilësor, Gjykatë kushtetuese partiake e politike dhe ambasada partiake e klanore e miqësore, të gjitha poret e jetës institucionale gjithashtu kontrollohen nga politika, papunësia mbi 45% zyrtarisht shkruan vetëm 30.1%, me sektor privat te lodhur.

Një mësim është se spiranca e dukshme dhe e fortë e BE-së është vendimtare për stabilitetin e rajonit dhe zhvillimin ekonomik të tij. Një tjetër është se qëndrimi i BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor nuk duhet bazuar mbi idenë e një fushë loje ekonomike. Dallimi që përmendet shpesh ndërmjet tregtisë "së drejtë" dhe "të lirë" është i zbatueshëm këtu. Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë nevojë për institucione të forta, të cilat do të sigurojnë qeverisje të efektshme të sektorit privat dhe publik. Përpjekjet vendase kanë një rol të rëndësishëm në lidhje me këtë. Praktikisht, duhet bërë më shumë.

Rajoni ka nevojë për asistencë nga BE-ja, e cila do të ndihmojë që të mposhten kurthet e papunësisë së lartë, përkeqësimi i lidhjes sociale dhe kriminalitetit në rritje. Që zhvillimi të rrënjohet, ndihma financiare e planifikuar mirë duhet të shoqërohet me marrëveshje tregtare të përshtatshme (marrëveshje të preferencës), projekte të infrastrukturës rajonale (rruge, ura, rrjete të energjisë elektrike dhe aeroporte) dhe masa për të stimuluar investimet e huaja të drejtëpërdrejta drejt vendit. Po kështu, bashkëpunimi i fortë -ndërrajonal dhe me autoritetet i BE-së është i nevojshëm për të luftuar kriminalitetin.

Nuk ka nevojë të përmendet se zhvillimi ekonomik i Ballkanit Perëndimor do të forcojë gjithashtu luftën kundër terrorizmit. Nga njëra anë rendi i dites i Europës është me shumë plane dhe gjithnjë e më tepër përfshin dinamikat politike dhe ekonomike në Ballkanin Perëndimor.

Ballkani Perëndimor akoma duket si një përzierje shpërthyes shtetesh të dobëta, para-shtetesh dhe protektoratesh të tashme apo të ardhshme që luftojnë me vështirësi të madhe për të ruajtur standarde dhe për të përparuar drejt stabilitetit dhe integritetit evropian. Për më tepër, ne nuk kemi një ide të qartë se sa quasi-shtete ekzistojnë në Ballkan dhe deri në çfarë mase funksionojnë. Shpërthimi i dhunës kohët e fundit në Kosovë bëri që shumë të mendojnë se rajoni përsëri po del jashtë kontrollit. E vërteta është se beteja nuk ka përfunduar. Ekziston një nevojë e menjëhershme për ta kthyer vështrimin tek kjo situatë, por shikimi duhet bërë me sytë e popujve që jetojnë në rajon. Në vazhden e angazhimit të tij në Evropën Juglindore, komuniteti ndërkombëtar është sjellë sikur të kishte "zgjidhjet e duhura" dhe është përballur me problemin duke imponuar këto zgjidhje. Me këtë qasje nuk mund të vazhdohet më tej. Kjo qasje krijon një krizë legjitimiteti dhe lehtëson rritjen e populizmit anti-Perëndimor. Kjo është një formulë e dështuar. Rajoni nuk është në gjendje të arrijë prosperitet dhe stabilitet të qëndrueshëm pa mekanizmat e integritetit rajonal. Në të njëjtën kohë është e qartë se shtetet jofunksionale dhe protektoratet, që dominojnë rajonin, nuk janë në gjendje për integrimin e Ballkanit në rrjedhat evropiane. Tranzicioni nga një shtet i dobët në një shtet anëtar, është detyra kritike me të cilën përballen vendet e Ballkanit sot.

Organizimet e sotme kushtetuese as nuk funksionojnë, as nuk janë objekt i një vlerësimi të mirëfilltë kritik. Ato të çojnë në një gjendje fluksi, por jo në një tranzicion të suksesshëm. Këto marrëveshje u hartuan për ti

dhënë fund krizave - përgjithësisht konflikteve të armatosura - duke trajtuar pikërisht të drejtën e këtij apo atij shteti për të ekzistuar. Por këto organizime kushtetuese kanë mënjanuar dhe kanë lënë shumë çështje kritike të pazgjidhura që kanë të bëjnë me aftësinë e shteteve për administrim efikas, duke përfshirë edhe monopolin e tyre për ruajtjen e rendit dhe vjeljen e taksave. Për më tepër, ato, në një farë mase, janë imponuar nga komuniteti ndërkombëtar, dhe si pasojë, publiku i sheh ato me një farë dyshimi. Kjo është më e evidente në Bosnjë dhe Kosovë, ku aktorët ndërkombëtarë zotërojnë pushtetin ekzekutiv. Në Bosnjë, influenca e mbetur e aktorëve nacionalistë është një tipar i përhershëm. Në Kosovë, aftësia e autoriteteve qendrore nuk është provuar dhe nuk mund të provohet, përse kohë aktorët ndërkombëtarë luajnë rolin përcaktues në vendimmarrje. Është tepër e rëndësishme që përpjekjet ndërkombëtare për forcimin e strukturave qeverisëse në Ballkan, të intensifikojnë si angazhimin, dhe po ashtu të rrisin transparencën. Me qëllim që kjo të ndodhë, vendet e rajonit duhet të mësojnë të ndihen direkt të angazhuar në transformimet e shoqërisë. Ashtu siç kemi thënë më lart, kushtetutat post-Jugosllave dolën nga luftërat për të drejtën e ekzistencës së shteteve të Ballkanit. Tani është koha të përqendrohemi në proceset e reformave dhe në procesin e bindjes së qytetarit të thjeshtë për nevojën e këtyre reformave. Nga njëra anë, kjo do të thotë rindërtim i administratës publike dhe rregullime makro-ekonomike që do të bëjnë të mundur që shteti të ofrojë shërbimet e tij me efikasitet. Nga ana tjetër, ka një nevojë urgjente për të thelluar procesin e demokratizimit për të siguruar përmirësime në përfaqësimin politik.

Vendet e Ballkanit Perëndimor duan që nesër të jenë anëtare të Bashkimit Evropian, por komuniteti ndërkombëtar sot e kësaj dite është akoma në rajon. Si efikasiteti, ashtu edhe legjitimiteti i prezencës së tij do të varen nga sa e suksesshme do të jetë BE-ja në kthimin e kësaj perspektive

anëtarësie në një motivim të efektshëm për reforma politike dhe ekonomike. Procesi i anëtarësimit presupozon ekzistencën e shteteve funksionale dhe që kanë dëshirën e aftësinë për te iu përgjigjur mekanizmit të kondicionalitetit.

Kjo nuk është arritur akoma në Ballkanin Perëndimor. Kjo do të thotë se BE-ja ka përpara një dileme të madhe - nuk duhet të dekurajojë vendet e Ballkanit Perëndimor në aspiratat e tyre, por as nuk duhet të ulë kriteret e saj për anëtarësim.

Kërkohet një strategji specifike për të tejkaluar këtë dilemë dhe Brukseli duhet ta diskutojë këtë si me qeveritë, ashtu edhe me komunitetet e rajonit. Në qoftë se do të gjejmë një strategji të zgjuar, më në fund ne do të mundim të gjejmë kufirin midis dështimit dhe suksesit në Evropë.

KONKLUZION

Perspektiva e integritimit në EU të kësaj pjese të kontinentit ishte një çështje tabu deri më 1999. Dhe vetëm në Samitin e Selanikut në qershor 2003 shteteve të Ballkanit Perëndimor iu ofrua një mundësi reale për tu bërë anëtare. Është tepër e rëndësishme që popujt e rajonit ta kuptojnë këtë fakt - që pavarësisht nga sa duket,- ata janë në tranzicion, jo në fluks.

Është e nënkuptueshme se procesi i zgjerimit varet nga aspirata që ofron Brukseli zyrtar për vendet e Ballkanit, por edhe nga gatishmëria e vendeve të Ballkanit për t'i plotësuar kriteret e kërkuara në procesin integruar. Asnjëra palë, as Brukseli dhe as vendet e Ballkanit, nuk e marrin me përkushtim procesin e zgjerimit. BE-ja nëpërmes kriterëve të cilat i bën më të ashpra çdo vit, dëshiron që procesi i zgjerimit në Ballkan, pas pranimit të Kroacisë, të vazhdojë kur të rregullohen “disa punë brenda shtëpisë”, kryesisht të karakterit ekonomik dhe të sigurisë, por edhe për shkak të problemeve të brendshme politike, migracionin në rritje etj. Krerë shtetesh

dhe qeverive të vendeve anëtare të BE e kanë përmendur vitin 2020 si mundësi për vazhdimin e procesit të zgjerimit në Ballkan, por deri atëherë nëpërmes instrumenteve të paranëtarësimit Brukseli synon që të mbajë gjallë aspiratën integruese.

Nga ana tjetër, krerët e shteteve në Ballkan me politikat e tyre, sidomos në vitet e fundit, kanë dëshmuar se procesi i aderimit në familjen evropiane, është në plan të dytë. Nëse nuk joshen me projekte investuese në vitet e ardhshme, euroskepticizmi në klasat politike të këtyre vendeve, por edhe tek qytetarët e rëndomtë, do të rritet.

Edhe pse BE pati mjaft suksese në zgjerimin e zonës së stabilitetit e të paqës në Europë, kur bëhet fjalë për Ballkanin arritjet janë mjaftë modeste në këto dy dekadat e fundit.

Bibliografia

1. Anton Bebler (2008)-Hyrje në integrimet Evropiane. Prishtinë, K.U. Victory;
2. Bashkim Rama "Ballkani pas rënies së murit të Berlinit" M&B, Tiranë, 2013;
3. Lisen Bashkurti (2006) Evropa Ballkani dhe sfidat e Kosovës, Tiranë, GEER;
4. Lisen Bashkurti (2008) Krizat Nderkombëtare. Tiranë;

Nga faqet e internetit:

- 1) <http://www.trt.net.tr/shqip/ballkani/2015/04/23/zgjerimi-i-be-s%C3%AB-n%C3%AB-ballkanin-per%C3%ABndimor-%C3%ABsht%C3%AB-%C3%A7%C3%ABshtje-madhore211692>;
- 2) <http://botasot.info/opinione/405922/ballkani-i-trazuar/>;
- 3) <http://koha.net/?id=27&l=54143>;

International University of Struga

4) www.al.com.mk;

5) www.balkanweb.com;

6) www.euinkosovo.org;

7) www.gazetaexpres.com.

VEPRIMTARIA KËRKIMORE AUSTRO-HUNGAREZE NE SHQIPËRI 1900-1918.

EDUART BEGOLLI

Shkolla e Mesme e Lartë “Ali Feto” Devoll ,Shqipëri Bilisht, Korçë,
Shqipëri Email: eduartbegolli@yahoo.com

Abstract

Austro-Hungarian research activity in Albania in the early twentieth century is a topic of interest not only to show the continuity of interest to researchers Austro-Hungarian problems of Albania and the Albanians but also because the Austro-Hungarian empire in this time has been one of the major powers interested in the Balkans in general and Albania in particular.

In my thesis is given second priority to the problem of making a brief overview of the results of scientific research in the framework of the Institute of Balkan Studies in Sarajevo (1908-1918) and the Royal Imperial Austro-Hungarian Academy of Sciences in Vienna.

Of interest in this work are the thoughts about this research activity which, as expressed in the material prepared has two purposes: 1-purely scientific; 2- inflammatory expansionist policy towards Albania dualistic Monarchy

The material contains 3 issues.

1- The main duties of researchers A-H in Albania at the beginning of the century. XX

2 The results of scholarly research activity AH in Albania at the beginning of the century. XX

3- Some thoughts on scholarly research activity Austro-Hungarians in Albania in 1900-1918.

Keywords: Albanology, peaceful penetration, scientific research activities, Balkan policy of Austria-Hungary, imperialism Austro-Hungarian open in Albania.

HYRJE

Pas vitit 1867 ku Austria mbeti jashtë Bashkimit Gjerman dhe njëkohësisht humbi zotërimet e saj në Itali vëmendja e Austro-Hungarisë u drejtua nga Ballkani¹⁷⁰. Në politikën e saj nën etiketën e të ashtuquajturës “depërtim paqësor” në Ballkan dhe në Lindjen e Afërme, Shqipëria do të luante një rol jo të vogël. Për këto arsye Austro-Hungaria i kushtoi një vëmendje të veçantë problemit shqiptar dhe përdori rrugë të ndryshme politike, ekonomike dhe kulturore për të ndikuar gjithnjë e më tepër në popullin shqiptar.

Në këtë kumtesë unë do të ndalem më tepër në përshkrimin e veprimtarisë kërkimore e shkencore austro – hungareze në shqipëri, rezultatet e saj dhe te jepet nje ide rreth qëllimit të kësaj veprimtarie.

1. DREJTIMET KRYESORE TË PUNËS SË STUDUESVE AUSTRO-HUNGAREZË NË SHQIPËRI

Në fillim të shek.XX rritet interesi i Austro-Hungarisë edhe më tej për studimet në Ballkan e veçanërisht në Shqipëri¹⁷¹. Tani studiuesit austro-hungarezë, duke u mbështetur edhe në punën e studiuesve të mëparshëm si Hahni etj i zgjerojnë dhe i pasurojnë më tepër dijet për Shqipërinë.

¹⁷⁰ Zef Prella, Studime historike” nr. L viti 1965, fq. 143

¹⁷¹ Hanh, Ippen, Lipih

Me këtë synojmë të paraqesim pikërisht disa nga autorët austro-hungarezë, që kryen studime në fillim të ShekXX., tematikën që prekën ata dhe rezultatet që sollën në kuadrin e njohurive mbi historinë, kulturën shqiptare, dhe resurset natyrore të Shqipërisë.

Karl Patsch në vitin 1904 ndërmori një udhëtim që kapte të gjitha skelat e Malit të Zi e të Shqipërisë¹⁷². Ai ndaloi në Tivar, Ulqin, Shëngjin, Durrës, Vlorë e Sarandë.¹⁷³ Karl Patsch jep të dhëna për Sanxhakun e Beratit. Ai flet për qytetin e Vlorës, për skelën, për pazarin, për popullsinë, për veçantitë që ai vëren,¹⁷⁴ por nuk haron të shprehet për ngjashmëritë e qytetit me qytetet e tjera të Perandorisë.¹⁷⁵ Ai thotë se artizanati nuk është i zhvilluar, jep të dhëna etnografike, tregon vendosjen e fshatrave, largësinë midis tyre, flet për ekonominë e zonës, për ullishtarinë dhe blegtorinë e zhvilluar. Aty përmend edhe elemente të kanunit¹⁷⁶.

Dr. Harnold Vettters, në veprën e vet “Gjenealogjia e Shqipërisë së Veriut”,¹⁷⁷ botuar më 1906 flet për një vëzhgim gjeologjik që ai ka bërë në Shqipërinë e Veriore në verën e vitit 1905. Ai vëzhgoi rrethinat e Shkodrës, Mirditës, Lezhës, Durrësit, Tiranës, Laçit etj. Për zonën e Shkodrës ai thotë se ka përmbajtje karstike dhe përbëhet nga konglomeratet dhe zhavoret. Studimi i tij është shoqëruar edhe me një hartë gjeologjike me interes për studimet e mëvonshme në këtë fushë. Kjo tregon se një vëzhgim i tillë ishte

¹⁷² Karl Patsch, Sanxhaku I Beratit në Shqipëri, Vjenë, 1904. AIH, A, III, 224.

¹⁷³ Po aty.

¹⁷⁴ Po aty.

¹⁷⁵ Po aty.

¹⁷⁶ Po aty.

¹⁷⁷ Dr. Harnold Vettters: “geologische der Nord Albanien”, Eien, 1906.

në vazhdën e studimeve të Hahn-it, Ipen-it etj të kryera në këtë fushë në shek.XIX.

Instituti për Studime Ballkanike në Sarajevë

Plani për ngritjen e institutit u prezantua që në vitin 1904, por në vitet e para mbeti i kufizuar në një veprimtari të ngushtë private. Më 05.01.1908 u bë plani nga punonjësi shkencor i muzeumeve Dr. Karl Patsch për të organizuar një institut në Sarajevë, gjë që pak kohë më vonë e mori përsipër Ministria Perandorake e Financave.¹⁷⁸ Ai u themelua si kërkesë e kohës që lindi nga interesi i Monarkisë Dualiste në Ballkan.

Nga shkaqet që çuan në ngritjen e institutit përmendim:

- Rivaliteti në fushën shkencore midis Fuqive të Mëdha të kohës për njohjen e Evropës Juglindore.
- Interesi gjithnjë në rritje i Austro-Hungarisë për këtë rajon.
- Nevoja e zgjerimit të njohurive për këtë rajon nëpërmjet një institucioni të specializuar në këtë drejtim.
- Egzistonte gjithnjë dëshira e studiuesve austro-hungarezë për njohjen sa më të gjerë të Evropës Juglindore.

Veprimtaria e Institutit për studime Ballkanike ishte e orientuar në tre drejtime kryesore:

- Në mbledhjen e materialit direkt nga tereni dhe nga Arkivat.
- Publikimi i lëndës së grumbulluar në këtë mënyrë.

¹⁷⁸ Kurt Gostentschnigg: "Zwischen Wissenschaft und Politik. Osterreich-Ungarische Albanologie". Graz 1996, f.197.

- Krijimi i një aparati shkencor që të mundësonte përpunimin profesional të rezultateve të arritura nga puna kërkimore¹⁷⁹.

Këtu përfshiheshin një bibliotekë që përfshinte gjithë Albanologjinë, një arkiv historik, letrar, epigrafik e fotografik dhe një përmbledhje hartash¹⁸⁰.

Punimet në terren përfshinin Bosnjën, Hercegovinën, Dalmacinë Jugore, Malin e Zi dhe Shqipërinë. Ndër të tjera u mbledh një material nga thesari folklorok shqiptar, i cili përfshinte krejt traditën e gegëve dhe të toskëve në këngë, fjalë të urta, mite, të drejtën etj. Për të arritur të dhëna sa më të plota e të besueshme u tërhoqën në bashkëpunim banorët vendas, veçanërisht në Shqipëri pati sukses organizimi i një rrjeti të dendur të shërbimit për grumbullimin e materialit.

Nën kryetitullin e përbashkët “Njohuri për Gadishullin e Ballkanit” u botuan nga instituti tre seri:

Udhëtime dhe vrojtime; kryesisht me përmbajtje natyrore gjeografike dhe etnografike, mes tyre fletorja 10; Nopsca: “nga Shala në Kelmend”, “Udhëtime Shqiptare” dhe fletorja 13; Eqrem Bej Vlora “Nga Berati prej Tomori”, faqe ditari me shënime shumë të rëndësishme mbi ekonominë kombëtare në Shqipërinë e Mesme.

Burime dhe kërkime, mes tyre fletorja 1; V. Prendushi “Kangë Popullore Gëgnishte”

Inventare dhe Bibliografi. Biblioteka përfshinte në vitin 1913, 7.125 seri, mes tyre seri për Serbinë, Malin e Zi e Shqipërinë, nga të cilat kjo e

¹⁷⁹ Po aty, f.128

¹⁸⁰ Po aty, f.129

fundit në asnjë institucion tjetër nuk përfaqësohej me kaq bollëk sa në atë të Sarajevës.¹⁸¹

Veprimtaria e Institutit u ndërpre me rënien e Perandorisë Dualiste në fund të Luftës së Parë Botërore.

Kërkimet shkencore në kuadrin e Akademisë së Shkencave Vjenë

Një kontribut të konsiderueshëm në fushën e kërkimeve austro-hungareze në Ballkan dha Akademia Vjeneze e Shkencave. Me iniciativën e saj duhej hulumtuar për qëllime studimore historike zona e Durrësit, për të përcaktuar vendin ku ishte zhvilluar beteja e madhe midis Çezarit e Pompeut në lashtësi. Realizimi i ekspeditës u la në dorë të Georg Vaith. Në veprën e tij “ Lufta e Durrësit midis Çezarit dhe Pompeut”, botuar në Vjenë më 1920, Vaith jep rezultatet e studimit të tij.

Vaith përmend edhe një numër rrugësh që përshkronin këtë zonë si: “Via Egnantia”, e cila kishte dy degë që bashkoheshin në vendin e quajtur Clionia; rruga “Apoloni – Amantia” dhe rruga “Via Publika” e mbishkrimit të Lollianus në Bylis.¹⁸² Ai vëren se kjo zonë edhe në lashtësi prekej nga malarja¹⁸³

Në fund të shtatorit 1913 deri në fund të tetorit 1913 në Shqipëri u zhvillua një udhëtim kërkimor nga studiues austro-hongarezë dhe italianë.¹⁸⁴ Në referimin e tij : “Mbi udhëtimin studimor në Shqipëri”, Ernest C Seldmayer flet për ekonominë bujqësore shqiptare duke përshkruar veçoritë e saj. Në referatin e tij ai ngre edhe probleme të tilla që kanë të bëjnë me

¹⁸¹ Po aty, f.129

¹⁸² Po aty, f 20

¹⁸³ Po aty, f 20

¹⁸⁴ Kurt Gostentschnigg: Zwischen..., vep e përm., f 130

ngritjen e një rrjeti rrugor, pasi ai ekzistues është i keq¹⁸⁵. Seldmayer është i mendimit që Shqipëria mund të përparojë ekonomikisht vetëm si vend me bujqësi të zhvilluar¹⁸⁶.

Inxhinier Dedy d.v., në një raport të tij lidhur me ekspeditën e mësipërme jep të dhëna mjaft interesante mbi një projekt hekurudhor në Shqipëri midis Vlorës dhe Shkodrës dhe mbi projekte të tjera për ndërtim rrugësh të ndryshme¹⁸⁷.

Në pranverë të vitit 1914 filluan kërkimet gjeografike dhe topografike në zonën midis Durrësit dhe Liqenit të Ohrit. Gjeografi nga Grazi, Franz Seiner u ngarkua me realizimin e punimeve hartografike¹⁸⁸. Kjo veprimtari u ndërpre pas atentatit të Sarajevës, ” sepse në situatën aktuale të paqetë” në Shqipëri nuk ishte i mundur vazhdimi i mëtejshëm i punimeve topografike të Seinerit¹⁸⁹.

Njëkohësisht me veprimtarinë e Seinerit në muajt prill-gusht 1914 në zonën kufitare midis Shqipërisë Veriore dhe Malit të Zi u zhvillua një udhëtim kërkimor me karakter zoologjik e botanik. Pjesëmarrës të këtij udhëtimi ishin midis të tjerëve zoologu Arnold Penther dhe botanisti Ignaz Dorfler.

Në raportin e tij¹⁹⁰ mbi këtë ekspeditë zoologu Penther tregon itinerarin e tij , vështirësitë që i dolën përpara ekspeditës , si pasojë e motit të keq ,

¹⁸⁵ Po aty, fq 21

¹⁸⁶ Po aty, fq 86

¹⁸⁷ Raport mbi një projekt hekurudhir në Shqipëri midis Vlorës dhe Shkodrës dhe mbi projekte të tjera për ndërtime rrugësh të ndryshme, Vjenë 1914, AIH, A.IV, 181

¹⁸⁸ Kurt Gostentschnigg: Zwischen....., vep. E përmend. Fq 132

¹⁸⁹ Po aty, fq 133.

¹⁹⁰ Arnold Penther: ”Bereicht über die 1914, ausgeführte zoologische Forschungreise im nordalbanische-montenegrische Grenzgebiet.

vështirësitë e terrenit, ekonominë, botën e gjallë etj. Materialet e mbledhura gjenden të gjitha në Muzeun Historik Natyror Mbretëror e Perandorak.

Gjatë periudhës gusht 1914 - janar 1916 veprimtaria kërkimore austro-hungareze në Shqipëri është zero. Kjo për arsye të Luftës së Parë Botërore. Me marrshimin e trupave perandorake nga zona malore e Malit të Zi, në Jug për në Shqipëri krijohen kushte mjaft të favorshme për hulumtime në këtë vënd. Intensiteti i veprimtarive kërkimore (ekspeditave) u rrit ndjeshëm gjatë Administrimit Ushtarak Perandorak të viteve 1916-1918 në Shqipëri.¹⁹¹ Gjatë vitit 1916 u zhvilluan tre ekspedita kërkimore austro-hungareze në Shqipëri. Ekspedita e parë që u organizua në pranverë dhe verë 1916 kishte karakter historik, etnografik, arkeologjik, gjuhësor dhe të studionte historinë e Artit në Shqipëri, Mal të Zi e Serbi.¹⁹²

Në veprën "Archeologikische Forschungen in Albanien und Montenegro" autorët e saj Praschniker dhe Schober përmendim pjesëmarrësit e ekspeditës që janë:

1. E. Reisch, përfaqësues i drejtorisë së Institutit Mbretëror dhe Perandorak Austriak.
2. Dr. Karabacek, përfaqësues i drejtorisë së Bibliotekës së Oborrit Mbretëror dhe Perandorak.
3. Dr. M. Haberlandt, përfaqësues i Këshillit të Ministrave, i cili la Vjenën më 19 maj 1916 për të qenë përfaqësues i shkencës historike në këtë ekspeditë të përbashkët.
4. Maksimilian Lambertz në këtë ekspeditë përfaqësonte shkencën gjuhësore shqiptare.
5. Artur Haberlandt, etnolog.
6. E. Buschbek, studiues i historisë së artit.

¹⁹¹ Kurt Gostentschnigg: Zwisch.... Vep. E përm, f.133

¹⁹² Po aty, f.133

7.F.Kidric, studiues për sllavistikën. Si arkeolog merrnin pjesë dy përpiluesit e këtij raporti.
8.A.Schober u mor me studimin e mbishkrimeve dhe
9.C.Praschniker me studimet e monumenteve të ndërtimit. Kostoja e ekspeditës u pagua një pjesë nga Ministria Perandorake Mbretërore për Kulturë dhe Arsim, një pjesë nga Akademia Perandorake e Shkencave dhe një pjesë nga Zyra e Dhomës së Lartë Mbretërore e Perandorake.

Plan i udhëtimit ishte hartuar në mënyrë të tillë që të fillonte nga Kotorri përmes Malit të Zi dhe Shqipërisë në Elbasan, nga atje përmes rrugës “Egnatia” drejtohej në Lindje mbi malësi dhe pastaj përmes Kosovës në Serbi. Meqënëse në ekspeditën e parë Schober u detyrua të largohet dhe Praschniker të mos e përfundonte udhëtimin e tij u pa e nevojshme të ndërmerrej një ekspeditë tjetër arkeologjike në Shqipëri dhe në Mal të Zi¹⁹³.

Në veprën e tyre “Popujt e Evropës dhe kultura e tyre kombëtare”¹⁹⁴, në kapitullin “Shqiptarët” M.Haberlandt dhe A.Haberlandt paraqesin të dhëna me interes të madh etnografik dhe kulturor për popullin shqiptar.

Në verën e vitit 1916 (muaj korrik-gush-shtator) u zhvillua një ekspeditë gjeologjike në Shqipërinë Veriore e të Mesme, në të cilën morrën pjesë gjeologu i Institutit Perandorak Gjeologjik dhe anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave Dr. F.Kerner dhe Dr. Hermann Veters, punonjës në të njëjtin institut. Kerner ishte njohës i saktë i ndërtimit vargmalor të Dalmacisë, kurse Veters ishte njohës për kërkimet e suksesshme në tokën shqiptare.

¹⁹³ Po aty.

¹⁹⁴ M. dhe A. Haberlandt AIH, E.1.22

Edhe **Akademia Hungareze e Shkencave** luajti një rol të rëndësishëm në ekspeditat kërkimore në Ballkan dhe në Shqipëri. Ajo organizoi disa ekspedita, nga të cilat përmendim:

Ekspedita që u krye nga muajt mars-nëntor 1917(1.3-30.11.1917). Kjo ekspeditë u krye në Serbi, Mal të Zi, Bosnjë-Hercegovinë dhe Shqipëri. Në Shqipëri u hulumtua në zonën e Kosovës, në Alpet e Shqipërisë Veriore, në Gjakovë në Luginën e Drinit dhe në Shkodër. Pjesëmarrësit e ekspeditës ishin specialistë të gjeografisë ekonomike dhe demografisë, botanikës, zoologjisë, prehistorisë(arkeologjisë), gjeografisë fizike dhe politike si dhe gjeografisë së tregjeve, artizanatit dhe etnografisë¹⁹⁵.

Në muajt shtator-nëntor 1917 arkitekti Ernert Foerk dhe drejtori i shkollës tregtare Emil Ferenczy, të ngarkuar nga Qeveria Mbretërore Hungareze kryen një udhëtim kërkimor në Ballkan. Ata studiuuan në Shqipëri gjendjen e artizanatit dhe monumentet e artit dhe respektivisht edhe kushtet ekonomike. Zonat që ata shkelën ishin: Kosova, Alpet Veriore Shqiptare, Gjakova, Lugina e Drinit dhe Shkodra¹⁹⁶.

Gjatë viteve të Administrimit Ushtarak-Perandorak në Shqipëri u krye edhe numërimi(regjistrimi) i parë i popullsisë në Shqipëri (në zonën e pushtuar nga Austro-Hungaria). Edhe më parë ishin bërë përpjekje për të bërë një regjistrim të popullsisë, por rezultatet qenë jo të kënaqshme. Seineri në veprën e vet jep të dhëna të plota edhe për numrin e vendbanimeve, të familjeve, të banorëve për cdo rreth, bënë ndarjen e popullsisë sipas kombësive, sipas besimit fetar dhe sipas zejës(zanatit).

¹⁹⁵ Po aty, f.135

¹⁹⁶ Po aty, f. 136

Albanologu i mirënjohur Franz Baron Nopesa (Nopcsa) zhvilloi veprimtarimë e tij kërkimore në Shqipërinë e Veriut gjatë viteve 1903-1921. Veprimtaria e Nopces ze një vend të veçantë në veprimtaritë kërkimore të kryera nga studiues austro-hungareze, kjo jo vetëm për faktin se ai jetoi e punoi gjatë në Shqipëri, por edhe për faktin se ai arriti të fitojë edhe besimin e Shqipëtareve që e njohën. Veprimtaria e Nopçës ishte e shumëanshme. Ai erdhi në Shqipëri si etnologu, gjeologu dhe gjeografi më i formuar. Nopça ka një numër veprash për Shqipërinë me një vlerë të paçmuar. Shumë autorë mendojnë se cilido studiues që merret apo dëshiron të merret me kulturën kombëtare shqiptare, studimin e vet duhet ta nisë nga Nopça. Ndër veprat e tij përmendim:” Gjeografia dhe Gjeologjia e Shqipërisë Veriore “, “Topografia dhe organizimi i fisit në Shqipërine Veriore” dhe “Fiset e Malësisë në Shqipërinë Veriore dhe ligji i zakoneve (kanuni)”.

REZULTATET E VEPRIMTARISË KËRKIMORE TË STUDIUESVE AUSTRO-HUNGAREZË NË SHQIPËRI NË FILLIM TË SHEKULLIT XX

Siç e kemi paraqitur edhe në dy kapitujt e parë veprimtaria kërkimore e austro-hungarezëve në Shqipëri ishte e shumanëshme. Studimet e tyre rrokin çështje të arkeologjisë, historisë, gjuhësisë, kulturës, ekonomisë, politikës etj.

Në aspektin ekonomik studiuesit austro-hungarezë studiuan rrethanat dhe kushtet e bujqësisë shqiptare (E.Seldmayer), gjendjen ekzistuese të pyjeve, tregëtinë në përgjithësi dhe tregjet kryesore të vendit, Shkodër, Durrës dhe Vlorë (shih raportet konsullore), gjendjen e komunikacionit të brendshëm e të artizanatit, studimin gjeologjik të Shqipërisë etj.

Në aspektin politik ata i kushtuan rëndësi gjendjes së brendshme të vendit, dhanë mendime të vlefshme për organizimin e shtetit të ri shqiptar që ai të ndërtohej duke marrë si model shtetet e tjera të Evropës.

Në gjithë këtë veprimtari kërkimore veç karakterit evidentues studiuesit austro-hungarezë japin edhe mendime për zhvillimin ekonomik e politik të Shqipërisë. Prof. Seldmayer¹⁹⁷ që studioi kushtet e rrethanat bujqësore të Shqipërisë, ishte i mendimit që Shqipëria mund të zhvillohej vetëm si shtet me një bujqësi të zhvilluar dhe për t'ia arritur kësaj ai mendonte se duheshin ngritur shkolla bujqësore, të ndërtoheshin ferma model të suversionohej me kredi bujqësia shqiptare, dhe ndërtimi i një rrjeti rrugor. Ai shihte mundësinë e punësimit në Shqipëri të studentëve austriakë të shkollave të larta të profilit bujqësor dhe atij teknik.

Vec njohjes së kushteve ekonomike ,të kushteve natyrore të Shqipërisë Monarkia i kushtoi një vëmendje të vecantë edhe njohjes së kulturës së popullit shqiptar.Në këtë drejtim Ballhausplaci në prapun e Luftërave Ballkanike mori iniciativën për ta bërë Vjenën qendrën e studimeve shqiptare. Qendra e Studimeve Hungareze për Evropën Juglindore e subvencionuar nga zyrat shtetërore ishte Instituti për Studime Ballkanike në Sarajevë.Nga kjo qendër u botuan shumë përmbledhje dhe vepra për Gadishullin Ballkanik dhe Shqipërinë (në rastin tonë),të cilat e shtuan njohjen për këtë pjesë të Evropës dhe bënë që të rritet interesimi për popujt e Ballkanit.

¹⁹⁷ E. Seldmayer. Referat über....

**DISA MENDIME MBI VEPRIMTARINË KËRKIMORE TË
STUDIUESVE AUSTRO-HUNGAREZË NË SHQIPËRI NË
VITET 1900-1918**

Në fillim të shekullit XIX me zgjerimin e madh të dijeve, si rezultat i zbulimeve të mëdha në shumë universitete evropiane filluan të zhvillojnë degë të vecanta e disiplina të reja si filologjia indiane, filologjia gjermane dhe indogjermanistika, të cilat nga ana e tyre zhvilluan metoda të reja, si ajo historike-krahasuese, të cilat u bënë bazë për studimin e gjuhësisë, historisë etj, në fillim të shekullit XIX.

Metoda historike krahasuese e studimit të gjuhësisë përfshiu studimin e të gjitha gjuhëve të njohura deri atëherë, kështu edhe të gjuhës shqipe. Nisur nga disa studime jo të mirfillta shkencore të disa diplomatëve dhe udhëtarëve (Laibnic, Tunman, Fallmerajerit, Ksilandiot, Bue), nga fund i shekullit XIX shohim fillimin e një albanologjie sistematike, e cila karakterizohet nga ndarjet në disiplina të veçanta. Kështu Franc Bop e përcakton gjuhën shqipe si gjuhë indoevropiane, kurse Hahn me studimin e tij “Albanische Studien” i vendos studimet shqiptare mbi baza të shëndosha shkencore.

Një vend i veçantë iu kushtua edhe studimit të çështjes së etnogjenezës së shqiptarëve. Ky problem që në fillim i ndau albanologët në 2 grupe:

1. Ai i autoktonistëve.
2. Ai atyre që mbështesin tezën e joautoktonisë.

Ky konflikt mendimesh shprehet edhe në historinë e studimeve austro-hungareze për Shqipërinë, baza e të cilave u hodh nga udhëtimet eksploruese, plot rreziqe e sakrificat të ndërmarra prej studiuesve të shkencës

në shekullin XIX. Është fjala që këto studime u përballën me kushte të vështira që lidheshin kryesisht me terrenin e vështirë, kushte jo të mira higjienike, mosbesimin e popullsisë, probleme gjuhësore etj., megjithatë ishin arritjet e punës së tyre që krijuan mundësitë për zhvillimin e disiplinave të vecanta të shkencës së albanologjisë.¹⁹⁸

Ndihma më e madhe e shkencës austro-hungareze në studimet e Shqipërisë ngre pyetjen nëse ajo ka pasur vetëm motive shkencore apo është shoqëruar edhe nga interesat shtetërore?

Lidhur me çështjen e mësipërme ekzistojnë mendime të ndryshme, madje edhe të kundërta.

Në përgjithësi shkenca historike austro-hungareze veprimtarinë e saj shkencore në Gadishullin Ballkanik e vendos nën nocionin e “depërtimit paqësor” dhe të “misionit të saj civilizues në Gadishullin Ballkanik”. Ky mendim gjen mbështetje në një farë mase edhe tek historiografia perëndimore. Lidhur me Shqipërinë ky argumentim gjen zbatim në rolin që luajti Austro-Hungaria në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912.

Shkenca historike shqiptare e kohës së monizmit është e mendimit se veprimtaria kulturore, arsimore dhe kërkimore austro-hungareze në Shqipëri në vitet në shqyrtim është zhvilluar në kurriz të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.¹⁹⁹

Është fakt që kërkimet e huaja në Shqipëri filluan në atë fazë kur u ashpërsuan interesat e huaja kontradiktore ndërkombëtare ndaj trashëgimisë

¹⁹⁸ Shih: Kurt Gostentschnigg: “Mpleksja me interes politike të Monarkisë së Dyfishtë”. Studime Albanologjike, nr.1, viti 1997.

¹⁹⁹ Zef Prela: “Problemi Kombëtar Shqiptar dhe kultusprotektorati Austro-hungarez”, Studime Historike, nr 3, viti 1965

së Perandorisë Osmane. Këto vite, fund i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX janë vite ku kolonializimi ishte problem i ditës dhe historiografia në përgjithësi flet për imperializmin që ka qenë karakteristikë për Fuqitë e Mëdha. Nga ky përcaktim dhe nga sa thamë më lart edhe Perandoria Austro-Hungareze nuk bën përjashtim. Ajo u përpoq të sigurojë mbizotërimin në Gadishullin Ballkanik dhe siç e kemi thënë më parë Shqipëria duhej të zinte një vend të veçantë në politikën e saj.

Në planin politik, Monarkia u paraqit si “mbrojtëse e interesave të shqiptarve”, dhe luajti një politikë të lëkundur në varësi të interesave mes Portës së Lartë dhe Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për çlirim kombëtar.

Në përgjithësi në historiografinë shqiptare është kristalizuar mendimi se “penetrimi paqësor” politik, ekonomik, e kulturor i Austro-Hungarisë në Shqipëri u shoqërua nga studimi shkencor i vendit.

Të gjitha këto fakte e tregues nuk lënë më dyshime se shkenca është përdorur si instrument i dhunës strukturore, krahas protektoratit të kultit dhe propagandës komerciale për realizimin e imperializmit të fshehtë (jo zyrtar) ndaj Shqipërisë e mes saj, tërthorazi për të luftuar pansllavizmin dhe imperializmin Italian²⁰⁰.

Kurt Gostentshnigg²⁰¹ e sheh më gjerë këtë problem kur thotë se – *asnjë shtet nuk mundet në të njëjtën kohë edhe të mendojë për fitimet e veta edhe të bëhet theror për një komb tjetër. Kur dikush bën diçka për një tjetër dhe mendon të ketë dobi për vete nga kjo punë, atëherë nuk mund të flitet më për sakrificë. Austro-Hungaria luajti sigurisht një rol vendimtar për Pavarsinë e Shqipërisë, por ndërkohë ajo vazhdimisht kujdesej të siguronte*

²⁰⁰ “Studime albanologjike”, Nr.1, viti 1997, f, 47

²⁰¹ Po aty, f 46.

ndikimin e saj ekonomiko- kulturor në këtë vend të vogël në periferinë e saj jugore.

KONKLUZION

Si përfundim mund të themi që kjo është një çështje e ndërlikuar dhe kjo duhet parë më gjerë, në kuptimin që roli i shkencës austro-hungareze të mos mohohet. Të dalë i qartë dhe i plotë, por njëkohësisht të vihet në dukje edhe fakti që kjo veprimtari shkencore në rrethana të caktuara është përdorur nga politika austro-hungareze për qëllimet e veta.

Ndikimi i studiuesve austro-hungarezë mbi Shqipërinë duhet parë me realizëm, duhet të mos mbivlerësohet duke u nisur edhe nga fakti që në kuadrin e ndryshimeve të sotme politike në Shqipëri të kalohet në ekstremin tjetër nga ai që mbante historiografia jonë e viteve të monizmit. Mund të thuhet se edhe pse kontributi diplomatik e shkencor i Monarkisë së Dyfishtë për Shqipërinë ishte i ndjeshme, por nuk duhet haruar që Ballhausplatsi ndiqte gjithmonë interes e veta politike dhe për realizimin e të cilave shkenca shihej si një mjet krahas protektoratit të kultit dhe depërtimit ekonomik.

Bibliografia

1. Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë: fondi Arkivi i Vjenës;
2. Kurt Gostentschnigg: “Zwischen Wissenschaft und Politik. Österreichisch-Ungarische Albanologie”. Dizertacion i pabotuar, Graz, 1996;
3. Dr. Harnold Vettters: “Geologie des Nord Albanien” Wien, 1906;
4. E. C. Selmayer: “Referat über eine Studienreise in albanien”. Wien, 1913;

5. Arnold Penther: “Bereicht über die 1914 ausgeführte zoologische Forschungreise in nordalbanische-montenegriscche, Grenzgebiet”, Vien, 1916;
6. C.Prashniker und A. Schober: “Archeologische Forschungen in albanien und Montenegro” Wien,1914;
7. A. Buda: Kriza Lindore e viteve 1875 – 1878 dhe Shqipëria, shkrime historike, Tiranë 1986. Çështjet shqiptare dhe mardhëniet ndërkombëtare në vitet 1878 – 81, po aty Shqipëria në vitet e Krizës Lindore 1877 – 1881;
8. A. Muka; Nopça dhe fshati shqiptar, Kultura popullore,Tiranë 1977, nr 1-2;
9. A. Puto; Çështja shqiptare dhe diplomacia e fuqive të Mëdha në vitet e Lidhjes së Prizrenit; Studime Historike, 1968, nr 3. -Problem shqiptar dhe fuqitë e mëdha në gjysmën e dytë të shëk. XIX dhe fillim i shek. XX, Studime Historike, 1970, nr.3;
10. Pavarsia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha (1912 – 1914), Tiranë 1978. -Lidhja shqiptare për mbrojtjen e të drejtave të kombit në vitet e Krizës Lindore, Studime Historike, Tiranë 1970, nr.3;
11. K. Frashëri; Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878–1881, Tiranë 1997.
12. Historia e Shqipërisë, Vëllimi II, III, Tiranë 1984;
13. K. Krisafi; Çështja shqiptare në Kongresin e Berlinit; Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Vëll, Tiranë 1979;
14. S. Pollo; Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar, studime historike nr. 2, Tiranë 1968. – Shpallja e Pavarsisë së Shqipërisë – kthesë e madhe në historinë e popullit shqiptar, Tiranë 1982;

15.K.Prifti; Shqipëria në Politikën e Fuqive të Mëdha dhe të Shteteve Ballkanike gjatë “Krizës së Lindjes” të vitit 1897; Studime Historike nr. 2, Tiranë 1977;

16. Z. Prela; Politika imperialiste Austro - -Hungareze në Shqipëri në vitet 1900 – 1912; Studime Historike nr 2, Tiranë 1966. Problem Kombëtar Shqiptar dhe Kultusprotektorati Austro – Hungarez’ Studime Historike nr.3. tiranë 1965.

“ZHVILLIMI DHE MBROTJA E LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT”

Dr. process Arta Hasa (Jakupi)

Juriste, “Spitali Italian Salus”, Rruga Vidhe Gjata n. 16, Mezez-Kashar,
Tirane, email: info@salus.al

Abstract

International legal recognition of human rights, starting with the Universal Declaration of Human Rights (1948) and the European Convention on Human Rights (1954), has been the greatest achievement of the twentieth century civilization. The fact that Albania has adopted the Constitution after the creation of the Convention on Human Rights, has made the latter to be included in our Constitution in Article 15 paragraph 1 "The rights and fundamental freedoms are indivisible, inalienable, inviolable and underlie all legal order ". The focus of this research paper is to address human rights in the 21st century in Albania, as well as the role of the international community. A particular place in this article occupies "The human rights of women and violence against women". The role of civil society in informing public opinion.

Keywords: human rights, violence against women, role and impact of International Human Rights, the 21 century.

1. Trajtimi i të drejtave të njeriut në shekullin e 21 në Shqipëri dhe roli i faktorit ndërkombëtar

Të drejtat e njeriut përkufizohen si “garanci bazë morale, që duhet t’i gëzojnë të gjithë njerëzit, në të gjitha vendet e kulturat, vetëm dhe pikërisht sepse janë qenie humane”. Ato janë të një prioriteti të lartë dhe se bindja e respektimi i tyre janë të detyrueshme, të patjetërsueshme e të padhunueshme

dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik Të drejtat e njeriut zakonisht konsiderohen si të drejta universale në sensin që çdo njeri i ka ato. Duke folur për të drejtat e njeriut në ditët e sotme, kemi si qëllim ndarjen në dy këndvështrime si positive po ashtu dhe në atë negative për një minimum jetik më të mirë, si të drejtën për të mos iu nënshtruar asnjë torture apo qëndrimi çnjerzor e diskriminues dhe të drejtën për të pasur kujdes minimum shëndetësor. Të drejtat e njeriut kanë qenë formuluar në norma ligjore të detyrueshme që mbrojnë individët dhe grupet kundër veprimeve që cenojnë dinjitetin njerëzor dhe liritë themelore. Dokumentet themelore janë quajtur Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut dhe konsistojnë në: Kartën e Kombeve të Bashkuara, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (UDHR), Paktin ndërkombëtar “Për të drejtat civile dhe politike” (ICCPR) dhe Paktin ndërkombëtar “Për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore” (ICESCR) ²⁰².

Të drejtat dhe liritë themelore tradicionalishtë trajtoheshin si ceshtje të kompetencës së brëndëshme ndërsa sot referuar specifikishtë dhe Kartës së Kombeve të Bashkuara e cila i referohet më shumë njohjes ndërkombëtare dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Me miratimin e kësaj karte, të drejtat e njeriut bëhen pjesë e së drejtës ndërkombëtare pozitive, pushojnë të jenë ceshtje e kompetencës ekskluzive të shteteve dhe bëhen ceshtje e preokupimit të bashkësisë ndërkombëtare.

Me miratimin Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në 1948 roli i ndërkombëtarëve në fuqizimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut bëhet më i rëndësishëm. Deklarata shpall se të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe me të drejta dhe liri pa asnjë lloja dallimi

²⁰² Arqile Kosta, “Doktrina e Të Drejtave të Njeriut,” Tiranë, 2007.

apo diskriminimi përsa i përket racës, fesë, mendimit., bindjes politike, origjinës kombëtare... etj²⁰³.

Paktin ndërkombëtar “*Për të drejtat civile dhe politike*”, përmban shumë nomra/nene për të drejtat demokratike dhe liritë e njeriut dhe mjetet për garantimin e tyre, ne vecanti, e drejta e jetës, e drejta e lirisë dhe sigurisë personale, liritë e mendimit, besimit ndërsa pakti ndërkombëtar trajton në mënyrë të vecantë, të drejtën e punës, të drejtën për shpërblim, të drejtën për greva dhe kushte të mira sigurie në vëndin e punës²⁰⁴.

Për sa i përket situates ne Shqipëri janë ndërmarrë disa reforma të rëndësishme mbi trajtimin sa më human të personave me liri të kufizuar (zbatimin e ligjit në vëndin e vuajtjes së dënimit, rehabilitimin dhe integrimin e të dënuarve në shoqëri dhe krijimin e një sistemi të sigurt dhe efikas për të gjithë shoqërinë).

Legjislacioni shqiptar në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ka përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore një sërë dispozitash që kanë të bëjnë me trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve, si dhe kompetencat dhe detyrat e organeve shtetërore kompetente, me qëllim respektimin e dinjitetit të dënuarve dhe të paraburgosurve, trajtimin e tyre pa njëanshmëri apo diskriminim për shkak të seksit, kombësisë, racës, gjendjes ekonomike dhe shoqërore, pikëpamjeve politike dhe besimit fetar, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurisë në të cilën mbahen dhe trajtohen të burgosurit dhe të paraburgosurit si dhe zhvillimin e programeve të rehabilitimit social dhe veprimtarive prodhuese për të burgosurit.

²⁰³, Jack Donnelly Ithaca, “Deklaratat Universale e të Drejtave të Njeriut në Teori dhe Praktikë”, London.

²⁰⁴ Henry J. Steiner; Philipp Alston, Oksford. “Të drejtat e njeriut në kontekstin ndërkombëtar”: E drejta, politika, morali.

Duke u inkuadruar tek të drejtat Ekonomike dhe Sociale fokusi kryesor i qeverisë në fushën e mbrojtjes shoqërore, është implementimi i sistemit të mbrojtjes sociale dhe standardeve, duke luftuar përjashtimin social dhe diskriminimin, përmirësimin e legjislacionit në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, monitorimin e zbatimit të legjislacionit aktual si edhe fuqizimit të kapaciteteve të strukturave implementuese të legjislacionit.

Me interes të vecantë dhe që ka një impakt shumë të me ekonomiko-social është skema aktuale e sigurimeve shoqërore, e cila është pregaditur sipas standarteve europiane (në përputhje me nenin 99 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit)²⁰⁵.

Por mund të konfirmojë se duhet akoma shumë punë që të garantohet respektimi i të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit duke siguruar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, garantimin e të drejtave të fëmijëve dhe nxitjen e reformave dhe zbatimit të ligjive aktuale.

Akoma në Shqipëri kemi probleme madhore për sa i përket respektimit të të drejtave të minoriteteve dhe mbrojtja e tyre.

Reformat të cilat duhen të ndërmerren duhet të jenë në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës “Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare”, të cilat janë ratifikuara nga Shqipëria.

²⁰⁵ <http://www.integrimi.gov.al>

Një ndër fenomenet problematike që edhe pse në shekullin 21 në Shqipëri ekzistojnë akoma është garantimi i lirisë së shprehjes, kjo si liri nuk mund të kuptohet e ndarë nga garantimi i një sërë lirish dhe të drejtash të tjera të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si: liria e shtypit, radios dhe televizionit (neni 22, pika 2) ²⁰⁶.

Shqipëria në kuadër të respektimit të të drejtave ka shumë rrugë për të berë akoma për, shumë reforma të brëndëshme që duhet të ndërmerren dhe ratifikimi dhe zbatimi i marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare.

2. Të drejtat njerëzore të grave dhe dhuna kundër grave.

Dhuna në familje është problem serioz dhe meriton vëmendje të nivelit të lartë nga autoritetet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në nivel ndërkombëtar edhe pse gradualisht kanë përparuar në hartimin dhe nënshkrimin e një tërësie normash ligjore.

Karta e Kombeve të Bashkuara vendosi elemente të reja të një rëndësie të madhe për gratë: Kombeve të Bashkuara iu dha mandati të promovonin progresin dhe zhvillimin ekonomik e social dhe të krijojnë organizma ndihmës. Organizatat e Grave e shfrytëzuan këtë mundësi.

Rol të madh në këtë proces luajti Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Statusin e Grave (themeluar në vitin 1947) i cili, midis të tjerave, hartoi CEDAW-n ²⁰⁷ dhe ishte nismëtar i katër konferencave botërore për gratë (në Meksiko, Kopenhagën, Najrobi dhe Pekin). Këto konferenca rezultuan në dokumente të nënshkruara nga shumica e vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara.. Si në Konferencën Botërore të të Drejtave të Njeriut, në Vjenë,

²⁰⁶ Aurela Anastasi, “E drejta kushtetuese”, Tiranë, 2007.

²⁰⁷ <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/>

në vitin 1993, ashtu edhe në Konferencën Botërore në Pekin, të drejtat e grave u njohën si të drejta të njeriut.

Të gjitha format e dhunës kundër grave shkojnë përtej sjelljes shtypëse ose diskriminimit në përgjithësi dhe përbëjnë dëm, i cili rezulton nga forca ose detyrimi. Ato janë shoqëruar me pabarazi midis burrave dhe grave e cila është shfaqje e pabarazise midis burrave dhe grave dhe përbën një formë të diskriminimit kundër grave²⁰⁸.

Komiteti CEDAW njeh dhunën kundër grave, duke përfshirë dhunën në familje, si formë të diskriminimit, ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit gjinor në konventë përfshin "dhunën gjinore, që është dhunë e drejtuar kundër një gruaje, sepse ajo është grua ose që ndikon mbi gratë në mënyrë disproporcionale".

Në deklaratën "Për eliminimin e dhunës kundër grave (DVAW), miratuar në vitin 1993, (Këshilli i Europës, konferenca e tretë ministeriale europiane "Për barazinë midis burrave dhe grave", Declaration on Policies for Combating Violence Against women in a Democratic Europe, Romë, 21-22 tetor 1993)²⁰⁹. Shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara e njohën dhunën kundër grave si një "shfaqje të marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të fuqisë midis burrave dhe grave, të cilat kanë çuar në sundimin dhe diskriminimin kundër grave nga burrat dhe në parandalimin e përparimit të plotë të grave".

Dhuna në familje është një nga format më të përhapura të dhunës dhe të diskriminimit kundër grave. Dhunën në familje, si dhunim të të drejtave njerëzore të grave, për herë të parë²¹⁰ e njohu Konferenca e Dytë Botërore e

²⁰⁸ Prof. Dr. Av.Aurela Anastasi, Prof. as. Edlira Haxhiymeri," Institucionet Shqiptare për mbrojtjen e gruas nga dhuna në familje".Tirane 2006.

²⁰⁹ <http://www.coe.int>

²¹⁰ Rasti i parë që ngriti çështjen e dhunës në familje si dhunim të të drejtave të njeriut, u soll në vitin 1998, përpara një gjykate ndërkombëtare, Komisionit Ndëramerikan për të Drejtat e

Grave në Kopenhagë (1980)²¹¹. Konferenca miratoi një rezolutë “Për gratë e dhunuara dhe dhunën në familje” dhe iu referua dhunës së ushtruar në shtëpi në raportin e saj final. Kjo u shtjellua në dy rekomandime të përgjithshme të Komitetit CEDAW ër dhunën kundër grave (Rekomandimi i përgjithshëm nr. 12, 1989 dhe rekomandimi i përgjithshëm nr. 19, 1992), ku Komiteti autorizon shtetet anëtare “të mbrojnë gratë kundër dhunës së çdo lloji, të ndodhur brenda familjes, në vendin e punës ose në ndonjë fushë tjetër të jetës sociale”.

Të gjitha të drejtat njerëzore dhe liritë e listuara njihen gjerësisht nga komuniteti ndërkombëtar. Sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR): ”Çdo njeri gëzon të drejtën e rendit shoqëror dhe

Njeriut. Sipas argumenteve të bëra në rastin *Pamela Ramjattan*, qeveria e Trinidadit dhe Tobagos, kur e dënoi atë me vdekje, shkeli të drejtat e znj. Ramjattan pas dështimit për të marrë në konsideratë faktorët lehtësues të veçantë, të përjetimeve të saj, si grua e dhunuar. Gjykimi i saj, në vijimësi, dha prova të sigurta se, gjatë 8 vjetëve të martesës, ajo u është nënshtruar formave të ndryshme të dhunës në familje, sipas ligjit zakonor. Siç duket, policia, avokatët e ndihmës ligjore, autoritetet e burgut, gjykatat dhe qeveria e Trinidadit dhe e Tobagos dështuan, pasi nuk morën parasysh abuzimin e dhunshëm, të cilit znj. Ramjattan dhe fëmijët e saj i ishin nënshtruar dhe pasojat e abuzimit në gjendjen mendore dhe veprimet e saj. Sipas deklaratës, rekomandimit nr.19 të CEDAW-t (Trinidadit dhe Tobago ratifikuan CEDAW në vitin 1990), Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut dhe konventës ndëramerikane “Për parandalimin, ndëshkimin dhe çrrënjësosjen e dhunës kundër grave”, e drejta e jetës së znj. Ramjattan, e gjykimit të drejtë, e mbrojtjes së barabartë para ligjit dhe e mosdiskriminimit në bazë seksi ishin dhunuar dukshëm. Fakti që rasti u paraqit para Komisionit është në vetvete një hap i rëndësishëm në lëvizjen ndërkombëtare për të garantuar të drejtat njerëzore të grave.

²¹¹, Prof. Dr. Av. Aurela Anastasi, Prof. as. Edlira Haxhiymeri, “Institucionet Shqiptare për mbrojtjen e gruas nga dhuna në familje”. Tiranë 2006

ndërkombëtar, në të cilin të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë deklaratë mund të realizohen plotësisht” (neni 28) ²¹².

Në vitin 1985, Asambleja e Përgjithshme miratoi rezolutën e parë për dhunën në familje, bazuar në një rekomandim të Komisionit për Statusin e Grave të Këshillit Ekonomik dhe Social dhe në rezultatin e Kongresit të 6-të të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kundërvajtësve.

Dhuna në familje është dukuri mbarëbotërore dhe Shqipëria, nuk mbetet jashtë ndikimit negativ të saj.

Si vend ballkanik, Shqipëria e ka përjetuar dhunën në familje të ligjruar edhe nga zakonet e trashëguara, të shkruara e të pashkruara, të vendit ²¹³.

Dhuna ndaj gruas është dukuri mjaft komplekse dhe vjen si rezultat i pabarazisë midis burrit e gruas dhe dëshmon për një diskriminim serioz të gruas në shoqërinë dhe familjen e sotme. Por, , niveli dhe graviteti i saj lidhen edhe me traditat patriarkale të familjes, të zonës ku banon etj

Por edhe në zonat më të civilizuar apo në kryeqytet vihet re ndjeshëm prepotenca e meshkujve që nuk arrijnë të kuptojnë harmoninë dhe mirëkuptimin, si vlera të vërteta të një familjeje bashkëkohore ²¹⁴.

Shqipëria është një vend me demokraci të re, transicioni i zgjatur ka krijuar shumë probleme shoqërore dhe ekonomike. Sistemi demokratik vazhdon të jetë i brishtë, institucionet shtetërore dhe vendore janë ende të dobëta dhe nuk ofrojnë mbrotje ligjore efikase (shume raste janë verifikuar

²¹² http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf

²¹³, Prof. Dr. Av.Aurela Anastasi, Prof. as. Edlira Haxhiymeri, “Institucionet Shqiptare per mbrojtjen e gruas nga dhuna në familje”,Tiranë, 2006.

²¹⁴, Prof. Dr. Av.Aurela Anastasi, Prof. as. Edlira Haxhiymeri,” Institucionet Shqiptare për mbrojtjen e gruas nga dhuna në familje”.Tiranë , 2006.

në shqipëri kur grate janë dhunuar apo vvarë gjatë kohës që kanë qënë me Urdhër Mbrotje nga Shteti). Nuk mund të lë pa përmendur që fenomeni i dhunës në familje është ndikuar dhe nga mungesa e investimeve në arsim, në shëndetësi etj.

3. Roli i shoqërisë civile në sensibilizimin e opinionit publik.

Duke ju referuar sensibilizimit të shoqërisë dhe opinionit publik doja ta filloja me rolin e medias së shkruar dhe elektronike e cila reflekton praninë e dhunës në shoqërinë tonë. Pas viteve '90, ajo ka raportuar gjithnjë e më shumë lajme nga më të dhembshmet të krimit në familje. Në fillim gazetarët e trajtonin këtë dukuri me ndrojtje, por, gradualisht, ajo ka zënë vend mjaft të dukshëm, por nuk mund të lë paevidentuar dhe rolin negativ të medias e cila shpesh here shkel etikën dhe profesionalizmin duke përçuar te lexuesi një imazh negativ të gruas ²¹⁵.

Jo vetëm media por situata bëhet edhe më e rëndë kur reagimi shoqëror është i dobët, i papërfillshëm, ndërsa shteti e sheh si një krim të rëndomtë e asgjë më tepër. Mungesa e legjislacionit specifik mbi dhunën ndaj grave në Shqipëri është një ndër problem madhore. Nëse i referohemi Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë ²¹⁶ ai nuk bën dallim mes akteve të dhunës të kryera nga një i panjohur dhe akteve të kryera nga një anëtar i familjes.

Institucionet statistikore nuk nxjerrin shifra të sakta në lidhje me fenomenin e dhunës ndaj grave në përgjithësi dhe dhunën në familje, në veçanti kjo vjen edhe si rezultat i mungesës së denoncimeve nga ana e grave të dhunuara, edhe pse duhet evidentuar që ka pasur një rritje të rasteve të denoncimeve, kjo falë dhe ngritjes së strehëzave për grate e dhunuara dhe

²¹⁵ Prof. Dr. Av. Aurela Anastasi, Prof. as. Edlira Haxhiymeri, "Institucionet Shqiptare për mbrojtjen e gruas nga dhuna në familje". Tiranë 2006.

²¹⁶ <http://www.qbz.gov.al/kode.htm>

dhënia e asistencës ligjore falas, iniciative e mbeshtetur fort edhe nga organizata te ndryshme jo qeveritare ²¹⁷.

Evidentimi me shifra nxit interesin e opinionit publik në luftimin e këtij fenomeni në mënyrë që të kemi një sensibilizim të shoqërisë dhe një edukim të shoqërisë për ta bërë dhunën të papranueshme, si shoqërisht, ashtu edhe moralisht.

BIBLIOGRAFIA

1. Arqile Kosta, “Doktrina e Te Drejtave të Njeriut,” Tiranë, 2007.
2. Deklaratat Universale e të Drejtave të Njeriut ne Teori dhe Praktike, Jack Donnelly Ithaca, London.
3. Të drejtat e njeriut në kontekstin ndërkombëtar: E drejta, politika, morali , Henry J. Steiner; Philipp Alston, Oksford.
4. Aurela Anastasi, “E drejta kushtetuese”, Tiranë, 2007.
5. Institucionet Shqiptare per mbrojtjen e gruas nga dhuna në familje.Tirane 2006, Prof. Dr. Av.Aurela Anastasi, Prof. as. Edlira Haxhiymer.

URL

1. [http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/;](http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/)
2. <http://www.integrimi.gov.al;>
3. <http://www.coe.int;>
4. <http://www.ohchr.org;>
5. [http://www.qbz.gov.al/kode.htm.](http://www.qbz.gov.al/kode.htm)

²¹⁷ Prof. Dr. Av.Aurela Anastasi, Prof. as. Edlira Haxhiymeri, “Institucionet Shqiptare për mbrojtjen e gruas nga dhuna në familje”,Tiranë, 2006.

INTERESAT E MËSIMDHËNËSVE PËR RIKUALIFIKIM NË PROGRAMIN E AKM

Remzi Rexhep Bujari-

Ma.Sc. në Pedagogji

Agim Milazim Bujari-

Ma.Sc. në Pedagogji Fakulteti i Edukimit-Universiteti i Prishtinës

Bashkim Ali Azemi-

Ma.Sc. në Pedagogji Instituti Pedagogjik i Kosovës

Abstract

Qualification is now seen as a necessity, because people today should receive information and to face future challenges in the years to come, so they plan qualifications practically be affordable in terms of time, place and financial opportunities. Also, interests have a major impact on training, because in modern conditions opened opportunities for gaining qualifications that allow adults to have more autonomy and a greater responsibility for his or her qualifications.

Interests qualification of adults can be defined as the interaction of many human activities, with the aim of improving knowledge, skills, abilities, personal perspective, civic, social and oriented in the profession, the modalities formal education, non-formal and informal, with means more varied (traditional and new electronics) in different environments (education and training, labor, public and household), according to its needs and opportunities for adults.

Interest is the main generator of promoting lifelong education of adults, because they also opportunistically select routes and different content to be educated.

The study of this issue, aims to ascertain the level of interest to teachers of primary schools in lifelong education.

Question: How are teachers of primary schools interested to educate themselves throughout their lives?

Hypothesis: Teachers of primary schools are interested to some extent in lifelong education.

For the realization of this study will be used *method of theoretical analysis*, documentation analysis method, statistical method, the comparison.

Population of this research is 556 teachers who continue their studies with AQT program, while the group is 152 teacher representatives.

Keywords: interests, teaching, education, lifelong.

HYRJE

Arsimimi gjatë gjithë jetës i mësuesve varet nga shumë faktorë, mirëpo ndër faktorët kyç është interesimi dhe dëshira e tyre që të arsimohen. Nëse mësuesi konsideron se me mbarimin e një niveli të shkollimit, e ka siguruar një nivel të dijes shkencore, dhe një vend të punës, atëherë për atë mësues ka përfunduar edhe arsimimi e që është një gabim i cili do t'i kushtoj gjeneratave të tëra. Përpjekja për të arritur një rikualifikim të dëshiruar apo të mundshëm, nënkupton të jesh në radhë të parë i interesuar.²¹⁸ Njerëzit janë autonom, por nuk janë të tërësisht të pavarur në realizimin e interesave për rikualifikim. Sa i përket faktorëve të tjerë, siç janë aspekti financiar, etj, janë

²¹⁸ Merriam, S. B. (2001). Andragogy and self-directed learning: Pillars of adult learning theory. *New Directions for Adult & Continuing Education*, v. 89, p. 3-14.

faktorë të cilët ndikojnë në arsimimin e mësuesve, mirëpo me angazhimin e mësuesve tejkalohen këto pengesa më lehtë se sa kur mësuesi nuk ka interesim për të vazhduar arsimin e tij. AKM, është një domosdoshmëri për të gjithë, andaj edhe mësuesve që të jenë aktual në punën e tyre, u duhet që në vazhdimësi të arsimohen.

METODOLOGJIA DHE METODAT

Qëllimi i hulumtimit

Studimi i kësaj problematike, ka për qëllim konstatimin e nivelit të interesave të mësimitdhënësve të shkollave nëntëvjeçare në programin e AKM-së.

Pyetja dhe Hipotezat e hulumtimit

Pyetja: Sa janë të interesuar mësimitdhënësit e shkollave nëntëvjeçare që të arsimohen gjatë gjithë jetës së tyre.

Hipoteza kryesore: Mësimitdhënësit e shkollave nëntëvjeçare deri diku janë të interesuar për pjesëmarrje në AKM.

Hipotezat ndihmëse: Mësuesit e gjinisë mashkullore janë më shumë të interesuar për pjesëmarrje në AKM.

Grupmosha e mësuesve 26-35 janë më të interesuar se sa mësuesit e grupmoshave të tjera, për pjesëmarrje në AKM.

Metodat e hulumtimit

Për realizimin e këtij studimi janë përdorur Metoda e analizës së dokumentacionit, Metoda statistikore, e krahasimit.

Popullacioni dhe grupi përfaqësues

Popullacionin e këtij hulumtimi e përbëjnë 556 mësime të shkollave nëntëvjeçare që vazhdojnë studimet në programin AKM, ndërsa grupi përfaqësues është 152 mësime. Grupin përfaqësues kemi planifikuar të përbëhet nga 226 mësime, por për disa shkaqe grupin përfaqësues e përbëjnë 152 mësime.

Instrumenti i hulumtimit

Si instrument i hulumtimit është përdorur shkalla Likert me 5 shkallët e saj: Shumë i interesuar, i interesuar, deri diku i interesuar, pak i interesuar, aspak i interesuar dhe plotësisht dakord, dakord, i lëkundur, Jo dakord dhe aspak dakord, i përbërë nga tri pjesë me gjithsej 40 pyetje.

Besueshmëria e instrumentit të hulumtimit

Besueshmëria e instrumentit është matë përmes Alpha Chronbah, dhe rezulton se instrumenti ka një besueshmëri të lartë.

Analiza e rezultateve

Rezultatet janë analizuar përmes programit SPSS 18, ku janë nxjerrë përqindjet, mesatarja dhe devijimi standard.

INTERPRETIMI I REZULTATEVE

Rezultatet e fituara me anë të programit SPSS, janë paraqitur në këtë punim fillimisht me anë të përqindjes për secilën shkallë, të njëjtat rezultate janë paraqitur edhe në tabelën numër 2, gjithashtu janë paraqitur edhe mesatarja dhe devijimi standard.

Rezultatet krahasimtare të paraqitura në grafikone

Në bazë të rezultateve të paraqitura në grafikonin numër 1, 92 % e mësueseve dhe 88.7 % e mësuesve janë të interesuar për rikualifikim në AKM. 7.5 % e mësueseve dhe 4.8 % e mësuesve kanë qëndrim neutral sa i përket rikualifikimit në AKM. Vetëm 6.5 % e mësuesve kanë qëndrim negativ sa i përket rikualifikimit në AKM.

Në bazë të rezultateve të hulumtimit të paraqitura në grafikonin numër 2, 90.7 % e mësuesve të grupmoshës 35-49, 100 % e mësimezhënësve të grupmoshës 26-34, dhe 87.5 % e mësimezhënësve të moshës mbi 49 kanë interesim për rikualifikim në AKM, ndërsa 8.3 % e mësuesve të moshës 35-49, dhe 12.5 % e mësuesve të moshës mbi 49 kanë qëndrim neutral për rikualifikim në AKM. Vetëm 3.7 % e mësuesve të moshës 35-49, kanë qëndrim negativ për rikualifikim në AKM.

Rezultatet e paraqitura në tabelë

Lidhur me pyetjen kryesore të hulumtimit, rezulton se 92.7 % e mësuesve kanë qëndrim pozitiv për rikualifikim në AKM, 6.6 % kanë qëndrim neutral sa i përket rikualifikimit në AKM, ndërsa 0.7 % e mësuesve kanë qëndrim negativ ndaj rikualifikimit në AKM.

Në bazë të rezultateve të paraqitura, vërehet se në pyetjet pozitive që janë bërë lidhur me interesin e mësuesve për rikualifikim në AKM, 92.9 % e tyre janë të interesuar, 3.8 % nuk janë të vendosur, ndërsa 3.3 % kanë mendim negativ për rikualifikimin.

Në pyetjet negative të parashtruara lidhur me interesat e mësuesve për rikualifikim, vërehet se 77.5 % e tyre kanë mendim negativ lidhur me këto pyetje, 7.2 % kanë mendim neutral, ndërsa 15.3 % kanë mendim pozitiv

lidhur me këto pyetje. Nëse krahasohen rezultatet nga pyetjet pozitive dhe negative lidhur me interesin e mësuesve për rikualifikim, vërehet se është një mospërputhje rreth 15 %. Mësuesit në pyetjet pozitive, kanë shprehur një interesim më të madh për rikualifikim, ndërsa në pyetjet negative, një numër i mësuesve nuk e ka shprehur të njëjtin interesim.

Lidhur me interesat e mësuesve për rikualifikim për karrierë dhe avancim profesional, 42.8 % e tyre kanë qëndrim pozitiv, 5 % e mësuesve kanë qëndrim neutral, ndërsa 5.2 % kanë qëndrim negativ

Lidhur me gatishmërinë për pagesën e studimeve të tyre, 62.5 % e mësuesve kanë qëndrim pozitiv, 6.6 % kanë qëndrim neutral, ndërsa 30.9 % kanë qëndrim negativ.

Në pyetjen negative, që lidhet me investimet financiare, 50.3 % kanë qëndrim pozitiv, pra nëse dikush i financon ata janë të gatshëm të avancohen, 8.6 % e mësuesve kanë qëndrim neutral, ndërsa 41.1 % e mësuesve kanë qëndrim negativ, e që nënkuptohet se 41.1 % e mësuesve janë në gjendje të paguajnë për këtë. Nëse krahasohen rezultatet e pyetjeve pozitive dhe atyre negative për pagesën e studimeve të tyre, është një mospërputhje prej rreth 20 %.

Mesatarja dhe devijimi standard

Duke u bazuar në rezultatet e paraqitura në tabelën numër 3, kryesisht në rastet kur është mesatarja e lartë, devijimi standard është i ulët, dhe e kundërta, kur është mesatarja e ulët, devijimi standard është i lartë. Në përgjithësi pyetjet që me orientim pozitiv kanë marrë përgjigje pozitive dhe në bazë të rangimit të përgjigjeve vërehet një mesatare e lartë, ndërsa devijimi standard i ulët.

KONKLUZION

Mësimdhënësit janë njerëz të rritur, që punojnë në organizata komplekse të sistemit, shkollës, klasës, lëndës mësimore, drejtimit të shkollës, aktivitet profesional etj.

Atyre iu kërkohet angazhimi i vazhdueshëm i përvetësimit të njohurive teknike dhe profesionale si përforsim i vetvetes identitetin personal me kompetenca për ushtrimin e profesionit, të mësimdhënësit.²¹⁹

Gjatë rikualifikimit ata përfitojnë njohuri dhe aftësi të reja për përdorim në mësimdhënie. Duke rikualifikuar dhe aftësuar mësimdhënësit me kompetenca të reja fuqizohen mësimdhënësit, por kjo varet edhe nga rrethi, pranimi.²²⁰

Rezultatet e hulumtimit kanë mbështetur hipotezën tonë, se mësuesit e shkollave nëntëvjeçare janë shumë të interesuar për rikualifikim në AKM, (Tabela numër 2).

Në bazë të rezultateve të paraqitura, vërehet se në pyetjet pozitive që janë bërë lidhur me **interesin e mësuesve për rikualifikim në AKM**, 92.9 % e tyre janë të interesuar, 3.8 % nuk janë të vendosur, ndërsa 3.3 % kanë mendim negativ për rikualifikimin.

²¹⁹ Munoz-Chrobak, E. (2001), "Conceptualizations of reflection in teacher education," Cornell University, Ithaca, NY.

²²⁰ Cooper, L. & Von Kotze, A. (2000), "Exploring the transformative potential of project based learning in university adult education" *Studies in the Education of Adults*, v. 32, no. 2, p. 212-229.

Në përgjithësi mësimehdhënësit të cilët janë duke vazhduar programin AKM, **kanë një interesim për vazhdimin e arsimit në këtë program.** Interesat e mësimehdhënësve për rikualifikim për karrierë dhe avancim profesional janë ato që vlerësohen me se shumti nga mësimehdhënësit.

Hipoteza ndihmëse e ngritur para fillimit të hulumtimit, se grupmosha e mësuesve 26-35 janë më të interesuar se sa mësuesit e grupmoshave të tjera, për pjesëmarrje në AKM, është mbështetur (grafikoni numër 2), ndërsa hipoteza që ka të bëjë me interesimin për **rikualifikim në AKM, në bazë gjinie** nuk është mbështetur, pasi që mësueset janë më të interesuara se sa mësuesit për arsimin gjatë gjithë jetës (grafikoni numër 1).

Në përgjithësi, mësuesit dëshirojnë të arsimohen, jo vetëm për marrjen e një diplome, por edhe nga dëshira për të mësuar e hulumtuar gjëra të reja ngase aty ju jepet mundësi për përvetësim të kompetencave të reja për mësimehdhënie. (Tabela numër 2)

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se rikualifikimi është i dëshiruar nga mësimehdhënësit por, veçantitë dhe dallimet kanë një kuptim kur flitet për mbështetjen financiare. NE KETE ASPEKT Mësimehdhënësit janë koshient për nevojën e rikualifikimit, por vetëm gjysma e tyre janë të gatshëm të paguajnë vetë për rikualifikim. (Tabela numër 2)

Lidhur me gatishmërinë për pagesën e studimeve të tyre, 62.5 % e mësuesve kanë qëndrim pozitiv, 6.6 % kanë qëndrim neutral, ndërsa 30.9 % kanë qëndrim negativ.

Faktorët tjerë

Në kuadër të arsimit të tyre, mësuesit i paraqesin disa faktorë, të cilët ndikojnë në arsimimin e tyre.

Karriera- Kur vjen në shprehje karriera e mësuesve dhe arsimimin i fëmijëve të tyre, mësuesit, në rend të parë e vendosin arsimimin e fëmijëve të tyre. (Tabela numër 2).

Ndikimi i drejtorit të shkollës

Vlerësimi nga ana e drejtorit të shkollës për trajnimet e kryera është një faktor i rëndësishëm që e kanë potencuar mësuesit. (Tabela numër 2)

Faktori kohë

Pavarësisht angazhimeve të mësuesve, ata janë të gatshëm që kohën e tyre ta shfrytëzojnë për arsimin gjatë gjithë jetës. (Tabela numër 2)

Mësimdhënësi nuk e sheh rikualifikimin si rrezik për vend pune, por si mundësi për zhvillim profesional. SHIH GRAFIKONIN.

Nga analiza e rezultateve mund të përfundojmë se mësimdhënësit në përgjithësi kanë interes për tu arsimuar dhe rikualifikuar në programin e AKM siç mund të shihet nga tabela numër 2.

Rezultatet e këtij studimi mes tjerash e tregojnë rëndësinë e jashtëzakonshme që ka rikualifikimi i mësimdhënësve në shoqëritë e dijes, andaj kërkohet nga Universitetet Kosovare të bëjnë ndryshime të konsiderueshme në sistemin e rikualifikimit dhe të trajnimit të mësuesve, si parakusht për një mësimdhënie cilësore.

Në bazë të rezultateve të paraqitura në tabelën numër 3, mesatarja është 3.55, nga 4 sa është maksimumi, ndërsa devijimi standard është 0.649, ndërsa në pyetjen e dytë lidhur me dëshirën për vazhdimin e arsimimit, mesatarja është 3.55, ndërsa devijimi standard është 0.708.

Në përgjithësi mësuesit, kanë një interesim dhe dëshirë të arsimohen, mirëpo janë edhe faktorët tjerë, të cilët në njëfarë forme paraqesin pengesë për vazhdimin e arsimimit.


Rekomandime për AKM-në

1. Rikualifikimi i mësimeve duhet zhvilluar përmes rrjetit të Universiteteve që merren me rikualifikim të mësimeve.
2. Hartimi dhe publikimi i materialeve për rikualifikim të mësimeve përmes kontributit në publikimin e materialeve.
3. Zhvillimi i ofertës rikualifikuese nga AKM.

SHTOJCA

TABELAT DHE GRAFIKONET

Grafikoni numër 1. Interesimi i mësuesve për arsimin gjatë gjithë jetës në bazë të gjinisë



Grafikoni numër 2. Interesimi i mësuesve për arsimin gjatë gjithë jetës në bazë të moshës




Tabela nr. 1. Besueshmëria e instrumentit të hulumtimit

Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items
.803	.759

Tabela nr. 2. Frekuenca e rezultateve të hulumtimit

	PYETJA KRYESORE	5 Shumë i interesuar %	4 I interesua r %	3 Deri diku i interesua r %	2 Pak i interesua r %	1 Aspak i interesua r %
1	Cili është niveli i interesimit Tuaj për vazhdimin e arsimimit në programin AKM	63.2	29.5	6.6	0.7	0
	PYETJET	5 Plotësisht Dakord %	4 Dakord %	3 I lëkundur %	2 Jo dakord %	1 Aspak dakord %
2	Kam dëshirë të vazhdoj të arsimohem	63.8	29.6	4.6	1.3	0.7
3	Të mësuarit në këtë moshë për mua është qesharake	7.2	7.9	3.9	34.2	46.7
4	Unë jam në gjendje të paguaj për aftësimin edhe arsimin tim	27.0	35.5	6.6	23.0	7.9
5	Arsimi është i	79.6	18.4	0.7	0.7	0.7

Scientific Challenges for Sustainable Development

	rëndësishëm për mua personalisht					
6	Arsimi nuk është për mua dhe njerëzit si unë	7.9	5.3	3.9	35.5	47.4
7	Dëshiroj të kem një nivel të lartë të aftësive dhe një kualifikim të lartë profesional.	72.4	25.0	1.3	1.3	0
8	E shoh edukimin si investim për të ardhmen time	75	22.4	1.3	0.7	0.7
9	Unë preferoj të mësoj me shumë në universitet se sa në trajnime	52	33.6	7.2	6.6	0.7
10	Të mësuarit në profesionin e mësimdhënësit është diçka që duhet të përjetohet si punë e juaja	63.8	32.9	2	1.3	0
11	Me pëlqen ideja e të mësuarit në rrugë të reja si përmes internetit	28.9	52	12.5	3.3	3.3
12	Të mësuarit na nevojitet vetëm që në fund të marrim një certifikatë/diplomë .	5.3	7.2	3.3	35.5	48.7

1 3	Nuk jam i interesuar të marr pjesë në ndonjë formë të arsimit	5.3	6.6	7.9	37.5	42.8
1 4	Unë dëshiroj të marr pjesë në trajnim dhe arsim gjatë gjithë jetës	50.7	34.9	7.9	4.6	2
1 5	Kam dëshirë të hulumtoj, të mësoj gjëra të reja, çfarëdo qofshin ato	63.8	31.6	2	2	0.7
1 6	Nuk kam kohë të shpenzoj për të mësuar më shumë	3.9	9.2	7.9	42.8	36.2
1 7	Nuk kam kohë për arsye familjare të arsimohem,	9.2	9.2	15.1	40.8	25.7
1 8	Preferoj ta shpenzoj kohën e lirë duke bërë gjëra tjera më shumë se sa të mësoj	2	5.9	3.9	44.7	43.4
1 9	Është shumë e vështirë të gjej kohë për të mësuar për shkak të orarit të punës	7.9	23.7	9.2	38.2	21.1
2 0	Dëshiroj të arsimohem por nuk gjej mbështetje	13.8	44.1	10.5	23	8.6

Scientific Challenges for Sustainable Development

	financiare					
2 1	Nuk kam nevojë të arsimohem për llojin e punës që bëj	5.3	8.6	4.6	54.6	27
2 2	Nuk kam kohë të lirë sepse më duhet të merrem me familjen	7.9	19.7	8.6	46.1	17.8
2 3	Unë nuk jam i interesuar të ndjekë ndonjë arsimim ose trajnim	3.9	5.3	6.6	50	34.2
2 4	Kam vullnet për të mësuar nëse paguan dikush tjetër për mua	19.7	23	6.6	36.8	13.8
2 5	Do të ndihesha jo mirë që të mbaja kurs me ndonjë person tjetër.	3.9	14.5	10.5	51.3	19.7
2 6	Jam shumë i vjetër për të mësuar dhe të marr pjesë në trajnime ose kurse.	3.9	7.2	3.9	42.8	42.1
2 7	Benifitet e mia do të ndalen nëse unë nuk trajnohem dhe kualifikohem .	13.2	23	10.5	36.8	16.4
2 8	Nuk e di se ku të shkoj ose ku të pyes rreth fushave të arsimit që unë	3.9	13.8	11.8	51.3	19.1

	dëshiroj					
29	Nuk e shoh rëndësinë e arsimit gjatë gjithë jetës në kushtet aktuale në Kosovë	5.9	18.4	9.9	44.7	21.1
30	Do të bëhesha nervoz nëse do të kthehesha në shkollë/ fakultet përsëri.	5.9	13.2	7.2	50	23.7
31	Nuk e di se cilat kurse do të jenë në interesin tim dhe si do të më hyjnë në punë mua sot.	4.6	18.4	15.8	49.3	11.8
32	Nuk mund të gjej këtu trajnimin që e dëshiroj unë	7.9	17.1	13.2	46.1	15.8
33	Asnjëra nga ofertat në universitet për arsimim nuk më përgjigjet mua.	1.3	7.9	10.5	53.3	27
34	Unë jam i kënaqur me rrogën që marr si mësues nuk më duhet trajnimi shtesë për rritje të pagës	5.3	8.6	11.2	50	25
35	Më shumë jam i interesuar për karrierën time profesionale sesa për arsimimin më	3.3	7.9	1.3	46.1	41.4

Scientific Challenges for Sustainable Development

	të mirë të fëmijëve					
36	Edhe pse kam marr pjesë në disa trajnime, drejtoria e shkollës nuk e vlerëson këtë gjë	21.7	36.8	9.2	23.7	8.6
37	Drejtoria e shkollës nuk interesohet për përmirësimin e mësimdhënies	14.5	23.7	9.2	34.9	17.8
38	Mësimdhënia më jep mundësi që të avancohem profesionalisht	48	47.4	0.7	2	2
39	Unë nuk e di me qartësi atë që pritet nga unë, pas kualifikimit	5.3	15.8	13.2	46.1	19.7
40	Nëse do të kisha mundësi nuk do ta vijoja programin AKM	5.3	7.2	2.6	42.1	42.8

Tabela nr. 3. Mesatarja dhe devijimi standard

Pyetjet	Mean	Std. Deviation	Pyetja	Mean	Std. Deviation
Pyetja 1	3.55	.649	Pyetja 21	1.11	1.062

Pyetja 2	3.55	.708	Pyetja 22	1.54	1.217
Pyetja 3	.95	1.217	Pyetja 23	.95	.989
Pyetja 4	2.51	1.317	Pyetja 24	1.98	1.398
Pyetja 5	3.76	.564	Pyetja 25	1.32	1.070
Pyetja 6	.91	1.198	Pyetja 26	.88	1.048
Pyetja 7	3.68	.569	Pyetja 27	1.80	1.324
Pyetja 8	3.70	.596	Pyetja 28	1.32	1.059
Pyetja 9	3.30	.912	Pyetja 29	1.43	1.183
Pyetja 10	3.59	.602	Pyetja 30	1.28	1.140
Pyetja 11	3.00	.921	Pyetja 31	1.55	1.066
Pyetja 12	.85	1.126	Pyetja 32	1.55	1.178
Pyetja 13	.94	1.117	Pyetja 33	1.03	.902
Pyetja 14	3.28	.936	Pyetja 34	1.19	1.072
Pyetja 15	3.56	.698	Pyetja 35	.86	1.013
Pyetja 16	1.02	1.082	Pyetja 36	2.39	1.293
Pyetja 17	1.36	1.220	Pyetja 37	1.82	1.362
Pyetja 18	.78	.920	Pyetja 38	3.37	.779
Pyetja 19	1.59	1.273	Pyetja 39	1.41	1.130
Pyetja 20	2.32	1.215	Pyetja 40	.90	1.102

LITERATURA

1. Briton, D. (1996), "The modern practice of Adult Education: A Post-Modern Critique", Albany, State University of New York Press.
2. Cooper, L. & Von Kotze, A. (2000), "Exploring the transformative potential of project based learning in university adult education", *Studies in the Education of Adults*, v. 32, no. 2, p. 212-229.
3. Malcolm S. Knowles, Elwood F. Holton III, Richard A. Sæanson, "The Adult Learner, 2005, Gulf Publishing Company, Houston, Texas.
4. Merriam, S. B. (2001), "Andragogy and self-directed learning: Pillars of adult learning theory", *New Directions for Adult & Continuing Education*, v. 89, p. 3-14.
5. Mezirow, J. (1998). On critical reflection. "Adult Education Quarterly", 48(3), 185-198.
6. Munoz-Chrobak, E. (2001), "Conceptualizations of reflection in teacher education", Cornell University, Ithaca, NY.
7. OECD (2000), "Literacy in the information age: final report of the international adult literacy survey", Statistics Canada.
8. *European Journal of Teacher Education*, nr. 1, 2009.
9. *European Journal of Teacher Education*, nr. 2, 2007.

KOMUNIKIMI TELEMATIK NË DIDAKTIKËN E GJUHËVE TË HUAJA

Dr. Renata Martini Kristo

Uu lind në Tiranë më 14 Maj te vitit 1965; studimet e larta universitare I kryen në Romë pranë Universitetit “la Sapienza” ku edhe diplomohet në vitin 1989 në Historinë e Gjuhës Italiane. Që prej vitit 2000 është pedagogë pranë Departamentit të Gjuhës Italiane në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës. Mban gradën “Doktor I Shkencave” të fituar pranë këtij institucioni në vitin 2012.

Abstract

Internet diffusion in the institutions that are traditionally related to formation (such as schools, universities) is designated to introduce theoretic, methodological and organizational novelties of paramount importance in didactics domain.

The scope of this paper, which originates in a systematic exploration of the net in order to establish contacts with world-wide experiences, is to process a system and a taxonomy of the didactic strategies on foreign languages which is due to this; these strategies include all structural levels of a language (phonetics, morphology, lexicon, syntax, textual cohesion) and are of concern taken in their whole for the four of the linguistic skills that are traditionally treated by glottodidactics studies (verbal and written meaning, verbal and written reproduction).

The integration of telematic communication in foreign languages didactics domain, has already paved the way for pretty interesting perspectives. This paper, will describe the reasons that have lead to electronic post choice to communicate in Italian and the objectives of this project. Through the analysis of the foreign language produced via the

electronic instrument will be identified several specific characteristics on linguistic and communicative competence within the telematic framework.

Based on these examples, herein will be highlighted, the most meaningful produced aspects of the foreign language as well as will be analyzed the strategies applied by the students in order to communicate in foreign language on a linguistic communicative competence level basis.

Keywords: e-mail, komunikim i folur, shkruar, strategji, L2.

HYRJE

Përhapja e internetit në institucionet që tradicionalisht kanë qenë të lidhura dhe u janë përkushtuar formimit (shkolla, universitete) ka bërë që në fushën e didaktikës të hyjnë risi të rëndësishme të tipit teorik, metodologjik dhe organizativ. Në mësimdhënien e gjuhëve të huaja, por edhe në atë të disiplinave të tjera, krijohet ndjesia e të gjendurit përballë një mjeti që është i aftë të ndryshojë thellësisht strategjitë didaktike të përdorura deri më tani, por që akoma nuk është arritur një shkallë e tillë qartësimi se si të mund të shfrytëzohet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Qëllimi i kësaj ndërhyrjeje, e cila merr shkas nga një hulumtim i rrjetit me qëllim vendosjen e një kontakti me eksperiencat e kryera në vende të tjera, është ai i përpunimit të një sistemi dhe klasifikimi të strategjive didaktike për gjuhët e huaja që kjo e bën të mundur; të tilla strategji përfshijnë të gjitha nivelet e strukturimit të një gjuhe (atë fonetik, morfologjik, leksikor, sintaksor, kohezion tekstori) dhe prekin në tërësinë e tyre katër aftësitë gjuhësore që tradicionalisht kanë qenë klasifikuar nga studimet glotodidaktike (kuptimi i folur dhe i shkruar, prodhimi i folur dhe i shkruar).

Do të mundohemi të përshkruajmë dhe të diskutojmë arsyet që kanë çuar në zgjedhjen e postës elektronike për të komunikuar në italisht dhe objektivat e këtij projekti. Nëpërmjet analizës së gjuhës së huaj të prodhuar me anë të mjetit elektronik do të identifikohen një sërë karakteristikash specifike të kompetencës gjuhësore dhe komunikative në kontekstin telematik.

Tema e natyrës gjuhësore të komunikimit e-mail, që paraqet karakteristika që i përkasin gjuhës së shkruar përveç aspekteve tipike të gjuhës së folur, është trajtuar gjerësisht në studime të mëparëshme. Në rastin tonë do të përiqemi të analizojmë, karakteristikat gjuhësore dhe ato të përmbajtjes të komunikimit elektronik në italishte mes studentëve që italishten e kanë gjuhë të huaj dhe u përkasin niveleve të ndryshme gjuhësore.

Duke u nisur nga këto shembuj, do të identifikohen dhe do të analizohen strategjitë e përdorura nga studentët për të komunikuar në gjuhë të huaj duke u nisur nga niveli i kompetencës gjuhësore dhe kulturore të gjithsecilit. Një objektiv i dytë i këtij kontributi është marrja në analizë e raportit mes gjuhës dhe përmbajtjes së mesazhit. Nga studimi i e-mail-eve të këmbëra, del qartë në pah se e-mailve më pak të përpunuara dhe të strukturuar nga pikëpamja stilistikore, u korespondojnë, në përgjithësi, mesazhe me një përmbajtje banale dhe sipërfaqësore, gjë që tregon se ekziston një lidhje mes aspektit thjesht gjuhësor dhe atij të përmbajtjes të aktit komunikativ.

Gjatë njëzetëvjeçarit të fundit, teknologjia e e-mail-it, është përdorur me sukses në mësimdhënien e gjuhëve të huaja, veçanërisht në kontekst universitar. Kjo ka sjellë një ndryshim thelbësor të dinamikës së klasës së gjuhës, duke krijuar një ambjent më interaktiv dhe bashkëpunues në të cilin

studenti ndërton vetë mënyrën e të nxënurit Komunikimi elektronik u jep mundësi studentëve të mësojnë dhe të përdorin gjuhën e huaj në mënyrë spontane dhe të natyrshme dhe bën të mundur ushtrimin e aftësisë së të shkruarit me qëllime reale komunikimi, në situata të vërteta dhe motivuese. Sipas studimeve të shumta mbi përdorimin e e-mail-it mes studentëve që mësojnë një gjuhë të huaj, komunikimi elektronik ndikon pozitivisht në cilësinë e gjuhës së prodhuar , duke qenë se bëhet fjalë për një tip teksti që ka karakteristika të gjuhës së shkruar, karakteristika të gjuhës së folur dhe të tjera karakteristika specifike.

Ideja e shfrytëzimit të postës elektronike si mjet komunikimi ka lindur në radhë të parë nga nevoja e qartësimit të problemit të një ndërveprimi të kufizuar gojor në klasat e gjuhës së huaj, në veçanti në fazat fillestare të një kursi. Ndrojtja, turpi, ngurimi në të shprehur dhe në komunikim, edhe në gjuhën amtare, paraqet një pengesë në aktivitetin e të nxënurit të gjuhës, në të gjitha format e saj. Posta elektronike u bë një mjet komunikimi ndërpersonal shumë efikas sepse bëri të mundur, në një kohë relativisht të shkurtër, vendosjen e kontakteve të reja mes studentëve dhe në të njëjtën kohë rivendosi kontaktet dhe miqësitë ekzistuese, duke çuar në këtë mënyrë në heqjen e barrierave psikologjike.

Arsyeja e dytë, jepet nga lehtësia e teknologjisë dhe nga fakti se posta elektronike mund të përdoret edhe në nivele të një kompetence minimale informatike.

Arsyeja e tretë, lidhet me karakteristikat teknike të mjetit: posta elektronike bën të mundur që t'i përgjigjesh drejtpërsëdrejti atij që shkruan, duke ia dërguar dërguesit edhe vetë tekstin e tij të plotë. Kjo lehtëson shkëmbimet në formë dialogu zinxhir, në mënyrë jo shumë të ndryshme nga

një bashkëbisedim, I bërë ky me ritme që sejcili I vendos në mënyrë autonome.

Duke u nisur nga sa më sipër, i vumë vetes këto objektiva pedagogjikë:

- Krijimi i një bashkësie virtuale në të cilën studentët të mos ndiheshin të izoluar, por pjesë e një grupi që po mëson ;
- Motivimi i studentëve dhe inkurajimi që të përdorin një gjuhë të huaj në situata të vërteta dhe me qëllime reale komunikimi ;
- Nxitja dhe stimulimi i komunikimit jashtë klase duke favorizuar një dialog të personalizuar mes studentëve;
- Inkurajimi i studentëve që të përdorin kompjuterin dhe të ushtrohen/mësojnë aftësitë që do të jenë të nevojshme edhe jashtë kontekstit universitar;
- Ndryshueshmëria e formave të vlerësimit në mënyrë të tillë, që t'i lejojë çdo studentin të verë në dukje pikat e tij më të forta.
- Ushtrimi i aftësive gjuhësore të të kuptuarit dhe prodhimit të shkruar dhe zhvillimi i strategjive komunikative specifike në një kontekst të vërtetë komunikimi;
- Nxitja e studentëve më të ndrojtur që të largojnë frikën e komunikimit dhe të të shprehurit duke krijuar një frymë miqësie dhe bashkëpunimi;
- Ta bëjmë më të përgjegjshëm dhe më aktiv studentin;

Baron (1984),²²¹ vëren se, një nga efektet sociale më kuptimplotë të komunikimit telematik është një shkallë pjesëmarrjeje më e lartë se sa ajo e komunikimit gojor. Përveç kësaj vëren se shumë studentë ndihen më rehat sesa kur ndërveprojnë me të folur. Ndikimet, që kjo gjë mund të ketë tek komunikimi në një gjuhë të huaj, janë të qarta. Komunikimi me e-mail u ka dhënë disa prej studentëve më të ndrojtur (atyre që në vetvete nuk do të kishin filluar kurrë vetë të parët, një shkëmbim komunikues), mundësinë e komunikimit në italishte pa u ndjerë në siklet nëse bënë ndonjë gabim në prani të klasës.

Mund të themi se mjeteleletronik ka ndikuar në krijimin e një distance të nevojëshme që studenti të ndihej i lirë të formulonte një mendim që, me shumë gjasa, nuk do ta kishte shprehur në një detyrë tradicionale me shkrim apo në një dialog në klasë.

Falë distancës hapsinore që përmendëm më sipër, mund të evidentojmë një sërë funksionesh metagjuhësore që nuk i gjejmë në aktivitetet tradicionale me shkrim që zhvillojmë në klasë. Fakti që studentët komunikojnë sipas ritmeve personale bën që edhe formulat e përsëritjes të përdorura të jenë të ndryshme nga ato të përdorura nëpër hartimet e shkruara. Për shembull:

- *Finero' qui perche ho niente dire, ed anche devo andare in biblioteca studiare per gli esami*

(do të mbaroj këtu, sepse nuk kam më për të thënë, dhe sepse duhet të shkoj në bibliotekë të studjoj për provimet)

- *...e' tardi e ho sonno.* (...është vonë dhe kam gjumë)

²²¹ Baron, N.S. (1984), "Computer Mediated Communication as a Force in Language Change", *Visible Language* 18,2: 118-141.

- *Vado – ho lezione in uno minuto!* (Po iki – kam leksion për një minutë!)
- *Sono le nove di mattina e ho lezione di storia l'arte fra poco!* (Është ora nëntë e mëngjesit dhe kam leksion historie arti pas pak!)

Shprehje të tilla u ngjajnë shumë atyre tipikeve të një bisede telefonike, tek të cilat folësi ndjen nevojën që të informojë bashkëbiseduesin për situatën e tij personale. Është gjithashtu interesante të vihet re, përdorimi i shpeshtë i atyre elementeve që kontestualizojnë një hapësirë fizike dhe kohore virtuale të njëjtë për bashkëbiseduesit, të cilët dinë se mesazhi mund të merret përnjëherë. Për shembull:

- *Ci vediamo martedì* (shihemi të martën)
- *Ci vediamo in giro!* (shihemi vërdallë!)
- *...ci vediamo a lezione d'italiano.* (shihemi në leksionin e italishtes.)

Strategjitë e aplikuara nga studentët për të komunikuar në gjuhë të huaj kanë si model komunikimin epistolar dhe bashkëbisedimin. Përsa i përket planit të zgjedhjes së strukturave, ngjajshmëria me komunikimin e shkruar, evidentohet tek niveli i lartë i kujdesit morfologjik, sintaksor dhe leksikor dhe ai i koherencës logjike të mesazheve të shkëmbyera, por edhe në një organizim më të mirë të ideve të shprehura.

Afrimi me komunikimin gojor, duket qartë tek përdorimi i shenjave të pikësimit me qëllime enfaze ose ekspresive dhe nga përdorimi i një numuri të madh pyetjesh, por edhe nga prania e shprehjeve tipike, karakteristike të gjuhës së folur, ose sidoqoftë të pranuar në një kontekst të tillë. Kjo sjell një liri më të madhe shprehëse dhe një stil përgjithësisht më spontan dhe të natyrshëm.

Baroni thekson se përdorimi i komunikimit me e-mail, ndikon jo vetëm në tipin e ideve të shprehura, por edhe në mënyrën sesi këto ide shprehen. Studenti ka më shumë kohë, sesa në rastin e një ndërveprimi ballë për ballë, për të reflektuar mbi çka do të shkruajë dhe për të strukturuar mesazhin dhe kjo e lejon atë që të ndërtojë mesazhe më komplekse nga pikëpamja gramatikore dhe më koherente nga pikëpamja logjike dhe strukturore. Është e rëndësishme të vihet re fakti se, kur studentët komunikojnë me anë të mjetit elektronik, stili i ndërveprimeve ngjan më spontan dhe i natyrshëm dhe për shumë aspekte më i ngjashëm me atë të një bashkëbisedimi nëse do ta krahasonim me forma të tjera të komunikimit të shkruar.

Në mjaft raste, tekstet e prodhuara bashkojnë spontaneitetin dhe shpejtësinë, tipike këto të gjuhës së folur, me përzgjedhjen dhe koherencën e gjuhës së shkruar.

Shumë studime kanë pasur si objekt të tyre natyrën gjuhësore të komunikimit me e-mail. Maynor (1994)²²² dhe Bertocchi (1999)²²³, arrijnë në përfundimin se ajo paraqet një konvergjencë mënyrash të shkruara dhe të folura. Disa nga karakteristikat thelbësore të cilat afrojnë komunikimin me e-mail me të folurën janë: përdorimi i një ortografie të thjeshtëzuar dhe përdorimi i shkronjave të mëdha ose të vogla, si edhe shenjat e pikësimit (për shembull pikë çuditëse) me qëllime enfatike dhe ekspresive. Tek mesazhet në italisht vihet re përdorimi i shkronjës së madhe në fillim të çdo fraze. Studentët, ndoshta, ndjenin nevojën e ruajtjes së një farë niveli

²²² Maynor, N. (1994), "The language of electronic mail: Written speech? In G. Little & M. Montgomery, (eds), Centennial usage studies", American Dialect Society, 78: 48-54.

²²³ Bertocchi, D. (1999), "L'e-mail si scrivo o si parlo? Italiano e oltre", 14:70-75.

formaliteti, meqë këto shkëmbime mesazhesh natyrisht do të lexoheshin dhe do të vlerësoheshin nga profesorët.

Një nga karakteristikat më të rëndësishme të komunikimit me e-mail tek folësit italianë (që italishten e kanë gjuhë mëmë), është thjeshtësimi sintaksor. Një formë e tillë thjeshtësimi, e cila duket se i shërben qëllimit për t'u përqëndruar tek përmbajtja më shumë sesa tek forma, nuk shfaqet, në të kundërt, në shkëmbimet në gjuhë të huaj. Gjuha e studentëve të një niveli fillestar, është vetë e thjeshtë, kështuqë nuk lejon një thjeshtësim të mëtejshëm. Edhe pse vlerësohet parimi i një vëmendjeje më të madhe ndaj përmbajtjes sesa ndaj formës, vihet re se gjuha e studentëve, fillimisht shumë e thjeshtë, transformohet, në mjaft raste, në më efikase dhe e përpunuar.

Ndryshe nga çfarë ndodh në komunikimin me e-mail mes italianëve, mund të vemë re se studentët nuk braktisin kurrë tërësisht formulat e përshëndetjes formale. Për shembull:

- ***Ciao S, come stai? Sto molto bene.*** (Përshëndetje S, si je? Jam shumë mirë.)
- ***Buon giorno A, grazie per la tua lettera.*** (Mirëdita A, faleminderit për letrën tënde.)
- ***Come stai? Sono molto molto stanco!*** (Si je? Jam shumë shumë i lodhur!)

Këto tipe shprehjesh i vemë re gjithnjë në mesazhet e shkëmbyera kryesisht mes studentëve fillestarë. Kjo, për mendimin tonë, ka të bëjë me faktin se këta studentë nuk kanë krijuar akoma një bagazh gjuhësor të tillë që t'i lejojë ata të eliminojnë të tilla formula.

Një tjetër aspekt gjuhësor i komunikimit me e-mail i analizuar nga Wang (1994) e Ferrara, Bruner e Whitemore (1991), është përdorimi i një numuri të madh pyetjesh. Fakti se studentët ndihen të lirë të nisin mesazhe dhe të ndërmarrin bashkëbisedimin e tyre virtual në çdo moment, u jep atyre mundësinë e fillimit të një argumenti të ri të bisedës, i cili në dukje mund të mos ketë lidhje me mesazhin e origjinës.

Ky aspekt, i cili del qartë edhe nga mesazhet fare të shkurtëra, lidhet me natyrën dialogjike dhe afër të folurës, së komunikimit, por edhe nga lehtësia dhe shpejtësia me të cilën shkëmbimet mund të ndodhin.

Një nga karakteristikat e komunikimit me e-mail, është ajo e të bërit të mundur që studentët bashkëbisedues të riformulojnë mesazhe të mëparshme. Fakti që studenti mund t'u kthehet pyetjeve të bëra nga shoku, jo vetëm që i jep vërtetësi bisedës, por bën të mundur edhe adoptimin e strategjive të komunikimit shumë më të ndryshme nga ato të përdorura në një letër të shkruar apo në një bisedë gojore.

Një tjetër aspekt që vëmë re është mungesa e shënjesve të rrëfimit, por kjo nuk duhet marrë si një dobësi gjuhësore, për faktin se bëhet fjalë për një komunikim që ngjan shumë me një bisedë gojore, në të cilën aktorët përdorin struktura tipike të të folurës dhe të pranuar në një variant të tillë. Nëse i njëjti mesazh do të jepej gojarisht, ajo që ngjan me një grumbull frazash pa lidhje, do të lidhjej në mënyrë perfekte me pyetjet të cilave po u jepet përgjigje. Mund të themi se, mjete elektronik, e çliron studentin nga detyrimet e vendosura nga gjuha e shkruar dhe e lejon atë të komunikojë thujtë në mënyrë gojore. Është gjithashtu e rëndësishme të vëmë re se, nevoja për t'iu referuar pjesëve të ndryshme të bisedës, nxit studentin të rilexojë mesazhet e marra, duke i kushtuar vëmendje si formës ashtu edhe përmbajtjes.

Thamë më sipër se shenjat e pikësimit si pika çuditëse janë më të shpeshta në këtë tip komunikimi sesa në format e tjera të komunikimit të shkruar. Edhe vetë shkrimi i disa fjalëve me gërma shtypi, si edhe përsëritja e së njëjtës fjalë me qëllime ekspresive apo enfatike, janë tipike të komunikimit elektronik dhe tregojnë “se një frazë është e ngarkuar nga ana emocionale”(Bertocchi 1999)²²⁴. Sidoqoftë, ekspresiviteti, nuk kufizohet vetëm tek aspektet tipografikë të gjuhës, por edhe, gjë sipas mendimit tonë shumë kuptimplotë, tek përdorimi i shprehjeve të veçanta, që studentët ose i kanë fituar në klasë apo në libra, ose thjesht i kopjojnë nga mesazhe të marra më parë.

Analiza e mesazheve të shkëmbyera, lejon që të reflektohet mbi raportin që ekziston mes formës dhe përmajtjes së komunikimit. Mund të vemë re se, mesazheve më pak të përpunuara dhe më pak të strukturuar nga pikëpamja stilistikore, u korrespondojnë, në përgjithësi, mesazhe me përmbajtje banale dhe sipërfaqore, me zhvillim dhe përpunim mendimi të pakët. Bëhet fjalë për mesazhe të shkëmbyera mes studentësh të nivelit fillestar të cilët nuk disponojnë akoma shumë elementë gjuhësorë, për t'u shprehur në mënyrë personale. E-mail-eve më të përpunuara, më të vemendëshme nga pikëpamja gjuhësore, u korrespondojnë shpesh mesazhe më koherente përmbajtje. Në të tilla raste vihet re një nivel më i lartë vazhdimësie në diskutim, i cili zhvillohet në mënyrë logjike dhe koherente duke krijuar dialogje me cilësi

²²⁴ Bertocchi, D. (1999), "L'e-mail si scrive o si parla? Italiano e oltre", 14:70-75.

KONKLUZION

Ndikimet pedagogjike të lidhura me përdorimin e teknologjisë e-mail për të favorizuar mësimdhënien e gjuhëve, janë të shumta. Mundësia për nxënësit që të komunikojnë mes tyre, në gjuhën e huaj, nëpërmjet postës elektronike, përfaqson veçse njërin nga mundësitë e shumta që ofron Interneti. Përfitimet e lidhura me aktivitetet që mund të realizohen në rrjet, janë të shumta dhe, është e padiskutueshme që komunikimi telematik paraqet një mjet të vyer për didaktikën e gjuhëve.

Nëse nga njera anë ekzistojnë dyshime mbi rëndësinë e postës elektronike, mbetet të pyesim veten se, në ç'mënyrë gjuha e atij që mëson mund të ndikohet nga mjete të reja teknologjike dhe në ç'përmasa komunikimi telematik mund të ndikojë në lehtësimin e të nxënurit gjuhësor. Rezultatet që sapo pamë, duket se tregojnë se komunikimi elektronik i jep studentit jo vetëm mundësinë e komunikimit në një gjuhë të re për të në një kontekst të vërtetë dhe real, por edhe vetë ambjenti telematik ndikon në mënyrën në të cilën vetë gjuha paraqitet dhe fiton një forcë të saj nëpërmjet mjetit. Mund të themi se, komunikimi telematik ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive gjuhësore në gjuhë të huaj.

Duke përmbyllur, mund të themi se: përdorimi i postës elektronike në klasat e gjuhës së huaj, nxit pjesëmarrjen e studentëve më të ndrojtur dhe, për shkak se ofron liri në zgjedhjen e kohës dhe të hapësirës, lejon nxënësin të ndërtojë mesazhe më të përpunuara nga pikëpamja gjuhësore.

Në veçanti, janë vënë re disa mospërputhje mes disa karakteristikave tipike të komunikimit me e-mail të atyre që italishten e kanë gjuhën e tyre të parë, dhe mesazheve të studentëve që italishten e kanë gjuhë të huaj. Është shumë interesante të reflektohet se si këto karakteristika mund të ndikojnë

aftësinë e të folurit të nxënësve. Mund të pyesim, për shembull, nëse nxënësit që përdorin shenjues të veçantë të bisedimit, janë më të prirur që t'i përdorin ato edhe në bashkëbisedimin gojor. Baroni (1984)²²⁵ thotë se komunikimi elektronik influencon gjuhën e folur dhe se është e mundur të presim një përmirësim në nivelin e kohezionit logjik dhe gramatikor të bashkëbisedimit gojor dhe se, nga ana e tyre, ato duket se afrojnë shumë me gjuhën e shkruar. Në rastin specifik të një gjuhe të huaj duhet mbajtur parasysh se aftësitë gjuhësore të shkruara dhe gojore të nxënësit, janë natyrisht më pak të zhvilluara sesa ato të folësve të gjuhës amtare dhe se impakti i komunikimit telematik mbi gjuhën, mund të shfaqet në të dyja drejtimet: nga njera anë gjuha e folur mund të ndikohet pozitivisht nga niveli më i lartë i koherencës logjike dhe gramatikore e bisedës së shkruar, ndërsa nga ana tjetër, gjuha e shkruar mund të nxjerrë përfitim nga shpejtësia dhe spontaneiteti i të folurës.

Analiza e këtyre të dhënave ka bërë të mundur nxjerrjen në pah të disa karakteristikave të gjuhës së huaj të prodhuar nga studentët në ambjentin telematik. Këto aspekte janë:

- Një nivel më i madh kujdesi gramatikor dhe koherence llogjike dhe një organizim më i mirë i ideve sesa në bashkëbisedimin përballë njëri-tjetrit;
- Një respektim i përgjithshëm i përdorimit konvencional të pikësimit, por një përdorim i shpeshtë i pasthirmave me qëllim ekspresiv;
- Një stil përgjithësisht më spontan dhe më i natyreshëm sesa ai tipik i komunikimit të shkruar;

²²⁵ Baron, N.S. (1984), "Computer Mediated Communication as a Force in Language Change", *Visible Language* 18, 2: 118-141.

- Një mungesë e formave të thjeshtësimit sintaksor që karakterizojnë komunikimin telematik të folësve të gjuhës amtare;
- Një përdorim i shumtë i pyetjeve të cilat e afrojnë komunikimin me dialogun;
- Një gjuhë më personale dhe shprehëse, qoftë në aspektin tipografik, qoftë në atë të përmbajtjes;
- Një liri më e madhe shprehëse sesa format tradicionale të komunikimit të shkruar dhe të dialogut me gojë.

Integrimi i postës elektronike në didaktikën e gjuhëve, si ndihmesë dhe suport i aktiviteteve të tjera didaktike klasike, paraqet padyshim një vlerë të shtuar me rëndësi si për nxënësin ashtu edhe për mësuesin, në termat e motivimit, përfshirjes, zhvillimit të aftësive gjuhësore, të komunikimit, në një kontekst të vërtetë dhe real, të njohjes me studentë të tjerë, të zhvillimit të aftësive që do të shërbejnë edhe jashtë kontekstit universitar.

Objektivi i këtij kërkimi, i kryer sipas kriterëve gjuhësorë dhe komunikativë, është ai i nxitjes së një reflektimi mbi karakteristikat specifike të kompetencës gjuhësore dhe komunikuese në kontekst telematik, si edhe sjellja e një kontributi në përcaktimin e mënyrës se si komunikimi elektronik mund të integrohet në klasat e gjuhës, me qëllim thjeshtësimin e të nxënurit gjuhësor dhe favorizimin e zhvillimit të aftësive gjuhësore të prodhimit të shkruar dhe të folur.

BIBLIOGRAFIA

1. **Baron, N.S.** (1984). Computer Mediated Communication as a Force in Language Change. *Visible Language* 18,2: 118-141.
2. **Bertocchi, D.** (1999). L'e-mail si scrivo o si parlo? *Italiano e oltre* 14:70-75.

3. **Chapelle, C.A.** (2001). *Computer Applications in Second language Acquisition*. Cambridge: Cambridge University Press.
4. **Gonzales-Bueno, M.** (1998). The effects of Electronic Mail on Spanish L2 Discourse *Language Learning and Technology* 1,2: 55-70.
5. **Halliday, M.A.K.** (1992). *Lingua parlata e lingua scritta*. Firenze: La Nuova Italia.
6. **Harrington, M. & Levy, M.** (2001). CALL begins With a “C”: interaction in computer-mediated language learning. *System* 29: 15-26
7. **Lapp, S.I.** (2000). Using Email Dialogue to Generate Communication in English as a Second Language Classroom. *The Australian Journal of Language and Literacy*
8. 23,1: 50-61.
9. **Maynor, N.** (1994). The language of electronic mail: Written speech? In G. Little & M. Montgomery, (eds), *Centennial usage studies*. American Dialect Society 78: 48-54.
10. **Murray, D.E.** (1988). The context of oral and Written language: A frameWork for mode and medium sWitching. *Language and Society* 17: 351-73.
11. **Passerini, L., Capussotti, E. & Braunstein, P.** (1996). La conversazione online tra oralità e scrittura. In AA.VV.: *Lo strabismo telematico. Contraddizioni e tendenze della società dell’informazione*. Torino: Utet.
12. **Porcelli, G. & Dolci, R.** (1999). *Multimedialità e insegnamenti linguistici. Modelli informatici per la scuola*. Torino: Utet.
13. **Passerini, L., Capussotti, E. & Braunstein, P.** (1996). La conversazione online tra oralità e scrittura. In AA.VV.: *Lo strabismo*

telematico. Contraddizioni e tendenze della società dell'informazione. Torino: Utet.

14. **Spina, S.** (1998). L'uso di internet nella didattica delle lingue straniere: problemi e prospettive.
(<http://www.cilea.it/collabora/GARR-NIR/nir-it98/atti/spina.pdf>)

Regional VET school in Dibra District New generations of VET students require new “educational technologies” to approach labour market. Active Teaching and Learning adapting latest developments on labour market.

Alma SELAMI

Abstract

This paper studies new ways of leading VET Schools into the labor market, analyzing the trade and improving the relations between business and school to create a hospitable climate for business. In order to be effective and efficient, vocational education and learning should be linked to labor market needs to train students as future laborers and to contribute so on to the community welfare.

This present study presents new methods of teaching. For example, e-learning and also integrating theory with practice through internships. Improving the general basic-curricula towards vocational schools. Teachers and instructors should also be trained to structure the new didactic programs, focusing on e-twinning facing and sharing experiences according to the new methodologies and technologies that are required and available.

The study also aims at arguing the need of identifying unknown regional touristic resources, evaluating these assets as an important source to improve community life and encourage people to focus on small businesses and family enterprises, while also preserving and developing traditional cultures as a unique charm.

Another scope of this study is to indicate the routes that must be followed in order to implement the new school profiles, including: general-

curricula adaptability, teachers' training, workshops, laboratories and respective equipment, and financial needs.

This study also includes aspects of how to approach VET to people in the most effective ways, as well as bringing the community to the school. New perspectives and prosperities need to be displayed.

The study concludes with some suggestion future jobs and prosperity in the Dibra area are likely to come from skill-intensive growth, but only if the programs are oriented toward real employment opportunities.

Twining with other regional VET schools in Kosovo and Macedonia will also be valid in sharing experiences to break geographical barriers.

Key Words: Vocational (VET) Schools, Labour Market, E- Learning, E-Twining, Employment Opportunity and Community Welfare.

INTRODUCTION

“You owe it to all of us to get on with what you're good at.” — [*W.H. Auden*](#)

It is our society's responsibility to encourage every person and to help them exploring their potential and skills, so that they can improve and develop personal and professional skills. The Albanian society is faced with serious challenges. Unemployment of young people is in critical levels. Thirty percent of registered jobseekers are young people.

At this point vocational education has its own important role in leading them toward their development. As already known, there is some inequality in the provision of vocational education and training services between rural and urban areas. The rural area population is considered as being fully self employed. Vocational education in rural areas is almost inexistent. Employment services are not at all provided in the rural areas, while such

areas, although underutilized, are one of the greatest economic generators of the country's economy.

Vocational training and education has to be considered as the most efficient way to reduce unemployment and to raise the effectiveness of the labor force. World markets do not currently compete with low cost jobs, but with high professional skills. They show interest in better quality and quantity of products, in reduced overall costs and in the transformation of the economy and the labor force into more competitive in the local, national and international markets.

It is highly important for the labour market to train future workers and contribute to the structural and synergic growth of the socio-economic system.

Finally, the study underlines the importance of enterprise-based schemes in vocational education and training and the relevance of a strategy for skill development. It should be kept in mind that the demand of labor is derived from sound policies that promote investment and job creation to support local communities: education and/or training alone never create jobs. When it comes to demand-related issues of education and/or training, there is always an interesting case of interdependence between supply and demand. What is important is the development of industry-specific education and/or training for employment programs. If improved demand in specific sectors becomes a condition for structural growth, there will be a strong case for more employment, and therefore for more education and/or training offered by public and/or private providers.

Now, what does this mean for all interested factors in Diber district? Education and/or training in different new courses should not be seen as a

means in itself, but rather as a way to find decent work, income and job satisfaction for many target groups: boys and girls, school-leavers and out-of-school youth, unemployed and underemployed, etc.

Future jobs and prosperity in Dibra area are likely to come from skill-intensive growth, but only if the programs are geared toward real employment opportunities. Therefore, a major planning and training effort in close approach to the private sector is required. The proposed way of looking at the future of the VET in Dibra district is the best way of implementing courses of programs in areas where employment linkages are not evident.

1. VET system in Albania

1.1 Introduction

Vocational Education(VET) is the period of studies, with a duration of (2, 3 and 4) years following basic and secondary level of education. By 2009 -2010 (VET) system has a new stucture according to law 10011 dt. 30.10.2008,” For some changes on the law Nr 8872, dt. 29.3.2002, For the Vocational Education System in the Republic of Albania. This structure is also according to the International Standarts of Education (ISCED).

These (2,3 and 4) years of studies could be described as follows:

1. **Level I-*Basic vocational*** is oriented towards a wide-range of vocational/occupational profiles and it lasts two years. It is equivalent to AQF/EQF level 2. It awards a certificate of basic vocational training (partly-qualified employee / assistant) and allows for transition in Level II of VET or to join the labor market. The Frame Curricula contains general education subjects (40%), vocational theory subjects (30%), required vocational modules, (30%), and optional practical modules.

2. **Level II -Vocational education** is oriented towards some vocational/occupational profiles and it lasts one year. It is equivalent to AQF/EQF level 3. Upon completing this level, a certificate of vocational competency for a qualified employee is awarded. At this point, transition to Level III of VET or access to the labor market is possible. The frame curricula comprises general education subjects (30%), vocational theory subjects (20%), and required vocational modules (50%). It is equivalent to the level III of the ACF and the ECF. It provides a certificate of vocational preparation of qualified workers. It allows the transition to Level III of the AP or in the labor market;
3. **Level III -Technical/managerial education** is also oriented towards general vocational/occupational profiles; it lasts 1 year and is also equivalent to AQF/EQF level IV. Upon completion of this vocational education level, pupils take the vocational state exam and the integrated vocational exam. At graduation of level III, a certificate of technician/manager in the relevant profile and the Vocational State Diploma are awarded. Graduates may join the labor market or pursue university or post-secondary studies at Level III (ISCED 3A) as well. In the end of this study level, the pupils are subject to the state vocational examination and State Matura exams. It provides the technician certificate, the state vocational maturity certificate .
4. **Level IV -Post- secondary vocational education** is as an upgraded level oriented towards professional “hands-on” specialization. It lasts 1-2 years after finishing the general or vocational education. It is equivalent to AQF/EQF level 5. Graduates are awarded with the professional diploma (in the specialized vocation) and are qualified to

enter the labour market. Students get 120 credits needed for Bachelor.

In order to be effective and efficient, vocational education and learning should be linked to labor market needs to train students as future laborers and to contribute so on to the community welfare. According to ILO survey (2014), the results showed that for the North Region of Albania, two were the most wanted professions were: Construction Technicians and Hotel Services.

2. “Nazmi Rushiti” as a vocational school, a brief history.

“Nazmi Rushiti” in all its activity aims to achieve the best standards of vocational schools. It also aims to respond to community and students demands on leading them into labor market with professional competencies achieved. It also indicates and educates students to live in democratic coexistence in the context of local and regional integration with courage and entrepreneurial skills.

2.1. A brief history

In 1946 the regional education section decided to open the first pedagogical school with 3 scholastic years. Officially it opened in 1948 with a total of 17 students. 4 years after valuating the importance of education the number of students went 92.

In 2009 was definitely changed from a pedagogical school into a vocational one.

It is oriented in:

1. Economic (2+2) structure
2. Business Administration (2+2) structure

3. ICT (2+2) structure
4. Technical Combined Education (2+1+1) structure

The school has got a great support by the Ministry of Education, the Ministry of Youth and Social Welfare as well as supportive projects by GIZ, ALBIZ , BRITISH COUNCIL, KULTUR-KONTAKT AUSTRIA etc.

2.1. The supply of high vocational school “Nazmi Rushiti”

Actually, the supply with VET graduates to regional labour market is various in profiles but not very considerable in numbers. However, since the scope of our study is the feasibility on opening at least the two new vocational orientations such as healthy social service and forest service. We would also pay attention to the new vocational post-secondary courses Business Management and IT Management.

The supply of high vocational school “N. Rushiti” is about 100 graduates per year on 419 students in four-year education (scholastic year 2014-15).

Nr.	School year	Student	Classes	Student	Classes	Student	Classes	Total	Classes	Student	Classes	Teachers	Teachers	Vice director	Supplying staff
		Viti 1		Viti 2		Viti 3			Viti 4		TOTAL				
1	2013-201	120	5	129	7	121	5	80	3	450	20	20	12	1	9
2	2014-201	142	6	119	6	88	4	70	3	419	19	20	15	1	10

By different surveys we did community demands are on the above orientations we gave.

On these premises, we could foresee that approximately 40 youngsters could be interested in the new vocational post-secondary course dedicated to “Business Management and IT Management”.

In conclusion, these results certify considerably the *desired feasibility* for the opening of two new above mentioned courses. Each course may have 15-20 students wishing to attend a one-year course of post-secondary education “Business Management” or “IT Management”. Therefore, these new courses would be useful because they offer a demand-driven vocational education with high chances to be employed after the end of the vocational education, which proves not only the feasibility but also the sustainability and the utility of these courses in Dibra District.

3. Dibra’s district touristic and cultural potential

Progress towards achieving Albania’s aspired economic development requires also a higher and differently skilled workforce. Working in the modern services and manufacturing sector requires higher skill levels than working in subsistence agriculture. The skills gap is severe in the private sector and the deficit is highest in the technician cadre, though there is a shortage of skills in all occupational categories (managers, professionals, technicians and artisans).

Dibra has got many touristic attractions and it can get benefits from it and these family enterprises can be well developed. Some of them are listed below:

3.1. Natural touristic Potential

Pocest waterfall, Herbel Rock, Kercini Rock, Gradishta e Gradecit, Top of Hynoska, Pasture of Rabdisht, Pasture of Cerjan, Pasture of Zimur, Black Drin Valley, Korabi Mountain, Pasture of Ladies, Cold Water (Vlesha), Grama Lake, Pasture of Grama, Grama Forests, Gorge of Seta (Arras- Cidhen), Gorge of Gjalicave (Cidhen), Pasture of Pllaju, Pasture of Xhaxhisht.

Kala of Scanderbeg, Runja Mountains, Murra with the red stone cave and gorge of Murra, Black drinking fountain, Big pond, Plateau of Runja, Cave of Bulac, Top of Arape, Meadows of Lepusha, Lama e Hunit, Fields of Hasa, Rravzat, Deluj (Water source).

3.2 Cultural and Touristic Potential

Burim Mosque, Kercisht Church, Grezhdan Castle, Kercin Castle, Herbel Churches, Buraviku i Begjunecit, Gradeci Castle ruins (Zdojan), Kullaku Castle (Brezhdan), Churches in Dohoshisht, Kepi i Qytetit, Scanderbeg Museum (Sine), Dine Hoxha Tower, Klan Dera Tower, Elez Murra Towers, Teqja e Sefere (Arap i poshtem), Teqja e Mere (Lishan i Eperrm), Christians Cemetery, Sefer Cani Tower.

3.3 Cultural, social aspects:

Oda Dibrane, Harvest Fair, Gostia Dibrane, the Feast of the cherry, Feast e Bjeshkes (Sllatine), Birthday of Skanderbeg (May 6), the Feast of Drin, The feast of apple.

3.4 Family and small local enterprises

In addition, to above touristic sources the kind of knowledge and skills required to support the evolution towards a more sophisticated economy requires “key competencies/catalytic skills” to the workers on any level and in any profession or occupation.

Што се однесува до синергијата со другите програми и/или организации, може да се напомене дека во моментот Агенцијата е партнер на Програма за развој на Обединетите Нации (УНДП), Агенција за вработување на Република Македонија (АВРМ) и Министерство за труд и социјална политика (МТСП) во националната иницијатива за трансформирање на 700 невработени лица во самовработени. Оваа соработка ќе продолжи и во 2015 година со реализација на нови 950 самовработувања.

Ваучерската програма функционира ефективно во однос на производството на резултати. Сепак, активностите и извештаите за нив се ограничени како резултат на недостатокот на финансиски средства.

- Одржливоста нормално се разгледува во однос на менаџерските, организациските, техничките и финансиските аспекти. Ваучерската програма, според оценка на странските експерти, е добро менаџирана, надгледувана и администрирана со добри вештини и системи. Што се однесува до потребното ниво на услуги, консултантите и советниците во најголем дел се соодветно квалификувани и

искусни. Од институционална гледна точка, организациската структура е соодветна и добро воспоставена.

ЗАКЛУЧОК

Интересот за ваучерската програма укажува на потребата за таква помош кај активните микро, мали и средни претпријатија, дизајнот на обезбедувањето услуги според ваучерскиот систем е успешно адаптиран на условите во земјата за време на фазите на имплементација во 2006-2014 година, и со тоа претставува солидна основа за понатамошна доградба и развој.

Организациската поставеност, каде програмата е раководена централно во АППРМ, имплементирана преку регионалните партнери или ОДП, а давањето на услугите се одвива преку локалните бизнис консултант и советници – обучувачи, функционира доста ефикасно. Меѓутоа, бидејќи програмата не е еднакво распространета на сите региони и бизниси. За таа цел се предлага:

- Да се развие промотивно/комуникациска стратегија, вклучувајќи промотивни материјали и активности. Во овој контекст посебно внимание треба да се посвети на промоција на потенцијалните претприемачи кои се веќе вработени и на т.н. иновативен ваучер, односно ваучери за иновативни фирми, со што би се зголемувала конкурентската способност на малите и средните претпријатија;
- Да се ангажираат повеќе ОДП, за да се овозможи поголема национална покриеност;
- Да се воспостават појаки формални надворешни врски со слични проекти и активности, и да се истражат можностите за кофинансирање;

- Да се подобри квалитетот и квантитетот на бизнис консултантите и советниците – обучувачи во земјата²²⁸;

Користена литература:

1. Извештај за реализација на програмата за поддршка на претприемништвото, конкурентноста и иновативноста на малите и средни претпријатија во 2014 година, АППРМ, јануари 2015
2. М.Стојчев, Љ.Николовски, Прирачник на процедури за спроведување на Програмата за ваучерско советување во малото стопанство и помош при самовработувањето во Република Македонија, АППРМ, 2010

²²⁸ Преку нудење на повеќе проекти за УРБ, поголеми квалификации т.е. професионална акредитација модифицирана база на податоци на АППРМ и зајакнување на капацитетот на националните организации.

Betimi para ligjit si betimi i Hipokratit? Roli i profesionit të juristit në shoqërinë moderne.

Dr. Fatmir Zanaj

Pedagog i Sociologjisë të së Drejtës, Fakulteti i Shkencave Sociale,
Universiteti i Tiranës

Dr Shpetim Cami

Pedagog i Shkencave Politike, Universiteti Nderkombëtar në Strugë,
Maqedoni

Abstrakt

Në periudhën e reformave aktuale në fushën e drejtësisë vendin tonë merr rëndësi përherë e më të madhe kontributi i gjithë aktorëve që përfshihen, nga këndvështrimi sociologjik, në profesionin e juristit si gjyqtarët, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, ekspertët ligjorë, akademikët e së Drejtës etj. Brenda fushës juridike, duke pasur kapacitete të ndryshme në fushën e ekspertizës ligjore, duke pasur pozicione të ndryshme në hierarkinë formale e informale të profesionit ligjor, ata aktorë konkurrojnë midis tyre për realizimin e disa synimeve kryesore si përcaktimi i të Drejtës dhe marrja e vendimeve gjyqësore në përshtatje me ligjin, mbajtja në këmbë e sistemit gjyqësor dhe forcimi i autonomisë e pavarësisë së tij, rritja e ekspertizës dhe e etikës profesionale, lufta kundër dukurive negative të korrupsionit, të manifestuara brenda fushës juridike në role të caktuar të profesionit ligjor.

Në këtë artikull do të trajtohen disa nga deformimet që shfaqen në rolin e avokatit dhe aktorëve të tjerë të procesit gjyqësor në shoqërinë bashkëkohore, të cilat ndikojnë negativisht në deformimin e misionit shoqëror të profesionistit të ligjit dhe dobësojnë pozitën e pushtetit juridik përballë pushteteve të tjerë në shoqërinë demokratike. Këto deformime do të

trajtohen përmes analizës së ecurisë së tre proceseve të bujshme gjyqësore të afro 5 vjetëve më parë, që tronditën opinionin publik shqiptar dhe u bënë objekt i debateve të ashpra mes forcave politike, i debateve e komenteve në shoqërinë civile e në media, por jo në gjirin e juristëve.

Do të trajtohen, gjithashtu, edhe pasojat që sjell moskuptimi si duhet i karakterit të dyfishtë si medium të rolit të juristit, duke u ndalur posaçërisht në rolin e të avokatit, edhe si përfaqësues i ligjit dhe i shoqërisë, edhe si përfaqësues i interesave private të klientit. Kjo analizë i referohet edhe disa rasteve konkrete të disa proceseve që janë zvarritur e vazhdojnë edhe sot e kësaj dite të jenë problematike dhe mjaft të debatueshëm në vendin tonë, që dëshmojnë edhe për ndërhyrjen e pushteteve të tjerë në vendimmarrjen e pushtetit ligjor. Në këtë drejtim do të vihet theksi kryesisht në procese që prekin temën e korrupsionit të zyrtarëve shtetërore, dhe duke abstraguat nga emra konkretë të personave me pushtet politik, do të ndriçohet kontributi që mund të japin juristët profesionistë në parandalimin e asaj dukurie negative që sociologu gjerman Jurgen Habermas e cilëson si "kolonizim të botës jetësore" të njerëzve nga segmente të korruptuar të botës së politikës dhe të biznesit.

Konceptet kyçe: reformimi i sistemit të drejtësisë, profesionisti si medium, profesioni i juristit si ai i mjekut, “sëmundjet” e profesionit ligjor, profesioni dhe ideologjia juridike.

HYRJE

1. Juristi si medium

Pavarësisht nëse është apo jo secili jurist i vetëdijshëm për funksionin e vet social, juristët si grup shoqëror dhe profesional qëndrojnë e veprojnë si medium në mes dy aspekte madhore të strukturës së shoqërisë moderne: ata qëndrojnë në mes dhe ndërmjetësojnë sa herë që lind konflikti midis

autoritetit publik dhe një individ apo një grupi njerëzish, sjellja e qëllimet e të cilëve mund të jenë, por edhe mund të mos jenë në përputhje me normat që autoriteti publik mbron.

Ekspertiza që juristët fitojnë në fakultetet e drejtësisë dhe më pas në punë në veprimtarinë e përditshme në role të ndryshëm si gjyqtarë, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore, avokatë, juristë në ndërmarrje e korporata private etj., e bën këtë grup profesional, nga këndvështrimi sociologjik, një mekanizëm të kontrollit shoqëror. Ashtu si profesioni i mësuesisë ka si një funksion themelor “socializimin” e nxënësve dhe e të rinjve, për të edukuar te ta dhe për t’ua kthyer atyre në bindje e shprehi pritshmëritë e shoqërisë për anëtarin e denjë të saj, duke përdorur edhe instrumentet e “ndëshkimit moral-pedagogjik” për ata që devijojnë nga këto pritshmëri, - edhe profesioni ligjor e kryen këtë funksion, duke synuar t’i mbajë njerëzit në një linjë me normat shoqërore juridike. Por profesioni i juristit shkon edhe më tej: për të “ftohur” mendjet e nxehta të njerëzve që priren drejt sjelljeve deviante e antiligjore, dhe në rastin ekstrem, kur ndodhet përballë akteve e sjelljeve kriminale, profesionisti ligjor merr vendime e zbaton procedura përmes të cilave përcaktohen në mënyrë dramatike fatet e njerëzve të dyshuar për ato sjellje, vendoset nëse janë fajtorë e dërgohen në institucionet e vuajtjes së dënimit, apo janë të pafajshëm e kthehen në gjirin e familjes e të shoqërisë.

Sa më e lartë është ekspertiza ligjore që ata zotërojnë, aq më i qartë, më i vetëdijshëm dhe i suksesshëm bëhet roli i juristëve si medium mes dy aspekteve të lartpërmendur të shoqërisë moderne. Nëse ky nivel nuk është në nivelin e kërkesave të kohës, siç vërehet në mjaft raste te veprimtaria e juristëve shqiptarë, mjaft prej të cilëve hynë në profesionin ligjor përmes kurseve të improvizuar me frymëzime politike-partiake pas vitit 1992, por edhe të tjerë që kanë marrë e vazhdojnë të marrin diploma si “juristë” në

rrugë e në shkolla të dyshimta private, pasi kanë fituar një pozitë të lakmuar në strukturat e biznesit e të politikës, - kjo pengon në realizimin e misionit të tyre si mediatorë shoqërorë. Shkenca na dëshmon se termi i ardhur nga greqishtja antike “nomos”, me të cilin kuptohej “ligji” apo “zakoni”, rrjedh nga rrënja indoevropiane “nemo”, që do të thotë “ndaj”, “veçoj”, “shpërndaj”. Në kohët antike mbreti (rex) kishte pushtetin për të përcaktuar kufijtë, për të vendosur rregullat, pra në kuptimin më të ngushtë për të vendosur se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e padrejtë. Siç shkruante Aristoteli, “...administrimi i ligjit është dallimi i asaj që është e drejtë nga ajo që është e padrejtë”. (Aristotle, NE, f. 81).

Në tërësinë e mekanizmave shoqërorë që realizojnë qeverisjen demokratike, të ashtuquajturin “sundimin e ligjit” në shoqëri, përmes të cilëve ushtrohet ndikimi i gjithanshëm ekonomik e politik, kulturor e juridik mbi legjislacionin dhe veprimtarinë ekzekutive të qeverisjes qendrore e vendore, profesioni ligjor është një nga më të rëndësishmit, në mos, siç shton Parsons, “ndoshta më i rëndësishmi”. (Parsons, T., ed. A. Javier Treviño, 2008, f. 308). Nga pozicioni që mban në tërësinë e mekanizmave të kontrollit shoqëror, profesioni ligjor ka disa karakteristika të rëndësishme sociologjike. Si mediator apo medium, pozita e tij në strukturën shoqërore e politike është ambigue, e dyzuar, sa e varur edhe e pavarur nga shteti. Ligjet, para të cilëve ai betohet e përgjigjet që të zbatojë, janë miratuar zyrtarisht nga shteti. Pjesë të kësaj strukture shtetërore janë gjykatat, ministria e drejtësisë, prokuroria. Edhe avokati si profesion privat, kur paraqitet në gjykatë me klientin e tij dhe luan rolin e vet në spektaklin e procesit gjyqësor, bëhet formalisht në një kuptim “nëpunës i gjykatës”. Nga ana tjetër, profesioni ligjor, që nga kohët e shfaqjes së profesionistëve të ligjit në perandorinë romake, kanë fituar një status të posaçëm, me imunitete speciale, si të pavarur nga autoriteti politik. Madje avokatët nuk paguhen nga

shteti, por drejtpërdrejt nga klientët e tyre. Së treti, në shoqëritë e përparuar demokratike të Perëndimit, edhe shoqatat private profesionale të juristëve e të avokatëve, fakultetet e drejtësisë dhe shoqatat akademike të profesorëve të së Drejtës, luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në rekrutimin, në kurrikulën e shkollimit e të kualifikimit, si dhe në promovimin e anëtarëve të profesionit ligjor. Një praktikë e tillë ende nuk njihet në Shqipëri, dhe kjo ka lehtësuar edhe më shumë ndërhyrjen e tepruar të shtetit dhe të politikës në punët e brendshme të profesionit ligjor, siç vërehet në mjaft nga progres-raportet e Komisionit European mbi Shqipërinë. Në Progres-raportin e KE për Shqipërinë në vitin 2009 thuhej qartë se: “Përpjekjet e qeverisë për të pakësuar pavarësinë e gjyqësorit e kanë politizuar debatin rreth reformës gjyqësore dhe e kanë penguar progresin”. (ALBANIA PROGRESS REPORT, 2009, f. 10)

Praktika dëshmon se janë ekspertët juristë ata që hartojnë ligjet që ligjvënësit i miratojnë në parlament, dhe janë të gjithë aktorët profesionistë ligjorë të roleve të ndryshëm në sistemin e drejtësisë ata që i zbatojnë këta ligje. Kontrata, si instrumenti kryesor funksionues i shoqërisë së hapur të tregut, nuk mund të kuptohet pa rolin aktiv të profesionistëve të ligjit. Pa rolin mjaft të rëndësishëm të juristëve nuk mund të imagjinohet realizimi i marrëdhënieve kontraktore, jo vetëm në fushën ekonomike e të biznesit, por edhe në fushat e tjera joekonomike të shoqërisë së sotme. Profesionit ligjor është fokusi i gjithë makinerisë shoqërore, sepse është instrumenti i përcaktimit dhe implementimit të normave shoqërore që lidhin legjitimitetin, nëpërmjet interpretimit autoritar ligjor, me aplikimin, me zbatimin e detyrueshëm të tyre prej organeve e agjencive politike-shoqërore. Por këto të fundit nuk janë pjesë e sistemit ligjor, në kuptimin më të ngushtë të termit, por janë pjesë e sistemit politik të shoqërisë. Nëse sistemi ligjor është fokusi i gjithë këtij makro-sistemi shoqëror-politik, sistemi i gjykatave, siç shprehej

Talkot Parsons, është fokusi i sistemit ligjor, i sistemit të drejtësisë, sepse gjykatat janë institucionet ndërmjetëse midis sistemeve politike dhe jopolitike, në një kuptim paralel me vendin e rolin e partive politike si institucione ndërmjetëse midis qeverisjes dhe “publikut”. (Parsons, T., ed. A. Javier Treviño, 2008, f. 79). Sociologë të tjerë të së Drejtës praninë e këtij roli ndërmjetës të nënsistemit të gjykatave në tërësinë e sistemit shoqëror e krahasojnë me atë të fushës magnetike që krijon magneti. Forca e ndikimit të kësaj “fushe magnetike” ndihet mbi të gjithë ata që ndodhen në rrezen e saj. Por ata që e përjetojnë “forcën tërheqëse” magnetike përgjithësisht nuk e dinë se cili është burimi i saj. Sepse si rrjedhojë e procesit të racionalizimit, i ashtuquajtur “pushteti i emërimit” të gjërave (prej gjykatave) paraqitet para masës së madhe të njerëzve joprofionistë me pamjen e pushtetit simbolik e të zhargonit juridik që përdorin gjatë proceseve gjyqësore gjyqtarët, avokatët, këshilltarët dhe ekspertët ligjorë etj. Fyerja që shqipton një person privat si një e folur private, kundër një personi tjetër privat, nënkupton vetëm folësin dhe nuk ka ndonjë fuqi simbolike. Ndryshe qëndron puna kur gjyqtari shqipton vendimin, duke e shpallur individin e pandehur sipas kodit binar, - fajtor” apo “i pafajshëm”. Gjykimi prej një trupi gjykues, që vendos për zgjidhjen e një konflikti apo përmbajtjen e negociatave mes personave duke shpallur publikisht të vërtetën rreth tyre, në analizë të fundit i përket klasës së akteve të emërimit apo të institutimit. Ai gjykim përfaqëson në formë kuintesencën e të shprehurit të autorizuar, publik, zyrtar, që është thënë në emër të të gjithëve kundrejt gjithsecilit”. (Bourdieu, P., 1987, f. 838). Ky pushtet i gjykatave është një lloj shprehjeje e vullnetit shoqëror për të ndryshuar botën nëpërmjet transformimit të fjalëve me të cilën ne emërtojmë dukuritë e kësaj bote, të cilat vënë në lëvizje agjencitë ligjzbatuese për realizimin në jetë të këtij vullneti.

2. Juristi si mjeku: përkushtimi ndaj Ligjit si betimi i Hipokratit.

Që nga kohët antike na vjen thënia se ashtu si mjeku shëron plagët e trupit, i urti (filozofi, që zotëron edhe dijen më të thellë mbi ligjin, atë që romakët e emërtuan “jurisprudencë”) shëron plagët e shpirtit. Krahasimi antik midis mjekut dhe të urtit i ka shtyrë sociologët e mëdhenj të ditëve tona të vështronjë e krahasojnë sociologjikisht të përbashkëtat midis profesionit të mjekut dhe profesionit të juristit.

Talkot Parsons (sociologu amerikan më i madh i shekullit të 20-të, ish-profesor i Harvardit) e krahason profesionin e mjekut me profesionin ligjor në dy plane, makrosociologjik e mikrosociologjik. Në planin më të përgjithshëm shoqëror, bazuar në paradigmen strukturaliste-funksionaliste, shfaqjen e deviancës në sjelljen e disa njerëzve apo të grupeve të caktuara shoqërore, ai e konsideron një sëmundje të sistemit, shprehje të dysfunksionit të tij, duke risjellë në vëmendje analizën e Durkheimit mbi sjelljen deviante si premisë të shfaqjes së gjendjes së anomisë. Një shembull i prekshëm i shfaqjes së kësaj “sëmundjeje” nga eksperiencia e vendit tonë ishte anormaliteti informal ekonomik, financiar, i shoqëruar me dhunën politike-policore të pushtetit zyrtar, që e shtynë shoqërinë tonë drejt situatës së anomisë, siç mund të konsiderohet situata e trazirave të marsit 1997, kur strukturat kryesore të shtetit u bënë pluhur e hi dhe sundimi i ligjit u zbeh dhe u zëvendësua gradualisht nga sundimi i kaosit dhe i bandave kriminale.

Ashtu si procesi i hartimit dhe i miratimit të ligjeve prej organeve legislative është, nga një këndvështrim, një lloj mekanizmi i zbutjes dhe zgjidhjes së konflikteve në shoqëri, duke miratuar e imponuar rregullat e bashkëjetesës civile mes grupeve të mëdha shoqërore, ashtu edhe profesioni ligjor, siç shprehej Parsons, “është një lloj vije e “dytë” e mbrojtjes nga rrjedhojat shkatërruese të konfliktit” (Parsons, T., ed. A. Javier Treviño, 2008, f. 312). Në këtë rast profesioni ligjor vepron si një jastëk zbutës në

marrëdhëniet midis organeve të legjislativit, ekzekutivit dhe publikut në tërësi në një shoqëri, duke ndihmuar në përpjekjet për të lënë jashtë ligjeve shfaqjet e paqëndrueshmërisë, të kundërthënieve, të teprimeve dhe deformimeve jorealiste juridike, duke mbrojtur shoqërinë nga interesat e ngushta të ekzekutivit, apo të ndonjë dege të tij.

Krahasimi mes profesionit të mjekut dhe atij të juristit bëhet prej Parsonsit edhe në planin e mikrosociologjik të marrëdhënieve që vendosin me klientët e tyre ekspertët e këtyre dy grupeve të rëndësishme profesionale në veprimtarinë e përditshme. Mjeku qëndron midis klientit të sëmurë, që kërkon të shërohet e të jetojë, dhe sëmundjes së tij, që e rrezikon ta dërgojë atë në botën tjetër. Mjeku është edhe punonjës i strukturave shëndetësore publike, por mund të shërbejë si profesionist edhe në spitalet e qendrat shëndetësore private. Në rastin e parë ai paguhet nga shteti, është përfaqësues i tij në një sferë të veçantë të kujdesit ndaj popullit. Dihet se tërthorazi, përsëri paga e tij krijohet nga të ardhurat e vjela nga taksapaguesit. Në rastin e dytë, për shërbimin privat që bën, ai paguhet drejtpërdrejt nga klienti i tij. Por në të dy rastet, mjeku që ka bërë betimin e Hipokratit dhe i qëndron atij besnik, duke e mjekuar klientin e sëmurë, ai e përgatit atë për të përballuar situatën e tij shëndetësore. Ai nuk mban qëndrime të kushtëzuara nga përkatësia etnike, fetare apo niveli kulturor i personit të sëmurë. Mjeku nuk e gjykon të sëmurin moralisht, ai është tolerant ndaj tij për historinë e shfaqjes së sëmundjes te ai person: ai përpiqet ta shërojë klientin e sëmurë! Edhe në rastin ekstrem, kur sëmundja është në fazën më të përparuar, kur ajo është e pashërueshme dhe i sëmuri i ka muajt apo ditët e numëruara, mjeku përpiqet ta përgatisë shpirtërisht atë të përballët me dinjitet njerëzor me këtë situatë. Si profesionist i vërtetë, ai krijon marrëdhënie konfidenciale të besimit të ndërsjellë me të sëmurin. Fakte specifike të sjelljes të të sëmurit në momentet e dhimbjes së padurueshme

apo të afrimit të çastit fatal, fakte që do të cenonin personalitetin e të sëmurit dhe kujtimin e njerëzve të tjerë për të, mbeten sekret në marrëdhëniet midis mjekut dhe të sëmurit që ai trajton. Mjekut nuk i lejohet ta mashtrojë të sëmurin, t'i krijojë atij dhe të afërmeve të tij pritshmëri të gënjeshtërtë, për të siguruar përfitime materiale apo favore të tjerë të pamerituar.

U desh të kalonin 25 shekuj që të kuptohej se disa nga parimet themelore të betimit të Hipokratit , ndryshe nga ç'mendonte greku i mençur se ata gjenin zbatim vetëm në fushën e mjekësisë (“...having sworn this Oath to the law of medicine, but to no others”), janë të zbatueshëm edhe në profesionin e juristit. Ashtu si mjeku, edhe juristi, me specifikat që ka secili rol brenda profesionit ligjor (gjyqtar, prokuror, avokat, këshilltar ligjor, jurist në një biznes etj.) paraqitet si ndërmjetës midis shtetit e ligjit, nga njëra anë, dhe interesave të klientit që përfaqëson, nga ana tjetër. Ky pozicion i juristit duket më i qartë në rolin e tij si avokat, ku shpalolet më qartë thelbi i profesionit si “një entitet që depërton mes kufijve të kapaciteteve dhe përgjegjësiive publike dhe private”. (Parsons, T., ed. A. Javier Treviño, 2008, f. 312).

Ashtu si mjeku përpiqet të qetësojë klientin e vet të sëmurë dhe t'i heqë atij stresin e frikën për fatin që e pret, edhe avokati bën të njëjtën gjë me të pandehurin. Duke ndërtuar marrëdhënie konfidenciale të besimit të ndërsjellë, ai e përpiqet ta bindë klientin e vet se të drejtat e tij janë të mbrojtura nga ligji dhe prej veprimtarisë së avokatit të tij. Ashtu si i sëmurit flet hapur para mjekut të vet, edhe i pandehuri në atmosferën e mirëbesimit flet hapur për jetën e vet, për veprën penale që ka kryer, për motivet e veprimit dhe frikën e ndëshkimit. Çfarë i pohon ai avokatit mbetet një sekret profesional i këtij të fundit. Juristi, avokati, pasi njuh në detaje veprën penale që ka kryer klienti i tij, pasi është krijuar atmosfera e mirëbesimit mes tyre,

përpiqet t'i sqarojë klientit të tij se në cilët elementë do të insistojë mbrojtja ligjore, pa i fshehur të pandehurit edhe pikat e dobëta të saj, sipas një strategjie të përgatitjes shpirtërore-psikologjike të pranimit me dinjitet të ndëshkimit të merituar ligjor për veprën e kryer, por jo tejkalimin e tij. Përveç ndikimit në substancën e sjelljes të të pandehurit, avokati e përgatit dhe e drejton sjelljen e klientit të vet edhe nga pikëpamja e formës, për të respektuar ritualin e procesit gjyqësor dhe procedurave të gjyqimit në gjykatë.

Që të bjerë dakord me vullnet të lirë “për të luajtur lojën” sipas kërkesave procedurale, avokati e bind klientin e tij që të njohë ligjin si mjetin e vetëm të zgjidhjes së konfliktit në çështjen e tij, “të adoptojë në heshtje një mënyrë shprehjeje dhe diskutimi që nënkupton heqjen dorë nga dhuna fizike dhe nga format elementare të dhunës simbolike, siç janë fyerjet;... të pranojë kërkesat specifike të konstruktimit juridik të çështjes.” (Bourdieu, P., 1987, f. 831). Avokati, profesionisti ligjor, e josh klientin e vet me “shpërblime manipuluese”, përmes të cilave ai ndikon në një masë të madhe mbi sjelljen e klientit të vet. Ky ndikim, sipas analizës së Parsonsit, sigurohet jo vetëm nëpërmjet asaj që klienti “arrin” të fitojë, pra diçka që ai shpresonte ta fitonte kur vendosi t'i drejtohej për këshillë avokatit, juristit, por edhe nga impakti i qëndrimit të juristit, nga takti që i krijon atij bindjen legjitime për arritjen e asaj që është e ligjshme në favor të tij, ndërsa i janë refuzuar qëllime të tjerë jo legjitime, i është refuzuar ndihma për arritjen e tyre.

Njeriu i thjeshtë, personi që nuk e njeh profesionin ligjor, nuk arrin dot t'i kuptojë të gjitha sekretet e profesionit të juristit, po ashtu si edhe ato të mjekut. Sekreti i arsytimit gjyqësor është një shembull i mistifikimit profesional. Duke e shtrirë këtë karakteristikë edhe për profesionin e mjekut, Richard Posner shprehet se, “profesione të tillë si drejtësia dhe mjekësia

ofrojnë shërbime të rëndësishme që janë të vështirë për t'u kuptuar e vlerësuar nga personat jashtë këtyre profesioneve". (Posner, R., 2010, f. 3). Edhe në planin akademik, siç shprehet filozofi i shquar anglez i së Drejtës H. L. A. Hart, literatura e gjerë që i kushtohet përgjigjeve të kësaj pyetjeje "ç'është e drejta?" e lë në bisht çdo literaturë tjetër që merret me përgjigjet e pyetjeve të tilla për disiplina të tjera, duke përmendur edhe faktin se pohimet e juristëve dhe filozofëve të ndryshëm rreth kësaj pyetjeje "janë njëherazi ndriçuese dhe çorientuese". Hart, H. L. A., 2000, f. 13, 14).

Posner mendon se profesionistët e këtyre dy fushave e pëlqejnë këtë aureolë mistike që rrethon profesionin e tyre, sepse ajo i ndihmon ata që ruajnë një status të privilegjuar në shoqëri. Por që ta fitojnë e ruajnë këtë status, ata duhet të përballen me mosbesimin laik të qytetarëve ndaj këtij misticizmi profesional, duke ekzagjeruar përpara syve të njerëzve jo vetëm aftësitë profesionale, por edhe çinteresimin e tyre në planin moral ndaj vlerave materiale. Ja përse janë ndoshta deficitet në ekspertizën dhe në integritetin moral të një masë të konsiderueshme e anëtarëve të këtyre dy profesioneve në shoqërinë tonë, të mjekët dhe juristët shqiptarë, që i kanë bërë qytetarët tanë të shprehen me nota aq negative për ta në sondazhe të ndryshme. (Shih UNODC 2011, f. 7, 20).

3. "Sëmundjet" e profesionistit ligjor rrezikojnë të sëmurin gjithë sistemin shoqëror e juridik, - rasti i vendit tonë.

Është e njohur se temperatura e lartë e një personi të sëmurë rrezikon të rëndohet më shumë, nëse mjeku që bën diagnozën e saj është vetë i sëmurë me temperaturë të lartë. Kur aktorët e ndryshëm të profesionit ligjor preken nga tri "sëmundje" që Parsons i emërton "presioni nga ana e klientëve, sentimentalizmi ndaj tyre dhe formalizmi" (Parsons T., ed. A. Javier Treviño, 2008, f. 306) atëherë në veprimtarinë e tyre profesionale shfaqen

sjellje deviante që i largojnë juristët nga roli i tyre si medium, nga pozita e tyre strukturore si mediatorë midis autoritetit publik dhe një individi apo një grupi njerëzish, që mund të jenë klientë të tyre. Ky deformim strukturor dëmton rëndë funksionimin e sistemit të drejtësisë, për rrjedhojë edhe sistemin shoqëror në tërësi. Pra mund të themi së është pothuaj një ligjësi sociologjike njëloj lidhjeje e ndërlikuar midis sëmundjeve të profesionit të juristit në një shoqëri të hapur dhe sëmundjeve të mbarë sistemit shoqëror si pandëshkueshmëria e veprimtarisë kriminale, korrupsioni, degradimi i standardeve morale dhe të eficiencës në tërë fushat e administrimit ekonomik, politik, kulturor etj.

Juristët janë pjesëmarrës së lojës së tregut në shoqërinë aktuale, apo sipas opinionit të Posner, ata mund të konsiderohen si “punonjës, pra si pjesëtarë të tregut të punës, ndonëse një treg pune mjaft i pazakontë, - po sidoqoftë një treg pune” (Posner, R., 2010, f. 57). Dihet, si çdo punonjës, edhe ata tundohen nga interesi për të siguruar të ardhura financiare sa më të mëdha. Nga një anë, ata janë punonjës, si p.sh gjyqtarët, që i rekruton në punë, - KLD i kryesuar nga Presidenti i Republikës, nga ana tjetër ata punojnë me klientët privatë, ndër të cilët qëllon shpesh të jenë edhe biznesmenë të pasur. Një klient i pasur si R. T, biznesmen i njohur në vendin tonë, i afërt me qeverinë e asaj kohe, në vjeshtën e vitit 2009 dhunoi fizikisht një gazetar të njohur, M. B., të një gazete me emër në shtypin shqiptar. Anëtarët e trupit gjykues të Gjykatës së Tiranës, avokati i z. R.T., kishin një rast të shkëlqyer të provonin se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit në Shqipëri, kishin një rast për t’i dhënë një mësim të çmuar gjithë njerëzve të pasur të këtij vendi se pasuria e tyre nuk mund dhe nuk duhet të jetë burim i arrogancës dhe i dhunës ndaj njerëzve të thjeshtë, nuk duhet të drejtohet kundër fjalës së lirë si një e drejtë themelore e njeriut, se duhet ndëshkuar cinizmi i ndonjërit prej

tyre në trajtimin përbuzës të atyre që i mbrojnë këto vlera të shoqërisë demokratike. Por paratë e z. R.T dhe mbështetja politike për të nga qeveria e kohës e shtynë gjykatën e Tiranës dhe avokatin e atij zotërie ta deformatojnë procesin e ta shpallin atë person “të pafajshëm”. Kur z. R.T, përmes një letre dërguar ambasadorit amerikan, guxoi që të sulmonte qëndrimin aktiv të tij në mbështetje të fjalës së lirë në Shqipëri, ambasadori Withers iu përgjigj atij me këto fjalë: “nëse letra juaj ka për qëllim të shkurajojë zyrtarët e ambasadës apo mua për të mos folur publikisht në raste të ardhshme mbi çështje të tilla parimore si liria e shtypit apo sundimi i ligjit, druaj se më duhet t’ju zhgënjej.” (Shqip, 2009, f. 1). Interesi i publikut, i shprehur në sundimin e ligjit dhe lirinë e shprehjes duhet të ketë epërsi ndaj interesit të një individi, sado e fryrë të jetë kuleta e tij. Në instancë të fundit, kjo është edhe në interesin individual si të juristit, edhe të klientit të pasur, sepse vetëm kështu shmanget shndërrimi gradual i gjendjes së shoqërisë nga demokratike dhe me liri shprehjeje, në një gjendje që Platoni e demaskoi 25 shekuj më parë, duke e cilësuar atë si padrejtësi, - sepse “padrejtësia, kur arrin në një shkallë të mjaftueshme fuqi, e ndjen veten më të fortë, më të lirë, më absolute se Drejtësia”. (Platoni, 1999, f. 34-35).

Tundimi nga qesja e parave dhe deformimi prej sentimentalizmit në sjelljen e juristit, të avokatit bëhet edhe më i qartë po të analizojnë rastin e procesit gjyqësor ndaj ish-ministrit L. B në vitin 2009. Mbështetur në denoncimin e bërë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), sipas prokurorisë, dy të pandehurit- ish-ministri dhe një vartës i tij, akuzoheshin se në bashkëpunim me njëri-tjetrin kishin kryer veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Shkeljes së barazisë në tender apo ankand publik” në rastin e ndërtimit të autostradës Durrës-Kukës, duke i sjellë dëm shtetit shqiptar në një shifër rreth 230 milionë euro. Mirëpo juristët e Gjykatës së Lartë, të

ndikuar nga prapavija e fuqishme ekonomike e politike e z. L. B., si edhe nga sentimentalizmi politik, nga afria ideo-politike me partinë politike që ai përfaqëson, hodhën poshtë vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke e mbyllur atë çështje të bujshme me argumentin e “shkeljes së afateve hetimore nga ana e prokurorisë”. Me këtë veprim, juristët dhe avokatët e kësaj çështjeje iu imponuan Gjykatës së Lartë të marrë një vendim, sipas të cilit ish-ministri L. B as u shpall “fajtor”, por as u shpall “i pafajshëm”! Ndërsa 230 milionë euro dëm financiar u hodhën mbi shpatullat e taksapaguesve shqiptarë, që do të paguajnë borxhet e marra nga qeveria për ndërtimin e rrugës Durrës-Kukës. Me siguri, juristët e avokatët që i shërbyen klientit të tyre, i kanë bërë mirë llogaritë e veta, në mënyrë që fitimi që ata kanë marrë, si financiar dhe politik, të jetë më i madh sesa pjesa që ata do të paguajnë në formën e taksave për të larë borxhin e qeverisë për atë rrugë, po ashtu më i madh sesa edhe përbuzja nga njerëzit e thjeshtë e të ndershëm të këtij vendi për mbulimin e një vjedhjeje të përmasave të mëdha.

Në rastin e lartpërmendur së fundi del në pah edhe shfaqja e tretë e “sëmundjes” së juristit, - rendja pas teknikaliteteve procedurale, legalizmi formalist, që çojnë në injorimin e elementit ideal të ligjit, të vlerave dhe të frymës së tij, duke mbivlerësuar shkronjën e ligjit. Interesi publik kërkon që të gjendet se ku kanë shkuar 230 milionë euro, dhe qëllimi i ligjit është plotësimi i këtij interesi, që qëndron mbi çdo lloj hollësie procedurale, shkelja e të cilës gjithashtu nuk duhet lejuar nga asnjëra palë, sepse dëmton natyrën e procesit të drejtë gjyqësor dhe respektimin e të drejtave të personit të pandehur, i prezumuar “i pafajshëm” për sa kohë që gjykata nuk është shprehur ndryshe. Të tilla teknikalitete të një lloji tjetër mbivlerësoi gjykata e Tiranës në vitin 2010, kur ndëshkoi me një gjobë marramendëse prej 400 mijë eurosh një televizion kombëtar jopublik, që transmetoi videon e

skandalit seksual të ish-ministrit Y. P. Ndërsa katër vjet më pas, në 25 mars 2014 një trup tjetër gjyqtarësh të Gjykatës së Tiranës e konsideruan të paplotë hetimin gjyqësor të vitit 2010, duke shpallur arsyetimin se transmetimi televiziv i asaj videoje “nuk përbën shkelje të privatësisë”, bazuar në tolerancën që funksionarët shtetërorë (në rastin në fjalë, Gjykata) duhet të kenë ndaj lirisë së medias dhe të shprehjes së lirë, atëherë kur çështja është me interes publik. (Shqip 2014, f. 1). Por ndërsa disa juristë korrigjuan vendimin e gabuar të tre vjetëve më parë të kolegëve të tyre të Gjykatës së Tiranës, ka mbetur i paqortuar vendimi i qeverisë shqiptare, që edhe pasi e shkarkoi nga detyra ish-ministrin në fjalë, pak muaj më pas atij skandali e emëroi atë në një funksion të lartë në administratën shtetërore. Ky veprim përbën një shkelje të rëndë të moralit shoqëror, i cili nuk shkon e nuk duhet të shkojë kundër frymës së ligjit. Në këtë rast siç shprehej filozofi i njohur amerikan i së Drejtës Lon Fuller, ligji “duhet t’i drejtohet kushëririt të tij nga gjaku, moralit të detyrës”. Standardi moral i një funksionari publik duhet t’i përgjigjet moralit të aspiratës së njerëzve të thjeshtë për një shoqëri të drejtë, të ndershme e demokratike. Nëse ligji hesht, atëherë e ngre zërin morali, sepse në rastin konkret të lartpërmendur, paga e atij funksionari që u kishte kërkuar disa vajzave favore seksuale në këmbim të vendit të punës, krijohet nga taksat e taksapaguesve shqiptarë, pra edhe nga të ardhurat e prindërve dhe e të afërmve të atyre vajzave. Në të gjitha rastet, bie në sy se shfaqjet e këtij sentimentalizmi politik dhe të rendjes pas teknikaliteteve procedurale manifestohen nga juristë e avokatë që publiku i njeh në jetën e përditshme për qëndrimet e tyre të njëanshme politike-partiake.

Për këtë arsye, fakti sociologjik i aleancës midis juristëve të tillë me krahe të ndryshëm të elitës politike, i shtyn në shumë raste politikanët që të bëjnë deklaratat në parlament “për rrezikun e cenimit të sigurisë juridike, për

respektimin e pavarësisë së gjyqësorit, që i merr vendimet në bazë të ligjit dhe të fakteve”, pikërisht atëherë kur juristë të tillë kritikohen apo sulmohen nga pala tjetër politike. Një shembull i tillë është rasti i gjyqtarit të Gjykatës së Apelit E. G., të sulmuar nga një ministër i qeverisë aktuale, z. S. T., por i mbrojtur në një konferencë shtypi të transmetuar në edicionin kryesor të lajmeve prej disa televizioneve në 9 prill 2014 nga një parlamentar i opozitës, z. O. B., me argumente të frymëzuar nga filozofia formaliste - legaliste. Politikanët që përzihen në punët e gjyqësorit nuk mbajnë parasysh se edhe filozofi i shquar gjerman i së Drejtës Gustav Radbruch, - duke e konsideruar sigurinë e dhënies së drejtësisë si tiparin e katërt të formulës së tij mbi ligjin (e ashtuquajtura “formula Radbruch”), - shtonte se me gjithë rëndësinë që ka siguria e dhënies fund të një konflikti gjyqësor përmes një zgjidhjeje ligjore, është “më e rëndësishme që ai fund të jetë një fund i drejtë”. (Gustav Radbruch, cituar nga Stanley L. Paulson, 1995, f. 490-491). Juristi, avokati si medium, i ndodhur në kufijtë ku pulsojnë dy anët e një kundërtie, midis interesave të klientit keqbërës, dhe komunitetit që kërkon respektimin e ligjit dhe të moralit shoqëror, e ka vetë në dorë lirinë e zgjedhjes. Në ditën e diplomimit të studentëve të drejtësisë në universitetin e Uashingtonit, profesori i Harvardit, Duncan Kennedy i ftuar në atë ceremoni i këshillonte juristët e rinj në rolin e avokatit: “Nëqoftëse ju mendoni se klienti juaj po përpiqet të bëjë diçka të tmerrshme dhe dëshiron të përdorë aftësitë tuaja si juristë për të bërë të keqen, ju nuk keni arsye që ta merrni përsipër mbrojtjen e tij, me përjashtim ndoshta kur gjykata ua ngarkon me detyrim atë çështje. E drejta juaj për ta refuzuar një çështje shkon përtej së drejtës tuaj për të mos bërë diçka që do ta ndihmonte një person me qëllime të liga... Ju duhet të ndiheni fajtor, dhe neve do të na keni kundër, nëse ju bëni përpara dhe përfaqësoni një rast që ju mendoni do të sjellë më shumë dëm sesa mirë (për shoqërinë, FZ). Ju nuk duhet ta merrni përsipër atë

çështje nëqoftëse ju mendoni se do të ishte më mirë për shoqërinë, apo se do të ishte më e moralshme që klienti juaj ta humbiste atë...Ju nuk duhet ta merrni përsipër çështjen edhe në rastin kur kjo përputhet me ushtrimin e të drejtave ligjore prej klientit tuaj, por ai është duke i përdorur të drejtat e tij ligjore për një kauzë të keqe”. (Kennedy, D., 1987, f. 1158)

Sepse ideali i ligjit, qëllimi final i tij, pra edhe i profesionistit të ligjit, është triumfi i drejtësisë. Të gjithë elementët formalë-proceduralë, të ashtuquajturit teknikalitete procedurale etj. të ecurisë së zhvillimit të procesit të drejtë ligjor, janë në shërbim të këtij qëllimi final të ligjit në një shoqëri demokratike. Këtu juristët janë më shpesh, ndoshta janë zakonisht, siç shprehej Kennedy, “më shumë sesa teknicienë të ligjit”. (Kennedy, D., 1987, f. 111160). Jo vetëm në sistemin anglo-sakson të të ashtuquajturit “Common Law”, por edhe në sistemin evropian të së Drejtës Civile, të cilët ka kohë që po përafrohen mes tyre, ata janë negociatorë dhe i japin formë kontratës, ligjit dhe marrëveshjeve të ndryshme, shpikin forma të reja të jetës shoqërore, mbushin boshllëqet e saj, zgjidhin konfliktet dhe rastet e dykuptimë. Në kushtet e një shoqërie demokratike, ideali, qëllimi i ligjit dhe elementët teknikë të tij janë të lidhur ngushtë midis tyre. Dhe siç shprehej dikur juristi e filozofi i njohur amerikan i së Drejtës Karl Llewellyn, “idealet pa teknikalitetet janë një çorbë konfuze. Por teknikalitetet pa idealet janë një kërcënim”. (Cituar nga Dinh, Viet D., 2005, f. 38).

4. Ndikimi i ideologjisë juridike në veprimtarinë e juristit profesionist.

Kur Talkot Parsons e shihte profesionin ligjor nga këndvështrimi sociologjik si element të kontrollit e të integritimit shoqëror, trajtimi i zgjeruar holistik i rolit të këtij profesioni në shoqërinë demokratike u kritikua nga qarqet e majta e liberale të shoqërisë amerikane. Sulmi kundër Parsonsit dhe

paradigmës strukturaliste-funksionaliste bëhej nga brenda spektrit të gjerë të ndjekësve të teorisë së tij, diferencat në mes të të cilëve, siç shprehej sociologu Alvin W. Gouldner ishin të mëdha dhe nxitën entropinë e teorisë parsonsiane. Madje në periudhën brezhnjeviane, edhe në ish - bllokun sovjetik, nevoja për mbështetjen e forcave shoqërore që nxisnin integrimin shoqëror dhe statuskuonë funksionale sistemike, siç e trajton gjerësisht këtë dukuri Gouldner, nxiti afrimin e pozicioneve teorike marksiste zyrtare me ato funksionaliste-strukturaliste. (Shih Gouldner, Alvin W., 1980, f. 545-601). Transformimi “ideologjik” i teorisë funksionaliste në mjaft prej ndjekësve të shumtë të saj i hapi rrugën teorizimeve neomarksiste të frymëzuara nga paradigma e konfliktit në radhët e profesoratis universitar të vendeve perëndimore në vitet 70-80 të shekullit të kaluar, siç konstatonte edhe ish-presidenti amerikan Richard Nixon, kur përmendte “praninë e zhargonit marksist në shumë universitete amerikane”. (Nixon, Richard, 1992, f. 234). Por shembja e regjimeve komuniste dhe komprometimi i mjaft koncepteve të huazuara nga teoria marksiste ka nxitur në ditët tona përpjekjet për rishikimin dhe rivlerësimin shkencor të teorisë funksionaliste të Parsonsit, sidomos qasjen e tij të veçantë mbi të Drejtën nga këndvështrimi i teorisë së sistemit shoqëror, “që ka qenë gjerësisht e neglizhuar”, siç shkruan me nota kritike sociologu amerikan i së Drejtës, Treviño. (Parsons, T., ed. A. Javier Treviño, 2008, f. 1).

Kur sociologjikisht interesohemi për njohjen e thelbit e të rolit të ideologjisë juridike në sjelljen e profesionistëve të ligjit në rolet e tyre të ndryshme në fushën juridike, kemi parasysh jo vetëm kuptimin konvencional original të termit “ideologji”, të cilit i referohet edhe kolegu ynë i nderuar A. Fuga kur shkruan për mekanizmat “që kryejnë transformimin e shkencave shoqërore dhe humane në një tërësi perspektivash manipuluese dhe propagande, pra i shndërrojnë në ideologji”, duke e konsideruar këtë si “një

përprjekje për të manipuluar publikun dhe për t'u vendosur në shërbim të një politike si formë propagande”. (Fuga, Artan, 2011, f. 14). Sociologjikisht duhet bërë dallimi midis ideologjisë juridike dhe ideologjisë gjyqësore. Ideologjia juridike lidhet më shumë me aspektet e kuptimit specifik të profesionit ligjor, me neutralitetin e ligjit e pavarësinë e sistemit të drejtësisë në një shoqëri demokratike, që është e vështirë për t'u kuptuar e vlerësuar nga njerëzit e thjeshtë jashtë këtyre profesioneve. Fjala vjen, njeriu i thjeshtë që udhëton në bulevardin “Gergj Fishta” për të shkuar te Gjykata e Tiranës e ka të vështirë të rrokë thelbin e sofistikuar të arsytimit ideologjik të filozofit ligjor Joseph Raz, se respekti i qytetarit për ligjin është burimi i detyrimit të tij për t'iu bindur atij, se respekti i madh kundrejt ligjit në një vend, mund të kërkojë kundërshtimin po aq të madh dhe aktiv ndaj ligjit në një vend tjetër, një gjykim që mund të na duket paradoksal. Apo gjykimin se respekti ndaj ligjit është një dukuri komplekse, që nënkupton dy elementë, respektin konjitiv (njohës) dhe respektin praktik. “Respekti njohës lidhet me vlerat e ligjit, vlera që i respekton dhe për të cilat krenohet qytetari me ligjet e vendit të vet”. Ndërsa respekti praktik shprehet, për shembull, “në ngurrimin e qytetarit për të përkrahur propozime për ndryshimin e strukturës së organeve të drejtësisë, pa pasur arsye të forta legjitime për ta bërë këtë gjë...” (Raz, J., 2009, f. 250, 251)

Ndërsa ideologjia gjyqësore, e shprehur në rastet konkrete të proceseve gjyqësore, lidhet më shumë me kuptimin konvencional të ideologjisë. Por edhe ideologjia gjyqësore është një dukuri komplekse. Studiuesit ligjorë kanë identifikuar herë tre modele të shpjegimit të sjelljes së juristëve, gjyqtarëve e avokatëve në arritjen e vendimeve gjyqësore, atë “legal”, “sipas qëndrimit ideopolitik” dhe atë “strategjik apo të zgjedhjes racionale” (Shih Fischman, J., Law, David S., 2009, f. 139), herë kanë identifikuar nëntë modele të tillë, siç bën profesori ligjor i universitetit të Çikagos, Posner, duke shtuar në tre

modelet e lartpërmendur edhe atë sociologjik, psikologjik, ekonomik, organizativ, pragmatik, fenomenologjik, dhe së fundi, atë legalist. (Posner, R., 2010, f. 19-56)

Po sa ndikon kjo lloj ideologjie gjyqësore dhe politika në sjelljen e gjyqtarëve dhe avokatëve tanë në ditët tona? A është ndikimi ideo-politik një nga faktorët më të mëdhenj të deformimit të sjelljes së tyre, të shfaqjeve të njëanshmërisë dhe të korrupsionit në procesin e marrjes së vendimeve gjyqësore? Mënyra sesi është ndërtuar sistemi institucional i drejtësisë në vendin tonë e ushqen rritjen e ndikimit ideopolitik mbi sjelljen e profesionistëve të ligjit. Përderisa politika dikton zgjedhjen në parlament të anëtarëve të Këshillit të lartë të Drejtësisë, kryetar i të cilit është Presidenti i Republikës, ish anëtar i udhëheqjes së lartë të një partie politike, vërtetohet ajo që konstatoi në prill të vitit 2014 juristi britanik Joshua Rozenberg, se “pengesa më e madhe për reformën (në sistemin e drejtësisë duket se është Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i cili është përgjegjës për punësimin, trajnimin, promovimin, disiplinimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve” (MAPO, 2014, f. 1). Krahas këtij trajtimi konstatoes, i ngjashëm me atë të mediave kur analizojnë dukuritë e ndryshme negative apo pozitive të funksionimit të sistemit të drejtësisë në vendin tonë, është i nevojshëm edhe studimi sociologjik i ndikimit të ideologjisë në sjelljen e juristëve profesionistë, pa injoruar faktin se ka dy dekada që nuk evidentohen më raste të ndikimeve ideologjike marksiste në sistemin tonë të drejtësisë. Siç na mëson sociologu i madh francez Emile Durkheim, edhe vetë ideologjia në këndvështrimin sociologjik është një fakt shoqëror. Dhe për të shpjeguar ndikimin e saj në sjelljen e profesionistëve të ligjit në procesin e kryerjes së detyrës në role të ndryshëm brenda fushës juridike lipset të identifikohen nga studime empirike socio-ligjore se cilët janë këto fakte shoqërore, pra mekanizmat e përcjelljes së këtij ndikimi në vendimet gjyqësore, si dhe cilët janë sektorët e punës të

sistemit të drejtësisë ku ky ndikim shfaqet më i fortë (si për shembull në fushën e politikës gjyqësore) dhe si të matet saktësisht ai ndikim.

Studimet socio-ligjore empirike në botën perëndimore e kanë kapërcyer tashmë paragjykimin formalist-legalist se mendimi ligjor, procesi i gjykimit dhe vetë sistemi i drejtësisë janë specifike e të mbyllur, se profesioni i juristit është konservativ dhe se ligji është një kategori e pavarur nga vlerat, ideologjia dhe preferencat. Në këto studime po synohet të kuptohet thelbi i ideologjisë gjyqësore dhe vështirësia e rrënjosur brenda saj për kapjen e vëzhgimin e kësaj dukurie, të përpunohen teknikat dhe metodat e matjes sasiore e statistikore të ndikimit të saj në sjelljen e vëzhgueshme të gjyqtarëve, si për shembull mënyra sesi votojnë “pro” apo “kundër” si anëtarë të një paneli apo trupi gjykues që vendos rreth një çështjeje të caktuar, veçanërisht në Gjykatën e Lartë apo të Apelit, duke e lidhur këtë me vëzhgimin e elementëve të sjelljes të tyre, të afrisë së tyre me parti apo grupe të caktuara presioni etj. Në botën perëndimore ka përvoja mjaft interesante sesi që në procesin e rekrutimit të studentëve të magistraturës, që përgatiten për t’u bërë gjyqtarë, në kurse përgatitore para promovimit të tyre në detyrë, vlerësohet kandidati nëse si person gëzon “famë dhe karakter të mirë”, nëse ka në rekordet e veta biografike raste falimentoje financiare, ndonjë lloj dënimi, ndonjë shfaqje mashtrimi në detyrën profesionale, nëse ka qenë apo jo subjekt i ndonjë ankese ndaj tij lidhur me disiplinën në punë në profesionin ligjor a në ndonjë profesion tjetër, nëse i janë suspenduar e mohuar të drejtat e ushtrimit të profesionit, nëse ka raste akuzash me dyshime të bazuar se ka shkelur ligjin, ka shkelur betimin etj. Përvoja të tilla lypsen të adoptohen edhe në rekrutimin e promovimin e gjyqtarëve shqiptarë.

Përsa kohë është në fuqi skema aktuale e rekrutimit, e punësimit, trajnimit, promovimit, disiplinimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve nga KLD e

Parlamenti, duket fare normale që autoritetet politike që bëjnë emërimin e gjyqtarëve, të bëjnë njëherësh presion ndaj juristëve-klientë të tyre që ata të argumentojnë nëpër procese gjyqësore në favor të qëllimeve e qëndrimeve politike e ideologjike të pushtetit të shumicës parlamentare të radhës, e mbuluar kjo me retorikën legaliste të “sigurisë ligjore” dhe të “pavarësisë së sistemit të gjykatave”. Richard Posner e quan këtë marrëdhënie midis autoriteteve politike dhe juristëve-klientë të tyre si një lloj tregu pune midis shitësve të “punës gjyqësore” dhe përdoruesve politikë të saj, që i shpërblejnë me paga të larta, me favore dhe me pushtet, (që buron për gjyqtarët nga gjerësia e diskrecionit që ata gëzojnë). Por pushteti nuk është i vetmi burim i rëndësisë shoqërore që gjyqtarët fitojnë në këtë marrëdhënie me autoritetin politik. Ata, dhe në përgjithësi profesioni ligjor, “arrijnë një lloj suksesi në “shitjen” para syve të opinionit të gjerë publik të gjyqtarëve si mishërim i vërtetë i sundimit të ligjit. Kështu nxiten qytetarët që të respektojnë gjyqtarët dhe pushteti që ata sigurojnë në këtë mënyrë bëhet një burim i pavarur i kënaqësisë profesionale në punën e tyre. Shumë njerëz kënaqen kur ushtrojnë pushtet mbi njerëz të tjerë , - dhe njeriu është një qenie hierarkike, ashtu si primatët e tjerë”. (Posner, R., 2010, f. 59). Kështu pushteti i gjyqtarëve bëhet një aneks i pushtetit politik dhe në vend që të kemi një qeverisje demokratike përmes ligjeve, pra “sundimin e ligjit” në shoqëri, rrezikojmë të rrëshqasim në “sundimin e njerëzve”, në sundimin e politikanëve e të gjyqtarëve, që kujdesen të bëhen të paprekshëm, duke mbjellë kudo rreth vetes kulturën e pandëshkueshmërisë.

KONKLUZION

Kuptimi i vendit dhe i rolit të profesionit ligjor në sistemin tonë shoqëror i është lënë dëshirës së juristëve dhe spontanitetit të zhvillimit. Edhe pse në çdo progres-raport të Komisionit European mbi Shqipërinë që

prej vitit 2005 kryefjala e vlerësimit të funksionimit të sektorit të drejtësisë është dobësia e këtij sistemi, korrupsioni i gjyqtarëve, ndikimi i fuqishëm i politikës mbi të, - ndryshimet kanë qenë fare të zbehta. Madje rezistenca e profesionistëve ligjorë ndaj procesit të reformave, e ndihmuar prej korrupsionit në tregun e punës, - të rekrutimit, punësimit, trajnimit, dhe promovimit të juristëve-klientë prej autoriteteve politike, - ka lindur në radhët e tyre vetëdijen e funksionimit si një korporatë, që mbron para së gjithash interesat e veta të posaçme.

Në këtë artikull bëhen përpjekje për të sqaruar pozicionin e profesionit ligjor në dy plane, në planin strukturor-funksionalist, duke sjellë në vëmendje trajtimin parsonsian të kësaj çështjeje dhe krahasimin e bërë prej tij të profesionit ligjor me atë të mjekut. Përzgjedhja e këtij vizioni sociologjik i shkon më shumë për shtat interesimit të qytetarit shqiptar për të pasur në shërbim të tij një mjek human dhe një gjyqtar e avokat të ndershëm.

Një jurist britanik, që takoi në javën e para të prillit 2014 kryeministrin shqiptar, deklaroi në shtyp se z. E. Rama i ka thënë se “Vija midis një reforme që i jep gjyqësorit më shumë hapësirë për integritet dhe që i merr pavarësinë është shumë e hollë. Për të ruajtur këtë vijë të hollë, ne duam një koalicion forcash, ku Bashkimi Europian dhe partnerët tanë ndërkombëtarë janë thelbësorë”. (MAPO, 2014, f. 1). Në frontin e bashkuar të përpjekjeve për reformimin e sistemit të drejtësisë, një rol më aktiv duhet të luajë edhe shkenca sociologjike – ligjore. Studimet empirike sociologjore pothuaj mungojnë në Shqipëri. Është koha që institucionet akademike publike e private të veprojnë më shpejt dhe në mënyrë proaktive për të “lundruar” me mençuri e studime në atë vijë të hollë ndarëse midis integritetit dhe pavarësisë të sistemit të drejtësisë, duke iu përgjigjur sfidave konceptuale

dhe metodologjike të kërkimit shkencor në këtë fushë të konsideruar aq të “mbyllur” e konservatore nga paragjykimet legaliste.

Bibliografia:

1. ALBANIA 2009 PROGRESS REPORT, Brussels, 14.10.2009, SEC (2009) 1337
2. Aristotle, The Nicomachean Ethics, book. 5, part 6. Lexuar në websitin <http://classics.mit.edu/Aristotle/nicomachaen.5.v.html>
3. Bourdieu, Pierre, The Force of Law: Toward a Sociology of the Juridical Field, The Hasting Law Journal, Vol. 38, July 1987.
4. Corruption in Albania: Bribery as experienced by the population, UNODC dhe Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë, 2011.
5. Dinh, Viet D., Liberty and the Rule of Law After September 11, Washington Journal of Law & Policy, 2005, Vol. 19, Nr. 31.
6. Fischman, Joshua B., Law, David S., What Is Judicial Ideology, and How Should We Measure It?, Washington Journal of Law & Policy, 2009, Vol. 29.
7. Fuga, Artan, Manipulimi me shkencat shoqërore, Lente Sociologjike, Vëllimi I, Nr. 1, Janar-Qershor 2011, f. 14.
8. Gouldner, Alvin W., La Crisi della Sociologia, Il Mulino, Bologna 1980.
9. Hart, H. L. A, Koncepti i së Drejtës, ISP & DITA 2000.
10. Kennedy, Duncan, The Responsibility of Lawyers for the Justice of their Causes, Texas Tech Law Review, Vol. 18, 1987.
11. MAPO, 8 prill 2014.
12. Nixon, Richard, Seize the Moment. America’s Challenge in a One-Superpower World, Simon & Schuster, New York 1992.

13. Parsons, Talkot, *On Law and the Legal System*, ed. by A. Javier Treviño, Cambridge Scholars Publishing 2008.
14. Platoni, Republika, CEU & Shtëpia e Librit, Tiranë 1999.
15. Posner, Richard A., *How Judges Think*, Harvard University Press, 2010.
16. Radbruch, Gustav, *Statutory Non-Law and Suprastatutory Law* (1946), cituar nga Stanley L. Paulson, *Radbruch on Unjust Laws: Competing Earlier and Later Views?* *Oxford Journal of Legal Studies*, Vol. 15, No. 3 (Autumn, 1995).
17. Raz, Joseph, *The Authority of Law*, Oxford University Press, 2009.
18. Shqip, 25 mars 2014.

GREVA SI E DREJTË JURIDIKE TË PUNTORVE

LIRIDON ZENKU

UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR I STRUGËS Adresa: Mehmed Mehmedi Nr. 31 Kërçovë R. Maqedonisë e-mail: zenku78@hotmail.com

Abstrakt

Greva është ndërprerje e organizuar e punës nga ana e të punësuarve me qëllim të realizimit të të drejtave dhe interesave ekonomike, sociale dhe profesionale nga marrëdhënia e punës.

Grevistët janë të punësuarit të cilët pakënaqësinë e tyre lidhur me të drejtat, kushtet e punës, interesat ekonomike, sociale dhe profesionale i shprehin me anë të grevës. Për organizimin e grevës formohet Këshilli Grevist - organ i përkohshëm i zgjedhur nga të punësuarit që përfaqëson interesat e të punësuarve dhe udhëheq e koordinon grevën në emrin e tyre.

Shërbime të rëndësishë jetike - shërbimet të cilat për shkak të ndërprerjes së punës mund të shkaktojnë rrezikshmërinë e jetës dhe shëndetit të njerëzve ose mund të shkaktojnë dëme të mëdha.

Meqë greva është një mjet shumë i rëndësishëm i puntorëve me të cilin ato i bëjnë presion pundhënsit për arsye të ndryshme, qoftë për përmisimin e kushteve për punë ose rritjen e rrogave, pra greva ka qenë është dhe do të jetë një ndër mjetet më të rëndësishme të puntorëve për të kërkuar përmisimin dhe avansimin e interesave të tyre.

Sfidat e ligjit për marrveshje pune mund të nxisë grevë për shkakë të pakënaqësive të puntorve si që janë: largimi nga puna, presioni ndaj tyre dhe në kohën e fundit zëvendësimi i puntorve me makina etj.

Me gjithë përpjekjet e bëra duke marrë dhe hulumtuar disa njohuri e informacione për „grevat dhe llojet e tyre” me anë të përkufizimeve precise dhe ilustrimeve me shembuj konkret, kamë trajtuar çështjet dhe svidat e ligjeve për marrëdhëniet e punës.

Fjalët çelës: Ligji, punëtorët, greva, asyet, mbrotja.

HYRJE

Me ligjin për marrëdhënje pune parashifen qëllimi i ligjit, obligimet e të dy palve kontraktuese punëdhënësit dhe puntorve pastaj “Greva” si mjetë mbrojtës i puntorve.

Greva është ndërprerje e organizuar e punës nga ana e të punësuarve me qëllim të realizimit të të drejtave dhe interesave ekonomike, sociale dhe profesionale nga marrëdhënia e punës.

Grevistët janë të punësuarit të cilët pakënaqësinë e tyre lidhur me të drejtat, kushtet e punës, interesat ekonomike, sociale dhe profesionale i shprehin me anë të grevës.

Sfidat e ligjit për marrveshje pune mund të nxisë grevë për shkakë të pakënaqësive të puntorve si që janë: largimi nga puna, presioni ndaj tyre dhe në kohën e fundit zëvendësimi i puntorve me makina etj.

Gjatë grevës së organizuar sipas kushteve të përcaktuara me këtë Ligj, punëdhënësit nuk mund të punësojnë punëtorë të rinj të cilët do të zëvendësonin pjesëmarrësit në grevë.

NOCIONI I GREVËS

Greva është ndërprerja e përkohshme e punës, te cilën punonjësit e përdorin për zgjidhjen e kërkesave të tyre ekonomike e shoqërore e që e ushtrojnë në përputhje me rregullat e përcaktuara në dispozitat kushtetuese, si dhe në aktet e tjera ligjore. Pjesmarrja në grevë sipas legjislacionit tonë është vullnetare. Asnjëri nuk mund të detyrohet që të marrë pjesë në grevë në kundërshtim me vullnetin e tij²²⁹. E drejta e grevës ushtrohet për përmisimin e kushteve të punës, shpërblimin e punës, mbrojtjen në punë, sigurimet shoqërore, si dhe të drejtat e tjera që lidhen me marrëdhëniet e punës, me qëllim që të arrihet nënshkrimi i kontratës kolektive. Greva e shpallur për herë të parë nuk mund të zgjasë më shumë se një ditë pune. Pas kësaj ajo mund të shpallet, por jo më para se të kenë kaluar 5 ditë nga shpallja e grevës së parë. Punonjësit mund ta shpallin pa njoftim paraprak grevë paralajmëruese, por kjo nuk mund të zgjasë më shumë se 1 orë.



²²⁹ Lumani ,Fatmire,,,'E drejta e punës'' Tetovë 2011, fq.66

ARSYET E MBAJTJES TË GREVËS

Arsyet për ngritjen e të punësuarve në greva mund të jenë²³⁰:

- a) Moszbatimi i dispozitave ligjore të cilat mbrojnë interesin e punëtorëve;
- b) Mos përmbushja e kërkesave ligjore të tyre, të cilat mbështeten në mbrojtjen e interesave sociale të punëtorëve;
- c) Për shkak të mos pagesave të pagave;
- d) Pasigurisë në punë;
- e) Moszbatimi i dispozitave të Kontratës së Përgjithshme Kolektive dhe Kontratës së Punës, e lidhur në mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, si dhe
- f) Për arsye të tjera të cilat kanë mbështetje në ligjet e zbatueshme të vendit tonë apo në konventa ndërkombëtare të punës.

ORGANIZIMI I GREVËS

Greva dhe greva e paralajmëruar mund të organizohen, në:

1. ndërmarrje - greva te punëdhënësi;
2. degë apo veprimtari - greva sipas veprimtarisë;
3. nivel vendi - greva e përgjithshme.

Greva nuk mund të fillojë para procedurës së bisedimeve në mes punëtorëve dhe punëdhënësit, në mënyrë që të gjendet ndonjë zgjidhje për plotësimin e kërkesave të punëtorëve pa organizimin e grevës²³¹.

²³⁰ Cela, Kudret, "Marrëdhëniet kolektive të punës", Tiranë, 2003

²³¹ Ligji për marrëdhënie të punës, 2005

Vendimin për ngritjen e punëtorëve në grevë, në një organizatë, në një pjesë të organizatës ose te punëdhënësi, e merr organi i organizatës sindikale apo më shumë se gjysma e të punësuarve.

Vendimin për ngritjen e punëtorëve në grevë, në nivel federate apo veprimtarie, e merr organi i sindikatës, përfaqësuese të kësaj federate apo veprimtarie.

Vendimin për ngritjen e punëtorëve në grevë të përgjithshme e merr organi kompetent, sipas statutit të sindikatës.

Greva organizohet në pajtim me ligjin dhe aktet e tjera që janë në përputhje me ligjin.

MËNYRAT E ORGANIZIMIT TË GREVËS

Greva mund të organizohet, përmes:

1. ndërprerjes së punës në vendin e punës;
2. tubimit të të punësuarve në hapësirat e punës;
3. mungesës së të punësuarave nga puna;
4. tubimit të të punësuarve jashtë ambienteve të punës, dhe në hapësira tjera.

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ORGANIZIMIN E GREVËS

Greva është e ligjshme kur plotësohen kushtet e më poshtme:

1. organizohet nga një sindikatë, që ka cilësinë e personit juridik dhe është e regjistruar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
2. organizohet nga gjysma e të punësuarve brenda një organizate punuese;

3. ka për qëllim të realizojë kërkesat nga marrëdhënia e punës, sipas ligjit dhe Kontratës së punës;
4. kur sindikata, nga njëra anë, dhe organizata e punëdhënësve, nga ana tjetër, janë përpjekur më parë të bien dakord lidhur me kërkesat e tyre;
5. nuk është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

PARALAJMËRIMI I GREVËS

Këshilli i grevistëve ka për obligim të paralajmërojë grevën tek punëdhënësi dhe sindikata;

Këshilli i grevistëve ka për obligim që të paralajmërojë grevën jo më vonë se shtatë (7) ditë nga dita e caktuar për fillimin e grevës, duke ua dorëzuar vendimin për ngritjen në grevë organit të qeverisjes dhe organit punëdrejtues të organizatës, përkatësisht punëdhënësit.

Vendimin përmes të cilit paralajmërohet greva, duhet të përmbajë:

1. arsyet për mbajtjen e grevës;
2. kërkesat e punëtorëve;
3. vendin ku do të mbahet greva;
4. kohën e fillimit dhe ditën e mbajtjes së grevës, si dhe
5. kërkesën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë paqësore;

Greva paralajmëruese mund të zgjasë deri në një (1) orë në ditë.

Këshilli Grevist ka për detyrë dhe përgjegjësi që gjatë kohës së mbajtjes së grevës, të mbajë rendin dhe qetësinë.

Në rastet kur greva del jashtë kontrollit, Këshilli Grevist detyrohet t'i lajmërojë organet kompetente për mbajtjen e rendit.

PAMUNDËSIA E MBAJTJES SË GREVËS

1. Greva nuk mund të mbahet ose duhet të pezullohet në gjendje të jashtëzakonshme për aq kohë sa vazhdon kjo gjendje;

2. Gjendje të jashtëzakonshme janë: fatkeqësitë natyrore, gjendja e luftës, epidemitë dhe rastet kur vihet në rrezik liria e zgjedhjeve.

Sigurimi i minimumit të procesit të punës

1. Këshilli Grevist ka për detyrë që gjatë kohës së grevës të bashkëpunojë me organin punëdrejtues të organizatës, përkatësisht me punëdhënësin për të siguruar minimumin e procesit të punës dhe të prodhimit, kur një punë e tillë është e domosdoshme për jetën dhe sigurinë e qytetarëve ose është kusht i pazëvendësueshëm i jetës dhe punës së qytetarëve.

2. Minimumi i procesit të punës përcaktohet varësisht nga kushtet e veprimtarisë, shkallës së rrezikshmërisë së jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe rrethanave tjera të rëndësishme për realizmin e nevojave të qytetarëve, punëdhënësve dhe subjekteve tjera.

3. Gjatë përcaktimit të minimumit të procesit të punës, punëdhënësi është i obliguar të marrë mendimin e organit kompetent të sindikatës.

4. Me akt të brendshëm nënligjor të punëdhënësit, i cili duhet të jetë në përputhje me Ligjin dhe Kontratën Kolektive, përcaktohen punët dhe detyrat të cilat duhen të kryhen edhe gjatë mbajtjes së grevës

Shërbimet e rëndësisë jetike

Organizimi i grevës në veprimtaritë me interes të veçantë publik, dhe në veprimtaritë në të cilat ndërprerja e punës, bazuar në natyrën e punës, mund të rrezikoj jetën, apo shëndetin e njerëzve, apo të shkaktoj dëme me pasoja të mëdha, mund të realizohet nëse plotësohen kushtet e veçanta të përcaktuara me këtë ligj²³². Si kusht i veçantë është që të sigurohet minimumi i procesit të punës dhe prodhimit, që të sigurohet jeta dhe shëndeti i njerëzve, apo mos shkaktimi i dëmeve me pasoja të mëdha.

Shërbime të rëndësisë jetike janë:

1. shërbimet e mbrojtjes për sigurinë e vendit;
2. shërbimet emergjente mjekësore dhe spitalore;
3. shërbimet e furnizimit me ujë;
4. shërbimet e furnizimit me energji elektrike;
5. shërbimet e kontrollit të trafikut ajror;
6. shërbimet e mbrojtjes kundër zjarrit;
7. shërbimet në burgje;
8. shërbimet për mbrojtjen e veterinarisë, kur janë në pyetje epidemitë e ndryshme;
9. shërbimet sanitare higjienike.

²³² Ligji për marrëdhënie të punës, 2005

TË DREJTAT E PUNËTORIT DHE PUNËDHËNËSIT

Për organizuesit e grevës, pjesëmarrësve grevistë dhe ndaj të punësuarve të tjerë, të cilët mbështesin grevën, nuk mund të merren masa disiplinore apo materiale dhe nuk mund t’ju ndërpritet marrëdhënia e punës²³³.

Gjatë grevës së organizuar sipas kushteve të përcaktuara me këtë Ligj, punëdhënësit nuk mund të punësojnë punëtorë të rinj të cilët do të zëvendësonin pjesëmarrësit në grevë. Mirpo Ministria e Arsimit dhe Shkencës të R. Maqedonisë ka bërë Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsim fillor dhe të mesëm *G. Z. e R. M. nr.135/2014*, ku thuhet: *“Në rast të ndërprerjes së punës edukative arsimore për shkak të grevës, drejtori i shkollës fillore dhe të mesme me pëlqim paraprak nga kryetari i komunës, e për shkollat fillore dhe të mesme shtetërore nga ministri, është i detyruar ta sigurojë realizimin e punës edukative arsimore me zëvendësimin e të punësuarve që bëjnë grevë, derisa zgjat greva,”*(në tekstin e mëtutjeshëm zëvendësimi i përkohshëm i mësimdhënsve me mësimdhënës të rinj –rezervë), *Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit për arsimë të Lartë G. Z. e R. M. nr.10/2015 i cili është në kundërshtim me Kushtetutën e R. Maqedonisë* dhe këtu bëhet cënimi i autonomisë të Universiteteve dhe ligjit për mardhënie pune. Punëdhënësi ka te drejta ta largon puntorin nga puna atëherë kur²³⁴:

- a)Puntori ka mar pjesë në grevë që është në kundërshtim me ligjin.
- b)Kur puntori ka bërë cënim të rendit të marreveshjes për punë.

²³³ Ligji për marrëdhënie të punës,2005

²³⁴ Lumani , Fatmire, ”E drejta e punës”, Tetovë ,2011, fq.66

c) Ose atë që ka nxit sjellje të dhunshme dhe jo demokratike.

Numri i puntorëve të larguar nga puna nuk guxon të jetë më i madhë se 2% nga numri i puntorëve pjesmarës në grevë.

NDËRPRERJA E GREVËS

Greva ndërpritet kur:

1. janë përmbushur kërkesat e grevistëve;
2. arrihet marrëveshja me punëdhënësin;
3. këshilli Grevist vlerëson arsyeshmërinë e ndërprerjes së grevës dhe
4. kur janë në pyetje rastet e gjendjes së jashtëzakonshme.

Procedura e pajtimit

Procedura për pajtim fillon me propozimin e palëve, më së voni, në afatin prej shtatë (7) ditësh, prej fillimit të kontestit²³⁵.

- Partnerët social e caktojnë përbërjen dhe strukturën e Komisionit të Pajtimit.
- Palët mund të pranojnë ose të refuzojnë propozimin e Komisionit të Pajtimit.
- Marrëveshja e arritur në procedurën e pajtimit duhet të jetë në formë të shkruar.

²³⁵ Ismajli, Hava, "E drejta e punës", Prishtinë, 2007

LLOJET E GREVAVE

Duke marrë për bazë kriteriumet e ndryshme, në teorinë juridike dhe në praktikën gjyqësore, njihen forma të ndryshme të grevës²³⁶.

Grevat ndahen:

1) Sipas mënyrës dhe mjeteve:

1.1. Greva ligjore (që janë në pajtim me ligjin);

1.2. Greva joligjore (janë në kundërshtim me ligjin).

2) Sipas formës së ushtrimit:

2.1. Greva paralajmëruese (paralajmërim të rezikut nga greva);

2.2. Greva befasuese (kur nuk informohet punëdhënsi);

2.3. Greva trombozoide (grevë në zemrën e ndërmarjes);

2.4. Greva me okupim të fabrikës (kur e pengojnë punëdhënsin për riorganizim);

2.5. Greva e paorganizuar (e egër).

3) Sipas përfshirjes së numrit të pjesëmarrësve që përfshihen në to:

3.1. Greva strukturale (në një pjesë të ndërmarjes);

3.2. Greva gjenerale (pjesëmarrjen e gjithë puntorëve);

4) Sipas qëllimit që duhet ti realizojnë sindikatat përmes grevave:

4.1. Greva e solidaritetit (që tu ndihmon puntorëve);

²³⁶ Lumani Fatmire, "E drejta e punës", Tetovë, 2011, fq.70

4.2.Greva profesionale ose ekonomike (interes profesionale dhe ekonomike);

4.3.Greva politike (për qëllim politik).

KONKLUZION

Në fund të këtij punimi që trajton një çështje shumë thelbësore, me interes të veçantë për kohën aktuale dhe shumë të debatueshme siç theksova edhe në fillim të punimit, pra do konstatoja disa përfundime sa i përket grevës.

Meqë greva është një mjet shumë i rëndësishëm i puntorëve me të cilin ato i bëjnë presion pundhënsit për arsye të ndryshme, qoftë për përmisimin e kushteve për punë ose rritjen e rrogave, pra greva ka qenë është dhe do të jetë një ndër mjetet më të rëndësishme të puntorëve për të kërkuar përmisimin dhe avansimin e interesave të tyre.

Me gjithë përpjekjet e bëra duke marrë dhe hulumtuar disa njohuri e informacione për „grevat dhe llojet e tyre” me anë të përkufizimeve precize dhe ilustrimeve me shembuj konkret, kamë trajtuar çështjet dhe svidat e ligjeve për marrëdhëniet e punës.

LITERATURA E SHFRYTZUAR:

1. Doc.Dr.Fatmire Lumani „E drejta e punës” Tetovë 2011;
2. Ligji për marrëdhënie të punës,2005;
3. Kudret Cela, Marrëdhëniet kolektive të punës,Tiranë 2003;
4. Hava Ismajli, E drejta e punës, Prishtinë,2007;
5. Ligji për marrëdhënie pune (tekst i spastruar) G. Z. e R.M. nr. 54/2013;
6. Ligji për marrëdhënie pune (tekst i spastruar) G. Z. e R.M. nr. 34/2014;

7. Ligj për ndryshimin e ligjit për pengimin dhe mbrotje nga diskriminimi;
8. Opsht Kolektiven dogovor za privatniot sector od oblata na stopanstvoto (precisten tekst);
9. Burime të ndryshme nga Interneti.

Roli i Planifikimit në Ekonominë e Tregut

Nerimane Bajraktari

Universiteti i Prizrenit "UKSHIN HOTI" Prizren Fakulteti Ekonomik

Abstrakt

Dekadat e fundit ndryshimet e mëdha politike, sociale dhe teknologjike, rritja e rolit të shtetit si blerës, shitës, rregullator dhe konkurrues në tregun e lirë dhe futja gjithnjë e më shumë e bizneseve në tregun ndërkombëtar, e kanë bërë mjedisin në të cilin operojnë bizneset mjaft kompleks. Atëherë, si do të mundën organizatat e biznesit të ndërmarrin veprime për të ardhmen në një mjedis të tillë kompleks dhe të ndryshueshëm. Për këtë arsye bëhet i domosdoshëm drejtimi apo planifikimi strategjik i një organizate biznesi.

Planifikimi është procesi me anën e të cilit anëtarët e një organizate parashikojnë të ardhmen dhe hartojnë procedurat dhe operacionet e nevojshme për arritjen e qëllimit të tyre.

Fakti që planifikimi është një element dominues në suksesin e një organizate biznesi, i ka rrënjët në shprehjen: "nëse ju nuk e dini ku po shkoni, ju do të mbeten në mes të rrugës." Cdo organizatë biznesi sado e vogël qoftë duhet të ketë të përcaktuar mirë qëllimin për të cilin është krijuar, misionin e saj dhe shërbimin që ajo presupozon t'i bëjë shoqërisë. Drejtuesi apo drejtuesit e biznesit duhet të arrijnë një konsensus përse i përket çështjes "*çfarë është biznesi ynë, çfarë ai do të jetë dhe çfarë duhet të jetë*". Mospasja e një vizioni të qartë lidhur me këto pyetje, do ta conte biznesin në një drejtim të gabuar dhe në shpenzimin pa efektivitet të burimeve. Përveç kësaj, cdo organizatë biznesi duhet ta ketë të qartë si ajo do të prodhojë dhe

shpërndajë produktet e saj. Kjo nënkupton që ajo të hartojë një plan strategjik të veprimtarisë së saj. Qëllimi është që në bazë të këtij plani organizata të llogarisë sasinë e burimeve të nevojshme për zbatimin me efektivitet të planit dhe në vecanti ajo do të përpiqet të krijojë disa kompetenca produkteve në mënyrë që të jetë në gjendje të përballojë konkurrencën.

Një problem i dytë i rëndësishëm dhe që kushtëzon një planifikim efektiv dhe real është problemi i informacionit. Në një kohë kur intensiteti i zhvillimit rritet, kur konkurrenca ashpërsohet, procesi i informacionit në vendin tonë lë për të dëshiruar. Mungojnë informacionet sistematike për zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e tregut brenda vendit dhe as që bëhet fjalë për informacione sistematike lidhur me zhvillimin e tregut botëror. Në mënyrë që të ndihmohen biznesmenët tanë dhe si rezultat të rritet kontributi i tyre në shoqëri, është i nevojshëm kontributi i shtetit. Kjo gjë mund të realizohet qoftë me anën e një gazete apo reviste informative, qoftë me anën e publikimit të veprimtarive (anuarëve) vjetore të cdo firme. Në vendet e zhvilluar, firmat detyrohen me ligj të botojnë cdo vit vjetarë të veprimtarisë së tyre. Në këto vjetare përshkruhet e gjithë veprimtaria financiare, prodhuese dhe tregtare e firmës.

Në këtë mënyrë organizatat e biznesit do të njohin mjedisin në të cilin ato zhvillojnë veprimtarinë e tyre, do të dinë të shfrytëzojnë shanset që u paraqiten dhe në të njëjtën kohë të shmangin apo t'i paraprijnë kërcënimeve.

Konceptet kyçe: blerës, shitës, rregullator, konkurrues, organizatë biznesi.

PLANIFIKIMI STRATEGJIK

Procesi i planifikimit strategjik është një proces drejtimi që përfshin konsultimin, negocimin dhe analizat që kanë për qëllim të sigurojnë marrjen


e vendimeve efektive. Vendimet në një organizatë mund të jenë të karakterit të prodhimit, funksionale, apo strategjike. Natyrisht nuk egziston një ndarje e prerë midis kategorive të ndryshme të vendimeve por vendimet strategjike dallohen për shkak të efekteve që ato japin dhe fushës që përfshijnë. Për shembull, për një prodhues bicikletash, vendimi strategjik ka të bëjë me hedhjen në treg të një modeli të ri, për një supermerkato ushqimore mund të lindë nevoja e zgjerimit të aktivitetit ndërsa për një universitet, krijimi i një departamenti të ri. Shpeshherë duhen marrë vendime lidhur me hyrjen në një biznes të ri ose prodhimin e një produkti të ri. Shpesh këto vendime shoqërohen me shpenzime të mëdha kapitale.

Rëndësinë e procesit të planifikimit strategjik në këtë artikull do ta ilustrojmë me idenë e një sistemi të thjeshtë kontrolli (skema 1 në vijim). Shembulli i përdorur ka të bëjë me kontrollin e temperaturës së dhomës që ngohet nga një burim nxehtësie (ajër apo ujë i ngrohtë). Ky sistem mishëron karakteristikat bazë të një procesi të drejtimit strategjik, egziston një qëllim që duhet arritur dhe procedurat që do të ndiqen për arritjen e këtij qëllimi. Nëse do të flasim me terma ekonomike, kemi të bëjmë me kontrollin dhe marrjen e vendimeve strategjike, ku si qëllim kemi arritjen e një fitimi apo efektiviteti të caktuar për firmën, dhe për arritjen e këtij qëllimi ndërmerren disa vendime strategjike.

Sistemi i kontrollit konsiston në një dhomë dhe rezultati që ne do të masim është temperatura e dhomës. Temperatura matet dhe pastaj krahasohet me normativën e vendosur. Me anën e një aparati të posacëm kakulohet diferenca në (+) ose (-). Në rast se diferenca është pozitive, me anën e aparatit automatik të kontrollit komandohet burimi i nxehtësisë për uljen e temperaturës dhe anasjelltas. Përveç këtij kontrolli automatik të burimit të

nxehtësisë, në dhomë mund të hyjnë rryma të pakontrolluara ajri, për shembull përmes dritares apo derës.

Skema 1 Një sistem kontrolli i shpejtë



Që një sistem i tillë të punojë me efektivitet duhet të ketë cilësitë e mëposhtëme:

- Një standart ose normativë
- Një procedurë të matjes së rezultatit
- Një sinjal “alarmi”
- Një procedurë kontrolli
- Një burim të përshtatshëm
- Një veprim korrigjues

Në shembullin e mësipërm si normativë shërben temperatura e dëshiruar e dhomës. Procedura e matjes së rezultatit realizohet nga termostati. Sinjali i “alarmit” është një mekanizëm elektronik, i cili transmeton shifrat e lexuara në termostat. Procedura e kontrollit është mekanizmi që krahason temperaturën faktike të dhomës me normativën e vendosur kalkulon

diferencën dhe pastaj transmeton komandën për veprimin korrigjues. Burimi i përshtatshëm, në rastin tonë, është mekanizmi që komandon sasinë e nxehtësisë që futet në dhomë.


Temperatura e dhomës mund të kontrollohet vetëm në rast se të gjitha elementet e mësipërm egzistojnë. Sikur vetëm një element të mungojë, sistemi dështon.

MODELI I PROCESIT TË MARRJES SË VENDIMEVE STRATEGJIKE

Nëqoftëse modelin ilustrues të përdorur më sipër do ta zbatonim në procesin e marrjes së vendimeve strategjike të një organizate, do të rezultonte modeli i paraqitur në skemën 2. Cdo organizatë biznesi i vë vetes disa objektiva që duhen arritur në veprimtarinë e saj. Me anën e analizave strategjike këto objektiva vlerësohen dhe kontrollohen.

Modeli i paraqitur në skemën 2, ose sic quhet ndryshe “*modeli reaktiv i marrjes së vendimeve*”, ka një mangësi. Sipas këtij modeli analizohet rezultati i arritur pasi është zbatuar vendimi strategjik. Ndërkohë, një objektiv jo i mirë mund të conte deri në dështimin e biznesit.

Skema 2. Modeli reaktiv i procesit të marrjes së vendimeve strategjike



Pra, procesi i marrjes së vendimeve strategjike duhet të masë jo vetëm rezultatin aktual të arritur, por edhe duhet të parashikojë rezultatet e së ardhmes dhe të ndërmarrë veprime paraprake. Ai duhet të jetë aktiv.

Një proces aktiv i marrjes së vendimeve strategjike përfshin parashikimin e të ardhmes së organizatës duke formuluar dhe vlerësuar opsionet strategjike dhe duke studjuar njëkohësisht ndikimin e tyre në të ardhmen e organizatës.

Skema 3 e procesit aktiv të marrjes së vendimeve strategjike, përmban në vetvete si skemën 1 ashtu edhe skemën 2. Përveç këtyre, në këtë model përfshihen edhe formulimi i opsionit strategjik, studimi i efektivitetit, vlerësimi i burimeve, një model për parashikimin e të ardhmes së organizatës dhe vlerësimin e faktorëve të rastit.


Sic e shohim edhe në skemë, në modelin aktiv pasi hartohen objektivat studiohen dhe analizohen ato nga pikëpamja e ndikimit që ato do të kenë në të ardhmen e organizatës. Pas kësaj formulohet strategjia, e cila përsëri studjohet nga pikëpamja e leverdisshmërisë.

ELEMENTET E PROCESIT TË MARRJES SË VENDIMEVE STRATEGJIKE

Procesi i marrjes së vendimeve strategjike i konceptuar në figurën 3, është shumë më kompleks se ai i skemës 1. Ky kompleksitet rrjedh qoftë nga rritja e numrit të elementeve të sistemit, qoftë nga kompleksiteti i elementeve. Secili nga këto elemente duhet të merret në konsideratë e të shqyrëtohet me kujdes. Mungesa e njërës prej tyre do të conte në dështimin e modelit. Elementet e domosdoshëm të një procesi të marrjes së vendimeve strategjike janë:

- Hartimi dhe rishikimi i objektivave
- Formulimi i opsionit strategjik
- Kontrolli i leverdisshmërisë
- Vlerësimi i burimeve
- Vlerësimi i pasigurisë
- Modeli i sistemit të organizatës
- Matja e rezultatit
- Kontrolli i leverdisshmërisë (sinjali i “alarmit”)
- Analiza e diferencës së rezultatit dhe zgjedhja
- Procesi i zbatimit
- Burimet

Skema 3. Modeli aktiv i procesit të marrjes së vendimeve strategjike



Nëntë elementet e para i përkasin procesit të planifikimit strategjik, ndërsa dy të fundit i shërbejnë procesit të zbatimit. Megjithëse në këtu e pasqyrojmë të ndarë procesin e zbatimit nga ai i planifikimit një ndarje e prerë nuk egziston. Në fund të fundit, procesi i planifikimit bëhet me qëllim zbatimi. Për shembull, studimi i leverdisshmërisë dhe vlerësimi i burimeve bëhen me qëllim që të lehtësojnë zbatimin.

Detyra e *hartimit dhe rishikimit të objektivave*, është natyrisht pjesa esenciale e procesit të planifikimit strategjik. Këtu bëhet fjalë qoftë për objektiva financiare qoftë objektiva jo financiare (objektiva në fushën e teknologjisë, shërbimit, cilësisë, reputacionit të organizatës, etj.)

Analiza e diferencës dhe zgjedhja përfshin krahasimin e gjendjes së mundshme të organizatës në të ardhmen me objektivat dhe vendos nëse

strategjitë ekzistuese janë të prranueshme apo duhen shqyrëtuar strategji të reja.

Formulimi i opsioneve strategjike është faza në të cilën organizata studion shanset dhe kërcënimet e mjedisit të jashtëm (konkurentët, kreditorët, tregu, teknologjia, etj.) dhe fuqitë dhe dobësitë brenda saj. Më tej sugjerohen opsionet strategjike më të përshtatshme.

Pas kësaj bëhet *studimi apo kontrolli i leverdisshmërisë* së cdo opsioni strategjik. Për shembull, opsioni i prodhimit të një produkti të ri do të kërkonte një teknologji të re, e cila nga ana e saj do të kërkonte fonde financiare.

Strategjitë e reja, normalisht do të kërkonin *burime* financiare, njerëzore, lëndësh të para, etj. Për këtë arsye përpara se të vendoset për zbatimin e një strategjie të re duhet të studiohen edhe burimet disponibël.

Vlerësimi i pasigurisë së bashku me *faktorët e rastësisë* të organizatës është një pjesë kyce e procesit të planifikimit strategjik. Përgjigja e konsumatorit, reagimi i konkurrencës, ndryshimet kulturore, tendencat ekonomike, etj. kanë një ndikim mjaft të madh në të ardhmen e organizatës, ndërkohë që ato nuk mund të kontrollohen dhe influencohen nga organizata.

Vlerësimi i faktorëve të mësipërm mund të bëhet me anën e modeleve dhe analizave statistikore. Metoda më e përhapur sot për vlerësimin e pasigurisë së mjedisit është ajo e skenareve.

Me qëllim që të bëhet një vlerësim i përafërt i së ardhmes së organizatës, e cila është rezultat i strategjive të përdorura dhe ndikimit të faktorëve të rastit, është e nevojshme të ndërtohet *modeli i sistemit të organizatës*. Disa organizata mund të përdorin modele financiare. Kohët e fundit po përdoren

modelet dinamike të korporatës, të cilat janë më fleksibël dhe si rezultat më efektiv.

LITERATURA

1. Dyson. R.G., and Foster.M.J. (1990). *Effectiveness in Strategic Planning*. European Journal of Operational Research. 5
163-170;
2. Shim.J.K. and Mc Glade.R. (1988). *The use of Corporate Planning Models*. 255-263 ;
3. 3. Dyson.R.G. (1992). *Strategic Planning Models & Analytic Techniques*. 5-13;
4. Gordon Donaldson. *The Strategic Audit*. Harvard Business Review. July-August 1995.

PAZOTËSIA E VEPRIMIT SI SHKAK PËR NULSHMËRINË E KONTRATAVE NË TË DREJTËN KONTRAKTORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Shpresa Alimi-Memedi, PhD Candidate

Abstrakt

Për lidhjen e një kontrate detyrimore duhet të plotësohen kushtet e përgjithshme si: ekzistimi i subjekteve me zotësi juridike dhe të veprimit, shprehja e akorduar e vullnetiti të subjekteve të kontratës, objekti i përshtatshëm për prestim obligator, ndërsa te kontratat formale edhe forma e parashikuar juridike.

Palë në një marrëdhënie kontraktore mund të jenë personat fizik dhe juridik me zotësinë e duhur për të qenë bartës i të drejtave dhe detyrimeve që e përbëjnë përmbajtjen e atyre marrëdhënieve. Këtu është fjala për zotësinë juridike. Krahas zotësisë juridike, për lidhjen e kontratës së plotfuqishme është e nevojshme që kontraktuesit ta kenë zotësinë për të vepruar që kërkohet për lidhjen e kontratës së caktuar. Mungesa e zotësisë së veprimit është shkak për nulshmërinë e kontratave. Parimisht kontrata e personit fizik pazotësi veprimi është e nulshme.

Në anën tjetër personat juridik, zotësia e tyre e veprimit është e përcaktuar dhe fitohet njëkohësisht me zotësinë e tyre juridike speciale. Personi juridik mund të lidhë kontrata në qarkullimin juridik brenda kornizave të zotësisë së tij juridike (neni 46, al.1). Cilat janë pasojat juridike nga tejkalimi i këtyre kornizave? Në këtë drejtim “Ligji mbi marrëdhëniet

detyrimore”²³⁷ i Republikës së Maqedonisë e ka pranuar teorinë *ultra vires* (jashtë autorizimeve), por me Ligjin mbi ndyshimin dhe plotësimin e LMD (84/08), kjo teori është braktisur nga shkakut se paraqiste pengesë për qarkullimin, pasi i shpallte të nulshme punët juridike të lidhura jashtë veprimtarisë së personit juridik. Me këtë arrihet mbrojtja e interesave të palës tjetër kontraktuese, e cila jo gjithmonë duhet të dijë se bashkëkontraktuesi i saj a vepron në korniza të veprimtarisë themelore të regjistruar. Krijimi i kushteve për zhvillim të pandërprerë të qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, është detyrë që për Republikën e Maqedonisë doli nga Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim.

Fjalë kyçe: personat fizik, personat juridik, zotësia e veprimit, kontrata, teoria *ultra vires*, nulshmëria, Ligji mbi marrëdhëniet detyrimore, e drejta e Unionit Evropian.

HYRJE

Saktësia e kufizimit në mes të kontratave të vlefshme dhe të pavlefshme, që drejtpërdrejtë ndikon në sigurinë juridike të qarkullimit juridiko-ekonomik, në radhë të parë mvaret nga saktësia dhe tërësia e përcaktimit pozitiv të kushteve për vlefshmërinë.²³⁸ Kjo do të thotë të përcaktohen të gjitha kushtet që kumulativisht duhet të ekzistojnë për lindjen e një kontrate. Si të tilla paraqiten: zotësia për të vepruar e subjekteve; deklarimi i lirë, serioz dhe i akorduar i vullnetit; objekti i detyrimit i

²³⁷ Закон за облигационите односи, “Службен Весник на Република Македонија”, бр. (18/01, 78/01, 04/02, 59/02, 05/03, 84/08, 81/09, 161/09). Në tekstin e mëposhtëm LMD.

²³⁸ Klarič, Petar dhe Martin Vedriš: Gradansko pravo (Opći dio, stvarno pravo, obvezno i nasljedno pravo), Zagreb: Narodne novine, 9 izd., 2006, fq. 138.

mundshëm, i caktuar, gjegjësisht i caktueshëm; baza e lejueshme dhe forma e kontratës e paraparë me ligj ose me vullnetin e palëve kontraktuese.²³⁹

Mjafton mungesa e vetëm njërit nga kushtet ose plotësimi i tij në aspekt përmbajtësor në kuptim negativ, që kontrata të jetë e pavlefshme, përderisa për vlefshmërinë e saj kërkohet ekzistimi kumulativ i të gjithëve.²⁴⁰ Kontratat e lidhura nga subjektet e drejtësisë pazotësi veprimi janë absolutisht të pavlefshme.

Deri me sjelljen e Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi marrëdhëniet detyimore të vitit 2008²⁴¹, instituti juridik i zotësisë juridike dhe të veprimit nuk kanë qenë të definuara me dispozita juridike për shkak të mungesës së aktit të vetëm kodifikues në Republikën e Maqedonisë nga sfera e së drejtës civile në përgjithësi. Këto dy nocione sipas teorisë juridike, bëjnë pjesë në Pjesën e përgjithshme të së drejtës civile dhe jo atë detyimore, por sërish për shkak të mungesës së aktit kodifikues nga lëmia e së drejtës civile dhe për shkak të lidhshmërisë në mes zotësisë juridike dhe asaj të veprimit me lindjen e marrëdhënies detyimore, këto nocione definoohen në kuadër të LMD.²⁴² Definimet për to janë të njëjtat që janë shfrytëzuar në shkencën dhe

²³⁹ Babič, Ilija: Leksikon obligacionog prava, Beograd: Služben list SRJ, 2 izd., 2001, стр. 214.

²⁴⁰ Romac, Ante: Rimsko Pravo, Zagreb: Pravni fakultet u Zagrebu, Centar za stručno usavršavanje i suradnju s udruženim radom, 1981, fq. 226.

²⁴¹ Ligji mbi ndryshimin dhe plotësimin e LMD, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 84/08. Në tekstin e mëposhtëm Novela 2008 e LMD.

²⁴² Kapitulli II (Pjesa I, IV Zotësia), e LMD.

praktikën juridike të Republikës së Maqedonisë, dhe i përgjigjen definimeve në kodifikimet bashkëkohore Evropiane.²⁴³

PAZOTËSIA E VEPRIMIT TE PERSONAT FIZIK DHE NULSHMËRIA E KONTRATAVE

Zotësia e veprimit është pjesë përbërëse e subjektivitetit juridik të cilën nuk do të thotë ta kenë të gjithë subjektet e drejtësisë. Një kategori e subjekteve nuk kanë fare zotësi të veprimit, disa nga ata kanë zotësi të kufizuar, ndërsa të tretët zotësi të pakufizuar veprimit.

Shumica e personave fizik kanë mundësi të pakufizuar për të lidhur kontrata, ndërsa të tjerët ose fare nuk kanë zotësi veprimit ose e kanë atë në mënyrë të kufizuar. Për këta të fundit²⁴⁴ nuk do të bëjmë fjalë në punimin tonë, pasi kontratat e lidhura nga personi fizik me zotësi të kufizuar veprimit pa pëlqimin e përfaqësuesit të tij ligjor janë shkak për rrëzueshmëri ose pavlefshmëri relative të kontratave, kontrata këto që mund të mbeten në fuqi me pëlqim plotësues të përfaqësuesit ligjor. I mituri me zotësi të kufizuar veprimit mundet pa pëlqimin e përfaqësuesit të tij ligjor t'i lidh vetëm ato kontrata lidhja e të cilave i është lejuar me ligj.

Personi me zotësi veprimit, pavarësisht e deklaron vullnetin juridikisht relevant për lidhjen e kontratës. Personi fizik e fiton zotësinë e

²⁴³ Галев, Гале dhe Неда Здравева: *Усогласување на Граѓанското право со правото на Европската Унија со посебен осврт врз облигационото право*, Методи за хармонизација на националното законодавство со правото на Европската Унија, Зборник од научната расправа, Македонска академија на науките и уметностите, Книга 2, 2008, fq. 232.

²⁴⁴ Personi fizik me mbushjen e moshës 14 vjeçare deri në moshën madhore dhe personi madhor të cilit i është kufizuar zotësia e veprimit janë me zotësi të kufizuar veprimit, përpos nëse me ligj nuk është paraparë diçka tjetër (neni 45b, al. 4, Novela 2008 e LMD).

veprimit me arritjen e moshës madhore dhe në raste të tjera të parapara me ligj (në rast të emancipimit, deri te i cili ka ardhur me lidhjen e martesës në moshën 16 vjeçare, të miratuar nga gjyqi²⁴⁵). Personi fizik deri në moshën 14 vjeçare, dhe personi madhor të cilit i është marrë zotësia e veprimit, janë pazotësi veprimi.²⁴⁶

Për lidhjen e kontratës së plotfuqishme është e nevojshme që kontraktuesit ta ketë zotësinë për të vepruar që kërkohet për lidhjen e asaj kontrate.²⁴⁷ Këtu nuk bëjnë pjesë rastet ku për vlefshmërinë e punës juridike është e mjaftueshme zotësia e kufizuar për të vepruar e të miturve të moshës 15 vjeçare, nëse kanë themeluar marrëdhënie pune. Ata mund të lidhin punë juridike të plotfuqishme në kuadër të disponimit me fitimin e vet.²⁴⁸

Kontrata e personit pazotësi veprimi është e nulshme. Në të drejtën krahasuese ekzistojnë raste kur personave pazotësi veprimi (të miturve të rinj nga mosha gjashtë vjeçare e më lartë) u është dhënë mundësia që pavarësisht

²⁴⁵ Zotësia e përgjithshme e veprimit, e fituar në këtë mënyrë, mbetet edhe nëse ka ardhur deri te shkëputja e martesës. Personat e moshës 16 vjeçare, nëse nuk kanë lidhur martesë kanë vetëm zotësi të kufizuar veprimi.

²⁴⁶ Me Novelën 2008 të LMD, LMD plotësohet me dy nene të reja: 45-a dhe 45-b. Fjalitë nga paragrafi i parë nën titullin 3.2.1., janë përmbajtja e nenit 45b, al. 1, 2 dhe 3.

²⁴⁷ Me Novelën 2008 të LMD, pas nenit 47 të LMD, shtohet nen i ri 47-a, me tre aline. Fjalët nga titulli i nenit 48 i LMD, “e personit pazotësi veprimi”, duhet të zëvendësohen me fjalët “e personit me zotësi të kufizuar veprimi”. Al. 1 nga neni 48 fshihet. Në al. 2, e cila bëhet numër 1, fjalët “person me zotësi”, zëvendësohen me fjalët “i mitur me zotësi”. Pas al. 1, shtohet një nen i ri, sipas të cilit: “Personi madhor të cilit me vendim gjyqësor i është kufizuar zotësia e veprimit mundet, pa pëlqimin e përfaqësuesit ligjor, t’i lidh të gjitha kontratat lidhja e të cilave nuk u është ndaluar me vendim gjyqësor”.

²⁴⁸ Shiko nenin 8, al. 2 të Ligjit mbi marrëdhëniet e punës, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 145/2014.

të lidhin kontrata të caktuara. Është fjala për të ashtuquajturat kontrata të përditshme.²⁴⁹

Me Novelën 2008 të LMD, sipas shembullit të shteteve të përmendura në fusnotën më lartë, si dhe nga ajo që në praktikë ishte përgjithësisht e pranuar²⁵⁰, u parapara dispozita sipas së cilës: “Kontrata e personit pazotësi veprimi që ka vlerë më të vogël (kontrata të përditshme) llogaritet e plotfuqishme, përveç nëse me ligj nuk është paraparë diçka tjetër” (neni 47-a, al.3).

Në këtë rast është paraparë fikcion në ekzistimin e zotësisë për të vepruar në anën e të miturit, edhe pse realisht ai nuk ekziston. Në bazë të tij vjen deri te plotfuqishmëria e kontratës, e cila përndryshe është e nulshme. Sipas natyrës së saj, zotësia e finguar, është lloj i zotësisë së veçantë për të vepruar. Në këtë pjesë të punimit vlen të përmenden edhe dy zgjidhjet e LMD-së. Në dispozitën 286, al.1 kemi përcaktimin: “Edhe personi pazotësi veprimi mundet në mënyrë të drejtë ta përmbush detyrimin nëse ekzistimi i detyrimit është i padyshimtë dhe nëse ka arritur afati për përmbushjen e tij”. Zgjidhjen tjetër e hasim në nenin 295: “Përmbushja e realizuar ndaj kreditorit pazotësi veprimi e liron debitorin, vetëm nëse ka qenë e dobishme për kreditorin ose nëse objekti i përmbushjes ende ndodhet te ai”. Këto dy raste na tregojnë se (nëse do të mund ta përmbushin, gjegjësisht ta pranojnë

²⁴⁹ Kodi i Përgjithshëm Pasuror i Malit të Zi (neni 408), parasheh pranimin e dhuratave nga personi i mitur. Një dispozitë të ngjajshme hasim edhe në Kodin Civil të Sërbisë (paragrafi 563). Kodi Civil i Polonisë (neni 14) përcakton lidhjen e kontratave që për objekt kanë send të llojit të imët. Kodi Civil i Republikës Federative Socialiste Sovjetike Ruse (neni 14) përcakton se të miturit mund të lidhin kontrata të caktuara me vlerë më të vogël. Cituar sipas Галев, Гале dhe Јадранка Дабовиќ-Анасатасовска: Облигационо право, Скопје: Академски печат, 2008, fq. 146.

²⁵⁰ Галев, Гале dhe Јадранка Дабовиќ-Анасатасовска: *ver.cit.*, fq. 145-146.

përbushjen e detyrimit) munden në raste të caktuara, të lidhin kontrata të plotfuqishme.²⁵¹

Kontratat e lidhura nga personi pazotësi veprimi janë absolutisht të pavlefshme pasi mungon një nga elementet esenciale të kontratës: ekzistimi i vullnetit relevant juridik. Këtu vullneti nuk ka të meta, siç ndodh me kontratat e rrëzueshme, këtu ai mungon në tërësi, kemi si palë persona që nuk mund ta deklarojnë vullnetin e tyre.

PAZOTËSIA E VEPRIMIT TE PERSONAT JURIDIK DHE NULSHMËRIA E KONTRATAVE

Si subjekt i drejtësisë, gjegjësisht si bartës i të drejtave dhe detyrimeve në një marrëdhënie detyrimore paraqiten edhe personat juridik. Ata, në kuptim të vërtetë të fjalës, si subjekte të raportit civilo-juridik, dhe në veçanti të raportit detyrimor paraqiten në Kodin Civil Gjerman të vitit 1896, dhe në Kodet tjera që pasuan pas sjelljes së tij.²⁵²

Personat juridik e fitojnë zotësinë për të vepruar në momentin e fitimit të zotësisë juridike, nëse me ligj nuk është paraparë diçka tjetër.²⁵³ Kjo ndodh nga shkak se, ata nuk i nënshtrohen pjekurisë psikofizike. Zotësia për të vepruar e personave juridik, duke qenë e determinuar në vëllimin e saj nga zotësia juridike speciale e këtyre personave, edhe vet paraqet lloj të veçantë të zotësisë për të vepruar.²⁵⁴

Sipas Prof. dr. Asen Grupçe në praktikë dhe shkencën juridike nuk ka qëndrim unik lidhur me çështjen se kur lidhja e punëve juridike jashtë

²⁵¹ Po aty, fq. 146-147

²⁵² Po aty, fq. 144

²⁵³ Neni 45b, al. 5, i paraparë me Novelën 2008 të LMD, në nenin 20.

²⁵⁴ Галев, Гале dhe Јадранка Дабовиќ-Анасатасовска: *ver.cit.*, fq. 147.

veprimtarisë së regjistruar të personit juridik, në të njëjtën kohë do të ketë për pasojë edhe nulshmërinë e vet punës. Lidhur me këtë çështje ekzistojnë dy qëndrime. Sipas njërit prej tyre ose sipas shumicës, këto punë janë të nulshme, pasi kjo ndalesë ka për qëllim që të sigurojë rend në qarkullimin juridiko-ekonomik. Sipas qëndrimit të kundërt, punët e lidhura jashtë veprimtarisë së regjistruar nuk duhet të sjellin nulshmërinë, pasi nuk sjellin në pyetje ndonjë interes qenësor të shoqërisë, por disa interesa më pak qenësore, individuale. Puna, për nga përmbajtja e saj nuk do të thotë të jetë në kundërshtim me rendin juridik. Anulimi i punës juridike për arsye të këtillë, e pengon qarkullimin, që paraqet element esencial për riprodhimin shoqëror. Me fjalë të tjera sigurimi i qarkullimit është lloj i interesit shoqëror. Sipas këtij qëndrimi këto punë do të jenë të nulshme nëse janë edhe në kundërshtim me rendin shoqëror.²⁵⁵

Duke marrë parasysh interesin ekonomik të një shteti - mospengimin e tregtisë, këto punë juridike nuk do të duhej të llogariten të nulshme, por personi juridik duhet t'i nënshtrohej dënimit administrativ. Mirëpo ky qëndrim nga aspekti i së drejtës nuk është i drejtë, pasi ajo ka përcaktuar që më parë që personat juridik kanë zotësi speciale juridike e cila u është njohur të gjithëve me statutin e tij.²⁵⁶

Sipas Ligjit mbi marrëdhëniet detyrimore të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1978²⁵⁷ (neni 54, al. 2), kontratat e lidhura

²⁵⁵ Групче, Асен: Имотно (Граѓанско) право, Општ дел, Скопје: Култура, 1983, fq. 261.

²⁵⁶ Klarič, Petar dhe Martin Vedriš: vep.cit., fq. 138.

²⁵⁷ Zakon o obligacionim odnosima, "Službeni List SFRJ", br. 29/78, në tekstin e mëposhtëm LMD-78. Ky ka qenë Ligj Federativ - që në pajtim me nenin 5 të Ligjit kushtetues për zbatimin e Kushtetutës së RM-së nga viti 1991 deri në fillim të vitit 2001 është aplikuar si ligj republikan.

nga personat juridik jashtë kornizave të zotësisë juridike të tyre, do të ishin pa pasoja juridike, pra të nulshme. Pala kontraktuese e ndërgjegjshme, ajo që nuk ka ditur dhe që nuk ka mundur të dijë se kontrata është lidhur jashtë zotësisë juridike të bashkëkontraktuesit, ka mundur të kërkojë kompenzim të dëmit të pësuar për shkak të lidhjes së kontratës së këtillë.

LMD në nenin 46, al.2 dhe 3 ka këtë përcaktim: “2) Kontrata e lidhur jashtë zotësisë juridike të personit juridik nuk ka veprim juridik, përveç nëse pala tjetër ka ditur ose ka mundur të dijë për tejkalimin. 3) Pala e ndërgjegjshme, mund të kërkojë kompenzim të dëmit që ka pësuar për shkak të lidhjes së kontratës që nuk ka veprim juridik.” Me këtë përcaktim Maqedonia e ka pranuar teorinë *ultra vires*²⁵⁸ (jashtë autorizimeve). Sipas kësaj teorie, personat juridik mund të ndërmarrin veprime *inter vires* (në kuadër të autorizimeve të tyre), ndërsa veprimet që i ndërmarrin *ultra vires* (jashtë autorizimeve të tyre), nuk prodhojnë veprim juridik.²⁵⁹ Kjo rregull e LMD, e inspiruar nga teoria *ultra vires*, në pajtim me nenin 16 të LMD²⁶⁰, është e aplikueshme vetëm në rastet që nuk janë të rregulluara me ligj tjetër (të veçantë). Kjo është nga shkakut se ligji i fundit, nëse ekziston, si ligj special, e derogon LMD, si ligj gjeneral. Si shembull karakteristik për një ligj special, është “Ligji mbi shoqëritë tregtare”²⁶¹, i cili ndryshe e rregullon çështjen mbi zotësinë e veprimit të personave juridik.²⁶² Sipas tij, janë të

²⁵⁸ Teori e zhvilluar në të drejtën angleze në shekullin XIX.

²⁵⁹ Чавдар, Кирил: Закон за облигационите односи (коментари, објаснувања, практика и предметен регистар), Скопје: Агенција Академик, 2001, fq. 122.

²⁶⁰ Neni 16: “Mbi marrëdhëniet detyrimore të rregulluara me ligje të tjera aplikohen dispozitat e këtij ligji në çështjet që nuk janë të rregulluar me atë ligj.”

²⁶¹ Законот за трговските друштва, “Службен Весник на Република Македонија”, бр. 28/04, në tekstin e mëposhtëm LSHT.

²⁶² Lidhur me këtë, shih nenin 444, al. 1 dhe 2, dhe nenin 706, al. 1, të LSHT.

plotfuqishme të gjitha marrëdhëniet detyrimore, që personi juridik do t'i lidh me personat e tretë, pa marrë parasysh se me atë rast, ka vepruar në korniza të veprimtarisë së tij të regjistruar ose jashtë saj.²⁶³

Sipas LMD personi juridik mund të lidh punë juridike në qarkullimin juridik në kuadër të zotësisë së tij juridike (neni 46, al.1,e LMD). Me Novelën 2008 të LMD, në nenin 21 të tij është paraparë që në nenin 46 të LMD, pas alinesë 1, të shtohet aline e re me numër 2, sipas së cilës: “Personat juridik hyjnë në qarkullimin juridik në pajtim me ligjin, statutin e tyre, marrëveshjen e shoqërisë, gjegjësisht aktet e tyre të përgjithshme”. Alinea 2 e nenit 46, që tash bëhet aline 3 pëson ndryshime, dhe sipas saj: “Punët juridike të ndërmarra nga personi juridik me persona të tretë, jashtë veprimtarive që e përbëjnë objektin e punës së tij, janë të plotfuqishme, përveç nëse personi i tretë ka ditur ose sipas rrethanave është dashur të dijë për tejkalimin ose nëse me ligj nuk është paraparë diçka tjetër”.

Krijimi i kushteve për zhvillim të pandërprerë të qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, është detyrë që për Republikën e Maqedonisë doli nga Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim. Kjo kushtëzon një sërë ndryshimesh dhe plotësimesh të ligjeve ekzistuese me të cilat rregullohet ai qarkullim.

Lidhur me zotësinë e veprimit të personave juridik, me Novelën 2008 të LMD, është braktisur teoria *ultra vires*. Shmangja e saj është rezultat i frymës së të drejtës së Unionit Evropian²⁶⁴, e cila e promovon lirinë e tregut, gjegjësisht lirinë e qarkullimit të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve. Për këtë funksion të legjislacionit të UE-së, doktrina *ultra vires*

²⁶³ Галев, Гале dhe Јадранка Дабовиќ-Анастасовска: *ver.cit.*, fq. 148.

²⁶⁴ Në tekstin e mëposhtëm UE.

paraqet pengesë për qarkullim, pasi i shpall të nulshme punët juridike të lidhura jashtë veprimtarisë së personit juridik dhe me këtë u arrit mbrojtja e interesave të palës tjetër kontraktuese e cila jo gjithmonë duhet të dijë se bashkëkontraktuesi i saj a vepron në korniza të veprimtarisë themelore të regjistruar, pasi edhe sipas LSHT regjistrimi i objektit të punëve të personit juridik në regjistrin përkatës, nuk do të thotë se personi i tretë ka ditur ose është dashur të dijë për tejkalimin. Me ndryshimet e nenit 46 të LMD, bëhet një hap drejt kyçjes në tregun e shteteve të UE-së. Kjo dispozitë është në pajtueshmëri me nenin 9 të Direktivës së Parë të Këshillit mbi kompanitë²⁶⁵ nga 9 marsi i vitit 1968 (68/151/EEC).²⁶⁶

LMD flet për punët juridike të lidhura jashtë zotësisë juridike të personit juridik, ndërsa me Novelën 2008 të LMD, flitet për punët e lidhura jashtë veprimtarisë që e përbëjnë objektin e punës së personit juridik. A është kjo e njëjtë? Me fjalë të tjera, a përputhen kufijtë e zotësisë juridike të personit juridik me objektin e punës së tij?

Në LSHT, në nenin 64, al.1 përcaktohet se: “Shoqëria tregtare mund të ndërmerr punë juridike dhe veprime vetëm në kufijtë e objektit të punës së regjistruara në regjistrin tregtar”. Në neni 62, al.4 përcaktohet se: “Shoqëria tregtare mundet edhe pa regjistrim në regjistrin tregtar të kryej edhe veprime të tjera që janë të nevojshme për ekzistimin e tij dhe për kryerjen e punëve nga objekti i punës së tij, por të cilat nuk bëjnë pjesë në mënyrë direkte në

²⁶⁵ **First Council Directive 68/151/EEC of 9 March 1968 on co-ordination of safeguards which, for the protection of the interests of members and others, are required by Member States of companies within the meaning of the second paragraph of Article 58 of the Treaty, with a view to making such safeguards equivalent throughout the Community, (Official Journal L 065, 14/03/1968) P. 0008 - 0012. Direktivën mund ta gjeni në web faqen: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:31968L0151>.**

²⁶⁶ Галев, Гале и Неда Здравева: *ver.cit.*, fq. 232.

kornizat e kryerjes së punëve nga objekti i punës së tij”. Sipas nenit 64, al.2: “Punët juridike që i lidh, gjegjësisht punët juridike që i ndërmerr shoqëria tregtare me, gjegjësisht ndaj personave të tretë dhe me të cilat është tejkaluuar objekti i punës së shoqërisë, të regjistruar në regjistrin tregtar, janë të plotfuqishme, përveç nëse shoqëria tregtare vërteton se personi i tretë ka ditur ose nga rrethanat është dashur të dijë për tejkalimin. Regjistrimi i objektit të punëve të shoqërisë në regjistrin tregtar, nuk do të thotë se personi i tretë ka ditur ose është dashur të dijë për tejkalimin”. Për tejkalimin e këtillë të shoqërisë tregtare ekziston përgjegjësia për kundërvajtje.

Në literaturë ceket se me aprovimin e dispozitave të lartpërmendura në LSHT e drejta maqedonase e ka hedhur poshtë doktrinën *ultra vires*, sipas së cilës punët juridike të cilat personi juridik i lidh jashtë objektit të punës së vërtetuar me aktet e tij, janë të nulshme. Sipas kësaj teorie, objekti i punës, e ka përcaktuar zotësinë juridike të personit juridik. Përfundimisht theksohet se në të drejtën maqedonase, as zotësia juridike as ajo e veprimit të shoqërive nuk janë të kufizuar me objektin e punës së tij. Pra nga kjo që u parashtrua më lartë vijmë deri tek përfundimi se në të drejtën maqedonase, nuk ekziston përputhshmëri përmbajtësore në mes zotësisë juridike të personit juridik dhe objektit të punës së tij, gjegjësisht se kufijtë e zotësisë juridike janë më të gjërë se objekti i punës së tij.²⁶⁷

Për ndërtimin e një sistemi te vlerësimit te performances ekzistojnë disa kritere të cilat institucioni apo biznesi i përdor për krijimin e një liste që do të vlerësojë dhe diferencojë pozita të ndryshme pune varësisht nga vlerësimi i bere. Ne te gjitha institucionet Sektori i Burimeve Njerëzore ka për detyrë, organizimin dhe funksionimin e procesit të vlerësimit të arritjeve individuale të çdo punonjësi. Bazuar ne strukturën e ndërtuar sipas kapaciteteve te resurseve disponuese njerëzore, aktivitetet e menaxhimit te tatimeve shtrihen ne tere vendin ne respektimin e legjislacionit tatimor ne shërbim te tatimpaguesve, inkasimin e te hyrave tatimore dhe detyra tjera te vizitave ne teren te përcaktuara sipas legjislacionit tatimor. Është me rëndësi te theksohet se përbërja e resurseve njerëzore ne Administratën Tatimore është gjithëpërfshirëse dhe shume etnike.

Numri i përgjithshëm i te punësuarve ne Administratën Tatimore te Kosovës me strukturë kualifikuese, përbërje etnike dhe gjinore:

Numri i përgjithshëm i të punësuarve	Struktura kualifikuese				Struktura etnike				Struktura gjinore		Gjithsej të punësuar
	Superior	Lartë	Mesëm	Filior	Shqiptar	Serb	Turq	Tjere	Meshkuj	Femra	
Gjithsej	617	12	154	2	757	16	3	9	535	250	785
%	78.6%	1.5%	19.6%	0.3%	96.4%	2.0%	0.4%	1.1%	68.2%	31.8%	100.0%

Tabela 1: Gjendja e numrit të punësuarve përfshi strukturën kualifikuese, etnike dhe gjinore. Burimi: Divizioni i Burimeve Njerëzore 2014.²⁸¹

Përmes kësaj strukture te resurseve ekzistuese, te kualifikuara dhe profesionale është ndërtuar skema organizative e Administratës Tatimore. Kurse veprimtaria e resurseve njerëzore te institucionit qe menaxhon sistemin tatimor ne Republikën e Kosovës zhvillohet përmes zyrave regjionale ne gjithë vendin. Shpërndarja e resurseve njerëzore sipas organizimit territorial është bazuar ne përbërjen gjeografike, zhvillimin ekonomik dhe numrin e bizneseve qe operojnë.

Performanca e mbajtësit të pozitës ne vendin e punës është rezultati i të arriturave individuale në detyrë, vijimi ne punë, sjellja dhe qëndrimi i përgjithshëm i secilit te punësuar. Sistemi i vlerësimit te performances është një pasqyre e qarte qe tregon për punën e nëpunësit dhe rezultatet e tij ne këtë aktivitet për te cilat i behet një vlerësim nga mbikëqyrësi i tij dhe

²⁸¹ Burimet Njerëzore – Administrata Tatimore e Kosovës.

vlerësohet me një note varësisht nga performimi i tij. Procesi i vlerësimit të performancës zhvillohet duke bërë vlerësimin e arritjes së objektivave të nëpunësve, vlerësim i cili bëhet nga mbikëqyrësit e tyre. Vlerësimi bëhet mbi bazën e mbarëvajtjes në punë për një periudhë 12 mujore. Viti i vlerësimit fillon nga 01 Janar deri më 31 Dhjetor të vitit, ku përmes formës zyrtare shpjegohen fazat e kryerjes së vlerësimit të punës. Në fillim të vitit i gjithë stafi duhet të njoftohet me objektivat e punës mbi të cilat do bëhet vlerësimi. Vlerësimi i performancës dhe mbarëvajtja në punë bazohet në vlerësimin e dy lloj faktorëve:

- a) arritjes së objektivave dhe
- b) vlerësimit të aftësive për të përmbushur këto objektiva.

Vlerësimi i mbarëvajtjes në punë, është një procedurë e hapur, e cila kryhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i punonjësit. Vlerësimi është diçka më shumë se një proces organizativ i cili duhet të ndodhë në vazhdimësi, prandaj në Administratën Tatimore ky proces kryhet vazhdimisht, në mënyrë të ndërgjegjshme dhe objektive. Kur vlerësojmë diçka, mundohemi të përcaktojmë vlerën, dobën dhe shkallën në të cilën shpalosen cilësitë. Vlerësojmë veten dhe njerëzit tjerë, vlerësojmë sjelljen, personalitetin dhe sistemet.²⁸² Brenda një viti vlerësues kryhet një vlerësim i përgjithshëm deri në fund të vitit, ku mbikëqyrësi duhet të vëzhgojë me kujdes dhe në vazhdimësi, mbarëvajtjen e punonjësve për të cilët është përgjegjës.

Ai apo ajo duhet të regjistrojë në mënyrë specifike ecurinë e punës për ata të cilët vlerësohen, duke vënë në pah çdo problem nëse ai paraqitet gjatë kohës së vlerësimit. Gjatë vlerësimit të performancës punonjësit duhet t'i vihen në dukje veprimtaritë (fushat) ku mbarëvajtja e tij është e dobët apo

²⁸² Zana Koli, Shyqyri Llaci, "Menaxhimi i Burimeve Njerëzore", Tiranë, 2005, faqe 219.

e lartë që ai disponon. Në rast se mbarëvajtja është e pakënaqshme, atëherë punonjësi me shkrim nga eprori i tij lidhur me gjendjen e vlerësimit. Vlerësimi i mbarëvajtjes në punë të resurseve njerëzore bazohet në objektivat e vendit të punës dhe rekomandohet të paraqiten detyrat, ku preferohet në 5-6 objektiva të cilat duhet të përmbajnë veprimtaritë kryesore që përdor punonjësi për realizimin e aktivitetit të tij. Objektivat duhet të renditen sipas: rëndësisë, kohës që kërkohet për t'i realizuar dhe përcaktohen duke u konsultuar direkt me punonjësin. Shumë i rëndësishëm është konsideruar edhe "**Vetëvlerësimi i performancës**" që kryhet nga vetë punonjësi. Forma e Vetëvlerësimit realizohet duke ngritur disa pyetje të cilave duhet t'u përgjigjet çdo punonjës, nga ku eprori bashkëbisedues merr informacion të drejtpërdrejtë.

Mirëpo problemi i vlerësimit të performancës nga ana e individëve për vetveten është përcjellë me dyshime se njerëzit mund të jen subjektive dhe se nuk duan ta bëjnë këtë.²⁸³ Moment tjetër në vlerësimin e performancës është edhe "**Vlerësimi i Aftësive Kryesore**" të secilit punonjës. Kjo rrugë, ndihmon në evidentimin e dobësive dhe epërsive të çdo punonjësi: Aftësitë kryesore vlerësohen për dy lloj nivelesh, vlerësimi behet me plotësimin e formave zyrtare sipas nivelit, p.sh.

1- Për nivelin Përgjegjës dhe Profesional, përdoret formulari: Profesionistet e përkrahjes,

2- Për nivelin menaxherial, përdoret formulari: Vlerësimi i aftësive të mbikëqyrësit.

Burimet Njerëzore shpërndajnë formularët e vlerësimit (në formë elektronike, tabelat përkatëse me udhëzimet e nevojshme) dhe sigurohet që ato të kthehen të plotësuar, miratuar nga personat përgjegjës dhe arkivohen në dosjen personale të secilit punonjës. Punonjësi i cili është në provë që në

²⁸³ Havolli, Ymer, " Menaxhimi i resurseve njerëzore", Prishtinë, 2005, faqe 134.

fillim, duhet të ketë të qarta objektivat për vendin e punës që mbulon. Mbarëvajtja në punë e kësaj kategorie punonjësish, duhet të diskutohet ndërmjet vetë punonjësit dhe vartësit të tij. Vlerësimi i resurseve behet për të gjithë punonjësit edhe për punonjësin në provë. Në rastin kur punonjësi ndërron vendin e punës brenda institucionit ku punon, vlerësimi i mbarëvajtjes së tij në punë kryhet nga eprori i ri, ku eprori i fundit duhet të konsultohet patjetër edhe me eprorët e mëparshëm të punonjësit që vlerësohet. Një aktivitet i tillë i vlerësimit në Administratën Tatimore të Kosovës në vazhdimësi respektohet.

1.2. Mospajtimet me vlerësimin

Pasi që punonjësi të njihet me vlerësimin e tij / saj, në raste të mospajtimit me vlerësimin që i është bërë, atëherë ka të drejtën e ankimit në një afat të caktuar bazuar në legjislacionin në fuqi nga dita e marrjes së vlerësimit. Zakonisht mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen duke diskutuar me përgjegjës të tij apo eprorin e radhës. Kur kjo nuk është e mundur, punonjësi paraqet ankesë me shkrim ku reflekton të gjitha argumentet e tij / saj. Pas kësaj, menaxhmenti i radhës duhet të komentojë me shkrim të gjitha pikat e ankesës së punonjësit dhe nëse eprorët nuk arrijnë të gjejnë një zgjidhje të përbashkët lidhur me vlerësimin, atëherë do të jetë eprori autorizues ai që do të vendosë në mënyrë zyrtare për këtë çështje duke u bazuar në legjislacion.

1.3. Efekti i vlerësimit

Procesi i Vlerësimit të mbarëvajtjes individuale në punë, është një proces mbështetës si për sektorin e Burimeve Njerëzore ashtu dhe për stafin menaxherial i cili mund të informohet saktë e në çdo moment për ecurinë e punës, vështirësitë aktuale apo nevojat për trajnim në ngritje profesionale. Për stafin e Administratës Tatimore të Kosovës viti i vlerësimit është 12 muaj dhe që në fillim të viti nga përgjegjës të tij dhe vartësit vendosen

objektivat e punës dhe i prezantohen ato punonjësve, kurse në fund të vitit kryhet vlerësimi i mbarëvajtjes në punë për vitin aktual ku do të vlerësohet performanca e punës për periudhën një vjeçare. Pasi që të vendosen objektivat atëherë ato si procedurë duhet aprovuar dhe pas kësaj dakordohet që vlerësimi i parë i punës për vitin aktual, të kryhet në mes të vitit, përkatësisht me 30 Qershor. Sistemi i vlerësimit të performancës ka rendësi të veçantë nga se përmes këtij aktiviteti arrihet deri të procesi i marrjes së informacionit për një sërë të dhënash lidhur me punën të cilën e zhvillon punonjësi i cili vlerësohet. Aktivitetet tilla që vlerësohen janë si: detyrat, funksionet dhe aktivitetet e punës, standardet e realizimeve, njohuritë, aftësitë, dhe eksperiencia e nevojshme për realizimin e punës, etj.

Nëpërmjet këtyre kritereve bëhet identifikimi i cilësisë dhe suksesit në një aktivitet të caktuar.²⁸⁴ Informatat e mbledhura gjatë sistemit të vlerësimit dhe analizës përdoren vlerësimin e performancës dhe hartimin e përshkrimeve dhe specifikimeve të punës, të cilat janë të nevojshme për arsye se : ndihmojnë vartësit dhe punonjësit të përcaktojnë përgjegjësit dhe detyrat e punës, shërbejnë si një udhëzues për lëvizjen e punonjësve në drejtimin lidhur me punën, përshkruajnë madhësinë dhe kohën e nevojshme për përpjekjet lidhur me punën, pajisin kandidatet me përgjegjësit, detyrat, kushtet dhe kërkesat e punës, të identifikojë linjat raportuese për eporet dhe vartësit, të përcaktojnë vlerën relative të punës, që të ruhet drejtësia brenda dhe jashtë dhe të sigurohet që nuk do të shkelin ligjet lidhur me problemet e punësimit.

II 2. Udhëzime për stafin

Sistemi i vlerësimit është i krijuar në atë mënyrë që të jetë i lehtë për t'u zbatuar dhe për t'iu dhënë një pasqyrë të qartë për kontributin e juaj

²⁸⁴ Havolli, Ymer , “Menaxhimi i resurseve njerëzore”, Prishtinë ,2005, faqe 126.

individual në realizimin e rezultateve në punë gjatë vitit që pason. Për të pasur një vlerësim drejte kërkohet që mbikëqyrësi të mbanë shënimet e performances gjate gjithë vitit. Ekzistojnë katër elemente kryesore të cilat do të ndikojnë në performancën e mire dhe sistemin e vlerësimit nga se ky sistem: vlerëson përmbushjen e detyrave dhe sjelljet e punonjëseve në punë, vlerëson potencialin e juaj dhe përshtatshmërinë për ngritje në detyrë, përcakton kategorinë e pagesës në bazë të rezultateve dhe ndihmon në zhvillimin e shkathtësive, aftësive dhe karrierës së punëtorit. E rëndësishme është që jo vetëm të behet vlerësimi, por që ky vlerësim të behet në mënyrë sa më të drejte, nga se një vlerësim jo i drejte do të ndikonte negativisht në arritjen e qëllimeve të caktuara.²⁸⁵ Për të ngrite menaxhimin e performances dhe sistemin e vlerësimit kërkohet që në këtë proces të rëndësishëm të përfshin dy elemente dhe atë: në rolin dhe përgjegjësitë e juaja gjate vlerësimit dhe Procesin vjetor të vlerësimit, formularin e vlerësimit të rezultateve dhe zhvillimit.

2.1. Roli dhe përgjegjësitë

Për të monitoruar dhe vlerësuar rezultatet se si nëpunësit janë duke përformuar është parësore të caktohen objektivat e qarta për nëpunësit të cilët duhet përmbushë gjate kohës për të cilën vlerësohen, me këtë rast mbikëqyrësi zhvillon takimin me punonjësin; duke diskutuar dhe rënë dakord me arritjen e objektivave të punës, duke vëzhguar dhe vlerësuar vet përmbushjen e detyrave (performancën), duke u angazhuar në bisedë të rregullt me mbikëqyrësin për të diskutuar progresin që është arritur dhe shqetësimet eventuale që ka, duke shqyrtuar mundësitë e përmirësimit të rezultateve përmes të mësuarit dhe zhvillimit dhe duke punuar në mënyrë konstruktive për të mbështetur punën e ekipit. Një sistem efikas i vlerësimit

²⁸⁵ Zana Koli, Shyqyri Llaci, “Menaxhimi i Burimeve Njerëzore”, Tiranë 2005, faqe 233.

do t'ju ndihmoj te vlerësoni stafin kundrejt objektivave te definuara duke reagua në mënyre konstruktive apo duke lavdëruar për punën e kryer.

Procesi vjetor i vlerësimit

Sistemi i vlerësimit te performances do të këtë karakter funksional vetëm atëherë kur bëhet një planifikim i mire i objektivave dhe implementimi i atyre objektivave ne mënyre te duhur. Secili i punësuar deri në nivelin e Drejtorëve duke e përfshirë edhe atë duhet të plotësojë një formular standard bashkë me mbikëqyrësin e tyre. Me këtë formular regjistrohet vlerësimi i rezultateve të punës, pjesëmarrjes, sjelljeve, potencialit dhe përshtatshmërisë për promovim. Është po ashtu një ndihmë në zhvillimin e aftësive, shkathtësive dhe planifikimit afatgjatë të karrierës, gjate një viti.

3.1. Vlerësimi në fillim të periudhës

Është një përmbledhje e shkurtë e ciklit të vlerësimit e cila me së miri përshkruhet përmes vlerësimeve të bëra sipas periudhave vlerësuese, në fillim të periudhës së vlerësimit mbahet takimi me mbikëqyrësin për të diskutuar dhe për te rene ne dakord për: objektivat e punës dhe për detyrat specifike për realizimin e objektivave. Para se të plotësohet dhe nënshkruhet pjesa e parë e formës standarde do të arrihet pajtimi për objektivat.

3.1.1. Objektivat

Metodat më të reja të vlerësimit të performancës vënë theksin në trajnimin si dhe në planet për zhvillimin dhe rritjen e punonjësve. Trajtimi i vlerësimit si proces që synon zhvillimin pranon që qëllimi i menaxhimit është të përmirësoj sjelljen në punë dhe jo thjeshtë të vlerësoj performancën

e kaluar.²⁸⁶ Objektivat tregojnë se si do të kontribuojë puna e punonjësit në realizimin e planit të punës për fushën e tij/saj të punës e përmes kësaj edhe në planin e punës së organizatës. Zakonisht shënohen numër i vogël i objektivave (5-6), duhet të kihet parasysh se shkalla e përmbushjes së detyrave në raport me objektivat e punës dhe ato të zhvillimit do të ketë një ndikim në vlerësimin e fund vitit dhe në rubrikën e notave. Po ashtu punonjësi duhet të dakordohet me menaxherin për fushat në të cilat ka nevojë të zhvillohet.

Objektivat e zhvillimit janë personale dhe ato përpilohen në bashkëpunim me menaxherin, duhet kujdesur që objektivat të ndërlidhen me rezultatet më të mira në punë të cilat duhet të jenë :

- a) **të qarta,**
- b) **të arritshme**
- c) **të matshme.**

Është detyre e të punësuarit të identifikojë se si do të demonstrohen, si do të përmbushen objektivat, duke përcaktuar masat që ndërlidhen me sasinë, cilësinë, caqet dhe afatet kohore. Punonjësi dhe menaxheri pajtohen për detyrat e tyre dhe nuk duhet të keni dyshime në lidhje me atë se çka pret menaxheri i juaj nga ju dhe si do të vlerësojë ai punën tuaj. Nëse nuk është e qartë, atëherë duhet të bisedohet me menaxherin e radhës.

3.2. Vlerësimi gjatë vitit

Punonjësi dhe menaxheri duhet të mbajnë diskutime të rregullta gjatë tërë vitit që nëse paraqitet nevoja të behet rishqyrtimi i objektivave të përcaktuara në fillim të vitit. Nuk ka ndonjë kohë të caktuar për një rishqyrtim formal (në shumicën e rasteve është 30 Qershori) mirëpo është

²⁸⁶ Zana Koli, Shyqyri Llaci, “Menaxhimi i Burimeve Njerëzore”, Tiranë, 2005, faqe 220.

një praktikë e mirë për të diskutuar rezultatet e arritura në raport me objektivat e punës dhe zhvillimit. Duhet pasur parasysh se një rishqyrtim mund të jetë edhe një bisedë joformale me menaxherin për çështje të përmbushjes së detyrave nga ju. Për shembull gjatë diskutimit të një rasti me menaxherin e juaj, ju mund të diskutoni se sa efektiv ka qenë kontributi i juaj, nëse keni pasur ndonjë problem dhe si i keni tejkaluar ato. Me këtë rast menaxheri do të përcjell progresin e juaj gjatë vitit, mirëpo ju e ndani një pjesë të përgjegjësisë për të përcjellë punën tuaj, të mbani ndonjë evidencë që do t'iu ndihmojë me informata gjatë diskutimeve për vlerësim të rezultateve të punës. Nëse punonjësi sheh ndonjë problem me punën e tij ose zhvillimin, duhet diskutuar ato me menaxherin sa më herët që është e mundshme. Punonjësi dhe menaxheri mund të bien dakord për të ndryshuar objektivat e punës, por ndryshimi i objektivave ndikon në performancën e dobët, nëse: a) Objektivat nuk pasqyrojnë atë çka dakorduar të arrihet, b) nëse objektivat nuk arrihen për shkak të faktorëve që janë jashtë kontrollit tuaj, c) nëse puna e juaj ndryshon në masë të madhe gjatë vitit.

3.2.1. Rezultatet

Vijueshmëria jo e rregullt në punë mund ta bëj më të vështirë përmbushjen e objektivave të parashtruara me rastin e vlerësimit të punës së punonjësit. Kjo mund direkt të ndikojë në notën e performancës në fund të vitit kur behet vlerësimi, menaxheri do të shikojë vijueshmërinë në punë kur shqyrton rezultatet e punës së të punësuarit. Nëse menaxheri i beson se ju nuk do të përmbushni objektivat ose vijimi në punë është nën standardin e kërkuar, do të diskutohet problemi me punonjësin dhe do të mbahen shënime të hollësishme për bisedën. Menaxheri do të kërkojë nga ju që të dakordoheni dhe të nënshkruani një kopje të shënimeve, me kete rast duhet

referuar udhëzimeve të hollësishme në lidhje me menaxhimin e rezultateve dhe vijimit të dobët në punë.

3.2.2. Notat indikative

Notat indikative janë parashikimi i menaxherit për notat që ata mund të japin në fund të periudhës së plotë të vlerësimit. Menaxherët e lartë mund të kërkojnë notat indikative, zakonisht në gjysmë të vitit për të kontrolluar nëse: sistemi i vlerësimit është duke u zbatuar në mënyrë të drejtë dhe se asnjë person nuk është duke u trajtuar pa drejtësisht. Notat duhet të shpërndahen në mënyrë të barabartë në mes të gradave dhe pjesëve dhe notat i përshtaten shkallës së pritur të shpërndarjes. Nuk ekziston ndonjë kuotë e paracaktuar sa i përket notave. Ne presim që shumica e të punësuarve të marrin një notë *‘të mirë’* dhe përafërsisht 20% do të marrin notën *‘ më të lartë’*. Si në çdo organizatë tjetër të madhe performanca e disa të punësuarve do të ketë nevojë për përmirësime, duke marr vlerësimin *‘ ka nevojë për përmirësime’*.

3.3. Vlerësimi në fund të vitit

Në fund të vitit ju gjithmonë duhet të jeni të qartë sa i përket performancës së juaj, me këtë rast nuk duhet të befasuar për asgjë që menaxheri i juaj diskuton me juve në takimin vlerësues të fund vitit. Në fund të vitit punonjësi dhe menaxheri do të rishikojnë performancën e punonjësit gjatë periudhës vlerësuese, duke ndërtuar diskutime të vazhdueshme, dhe të arrihet pajtueshmëri për vlerësimin e arritjes së objektivave të fund vitit. Nëse dëshirohet, mund të behet vetëvlerësimi i rezultateve të punës suaj për të diskutuar në rishqyrtimin e fund vitit. Gjate zhvillimit të procesit të vlerësimit menaxheri analizon disa faktorë me rëndësi si: diskuton të arriturat e juaja sa i përket objektivave të punës dhe atyre të zhvillimit, përshkruan sjelljet e juaja duke përdorur skemën e sjelljeve aftësive dhe zotësive,

plotëson kolonën për marrëveshjen e arritur, diskuton notën e përgjithshme me juve dhe përshkruan performansën e punonjësit gjatë periudhës që vlerësohet. Pas analizës së këtyre faktorëve atëherë menaxheri dhe punonjësi dakordohen me vlerësimin dhe nënshkruajnë në pjesën e formës së vlerësimit. Nëse pas bisedës nuk pajtueshmëri me vlerësimin e menaxherit, atëherë mund të shtohen komentet e juaja në rubrikën përkatëse.

III 4. Komentet – Rekomandimet për vlerësimin

Shumica e detyrave dhe aktiviteteve zhvillimore të identifikuara nga punonjësi dhe menaxheri mund të kryhen si pjesë e punës normale, nganjëherë roli i tanishëm nuk mund të plotësojë një nevojë specifike për zhvillim. Në raste të tilla, punonjësi dhe menaxheri do të shqyrtojnë nëse ka nevojë për një zhvendosje zhvillimore. Por nëse menaxheri beson se punonjësi është i përshtatshëm për ngritje në detyrë atëherë jepet komenti për fuqinë e avancimit në detyrë, duke ju referuar udhëzimeve në lidhje me vlerësimin për ngritje në detyrë. Atëherë punonjësi dhe menaxheri pajtohen bashkërisht dhe nënshkruajnë pjesën nevojshme të formës standarde të vlerësimit.

4.1. Ngritje në detyrë

Menaxheri vlerëson përshtatshmërinë e të punësuarit për ngritje në detyrë duke u bazuar në performancën e tij gjatë vitit të fundit. Këtu merren parasysh këta faktorë si: shkalla e aftësive dhe zotësive të punës aktuale duke u bazuar në të gjitha aspektet e performancës dhe të skemës së sjelljeve, aftësive dhe zotësive, llojin e punës për të cilën më së miri përshtatet i punësuarit, në bazë të shkathtësive dhe përvojës gjatë vitit të fundit dhe nëse është nevojë ndonjë dëshmi nga vitet e mëhershme dhe nëse i punësuarit ka dëshmuar : Një nivel të lartë të qëndrueshëm të performancës në gradën aktuale, nëse dëshmon aftësi për të realizuar një performancë të mirë në një

nivel më të lartë dhe sjellje pozitive që priten nga i tërë personeli. Nëse menaxheri ose i punësuar ka ndryshuar brenda vitit, menaxheri që kryen vlerësimin e fundvitit do të këshillohet me menaxherin e mëhershëm. Nëse është e mundshme ata po ashtu do të marrin parasysh ndonjë koment nga dikush tjetër për të cilin ka realizuar punë i punësuar gjatë periudhës që vlerësohet. Në raste tejet të veçanta, një menaxher mund të përkrah një kërkesë për avancim gjatë vitit nëse i punësuar ka dëshmuar përshtatshmëri që nga koha kur është bërë vlerësimi i fundit i fund vitit.

KONKLUZION

Qëllimi i këtij punimi është të pasqyroj mënyrën e funksionimit të menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën publike, duke pasqyruar dhe fokusuar me theks të veçantë rastin e vlerësimit në Administratën Tatimore të Kosovës. Vlerësimi i arritjes së objektivave dhe kryerjes së detyrave të punës është një mënyrë për të sqaruar se çfarë pritet nga puna, kjo ndihmon zhvillimin e standardeve për punë të kënaqshme, duke cilësuar sasinë dhe cilësinë e punës së pranueshme dhe të përshtatshme për një punë të caktuar. Kjo bëhet për të mirën e nëpunësit, mbikëqyrësit dhe organizatës në të cilën punohet.

Vlerësimi i kryerjes së punës duhet të evidentojë pikat e dobëta dhe të forta në arritjet e punës së secilit të punësuar në organizatë dhe të këshillojë në mënyrë objektive nëpunësit mbi bazën e këtyre vëzhgimeve. Në këtë mënyrë vlerësimi i personelit bëhet një pjesë e planit individual të nëpunësve në procesin e vendosjes së qëllimeve dhe objektivave brenda një organizate. Ai është një ndihmesë për emërimet dhe promocionet, krijon bazën për të përcaktuar rritjet e pagave dhe shpërblimet dhe mund të përdoret edhe për të përcaktuar radhën e mbajtjes në punë kur paraqitet nevoja e reduktimit të stafit, apo ngritjes në detyrë.

Vlerësimi i performancës shërben gjithashtu si një ndihmesë për burimet njerëzore, për përcaktimin e politikave dhe procedurave të reja. Vlerësimet shërbejnë edhe si kontroll për kërkesat e kualifikimit, shqyrtimit, nevojat e trajnimit dhe për të zbuluar rastet kur punonjësit nuk janë të përshtatshëm për punën ku janë caktuar. Vlerësimi i performancës duhet të behet ne baze te standardeve te punës, cilat janë objektivat, çka organizata dhe mbikëqyrësi kërkon nga punonjësi, etj. Këto standarde duhet t'i bëhen të qarta punonjësit kur ai përzgjidhet, orientohet dhe trajnohet.

Literatura

1. Prof. Asosc. Dr. Zana Koli, “Menaxhimi i Burimeve Njerëzore”, Tiranë ;
2. Dr. sc. Artan Nimani, “Menaxhimi i Burimeve Njerëzore”, Prishtinë;
3. Prof. Dr. Shyqyri Llaci, “Menaxhimi i burimeve Njerëzore”, Tiranë;
4. Ymer ,Havolli , “Menaxhimi i resurseve njerëzore”, Prishtinë;
5. Dr. Ilirjan Lipi, “Menaxhimi i Burimeve Njerëzore”, Tiranë.

IMPLEMENTATION OF GFS IN PUBLIC SECTOR OF KOSOVO

Mr.sc. Gazmend Morina¹ , Mr.sc. Ajete Ukshini²

1Kolegji ISPE, Fakulteti Ekonomik, Prishtinë

E-mail address: gazmend_morina@hotmail.com

2Ministria e Financave, Thesari i Kosovës, Prishtinë

E-mail address : ajete_ukshini@hotmail.com

Abstract

In this paper will explain the functioning of the system of GFS (Government Finance Statistics) in the public sector in Kosovo. GFS is part of a series of international guidelines on statistical methodologies that have been issued by the International Monetary Fund. GFS was produced by the IMF's Statistics Department in fulfillment of its mission to provide strong leadership for the development and application of sound statistical practices, and is published in service of the worldwide trend toward greater accountability and fiscal transparency.

GFS will help the Ministry of Finance to prepare the annual data according to GFS and annual government finance statistics.

It will also explain the classification of public expenditure in the public sector at central and local level and classification of public enterprises in Kosovo with specific budget.

Keywords: GFS, International Monetary Fund, Reports, Statistics, Sector

1. HYRJJE

Government Finance Statistics (GFS) është një udhërrëfyes apo standard përmes të cilit Fondi Monetar Ndërkombëtar po synon që Qeverisë së Kosovës t'i ndihmoj ta ndërtoj një sistem për të siguruar një udhëheqje të shëndoshë në lidhje me politikën fiskale, përpilimin dhe raportimin e të

dhënave fiskale. GFS i referohet në përgjithësi qeverisë qendrore, sektorit publik, duke i përfshirë edhe ndërmarrjet publike, të cilat në Kosovë nga paslufta nuk janë të përfshira në buxhetin e Kosovës, përveç Radio Televizionit të Kosovës, i cili është njësi me buxhet ekstra. Po ashtu GFS synon edhe në një bashkëpunim apo gërshetim të sektorit publik me sektorin privat.

GFS ka për qëllim që t'i udhëzojë qeveritë qendrore që t'i caktojë apo definojë institucionet të cilat duhet t'i përgatitin politikat fiskale, institucionet e caktuara të cilat duhet t'i menaxhojnë të dhënat fiskale si për shpenzimet, të hyrat, borxhet dhe pasuritë.

GFS është përgaditur dhe menaxhohet nga Departamenti i Statistikave të Fondit Monetar Ndërkombëtar. GFS ka për qëllim edhe harmonizimin apo përshtatshmërinë e politikave dhe procedurave në aspektin ndërkombëtar. Objektivat e GFS janë edhe klasifikimi i sektorit publik, mënyra e raportimit të shpenzimeve, të hyrave, pasurive si dhe mënyra e raportimit financiar. Në këtë drejtim Fondi Monetar Ndërkombëtar ka filluar me trajnimin e zyrtarëve të institucioneve kyqe të Kosovës në këtë fushë si Ministrisë së Financave, Bankës Qendrore të Kosovës, Thesarit të Kosovës, Entit të Statistikave të Kosovës, duke organizuar trajnime, seminare apo konferenca si brenda Kosovës ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, duke qenë të ftuar bashk me zyrtarë të institucioneve të vendeve të rajonit, Evropës etj.

2. GFS Manual

Për zbatimin e GFS në praktik, dhe për ta lehtësuar përdorimin e tij, Fondi Monetar Ndërkombëtar, e ka përpiluar një udhëzues i cili ka evaluar prej vitesh, dhe tani më i fundit është ai i vitit 2014.

Pra, raportimi në Fondin Monetar Ndërkombëtar është i bazuar në Udhëzuesin e GFS 2014. Për të pasur një mbikëqyrje fiskale, Bordi Ekzekutiv i FMN-së, vendosi që të miratojë Udhëzuesin e GFS 2001/14, si një format standard i paraqitjes së të dhënave fiskale në publikimet e Fondit

Monetar Ndërkombëtar. Udhëzuesi i GFS është një udhërrëfyes shumë i rëndësishëm i cili ju lehtëson përdorimin dhe zbatimin në praktikë të të dhënave dhe analizave fiskale për qëllime të raportimit, të gjithë atyre që dëshirojnë ta implementojnë strukturën e GFS. Këtë dobi dhe përfitim të një rëndësie të madhe e ka fatin ta ketë edhe Kosova, pasi që FMN-ja po dëshironë ta ndihmojë Kosovën edhe në fushën e të dhënave fiskale dhe mënyrën e raportimit të tyre.

Përveq Kosovës FMN është duke iu ndihmuar edhe vendeve tjera të Ballkanit. Në vijim shihet një pasqyrë e zbatimit të GFS në Kosovë dhe vendet e tjera të rajonit.

Tabela 1 . Aplikimi i GFS në vendet e Ballkanit

Vendi	Fondi Monetar Ndërkombëtar		Banka Botërore / FMN	Eurostat	
	Të dhënat fiskale të Frekuenca ve të Larta Statistikat Financiare Ndërkombëtare	Të dhënat vjetore të GFS Vjetari i Statistika ve Financiar e Qeveritar e	Të dhënat Tremuj ore të Statistika ve të Borxhit në Sektorin Publik	Procedurat e Deficitit të Tepruar (EDP)	Llogaritë e të Dhënave Kombëtare
Shqipëria	✓	✓ ①	✓ ③	✓ ④	✓ ④
Bosna dhe Hercegovina	✓ ③	✓ ①	χ	χ	χ
Kosova	χ	χ	χ	χ	χ

			χ		
Maqedonia	χ	✓ ① ③	χ	χ	✓ ④
Serbia	χ	✓ ②	χ	χ	✓ ④

- ❶ Nuk ka të dhëna të bilancit
- ❷ Vetëm të dhëna të pjesëshme të bilancit
- ❸ Mbulim i të dhënave më pak se qeveria e përgjithshme
- ❹ Pjesërisht / vetëm të dhënat jo zyrtare

3. INSTITUCIONET PJESMARRËSE

Shteti i Kosovës, konkretisht qeveria e përgjithshme, konform rregullave të GFS duhet të themelojë, definojë apo caktojë institucionet përkatëse që do të merren me mbledhjen, analizën dhe raportimin e të dhënave fiskale. Sipas Udhëzuesit 2014 të GFS, në Kosovë këto institucione pjesmarrëse do të jenë:

- a) Ministria e Financave – Thesari
- b) Banka Qendrore e Kosovës
- c) Enti i Statistikave të Kosovës


4. SEKTORI PUBLIK / KLASIFIKIMI

Sektori publik sipas strukturës së GFS, përbëhet nga të gjitha njësitë institucionale rezidente të kontrolluara direkt apo indirekt, nga njësitë e qeverisë rezidente, që nënkupton të gjitha njësitë e sektorit të qeverisë së përgjithshme dhe korporatat publike rezidente.

Kufiri i sektorit publik përcaktohet nga kontrolli e jo nga pronësia.

Tabela 2. *Sektori Publik dhe Sektorët tjerë të Ekonomisë*

Sektori i qeverisë përgjithshme	Korporatat jofinanciare	Korporatat financiare	Familjet	Institucionet jofitimpruese të familjeve
Qeveria qendrore, Qeveria shtetërore, Qeveria lokale	Korporatat Publike	Korporatat Publike, BQK	Privat	Privat
	Korporatat Private	Korporatat Private		



= Sektori Publik

Nga tabela e lartëcekur dhe nga manuali i GFS i hartuar nga FMN, shihet që në sektorin publik në Kosovë duhet të përfshihen më shumë ndërmarrjet publike, si dhe ndërmarrjet me buget ekstra si: Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekom i Kosovës, Radio Televizioni i Kosovës etj, duke krijuar kështu një bashkëpunim dhe gërshetim të sektorit publik me sektorin privat. Pra standardi i GFS i jep shumë rëndësi klasifikimit të sektorit publik, dhe e bënë më gjithpërfshirës, se sa që është aktualisht në Kosovë.

4.1. Sektori Publik dhe Komponentët Kryesorë të Tij




Figura 1. Sektori publik dhe komponentët kryesor të tij

5. TË HYRAT

Sipas procedurave të GFS të hyrat në sektorin publik duhet të klasifikohen në:

a) TAKSA

- Tatimet në të ardhura, fitime dhe fitim të kapitalit
- Tatimet sipas listës së pagave dhe fuqisë punëtore
- Tatimet në pronë (tatimet periodike mbi pasurinë e paluajtshme, pasurinë neto)
- Tatime në mallra dhe shërbime
- Taksa mbi Vlerën e Shtuar
- Taksat në transaksionet financiare kapitale dhe Tregtinë Ndërkombëtare
- Akciza

b) KONTRIBUTET SHOQËRORE

- Kontributet e sigurimeve shoqërore
- Kontributet e punëtorit, punëdhënësit, të vetë-punësuarit, të vetë-punëdhënësit

c) GRANTET

- Nga qeveritë e huaja (rrjedhëse, kapitale)
- Nga organizatat ndërkombëtare (rrjedhëse, kapitale)
- Nga njësitë e qeverisë përgjithshme (rrjedhëse, kapitale)

d) TË HYRAT TJERA

- Të ardhurat nga prona (interesi, dividendat, investimet, qiraja)
- Shitja e mallrave dhe shërbimeve (taksat administrative)
- Dënimet, gjobat dhe humbjet
- Primet, tarifrat dhe kërkesat vijuese,
- Kërkesat kapitale

6. SHPENZIMET


Klasifikimi i shpenzimeve në sektorin qeveritar në Kosovë është i përafërt me atë që e kërkon procedura e GFS. Pra, shpenzimet publike duhet klasifikohen sipas:

- a) Klasifikimit ekonomik
- b) Klasifikimi funksional

Mirëpo sipas GFS shpenzimet apo konkretisht kontabiliteti publik duhet të regjistrohet sipas parimit akrual të kontabilitetit. Pra, sektori qevritar duhet të kalojë nga parimi kontabël mbi bazën e cash-it, në parimin akrual kontabël.

Kalimi nga parimi i cash-it në parimin akrual është një ndryshim shumë i madh dhe rrënjësor, sepse parimi akrual kërkon klasifikim dhe përshkrim më detal të të hyrave, shpenzimeve, pasurive dhe detyrimeve.

Tabela 3. Llojet kryesore të pasurive financiare dhe detyrimeve



7. BORXHI I SEKTORIT PUBLIK

Borxhi i sektorit qeveritar nënkupton kërkesat financiare që kërkojnë pagesa të interesit dhe ose principalit nga debitori te kreditori në datën, apo datat në të ardhmen.

7.1 Instrumentet e Borxhit

- a) Letrat me vlerë të borxhit
- b) Kreditë
- c) Të drejtat special të tërheqjes (Special Drawing Rights)
- d) Valutat & Depozitat
- e) Pagesat e llogarive tjera
- f) Sigurimet, pensionet & Skemat Standarde të Garancisë

Tabela 4. Prezentimi i të dhënave të borxhit në sektorin publik

Nivelet e Qeverisë (NQ)	NQ1	NQ2	NQ3	NQ4	NQ5
Qeveria qendrore buxhetore					
Njësitë Ekstra buxhetore					
Fondet e sigurimeve sociale					
Qeveria shtetërore					
Qeveria lokale					
Korporatat jofinanciare të sekt.publik					
Korporatat financiare të sektor. publik					

8. KONKLUZION

Pas përfundimit të këtij hulumtimi dhe punimi shkencor disa nga konkluzionet tona janë:

- GFS është një standard ndërkombëtar për përpilimin e të dhënave fiskale me qëllim të raportimit të tyre, i cili po i ofrohet si ndihmë Kosovës nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Këtë standard sot e përdorin rreth 140 vende.
- Standardi i GFS kërkon një klasifikim më në detal të të dhënave si: sektorit publik, të hyrave, shpenzimeve, borxheve, pasurive dhe detyrimeve, me qëllim që raportimi i tyre të jetë më i klasifikuar në detaje.
- Sektori publik në Kosovë momentalisht raporton në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në bazë të cash-it, kurse sipas standardit të GFS, sektori qeveritar në Kosovë duhet të raportojë në bazë të parimit akruar të kontabilitetit, pasi që sipas këtij parimi të dhënat financiare paraqiten më në detaje dhe më të

qartësuar. Parimi akrual është shumë më i ndërlikuar se parimi mbi bazën e cash-it, andaj edhe ky ndryshim i parimit kontabël do të jetë shumë i dallueshëm, dhe esencial.

- Fondi Monetar Ndërkombëtar ka filluar me trajnimin e zyrtarëve të institucioneve gjegjëse për përpilimin e të dhënave fiskale në Kosovë, për ta adoptuar Udhëzuesin e GFS, për qëllime të raportimit të të dhënave fiskale.
- Sektori publik në Kosovë mendojmë që ende nuk është në gjendje të duhur profesionale për kalimin në parimin akrual të raportimit. Andaj ky kalim do të duhet të bëhet në mënyrë graduale, dhe të trajnohen profesionalisht zyrtarët që janë të lidhur me këtë proces.
- Në përpilimin e të dhënave financiare, fiskale apo konkretisht në tërë sektorin publik në Kosovë duhet të përfshihen edhe korporatat publike financiare dhe jo financiare, si dhe Banka Qendore, e cila edhe ashtu është faktor i rëndësishëm në këtë aspekt.
- Qeveria e Kosovës duhet të hartojë udhëzues, rregullore dhe procedura për të gjitha elementet të cilat i trajton standardi i GFS. Po ashtu duhet ta thellojë bashkëpunimin me organet kompetente të FMN-së, Bankën Botërore dhe institucionet tjera kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me këtë fushë të qeverisjes.

REFERENCAT

1. “Government Finance Statistics Manual 2014”, International Monetary Fund;
2. “Public Sector Debt Statistic”, International Monetary Fund, The World Bank for International Settlements ;
3. “Manual on Government Deficit and Debt”, Eurostat, 2014 Edition, ISSN 2315-0815

4. International Accounting Standard, International Federation of Accountants
5. Ligji Nr.03/L-175, Për Borxhet Publike, Kuvendi i Kosovës, Dhjetor 2009
6. Rregullore QRK - NR. 22/2013 MBI PROCEDURAT PËR EMETIMIN DHE MENAXHIMIN E BORXHEVE SHTETËRORE, GARANCIVE SHTETËRORE DHE BORXHEVE KOMUNALE, Qeveria e Republikës së Kosovës, 2013.

Increase timing performance of a Java application using multithreaded programming

Genta Rexha¹, Kliv Shaplo², Igli Tafa²

¹University of Elbasan, Faculty of Economy, Department of Marketing and Engineering

²Polytechnic University of Tirana, Faculty of Information Technology, Department of Computer Engineering

Abstract

In this paper is introduced a comparison of the application's performance, once programmed through multiple threads and once programmed through only one thread to complete a specified task. The application will download 15 images from a website and will count, in the two cases, the necessary time. The application will compare them and will lead to a conclusion of an evident time increasing performance, which for the end user means a faster application.

Keywords: Timing performance, process, thread, recourse management, CPU, task, single-threaded, multiple-threaded.

1. INTRODUCTION

The earlier computers could support only one processor, as the heart of their system. This means that the performance in executing programs and different applications was limited only by the hardware capabilities of that CPU. So, if there are two programs that needed to run, the CPU had to switch execution time between them, resulting to something that the user calls multitasking [1]. In order to have true multitasking or true parallelism, one single microprocessor isn't enough; two or more cores are needed. So,

applications execution time is no more sliced by one CPU, but different CPU execute different programs, all at the same time, in a parallel way. This resource allocation is done all by the Operating System, using special algorithms.

It is not the intention of this paper to go deeper in this subject, because here will be expounded how a Java programmer [2, 3] must profit by these technology facilities, how to create a program that executes in a parallel way that solves independent tasks not one after the other, but all at the same time. Here comes the concept of multithreading [4, 5]. One special task is done by one special thread.

Below are explained some terms that are used in this work.

Process – is a program in execution.

Thread – refers to a sequence of instructions executed inside the context of a process.

Application-level threads – threads which are managed by threads libraries in user's space.

Task – work that should be performed.

2. Threads and multithread concept

As mentioned above, a process is a program in execution and it can be divided into a number of individual or special parts that are called threads. So, a process may be thought as an only one thread in the case of single-threading or as a group of threads in the case of multi-threading [6, 7]. This concept is shown in Figure 1.

Figure 1 Single-threading (a), multi-threading (b)

The interesting thing on programming in a multi-threaded way is that thread-based multitasking has some great advantages:

1. Threads share the same address space, processes not

2. Inter-thread communication is inexpensive
3. Switching between threads is inexpensive.

At the end of the day, using multithreaded programming, these global results are obvious to the user of the application:

- Improvement of performance
- Improvement of program structure
- Improvement of application responsiveness
- Improvement in processors efficiency.

3. Threads in Java

Java is a powerful programming language; it is based upon processes as the architecture construct of the application [8, 9]. Processes may include one thread or multiple threads that share the same memory space, state and variables. In Java threads are objects and can be created in two different manners: one way is by implementing the `java.lang. Runnable` interface and the other way is by extending the `java.lang. Thread` class [10, 11].

In the figures below, are represented these methods by them snippet code.

Figure 2 Extending Thread class

Figure 3 Implementing Runnable interface

Each of these solutions has its own advantages. Applying the `Runnable` interface gives more flexibility on extending other base classes, but extending the `Thread` class gives a full control over the thread life cycle. Both of this use the `run()` method, which need to be overridden by the code that the new thread, after creation, needs to execute.

By the way, it's important to mention something about a thread life cycle in Java.

Figure 4 Thread life-cycle

Threads might be in five different states which are controlled by JVM [12]. They are listed below:

1. New – this is a just born thread; the program hasn't yet started the thread.
2. Runnable – in this state, the thread is considered to execute his task, after the program has started the thread
3. Waiting – this is a transitory state, while the thread is waiting for another thread to finish something.
4. Timed waiting – threads enter in this state for a specified amount of time from the runnable state. When the time interval expires the thread goes back to the runnable state.
5. Terminated – thread enters in this state after completing its task.

The developing process of this small app doesn't make use of the extension of other Java classes, but needs a little bit of thread control, so during coding is used extending the Thread class.

4. Application's theory

The application that is developed (the environment used is Eclipse) aims to speed up the time needed to download images from a specific website, but it is flexible for downloading images also from different sites. The site that's chosen is an Albanian e-commerce website **<http://www.123.al>**. A table of URLs is constructed for 15 images to be downloaded. Every table element contains an image URL. Every download is conceived like a thread task.

The idea is that are created two Java classes, one that supports only one thread and one that supports more than one thread (multi-threads). The first script when executes, creates a thread which task is to iterate through the URLs table and download the image that addresses each URL. Is measured the time when thread began running and the time it terminated, meaning that all images were downloaded. Getting time is done by the Java language

method `System.currentTimeMillis()`. The second script, the multi-threaded one, creates 15 threads for 15 images to download. So each download is a different thread task, in this way are created 15 parallel tasks (downloads). The time in milliseconds, when the first thread began working and the time, when the last thread finished working are measured. The difference between the two gives the time needed for this small multithreading app to end its job. Figure 5 and Figure 6 give an example of the application output in the two cases.

Figure 5 Single-thread application output

Figure 6 Multi-thread application output

As it is clear by the screenshots, in the case of a multithreaded app, it produces a huge time profit and a faster app. In the last situation a barrier concept is used, which means that the main thread creates and starts a number of processing threads and then waits for them to finish. The main thread waits in a barrier. A public function is constructed in a file `Lock.java`, where are counted all running threads. In the following screenshot are presented the lines of the code which create the barrier.

Figure 7 The barrier concept

First, the main thread waits (stays inside the while loop, the barrier), for all thread to execute and then terminates the program. In Figure 8 is given the full multi-threaded source code in Java.

Figure 8 Multi-threaded source code in Java

Here is not shown the source code for the single-threaded application, being it simpler, because it doesn't have a barrier concept.

5. Experiment statistics

After explaining some important points of the work and the source code, the statistics about the program execution and timing performance are given.

Different downloads are done with 15, 30, 45, 60, 75 and 90 images and their download time is measured, as shown in the tables below:

Table 1: Download time of a single-threaded app

Table 2: Download time of a multi-threaded app

It is important to note that sometimes, for example, if the same download is executed more than once (same number of pictures and same code), download time may differ with a specific amount of milliseconds. This is explained only by the fact of a changing network load in time, that affects downloading speed and packets forwarding. Figure 9 makes the comparison between the two tables more visible, where the X axis presents the number of images to download and the Y axis is the time in milliseconds.

Figure 9 Time comparison Chart

CONCLUSION

Analyzing the data given in Table 1 and 2 and observing their presentation in Figure 9, it's quite obvious that the multithread version of the application is faster. **The timing performance is increased nearly by a factor of 6.** This means, that building a nearly parallel functional application, is very important and will have a great feedback from the user. Even that programming with multithreads that run concurrently to solve a specific task has this massive time profit and an improved structural frame of the app, improved responsiveness etc, here arises two problems that are typical for programs with more lines of code and more complex that the one shown in this paper.

One problem is the **read/write problem** and the second one is the **producer and consumer problem**. The first has to do with the fact that one thread tries to update the data that one other thread is reading. This leads to an inconsistent state of the shared data and the only solution is the

synchronization of the thread access in the data. The second problem with threads has to do with two threads that put and read data from a buffer. What arises here is that it must be provided a way that a thread can't read an empty buffer and can't write on a full one.

Saying all that, must be accepted that programming with threads is necessary, sometimes inevitable, but it needs caution, because complexity increases and new problems should be prevented.

FIGURES




Figure 10 Single-threading (a), multi-threading (b)

```
import java.lang.*;  
  
class Example extends  
Thread {  
  
    public void run()  
    {  
  
        // body of  
execution  
    }  
  
}
```

Figure 11 Extending Thread class

```
import java.lang.*;  
class Example implements  
Runnable {  
  
    public void run()  
  
    {  
  
        // body of  
execution  
  
    }  
  
}
```

Figure 12 Implementing Runnable interface




Figure 13 Thread life-cycle

**Getting 15 imgs by one thread
Application terminated in 5629 ms**

Figure 14 Single-thread application output

**Getting 15 imgs by multiple threads
Application terminated in 900 ms**

Figure 15 Multi-thread application output


```

time1 =
System.currentTimeMillis();

for (String address: ings) {

DownTh thr = new DownTh(address,
destF + "multi" + (ind++) +
".jpg", lkVar);
thr.start();}
while (lkVar.getActiveTh() > 0)

        synchronized
(lkVar) {

                lkVar.wait();

}
time2 =
System.currentTimeMillis();
System.out.println("\tApplication
terminated in: " + (time2-time1)+"
ms");
}
catch(Exception e){
}
}
}
    
```

Figure 17 Multi-threaded source code in Java




Figure 18 Time comparison Chart

TABLES

Images number	Times in milliseconds
15	5629 ms
30	10654 ms

45	15463 ms
60	27144 ms
75	33086 ms
90	39066 ms

Table 1 Download time of a single-threaded app

Table 2 Download time of a multi-threaded app

Images number	Times in milliseconds
15	900 ms
30	1407 ms
45	2141 ms
60	4059 ms
75	4510 ms
90	6203 ms

References

- [1] D. Geer, *Chip Makers turn to Multicore Processors*, Computer, Vol. 38, Issue 5, pp. 11 – 13, 2005
- [2] T. Kielmann, P. Hatcher, L. Bouge, H. E.Bal, *Enabling Java for high-performance computing*, Communications of the ACM, Vol. 44 No. 10, Pages 110-117, 2001.
- [3] J. Block, *Effective Java*, Java Series, 2nd edition, 2008.
- [4] Y. Lin, *Multithreaded Programming, Current practices, challenges, languages/tools support*, System Group, Sun Microsystems, 2006
- [5] Kuo-Yi Chen, J. Morris Chang, Ting-Wei Hou, *Multithreading in Java: Performance and Scalability on Multicore Systems*, IEEE Transactions on Computers, Vol. 60, Issue 11, pp. 1521 - 1534, 2011.

[6] B. Sand, *Coping with Java Threads*, IEEE Computer, Vol. 37, N. 4, pp. 20-27, 2004.

[7] R. Milner, *Communication and Concurrency*, Prentice Hall, 1995

[8] B. Goetz, T. Pierels, J. Bloch, J. Bowbeer, D. Holmes, D. Lea, *Java Concurrency in Practice*, 2006.

[9] M. Lathia, *Book reviews: the new wave - concurrent programming*, IEEE Distributed Systems Online, 7(4), 2006.

[10] V. K.Garg, N. Mittal, *A critique of Java for concurrent programming*, IEEE distributed systems online, Vol. 6, No. 9; pp. 1541-4922, 2005.

[11] D. Holmes, *Concurrent Programming in Java: Language and Libraries*, 25th International Conference on Technology of Object-Oriented Languages and Systems, 24-28 November 1997, Melbourne, Australia, IEEE Computer Society 1997.

[12] Y. Wen, J. Zhao, M. Huang, H. Chen, *Towards Detecting Thread Deadlock in Java Programs with JVM Introspection*, IEEE 10th International Conference on Trust, Security and Privacy in Computing and Communications (TrustCom), pp. 1600 – 1607, 2011.

BRAND IDENTITY- CASE STUDY OF TELEVISION PLATFORM “DIGITALB”

Assoc. Prof. Dr. Vjollca HYSI (PANAJOTI)

University of Tirana, Faculty of Economy, Head of Marketing Department,
email: vjollcapanajoti@feut.edu.al

Dr. Irma SHYLE,

Polytechnic University of Tirana, Department of Production and
Management, email: irmitash@yahoo.com

Abstract

